



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË
AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

**RAPORT AUDITIMI
FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIE
NË
AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË**

MAJ 2024



Përmbajtja	Faqe
I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	
1.Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	3-8
2.Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	
3.Konkluzioni i përgjithshëm dhe opinionimi i auditimit	
II. HYRJA	
-Objekti i auditimit	
-Qëllimi i auditimit	
-Identifikimi i çështjes	
-Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	11-14
-Përgjegjësitë e audituesve	
-Kriteret e vlerësimit	
-Standardet e auditimit	
Metodat e auditimit	
Dokumentimi i auditimit	
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	
-Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	15
1. Mbi funksionimin e organeve drejtuese te Akademisë.	16-27
2. Mbi hartimin dhe Zbatimin e Buxhetit të Shtetit.	27-35
3. Mbi pasqyrat financiare të Institucionit.	35-111
4. Mbi administrimin e pronës shtetërore. Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare	112-136
5. Zbatimi i dispozitave ligjore për marëdhëniet e punës dhe pagave.	136-144
6. Prokurimet e fondeve publike.	144-176
7. Vlerësimi i sistemeve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit	176-190
8. Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme.	194-202
9. Probleme të ndryshme që mund të dalin gjatë auditimit.	202-226
IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET	202-226
V. ANEKSE	226



I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Mbështetur në Ligjin 154/2014 Datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 959/1 prot., datë 07.11.2023, i ndryshuar, nga data 07.11.2023-15.01.2024 për periudhën nga 01.01.2020 deri më 31.12.2023, u krye auditimi financiar dhe i përputhshmërisë në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. I.S, (përgjegjës grupi)
2. A.K, Auditues
3. A.M, Auditues
4. A.H, Auditues.

Auditimi u krye mbi bazën e riskut.

Për përfitimin e rezultateve të auditimit, grupi i auditimit u mbështet mbi dy elementë: në sistemin e kontrollit të brendshëm dhe në punën konkrete mbi evidencat e auditimit, por kryesisht mbi këtë të fundit. Audituesit janë kujdesur që evidencat me të cilat kanë punuar për të argumentuar rezultatet e auditimit, të plotësonin tre cilësi: të ishin të përshtatshme (të kishin lidhje me çështjen që auditohej), të besueshme (burimi nga vjen evidenca të ketë besueshmëri) dhe të mjaftueshme (sasia e evidencës të jetë e mjaftueshme për arritjen e konkluzioneve të auditimit). Në përfundim të punës audituese në terren, nga grupi i auditimit janë mbajtur dhe protokolluar në subjekt aktet e konstatimit dhe pas kryerjes së takimit përmbyllës mes palëve nga subjekti u paraqitën kundërshtitë për aktet e mbajtura. Pas hartimit të akteve të konstatimit dhe projektraportit, nga subjekti i audituar janë bërë kundërshtitë, të cilat janë trajtuar nga grupi i auditimit dhe janë bërë pjesë të materialit në projektraport dhe në raportin përfundimtar të auditimit.

2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca me raportin përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
	Gjatë auditimit në terren, për gjithë periudhën objekt auditimi, nuk është vendosur në dispozicion asnjë dokumentacion për sa i përket përgatitjes së projekt - buxhetit vjetor, si një nga detyrat funksionale të Kryesisë. Për vitin 2021, nuk rezulton asnjë dokument i mbledhjeve të kryera nga GMS, ku pjesë e saj janë edhe anëtarët e Kryesisë, për përgatitjen e projekt-buxhetit vjetor. <i>Për periudhën 2022-2023, u konstata se në përfundim të takimeve të kryera nuk janë mbajtur protokollat e mbledhjeve për vendimet respektive të çdo mbledhjeje, të cilat duhet të ishin regjistruar nga sekretari dhe të vendoseshin në dispozicion të drejtimit të njësisë publike, veprime në kundërshtim me nenin 27 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.</i>		E lartë	Të merren masa nga titullari i institucionit, që Kryesia në përmbushje të detyrave funksionale të saj, të bëjë hartimin e projekt – buxhetit, si dhe mbajtjen e protokolleve respektive me qëllim sigurimin e gjurmës së auditimit e më pas të bëjë kalimin për miratim nga Asambleja.
	Nuk ka gjurmë dokumentacioni për veprimtarinë e 3(tre) njësisë dhe komisioneve të ngritura pranë Akademisë së Shkencave. Gjatë auditimit është konstatuar se Seksioni i Shkencave Natyrore e Teknike ka dërguar informacion mbi komisionet e biologjisë,			Të merren masa nga titullari i institucionit, që Kryesia të ketë një bashkëveprim mes strukturave të ngritura pranë saj,



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQPËRISË

	<p>bujqësisë, veterinarisë, fizikë - kimisë, matematikë - informatikës, të mjekësisë dhe të inxhinierisë, për sa i takon veprimtarisë dhe funksionimi të tyre. Ky informacion është dërguar për periudhën janar - qershor 2021 me nr. 489 prot., datë 13.07.2021, po ashtu edhe për periudhën korrik - dhjetor 2021 me nr. 802 prot., datë 23.12.2021.</p> <p>Nga auditimi u konstatua, se nuk rezulton më asnjë korrespondencë mbi ndjekjen dhe organizimin e punës për këto seksione për periudhën janar-dhjetor 2022 dhe janar-dhjetor 2023.</p>		mbi organizimin dhe ndjekjen e punës së tyre.
	<p>Nga auditimi konstatohet se në rendin e ditës të miratuar nga kryetari me nr. 421 prot., datë 17.06.2021, <u>nuk janë planifikuar diskutimet për miratimin e disa amendamenteve në Statut dhe në rregulloren "Për çmimet shkencore që akordohen nga Akademia e Shkencave dhe për mënyrën e organizimit të konkurseve të tyre"</u>, veprim ky në kundërshtim me nenin 8, pika 1 e Ligjit Nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike".</p> <p>Me Vendimin e Asamblesë nr. 47, datë 21.07.2021, vendim qarkullues, janë miratuar amendimet e Statutit, në kundërshtim me nenin 27, pika 1, të Statutit, ku nuk përfshihen në vendime qarkulluese të Asamblesë ndryshimet e amendamenteve në Statut. Pra ky vendim është marrë në kundërshtim me përcaktimet statutore.</p> <p>Gjatë auditimit është konstatuar se për mbledhjen e kryer në 09.07.2021 nuk ka një procesverbal të mbledhjes, kjo në kundërshtim me nenin 16 të Ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999, duke pasur në vëmendje rëndësinë e mbledhjes për ndryshimet e ardhura të Statutit të institucionit. Mos mbajtja e procesverbalit të mbledhjeve është një fenomen i përhapur gjatë mbledhjeve të Asamblesë.</p> <p>Gjatë vitit 2021, Kryetari ka miratuar vendimin e Asamblesë nr. 49, datë 23.07.2021. Me këtë vendim miratohet ngritja dhe riorganizimi i rrjetit të instituteve të shkencave albanologjike ndërmjet kalimit pranë Akademisë së Shkencave të instituteve ekzistuese të Akademisë së Studimeve Albanologjike (ASA): të Institutit të Historisë, të Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë, të Institutit të Antropologjisë Kulturore dhe Studimeve për Artin, të Institutit të Arkeologjisë.</p> <p>Gjatë auditimit është konstatuar se nuk ka një relacion arsyetues nga Kryesia, mbi riorganizimin e këtyre instituteve, duke pasur në vëmendje se marrja e një vendimi qarkullues, formulohet dhe propozohet nga kryesia dhe më pas u përcillet anëtarëve për konfirmim. Po ashtu nuk ka dokumentacion shoqërues që konfirmon shprehjen e dakordësisë së anëtarëve në rrugë elektronike në kundërshtim me nenin 27, pika 2 e Statutit. Vendime të tilla nuk përfshihen në fushën e vendimeve qarkulluese, pasi ato përfshijnë çështje të cilat kanë më shumë rol këshillues e ratifikues dhe jo riorganizim të instituteve, veprim ky në kundërshtim me nenin 27, pika 1 e Statutit.</p> <p>Me vendimin nr.5, datë 29.01.2021, Kryesia shpall njoftimin për 5 vendet e lira për konkurrim për anëtarët e rinj në Asamblesë e ASHSH. Me Vendimin nr.12, datë 02.02.2021 të Kryesisë është shpallur i njëjti vendim me Vendim nr.5, datë 29.01.2021.</p>	E lartë	Të merren masa nga titullari i institucionit, që për të gjitha vendimet e Asamblesë të dokumentohet qartë dhe të protokollohen të gjitha materialet e veprimtarisë së saj.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQPËRISË

<p><u>Konstatohet se ka dy vendime me të njëjtën përmbajtje.</u> Në vijim të vendimit të parë, atij me nr.05, datë 29.01.2021, Kryesia me shkresën nr.85/1 prot., datë 02.02.2021, paraqet kriteret e plotësimit për kandidaturat, vendos afatet për paraqitjen e interesit për konkurim, afatin për shqyrtimin e plotësimit të kriterëve ligjore nga Komisioni Teknik, afatin e vlerësimit nga njësia bazë universitare a kërkimore, si dhe afatin e shqyrtimit të kandidaturave në komisionet dhe seksionet shkencore të ASH. Ndërkohë kryesia nuk ka përcaktuar anëtarët komisionit teknik, kjo në kundërshtim me nenin 7, pika 6 e Statutit. Në vijimësi Kryesia del me vendimin nr.20, datë 16.03.2021 për shtyrje afati të regjistrimit të kandidatëve që konkurrojnë për praninë si anëtarë, por duke ju referuar vendimit të dytë me nr.12, datë 02.02.2021, ku kërkohet të shtyhet afati deri më 31 mars 2021. <u>Konstatohet një mungesë koherence dhe mos përputhje mes vendimeve të Kryesisë për të njëjtin fakt.</u> Me vendimin nr.25, datë 07.04.2021 ka vendosur miratimin për vijimin e procedurës për kandidatët të cilët kanë aplikuar. Për këtë procedurë nuk ka më asnjë gjurmë dokumentare mbi vijimin e procedurës.</p> <p>Grupi i auditimit konstaton se në vitin 2022, Kryesia del me Vendim nr.22, datë 12.04.2022 për disa fusha të reja konkurimi për anëtarë të rinj të Asamblesë. Komisioni teknik i verifikimit me shkresën nr.452 prot., datë 21.06.2022, ka verifikuar dhe shqyrtuar dosjet e kandidaturave të paraqitura për konkurim. Në vijim të procedurës, Kryesia ka dalë me vendim nr.62, datë 24.10.2022, ku vendos të miratojë vijimin e procedurës së konkurrimit për kandidatët që plotësojnë kriteret e parashikuara dhe vendos të mbyllet ky proces brenda datës 25.11.2022. Me Vendim nr.01, datë 04.01.2023 është thirrur mbledhja vjetore e Asamblesë me datë 30.01.2023, ku në rendin e ditës ishte parashikuar zgjedhja e anëtarëve të rinj të Asamblesë. Nuk ka një procesverbal mbledhje kjo në kundërshtim me nenin 16 të Ligjit nr.8480/1999.</p>			
<p>Nga auditimi i hartimit dhe zbatimit të buxhetit të ASHSH u konstatuan mangësitë si më poshtë:</p> <p>-Për vitin 2021: Programi 01520 “Veprimtari Akademike” është realizuar në masën 57%, pra në vlerën 125,178 mijë lekë, kundrejt 218,361 mijë lekë të planit të periudhës/progresiv, ose me një mosrealizim në vlerën 91,753 mijë lekë kundrejt planit përfundimtar.</p> <p><u>Shpenzimet korrente</u> janë realizuar në masën 56 %, me një mosrealizim në vlerën 92,841 mijë lekë kundrejt planit të rishikuar. Në shpenzimet totale të realizuara, shpenzimet korrente zënë peshën kryesore prej 95%. Konkretisht në llogarinë 602 “Mallra e shërbime” ka një mosrealizim prej 91,753 mije lekë.</p> <p><u>Në llogarinë 604 “Transferta Korrente të Brendshme”</u> ka një mosrealizim prej 877 mijë lekë, ose 12% të fondit të përlllogaritur. Llogaria 604 ka qenë në vitin 2020 820 mijë lekë, plani i PBA për vitin 2022 1,000 mijë lekë dhe realizimi 12%. Kjo tregon që 86% e llogarisë 604 nuk është realizuar, gjë që tregon problematika në planifikimin e buxhetit.</p> <p>-Raportet e monitorimit të buxhetit për vitin 2021 janë dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në zbatim të Udhëzimit</p>		<p>E lartë</p>	<p>Të gjitha hallkat e ASHSH të bashkëpunojnë në fazën e hartimit të projektbuxhetit për të shmangur realizimin e tij në përqindje të ulët dhe rialokime të shpeshta gjatë vitit. Kjo mund të bëhet me anë të mbledhjeve të ndryshme mes Sektorëve, me anë të kërkesave të Njësive për projektet që do të zhvillohen të cilat duhet të dokumentohen.</p> <p>Strukturat përgjegjëse të ASHSH të marrin masa për përgatitjen brenda afateve të përcaktuara në ligj të raporteve të monitorimit 4 mujore dhe vjetore të zbatimit të buxhetit, të cilat i japin mundësinë institucionit të përmirësojë procesin e</p>



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQPËRISË

<p>nr. 22, datë 27.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”, konkretisht:</p> <p>- Raporti i monitorimit 4–mujor për zbatimin e buxhetit është dërguar me shkresën nr. 47, prot datë 16.06.2021, 17 ditë me vonesë, në kundërshtim me afatin përcaktuar në Udhëzimin nr. 22, datë 27.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”.</p> <p>Raportet e monitorimit të buxhetit për vitin 2022 janë dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në zbatim të Udhëzimit nr. 22, datë 27.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”, konkretisht:</p> <p>- Raporti i monitorimit 12–mujor për zbatimin e buxhetit të vitit 2022 është dërguar me shkresën nr. 165 prot., datë 02.03.2023, 2 ditë më vonë se afati i përcaktuar në Udhëzimin nr. 22, datë 27.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”.</p>		planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit.
<p>Nga auditimi u konstatua se:</p> <p>Nga ana e ASH, për të dy vitet objekt auditimi, të ardhurat e trashëguara nuk rakordohen me degën e thesarit dhe mungon argumentimi i tyre në formatin e akt rakordimit.</p> <p>Sa më sipër rezulton se nuk janë kryer veprimet rregulluese dhe përmbyllëse të fundit të periudhës nga ana e ASH duke operuar në kundërshtim me UMF nr.8 datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore të Njësitë të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar.</p> <p>Për vitin 2021 llogaria 12 “Rezultatet e mbartur” me vlerë totale prej 9,126,323 lekë, nuk rezultonte e argumentuar me të ardhurat në likuiditete në llogarinë financiare të disponibiliteteve, si dhe me të drejta të konstatuara por të pa arkëtuara në periudhat përkatëse ushtrimore në kundërshtim me UMF nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Paragrafi Funksionimi i llogarisë 12 ”Rezultati i mbartur”.</p>		<p>E lartë Nga ana e Akademisë së Shkencave, sektori financës, të merren masa për kontabilizimin në trajtën e regjistrimit dyfish me kundërparti diferencat nga përdorimi i sponsorizimeve në llogarinë 85 “Rezultati i ushtrimit”, kurse diferenca si rezultat i ushtrimit të mëparshëm të pasqyrohen në llogarinë 12 “Rezultat i mbartur”, për një pasqyrim më të drejtë të kundërpartisë së disponibiliteteve në thesar, me qëllim që të parandalohen gabimet apo parregullsitë e mundshme në interpretimin e llogarive të pasqyrave financiare.</p> <p>Nga ana e Akademisë së Shkencave, sektori financës në kushtet kur llogaria 12 “Rezultat i mbartur” pasqyron rezultatin e viteve të kaluara mbetur të papërdorur me të drejta të paparashikueshme për ta përdorur në vitin korrent, të merren masa për të kryer argumentimin e saj si dhe me të drejta të konstatuara por të pa arkëtuara në periudhat përkatëse ushtrimore.</p>
<p>Nga auditimi u konstatua fenomen i përsëritur për të dy vitet, (2021 – 2022) mbi rakordimin e vlerave mes situacionit të shpenzimeve paraqitura në akt-rakordimin me degën e thesarit Tiranë, “Shpenzimet korrente” dhe ato të pasqyruara në pasqyrat</p>		<p>E lartë Nga ana e Sektorit të Financës të kryet rakordimi dhe unifikimi i vlerave të paraqitura në pasqyrat financiare me vlerat e</p>



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

<p>financiare për llogaritë e shpenzimeve. Për vitin 2021 u konstatua diferencë prej 88,529 lekë dhe për vitin 2022 u konstatua një diferencë prej 9,468,967 lekë.</p> <p>- Në relacionin e pasqyrave financiare apo në shënime shpjeguese, mungon argumentimi lidhur me shifrat e rakorduara me thesarin dhe vlerat që përfshihen në deklaratat financiare, si dhe mungon shpjegimi mbi këto diferenca. Sa më lart është në kundërshtim me UMF nr. 24128, datë 27.12.2011 “Procesimi i transaksioneve në fund të vitit” dhe UMF nr. 9, datë 20.03.2018 “Procedura standarde e zbatimit të buxhetit”, Kreu III, “Procedurat për kryerjen e shpenzimeve publike”, nënkapitulli “Marrja e angazhimeve dhe kryerja e shpenzimeve publike” dhe UMF nr. 8, dt. 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 37 – 39.</p> <p>Nga auditimi mbi rakordimin zë për zë të vlerave mes situacionit të shpenzimeve dhe ato të pasqyruara në pasqyrat financiare rezultojnë se:</p> <p>✓ për të dy vitet nga ana e ASH në totalin e llogarisë së shpenzimeve operohej duke shtuar edhe llogarinë 63 “Ndryshim i gjendjes së inventarit” në total të shpenzimeve me qëllim nxjerrjen e rezultatit final të tyre,</p> <p>✓ për vitin 2021 në pasqyrën e performancës financiare (PASH) nuk rezultonte me vlerë llogaria 604 “Transferime korrente të brendshme” ndërkohë që në situacionin e thesarit kjo llogari përmban vlerë (konkretisht 122,740 lekë)</p> <p>Nga krahasimi mes pasqyrave dhe situacionit të shpenzimeve, u konstatua ndryshim tjetër ishte sa i takon veprimeve me llogarinë 231, llogari e cila në pasqyra financiare rezultojnë pa vlerë (në shënime shpjeguese nuk jepet informacion se për çfarë është çelur kjo llogari apo për çfarë është përdorur) ndërkohë në situacionin me thesarin përmban vlerë (konkretisht, 4,745,046 lekë).</p>		<p>paraqitura në aktet e rakordimit me degën e thesarit duke argumentuar në shënime shpjeguese se çfarë përfshihet në shifrat e rakorduara me thesarin dhe çfarë vlerash përfshihen në deklaratat financiare.</p>
<p>Nga auditimi në terren për projektet e financuara nga Akademia u konstatua se:</p> <p>- Në Akademinë e Shkencave në 3 raste, rezultojnë që nuk kanë gjetur zbatim përcaktimet e nenit 45 “Njësitë afatshkurtra”, pika 2 i Statutit të ASH miratuar me Vendim të Asamblesë nr. 22, datë 18.10.2019, i ndryshuar, pasi nuk ka raportime mbi statusin e secilës fazë të studimit, si dhe mungon një preventiv për të argumentuar nevojat financiare (respektive nga secili projekt për secilën fazë) me qëllim miratimin e vijueshmërisë apo jo të tyre;</p> <p>Për projektet e Qendrës Kërkimore Nanoteknologjike NanoAlb, që shtrijnë veprimtarinë përkatësisht në laboratorët e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, laboratorin e Fizikës në Universitetin Politeknik të Tiranës dhe në disa universitete në Kosovë, referuar të dhënave vendosur në dispozicion të audituesve rezultojnë se janë kryer 5 projekte, për periudhën 2022-2023 të cilët mbajnë statusin në proces, me vlerë totale të shpenzimeve deri në fund të vitit 2023 prej 9,048,239 lekë.</p> <p>1.1 Gjetje nga auditimi:</p> <p>Nga auditimi mbi raportet e dërguar në ASH nga ana e ekipit të punës mbi projektin “Studimi sero-epidemiologjik i Gjendjes imunitare ndaj virusit SARS-CoV-2 në popullatën shqiptare”,</p>	<p><i>E lartë</i></p>	<p>Nga ana e Akademisë së Shkencave të merren masat:</p> <p>- Të analizohen pagesat në vlerën 21,063,732 lekë, të kryera për “Studimi sero epidemiologjik të gjendjes imunitare ndaj virusit SARS-COV-2 në popullatën shqiptare” SEROIMUNE, duke argumentuar nevojat dhe nxjerrjen e përgjegjësisë konkrete.</p> <p>- Të analizohen pagesat e kryera deri në fund të vitit 2023 në vlerën prej 2,323,798 lekë për projektin pilot “Përzgjedhja e materialit bimor të kumbullës, të kontrolluar nga viruset sipas protokollit, për krijimin e impiantit pilot nëpërmjet shëndetësisë dhe mikroshtetit, në funksion të</p>



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQPËRISË

<p>drejtuar nga z. G.S, përfunduar të 4 fazat e studimit me kosto totale prej 24,163,492 lekë:</p> <p>- Mungon gjurma e administruar e komunikimit me institucionet përgjegjëse (Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Instituti Shëndetit Publik apo institucione të tjera të cilat u morën me menaxhimin e pandemisë) për të koordinuar punën apo dhënë orientime/sugjerime referuar studimit, përcaktuar në projekt propozimin për studimin “Faza e III e studimit të seroprevalencës së antitropave, anti-SARS-CoV-2 si dhe e përgjigjes imunitare ndaj këtij virusi në popullatën shqiptare”, datë 05.11.2020; pika 1 “Rëndësia e studimit”, paragrafi 2.</p> <p>1.2 Gjetje nga auditimi:</p> <p>Nga auditimi mbi dokumentacionin justifikues lidhur me projektin pilot “Përzgjedhja e materialit bimor të kumbullës, të kontrolluar nga viruset sipas protokollit, për krijimin e impiantit pilot nëpërmjet shëndetësisë dhe mikroshumimit, në funksion të fillimit të certifikimit të materialit mbjellës, VITROCERT” drejtuar prej zj.E.K, udhëheqëse e projektit, kosto paraprake e tij deri në fund të vitit 2023 është 2,323,798 lekë.</p> <p>Ka përfunduar faza e parë në v.2022 me vlerë 867,600 lekë ka vijuar me statusin në proces faza e dytë deri fund vitit 2023 me vlerën 1,456,198 lekë u konstatua se:</p> <p>- Në përfundim të fazës së parë, “Vitrocet 2 - 2022” <u>nuk rezulton gjurmë dokumentare e rezultatit final (raport)</u> nga ky projekt.</p> <p><i>Në kushtet e mungesës së dokumentacionit justifikues bazë, argumentues dhe të domosdoshëm në aspektin e dokumentimit financiar vlera prej 23,387,530 lekë (21,063,732 lekë për projektin e Seroimunologjisë, 2,323,798 lekë për projektin Vitrocet) përbëjnë shpenzim jo efektiv të buxhetit të shtetit. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.3 faqe 35-111 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).</i></p>		<p><i>fillimit të certifikimit të materialit mbjellës, “VITROCERT”, duke dokumentuar gjurmë dokumentare e rezultatit final (raport) nga ky projekt.</i></p> <p><i>- Në bashkëpunim me njësitë e kërkim-studimit dhe qendrat kërkimore e studimore të unifikohet dhe normohet mënyra e raportimit të aktiviteteve, ku në mënyrë të veçantë të raportohet sipas dokumentacionit për pjesën financiare të ecurisë së projekteve kërkimore-shkencore që zbatohen nga ana e ASH.</i></p> <p><i>- Të rishqyrtohet kuadri ligjor e nënligjor, aktet rregulluese për të riparë dhe formalizuar pronësinë intelektuale sa i takon projekteve/studimeve të zbatuara me fondet e ASH dhe jo vetëm, dhe që hartohen nga ana e stafit shkencor.</i></p>
<p>Nga auditimi i dokumentacionit justifikues mbi projektin “ArkeoBylis – gërmime metoda gjeofizike i agorasë së Bylisit” drejtuar nga z.N.C, udhëheqës i projektit, me kosto totale prej 2,821,434 lekë u konstatua se:</p> <p>- Mungesë e informacionit lidhur me personat/punëtorët që ishin pjesë e këtij studimi, si në numër personash po ashtu edhe në trajtë nominale për të verifikuar se për cilët është kryer pagesa.</p> <p>- Në raportin e dërguar në ASH për veprimtarinë e projektit Arkeobylylis 2023 nuk rezulton që ky raport të përmbajë ekstremitete të regjistrimit (vetëm nënshkrimi i drejtorit ekzekutiv pa numër protokollit, datë).</p> <p>- Nuk ka <u>asnjë rezultat final të dokumentuar</u> nga ky projekt, apo gjurmë e publikimit të rezultateve të studimit.</p> <p><i>Në kushtet e mungesës së dokumentacionit justifikues bazë dhe të domosdoshëm vlera prej 2,821,434 lekë përbën përdorim jo efektiv të fondeve të buxhetit të shtetit.</i></p>		<p>E lartë</p> <p>Nga ana e Akademisë së Shkencave të merren masat për analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjëse, plotësimin dhe dokumentimin e praktikave dokumentare duke shmangur mangësitë dhe boshllëqet ligjore si dhe argumentim, dokumentim dhe justifikim të veprimtarisë kërkimore / studimore e cila financohet prej buxhetit Akademisë së Shkencave, rrjedhimisht buxheti i shtetit.</p>

**OPINIONI I AUDITIMIT**

Ne kemi audituar hartimin, paraqitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare të ASH, për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës, pasqyrën e ndryshimeve në kapital, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i zbatimit të parimeve kontabël si dhe i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

I. Opinioni i modifikuar/kualifikuar mbi pasqyrat financiare të vitit 2022¹:

Sipas opinionit tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, shprehim një opinion të modifikuar për llogaritë vjetore të subjektit Akademia e Shkencave duke arritur në përfundimin se anomali të apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura, në llogaritë vjetore të vitit 2022, të cilat justifikojnë dhënien e një opinionit të Kualifikuar/Modifikuar për pasqyrat financiare.

Baza për opinionin të kualifikuar mbi pasqyrat financiare:

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në INTOSAIP-10, “Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t”, si dhe ISSAI 130 “Kodi Etik”, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura.

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e precizionit të materialitetit sasior prej 2,8 milion lekë për shpenzimet e vitit 2022 si dhe anomali të e rezultuara, si vijon:

- Nuk është kryer inventarizim i pasurisë për asnjë nga vitet objekt auditimi e për pasojë nuk marrim dot siguri të arsyeshme mbi tepricat e llogarive për llogaritë 212, 214, 215 dhe 218.
- Nuk ka një regjistër për aktivet e institucionit, në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik.
- Llogaria 212 “Ndërtime e konstruksione” në përbërje të saj përmban elemente të keqklasifikimit kontabël të llogarive të aktiveve (si për fond biblioteke dhe për shitje, të pa ndara në nënlllogaritë respektive) në kundërshtim me SKK 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Jomateriale, i përmirësuar”.
- Në pasqyrat financiare mungon shpjegimi dhe nuk tregohet se çfarë përfshihet në shifrat e rakorduara me thesarin dhe çfarë vlerash përfshihen në deklaratat financiare dhe shpjegimi se përse këto shuma rezultojnë me diferenca në kundërshtim me piken nr. 3.7, paragrafi 83 dhe 85 të UMF nr. 8, date 9.3.2018, i ndryshuar.

¹ - Referuar Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së, miratuar me vendimin nr. 246, datë 29.12.2022 “Për miratimin e manualit të auditimit financiar” të Kryetarit të KLSH-së, kapitulli VII, pika 7.3,5 (faqe 54 dhe 60-61), “Një “Opinion i Kualifikuar”, jepet në rastet kur: *audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se: anomali të apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë.*”



- Problematika të evidentuara lidhur me linjat e raportimit të kostove për qendrat/projektet/studimet e financuara.

II. Për Përputhshmërinë

Opinion i modifikuar, kualifikuar²

Mbështetur në, ISSAI 4000 “Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Përputhshmërisë”, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së ASH me kriteret e vlerësimit përfshirë kuadrin ligjor, rregullat, rregulloret dhe marrëveshjet që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të këtij institucioni.

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e Akademisë së Shkencave janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një **opinionit të kualifikuar/modifikuar**.

Baza për opinionin e modifikuar/kualifikuar të përputhshmërisë.

Ne jemi përpjekur të sigurohemi që konkluzionet dhe opinionet e tona të kenë një siguri të arsyeshme, si rrjedhojë e punës sonë audituese.

Konkluzionet dhe opinionin ynë janë të bazuara në kompetencën për vlerësim objektiv dhe profesional të evidencës së auditimit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion ASH, e cila konsiderohet nga ana e jonë përfaqësuese, e mjaftueshme, e përshtatshme dhe e besueshme.

Parregullsitë janë të shoqëruara me efekte financiare për buxhetin e shtetit, ku janë kërkuar 3,165,092 leke dëmshpërblim dhe mbi 26 milione lekë shpenzime pa efektivitet dhe pa eficence, Kane rezultuar parregullsi në fushën e projekteve kërkimore-shkencore, në fushën e prokurimeve, në regjistrimin dhe inventarizimin e pasurisë, në perditesimin e rregullores së brendshme dhe cilësinë e komponentëve të kontrollit të brendshëm etj.

Ne kemi përdorur gjykimin objektiv dhe kemi zbatuar skepticizmin profesional në vlerësimin e sasisë dhe cilësisë së evidencave dhe në këtë mënyrë kemi kontribuar në garantimin e mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë së tyre me qëllimin e dhënies së një opinionit me siguri të arsyeshme.

Auditimi është kryer sipas standardeve të cilat bazohen në Parimet Themelore të Auditimit niveli 3 (ISSAI 100 - 999) të Standardeve Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.

Procedurat e auditimit të bazuara në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit: ISSAI 400 “Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë”, ISSAI 1500 (ISA 500) dhe ISSAI 1530 (ISA 530); Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë, si dhe dokumentimi i auditimit në përputhje me kërkesat e Rregullores së Procedurave të Auditimit, kanë shërbyer si bazë për arritjen e konkluzioneve dhe dhënien e opinionit në këtë auditim përputhshmërie.

Ne kemi mbledhur dhe vlerësuar evidencën e auditimit, si dhe kemi konkluduar me gjetje dhe rekomandime në lidhje me fushën/objektin e auditimit, qasjen, kohën dhe burimet, me qëllim për të kryer një punë audituese që redukton në një nivel të ulët të pranueshëm, riskun e një konkluzioni ose opinionit të gabuar rreth objektivit të auditimit.

² *Opinionit i modifikuar/ i kualifikuar: Audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se: Anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në lidhje me kriteret e aplikuar*



I. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014 Datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 959/1 prot., datë 07.11.2023, i ndryshuar, nga data 07.11.2023-15.01.2024 për periudhën nga 01.01.2020 deri më 31.12.2023, u krye auditimi financiar dhe i përputhshmërisë në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, nga grupi i auditimit me përbërje:

5. I.S, (përgjegjës grupi)
6. A.K , Auditues
7. A.M, Auditues
8. A.H, Auditues.

1. Titulli

Raporti i Auditimit Financiar dhe Përputhshmërisë në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë

2. Marrësi

Ky Projekt-raport i adresohet Kryetarit të Akademisë së Shkencave, z. S.Gj

3. Objektivat dhe qëllimi

Objektivi i përgjithshëm është shprehja e një opinionit me një siguri të arsyeshme nga ana e audituesve nëse transaksionet financiare dhe shpenzimet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar për periudhën 01.01.2021-31.12.2023 si dhe nëse janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar.

Për auditimin Financiar, qëllimi i tij është të rrisë shkallën e besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare të Projektit për periudhën 01.01.2021-31.12.2023.

Auditimi financiar do të kryhet në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI) të miratuara nga Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI), dhe standardet e auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, i cili është një anëtar i INTOSAI-t.

Këto standarde kërkojnë që auditori të planifikojë dhe kryejë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare janë pa anomali materiale. Një auditim përfshin ekzaminimin në bazë të testit, të provave që mbështesin shumat dhe dhënien e informacioneve shpjeguese në pasqyrat financiare. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin e parimeve të kontabilitetit të përdorura dhe vlerësimet e rëndësishme të bëra nga drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për marrjen e dëshmive të auditimit në lidhje me shumat dhe dhënien e informacioneve shpjeguese në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në bërjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, auditori konsideron kontrollin e brendshëm të rëndësishëm për përgatitjen e pasqyrave financiare nga secili prej entiteteve, në mënyrë që të hartojë procedura auditimi që janë të përshtatshme në rrethana, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të njësisë ekonomike.



Auditimi i përputhshmërisë ka për qëllim;

-vlerësimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e raportuara janë në çdo aspekt material, në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë Akademia e Shkencave të Shqipërisë.

-dhënia e opinionit mbi rregullshmërinë dhe përputhshmërinë apo hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësim.

-Dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuar si: Rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kriterëve: Standarde, ligje, Vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, buxhete, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë, që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet etj.

-Njëherësh aspektet e rregullshmërisë (respektimi i kriterëve formale siç janë ligjet përkatëse, rregulloret dhe marrëveshjet) dhe ligjshmërisë (respektimi i parimeve të përgjithshme që rregullojnë menaxhimin e shëndoshë financiar dhe sjelljen e zyrtarëve publik).

-Promovimin e qeverisjes së mirë, duke identifikuar dhe raportuar devijimet nga kriteret, në mënyrë që të merren veprime korrigjuese, si dhe të identifikojë personat përgjegjës për veprimet e tyre.

4. Identifikimi i çështjes:

Raporti synon të identifikojë përmbushjen e rolit dhe të përgjegjësisë të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, në funksion të misionit dhe vizionit institucional të miratuar në aktet rregullatore.

Në funksion të këtij angazhimi, janë vlerësuar aktivitetet që kanë të bëjnë me respektimin e kriterëve mbi administrimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, respektimin e organigramës dhe të strukturës organike, vendimmarrja e organeve drejtuese etj. Në fokusin e angazhimit janë përgatitja dhe miratimi i Pasqyrave Financiare Vjetore nga ana e ASH, në mbështetje të dispozitave ligjore dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi në fushën e kontabilitetit të sektorit publik dhe pasqyrave financiare, si dhe aspektet e zbatimit të kërkesave të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar e kontrollin”, i ndryshuar.

Aktivitetet e vlerësuara nga ana e grupit të auditimit, janë parashikuar sipas drejtimeve të miratuara nga Kryetari i KLSH-së, në programin e auditimit nr. 959/1 prot., datë 07.11.2023, i ndryshuar.

5. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim:

Drejtimi i ASH është përgjegjës për menaxhimin e fondeve publike, zbatimin e kuadrit rregullator ligjor dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare. Ky Institucion duhet që të menaxhojë burimet dhe të ushtrrojë autoritetin në përputhje me vendimet dhe kërkesat e legjislacionit.

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar dhe për vendosjen dhe funksionimin e kontrollit të brendshëm, që ai i konsideron të nevojshme, për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që janë pa anomali materiale për shkak të mashtimit apo gabimit.

Është përgjegjësi e subjektit të audituar për të siguruar besueshmërinë dhe saktësinë e pasqyrave financiare, si edhe pohimet respektive në pasqyrat vjetore.



Drejtimi ka përgjegjësinë e tij për hartimin, zbatimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të kontrollit të brendshëm për të parandaluar, ose për të zbuluar dhe rregulluar gabimet materiale ose mospërputhshmëritë, që të jetë i përshtatshëm për këtë qëllim.

Drejtimi dhe menaxhimi janë përgjegjës për përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet. Ata përgjigjen për garantimin e sistemeve të përshtatshme dhe efektive të menaxhimit financiar dhe kontrollit në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator.

6. Përgjegjësitë e audituesve

Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Në këtë kontekst duhet:

-Të vlerësojë nëse, informacionet mbi çështjet në të gjitha aspektet materiale janë në përputhje me kriteret e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi. Masa e ndjekjes nga subjekti i audituar i rregullave, legjislacionit dhe akteve normative, politikave, kodeve të miratuara apo kushtet e përcaktuara (ISSAI 1000 - 2999 dhe ISSAI 4000), nuk paraqesin devijime materiale nga kriteret e vlerësimit, si pasaktësi apo gabime dhe janë në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtrohet veprimtaria e subjektit të audituar. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI), bazuar në këto standarde në aplikojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

-Të kryej në mënyrë efektive auditimin (ISSAI 1300)

-Të vlerësojë nëse është siguruar evidenca e mjaftueshme dhe e përshtatshme e auditimit dhe nëse bazuar në këtë evidence ai mund të formojë konkluzionet përkatëse (ISSAI 1500/ISA 300).

-Të kryej procedura të përshtatshme auditimi në funksion të këtij objekti.

Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10 “Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t”, si dhe ISSAI 30 “Kodi Etik”, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të vlerësuar përputhshmërinë e aktivitetit. Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse çështjet subjekt auditimi, që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë në veprimtarinë e subjektit të audituar.

7. Kriteret e vlerësimit

Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; Ligji nr. 53/2019, datë 18.07.2019 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar; Ligji nr.16/2020 “Për prokurimin publik”, Ligj nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”; Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar; Ligjet vjetore të buxhetit të shtetit; Ligji 152/2013 “Për statusin e nënpunësit civil”, i ndryshuar;

VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar; VKM nr. 918 datë 29.12.2014 “Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike”; VKM nr. 717, datë 23.06.2009 “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore



dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore", i ndryshuar; VKM nr. 187, datë 08.03.2017 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit", i ndryshuar;

Vendimi nr. 36/2020, datë 09.07.2020 "Për miratimin e strukturës, organikës dhe nivelit të pagave për akademinë e shkencave në Republikën e Shqipërisë" i Kuvendit të Shqipërisë;

Udhëzimi MF nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme", i ndryshuar;

Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar;

Udhëzimet standard të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit;

Dispozitat ligjore dhe nënligjore, që rregullojnë veprimtarinë e Njësive të Menaxhimit të Projekteve; të tjera.

8. Standardet e auditimit

-Standardet e zbatuara gjatë kryerjes së auditimit:

ISSAI (100) "Parimet themelore të auditimit të sektorit publik" që përcakton parime themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;

ISSAI (200) "Parimet themelore të auditimit financiar" që përcakton parime themelore dhe zhvillon më tej ato, duke përshtatur me kontekstin specifik të auditimit financiar;

ISSAI (1000 - 2999) "Udhëzimet për auditimin financiar";

ISSAI 4000 "Udhëzimet për auditime përputhshmërisë";

Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA), Federata Ndërkombëtare kontabilisteve (IFAC);

Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI¹,

INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin Financiar"; etj.

Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të audituesve.

9. Metodatat e auditimit

Auditim i njëpasnjëshëm me zgjedhje dhe ose i plotë sipas gjykimit të audituesit.

10. Dokumentimi i auditimit

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën, dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Rezultatet e këtyre procedurave, evidencat e marra gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale të bëra në arritjen e konkluzioneve u konsideruan të përshtatshme dhe të rëndësishme për të konfirmuar dhe mbështetur konkluzionet dhe raportin e audituesve dhe shërbyen si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit, mbi bazën e evidencave të marra, akt – konstatimeve dhe akt – verifikimeve të mbajtur, observacioneve të paraqitura u përgatit Raporti i Auditimit.



II. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI SUBJEKTIN NËN AUDITIM

Akademia është institucioni publik më i lartë që përfaqëson e mbart vlerat më të mira të shkencës, të kërkimit shkencor, të krijimtarisë dhe të debatit e bashkëveprimit të mendimit shkencor në vend, përmes një bashkësie të zgjedhur shkencëtarësh e krijuesish. Akademia është institucion autonom në fushën e kërkimit, që e mbështet veprimtarinë e saj në prova shkencore dhe në dobi të vendit. Akademia, si person juridik, përbëhet nga trupa e shkencëtarëve dhe e kërkuesve, që në këtë ligj do të quhet Asamble.

1. Akademia si institucion përbëhet nga organet e saj drejtuese:

- a) Asambleja
- b) Kryesia
- c) Kryetari.

2. Akademia përfshin edhe disa struktura të ngritura në përbërje ose pranë saj, si:

- a) seksione
- b) komisione
- c) njësi të kërkim-studimit
- ç) Akademia e të Rinjve
- d) biblioteka
- dh) enti botues
- e) administrata ndihmëse.

Asambleja është trupa e shkencëtarëve dhe e kërkuesve, e cila përbëhet nga akademikë dhe akademikë të asociuar, të cilët do të quhen anëtarë të Asamblesë. Numri i akademikëve është deri në 30, ndërsa numri i akademikëve të asociuar është deri në 10.

Anëtarët zgjidhen nga Asambleja ndër mbajtësit e titullit “Profesor”, që kanë një kontribut të veçantë me një ndikim të gjithëpranuar në fushën përkatëse, në bazë të kandidaturave të përzgjedhura nëpërmjet procedurave e kriterëve të përcaktuara në statutin e Akademisë. Në procedurat e kandidimit e të përzgjedhjes përfshihen edhe struktura apo përfaqësues të institucioneve të kërkimit shkencor, të arsimit të lartë e të kulturës. Në raste të veçanta, anëtarë zgjidhen personalitete me kontribut të spikatur nga fusha e krijimtarisë artistike, kulturës dhe jetës sociale në përgjithësi. Si rregull, akademikët zgjidhen nga radhët e akademikëve të asociuar. Në rast kandidimi të drejtpërdrejtë, kandidati duhet të marrë mbështetjen e jo më pak se 2/3-ve të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Asamblesë. Asambleja zgjedh edhe anëtarë të jashtëm ndër personat me shtetësi apo origjinë shqiptare me banim jashtë vendit, figura të shkencës e të kulturës, si dhe anëtarë nderi ndër figurat e shkencës e të kulturës që janë shtetas joshqiptarë me banim jashtë vendit, të cilët me punimet e tyre kanë ndikuar në ecurinë e mendimit e të zbatimit të shkencës në Shqipëri apo në promovimin e të vërtetave dhe të vlerave të origjinës, gjuhës e kulturës shqiptare. Numri i anëtarëve të nderit është deri në 15. Personat me origjinë shqiptare, që janë anëtarë me të drejta të plota të një akademie pjesëtare të “All European Academies”, fitojnë drejtpërdrejt statusin e anëtarit të jashtëm të Akademisë së Shkencave, e cila formalizohet nga një mbledhje ceremoniale e Asamblesë. Anëtarët e Asamblesë që mbushin moshën 75 vjeç marrin statusin e anëtarit “Emeritus”. Personat e zgjedhur sipas këtij neni quhen “Anëtarë të Akademisë”.



2. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Mbi funksionimin e organeve drejtuese te Akademisë.

Në zbatim të pikës 1të programit të auditimit Nr.959/1 datë07.11.2023, i ndryshuar, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Statuti i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë;
2. Ligji Nr.53/2019 "Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
3. Vendimi nr.16, datë 24.03.2022 i Kryesisë "Për miratimin e rregullores së brendshme administrative të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë".

Auditimi u fokusua kryesisht në këto çështje:

- ☒ organet drejtuese të Akademisë, përcaktimi i roleve dhe veprimtaria e tyre pranë saj;
- ☒ marrëdhënia e Akademisë me institucionet e tjera të kërkimit shkencor dhe të politikave të zhvillimit të tyre;
- ☒ strukturat e ngritura pranë Akademisë dhe funksionimi i tyre;
- ☒ përbërja dhe funksionimi i Asamblesë;
- ☒ organet ekzekutive dhe funksionimi i tyre.

Nga auditimi:

➤ **Organizimi dhe funksionimi i organeve drejtuese të Akademisë.**

Akademia e Shkencave është institucioni publik më i lartë që përfaqëson e mbart vlerat më të mira të shkencës, të kërkimit shkencor, të krijimtarisë dhe të debatit e bashkëveprimit të mendimit shkencor në vend, përmes një bashkësie të zgjedhur shkencëtarësh e krijuesish. Si një institucion autonom në fushën e kërkimit, mbështet veprimtarinë e saj në prova shkencore dhe në dobi të vendit. Në përputhje me Ligjin Nr.53/2019, i ndryshuar, në nenet 5 e në vazhdim përcakton organet drejtuese të saj, si dhe funksionet.

Në Ligjin Nr.53/2019 "Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ku në mënyrë eksplicite përcaktohet se:

Akademia si institucion përbëhet nga organet e saj drejtuese: a) Asambleja; b) Kryesia; c) Kryetari. Akademia përfshin edhe disa struktura të ngritura në përbërje ose pranë saj, si: a) seksione; b) komisione; c) njësi të kërkim-studimit; ç) Akademia e të Rinjve; d) biblioteka; dh) enti botues; e) administrata ndihmës.

Asambleja është trupa e shkencëtarëve dhe e kërkuesve, e cila përbëhet nga akademikë dhe akademikë të asociuar, të cilët do të quhen anëtarë të Asamblesë. Numri i akademikëve duhet të jetë deri në 30, ndërsa numri i akademikëve të asociuar deri në 10. Për periudhën objekt auditimi nga 01.01.2021e në vazhdim, Asambleja përbëhet nga 54 anëtarë ku 23 prej tyre janë akademikë, 10 anëtarë janë akademikë të asociuar dhe 21 anëtarë janë akademikë emeritus.

Në nenin 7 të Ligjit, përcaktohen detyrat e Asamblesë, të cilat janë: zgjedhja e anëtarëve të Akademisë, zgjedhja e kryetarit, zëvendëskryetarit, sekretarit shkencor dhe drejtuesve të seksioneve. Gjithashtu miraton projektbuxhetin vjetor, pas përgatitjes së tij nga Kryesia, dhe ia dërgon Kuvendit për miratim, miraton raportin vjetor të veprimtarisë së Akademisë për vitin përmbyllës pas përgatitjes së tij nga Kryesia, miraton programin e punës për vitin pasardhës, si



dhe programet afatgjata e strategjitë e zhvillimit, miraton statutin dhe ndryshimet e tij me 2/3 e votave.

➤ **Zgjedhjet për kryetar dhe zëvendëskryetar.**

Grupi i auditimit konstaton se, përsa i përket zgjedhjes së kryetarit të Akademisë, e cila është një prej detyrave të Asamblesë, zgjedhjet e fundit janë kryer në tetor të vitit 2023, nga ku është rizgjedhur për të dytën herë rradhazi kryetari i Akademisë. Kryetari i Akademisë zgjidhet ndër anëtarët e Asamblesë me titullin “akademik”.

Me vendimin Nr.46, datë 11.09.2023 të Asamblesë është caktuar se zgjedhjet për kryetar do të mbahen në datën 20.10.2023, ku është përcaktuar edhe komisioni teknik i zgjedhjeve. Zgjedhjet janë mbajtur në datën e përcaktuar.

Në datën 19.10.2023 në procesverbalin e mbledhjes, komisioni teknik i përgatitjes së zgjedhjeve i vendos në dispozicion komisionit zgjedhor listën e plotë të anëtarëve të Asamblesë të shoqëruar me informacionin e nevojshëm për mënyrën e votimit, dosjen e kandidimit të Akad. S.Gj. për kryetar dhe Akad. V.T. për zëvendëskryetar si dhe fletën e votimit dhe zarfet me vota të sekretuara për anëtarët që gëzojnë të drejtën e votimit në distancë. Konstatohet se për komisionin zgjedhor nuk ka një urdhër për ngritjen e tij.

Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni zgjedhor, shprehet se gjatë procesit të votimit janë përdorur edhe fletët e votimit rezervë, për arsye të dëmtimit në proces votimi nga votuesit, të cilat kanë qenë 2 (dy) të tilla. Akademia e Shkencave pas përfundimit të votimit dhe shpalljes së rezultateve ka dërguar në presidencë njoftimin, për shpalljen e fituesit. Me Dekretin nr.311, datë 30.10.2023 “Për emërimin e Kryetarit të Akademisë së Shkencave”, i cili hyn në fuqi menjëherë, është riemëruar në detyrë Kryetari i Akademisë së Shkencave.

➤ **Detyrat funksionale të Asamblesë.**

Detyrat e Akademisë, të përcaktuara ato në nenin 7 të Ligjit Nr.53/2019, të ndryshuar, janë: miratimi i projektbuxhetit vjetor pas përgatitjes së tij nga Kryesia, dhe dërgimi në Kuvend për miratim, po ashtu Asambleja miraton raportin vjetor të veprimtarisë së saj për vitin përmbyllës pas përgatitjes së tij nga Kryesia, miraton programin e punës për vitin pasardhës, si dhe miraton statutin dhe ndryshimet e tij me 2/3 e votave.

Në përmbushje të rolit të funksioneve të ASHSH-së, të parashikuara në nenin 4 të Ligjit, në pikat 2-6 dhe 14-18, nëpërmjet ngritjes së funksionimit të njësisve të kërkim-studimit të përkohshëm e të përhershëm pranë saj është miratuar “Strategjia e zhvillimit të Akademisë së Shkencave për periudhën 2020-2025 me Urdhër të Kryetarit më Nr.79/1 prot., datë 19.02.2019. Kjo strategji për realizimin e saj është projektuar me 2 faza të reformave. Faza e para është reformimi i vetë Akademisë së Shkencave dhe i strukturave të saj dhe faza e dytë e saj është roli i ASH-së në reformimin e vetë sistemit të kërkimit shkencor në Shqipëri.

Ndërkohë programi për veprimtarinë vjetore të Akademisë së Shkencave për vitin 2023 është miratuar nga Asambleja me nr.140 prot., datë 28.02.2023. Programi në përmbajtje përcakton, veprimtarinë në kuadër të protokollit të bashkëpunimit midis ASHSH dhe ASHAK, kongreset, konferencat si dhe kuvende kryesore në nivel të Akademisë, në nivel seksionesh, në nivel qëndror, si dhe në nivel komisionesh. Gjithashtu pjesë e veprimtarisë vjetore janë dhe tre projektet madhor të Akademisë së Shkencave, më konkretisht: “Historia e Shqiptarëve”, “Fjalori i Gjuhës Shqipe” dhe “Enciklopedia Shqiptare”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

Vendimi i Asamblesë nr.10, datë 25.02.2022 “Për miratimin e veprimtarisë së Akademisë së Shkencave gjatë 2021, programit të saj për vitin 2022, shpalljen e vitit 2022 si viti i akademizimit shqipëtar, si dhe zgjedhjen e anëtarëve të jashtëm të ASH”.

➤ **Kryesia.**

Kryesia e Akademisë së Shkencave si pjesë e strukturës së organeve drejtuese të saj, organizon dhe drejton Akademinë në bazë e në zbatim të këtij ligji, dhe në bazë të vendimeve të Asamblesë. Gjithashtu, ndjek dhe organizon punën e seksioneve, komisioneve, si dhe të njësisive të ngritura, përgatit projektprogramin dhe projektbuxhetin, mbledhjet e Asamblesë dhe përgatit raportin vjetor.

Për periudhën objekt auditimi nga 01.01.2021- 31.12.2023, Kryesia si organ ekzekutiv përbëhet nga kryetari, zëvendëskryetari, sekretari shkencor dhe drejtuesit e seksioneve. Kryetar i Kryesisë është Akad. S.Gj, zëvendëskryetar Akad.V.T, sekretar shkencor Akad. Sh.S, kryetar i seksionit të shkencave shoqërore dhe albanologjike Akad. G.H dhe kryetar i seksionit të shkencave natyrore dhe teknike Akad. N.F.

Titulli i gjetjes	“Mangësi në dokumentimin e procesve të buxhetimit nga ana e NZ dhe GMS”.
Situata:	Gjatë auditimit në terren, për gjithë periudhën objekt auditimi, nuk është vendosur në dispozicion asnjë dokumentacion për sa i përket përgatitjes së projekt - buxhetit vjetor, si një nga detyrat funksionale të Kryesisë. Për vitin 2021, nuk rezulton asnjë dokument i mbledhjeve të kryera nga GMS, ku pjesë e saj janë edhe anëtarët e Kryesisë, për përgatitjen e projekt-buxhetit vjetor. <i>Për periudhën 2022-2023, u konstatua se në përfundim të takimeve të kryera nuk janë mbajtur protokollet e mbledhjeve për vendimet respektive të çdo mbledhjeje, të cilat duhet të ishin regjistruar nga sekretari dhe të vendoseshin në dispozicion të drejtimit të njësisë publike.</i>
Kriteri:	Pika 1 ç) nenin 12 i Ligjit nr.59/2019 të ndryshuar dhe pikën 4 të nenit 31 të Statutit. <i>neni 27 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.</i>
Ndikimi/Efekti:	Mos përmbushja e detyrave funksionale të Kryesisë.
Shkaku:	Mangësi në dokumentimin e proceseve të buxhetimit nga ana e NZ dhe GMS.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi	Të merren masa nga titullari i institucionit, që Kryesia në përmbushje të detyrave funksionale të saj, të bëjë hartimin e projekt – buxhetit, si dhe mbajtjen e protokolleve respektive me qëllim sigurimin e gjurmës së auditimit e më pas të bëjë kalimin për miratim nga Asambleja.
Afati i zbatimit	Në vazhdimësi.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, është paraqitur observacion me shkresën nr. 959/6 prot., datë 02.04.2024 nga Kryetari i ASHSH S.Gj.

Pretendimet e paraqitura janë si më poshtë vijon:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQPËRISË

Rekomandimi pranohet pasi ai përbën një detyrë funksionale të Asamblesë, kryesisë e kryetarit. Angazhimi i kryesisë në hartimin e projekt buxhetit është parësor dhe i vazhdueshëm, për këtë janë dhënë shpjegime të plota, ashtu si dhe për rolin e GMS si një kryesi e zgjeruar, këshilluese për titullarin. Nuk pajtohem me mospranimin e tyre dhe vecanërisht me përcaktimet se ka neglizhencë në këtë drejtim. I vetmi problem procedural këtu është roli i Asamblesë në këtë proces. Sic dihet projekt buxheti është një proces e paraprakisht miratohet vetëm fondi në total, cka qeveria e vendos në planet e saja tre vjecare. Në këto kushte miratimi nga Asambleja paraprakisht i projekt fondit, i cili është objekt negocimi me Kuvendin deri në miratim, duket i pamundur ndërkohë që projekt buxheti përgatitet në këshillim me Asamblenë, seksionet, komisionet, njësitë, konform nenit 22 pika 4/a të ligjit dhe me tej Asambleja miraton buxhetin e shpërndarjen e buxhetit sipas zërave e veprimtarive kryesore.

Qëndrimi i grupit të auditimit

*Grupi i auditimit lexoi me vëmendje të gjitha parashtrimet dhe nuk është vendosur në dispozicion asnjë dokumentacion shtesë. Argumenti juaj nuk paraqet fakt të ri, arsye për te cilën **nuk pranohet observacioni.***

-Njësitë e kërkim-studimit, në Akademinë e Shkencave, sipas nevojave, detyrave e problemeve në fushën e kërkimit, në përmbushje të rolit të saj, mund të ngrihen njësi të kërkim-studimit me aktivitet afatshkurtër e afatgjatë. Këto njësi janë autonome në realizimin e detyrave të tyre dhe duhet të mbajnë marrëdhënie me Kryesinë e Kryetarin dhe raportojnë pranë tyre. Momentalisht në Akademinë e Shkencave funksionojnë 3 (tre) njësi të kërkim studimit, të cilat janë Nano- ALB, njësia e kërkim studimit në fushën e bioshkencës, bioteknologjisë dhe gjenetikës, si dhe njësia kërkimore shkencore e sizmologjisë dhe gjeoshkencës.

Si një detyrë funksionale, Kryesia duhet të ndjekë dhe të organizojë punën e komisioneve, seksioneve dhe njësite të ngritura të Akademisë, në përputhje me nenin 12, pika 1 b) të Ligjit Nr.59/2019, të ndryshuar. Gjatë auditimit është konstatuar se Seksioni i Shkencave Natyrore e Teknike ka dërguar informacion mbi komisionet e biologjisë, bujqësisë, veterinarisë, të fizikë kimisë, të matematikë informatikës, të mjekësisë dhe të inxhierisë, për sa i takon veprimtarisë dhe funksionimi të tyre. Ky informacion është dërguar për periudhën janar-qershor 2021 me nr.489 prot., datë 13.07.2021, po ashtu edhe për periudhën korrik-dhjetor 2021 me nr.802 prot., datë 23.12.2021.

Titulli i gjetjes	Mungesa, e raportimeve periodike mbi ndjekjen dhe organizimin e punës mes Seksioneve dhe Kryesisë.
Situata:	Nuk ka gjurmë dokumentacioni për raportimin e veprimtarisë së 3(tre) njësiteve dhe komisioneve të ngritura pranë Akademisë së Shkencave. Gjatë auditimit është konstatuar se Seksioni i Shkencave Natyrore e Teknike ka dërguar informacion mbi komisionet e biologjisë, bujqësisë, veterinarisë, fizikë - kimisë, matematikë - informatikës, të mjekësisë dhe të inxhinierisë, për sa i takon veprimtarisë dhe funksionimit të tyre. Ky informacion është dërguar për periudhën janar - qershor 2021 me nr. 489 prot., datë 13.07.2021, po ashtu edhe për periudhën korrik - dhjetor 2021 me nr. 802 prot., datë 23.12.2021.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

	Nga auditimi u konstatua, se nuk rezulton më asnjë korrespondencë mbi ndjekjen dhe organizimin e punës për këto seksione për periudhën janar-dhjetor 2022 dhe janar-dhjetor 2023.
Kriteri:	Nenit 31, pika 2 e Statutit; Nenit 12, pika 1 b) e Ligjit nr.59/2019, të ndryshuar.
Ndikimi/Efekti:	Mungesa e një pasqyrimi mbi ndjekjen dhe organizimin e punës mes Kryesisë dhe seksioneve/njësive kërkimore të ngritura pranë saj.
Shkaku:	Mungesa e raportimeve periodike mbi ndjekjen dhe organizimin e punës mes Seksioneve dhe Kryesisë.
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandimi	Të merren masa nga titullari i institucionit, që Kryesia të ketë një bashkëveprim mes strukturave të ngritura pranë saj, mbi organizimin dhe ndjekjen e punës së tyre.
Afati i zbatimit	Menjëherë.

Nga auditimi u konstatua, se nuk rezulton asnjë korrespondencë mbi ndjekjen dhe organizimin e punës për këto seksione për periudhën janar-dhjetor 2022 dhe janar-dhjetor 2023, kjo në kundërshtim me nenin 12, pika 1 b) të Ligjit nr.59/2019, të ndryshuar. Gjithashtu nuk ka gjurmë dokumentacioni për veprimtarinë e Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike për të gjithë periudhën objekt auditimi dhe korrespondencës dhe shkëmbimit të informacionit mbi punën mes Kryesisë si një detyrim funksional i saj dhe seksioneve, kjo në kundërshtim me pikën 2 të nenit 31 të Statutit dhe pika 1 b) e nenit 12 e Ligjit nr.59/2019 të ndryshuar.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, është paraqitur observacion me shkresën nr. 959/6 prot., datë 02.04.2024 nga Kryetari i ASHSH S.Gj.

Pretendimet e paraqitura janë si më poshtë vijon:

- Rekomandimi pranohet pasi ai përbën një nga detyrat funksionale të Asamblesë, kryesisë e të kryetarit, ndërkohë kategorizimi si “neglizhencë institucionale” nuk qëndron. Rekomandimi është plotësuar tashmë e do të kihet parasysh në vazhdimësi, pasi Asambleja e Akademisë, në mbledhjen e 23 shkurtit 2024 ka miratuar programin e fazës së dytë të reformës dhe ka përcaktuar qartë edhe detyrat organizative e bashkëvepruese me strukturat brenda e jashtë Akademisë. Për ta realizuar atë me të njëjtin efektivitet e sukses si fazën e parë, ecuria pozitive e së cilës paraqitet edhe në raportin e auditimit, nëpërmjet pasqyrimin të raporteve vjetore të ASH: vitet 2021, 2022, 2023 dhe të strategjisë së zhvillimit të ASH. Këto vlerësime e konkluzione të Asamblesës për fazën e parë të reformës, të njëjta me të Komisionit Për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, në dëgjuesën e organizuar për zbatimin e ligjit të ri e ecurinë e reformës nga ASH, si dhe arritjet e pasqyruara në raportet vjetore ligjore e statutove të sipërcituara, si dhe në vërejtjet tona të mëparshme, bëjnë që të mos pajtohem me titullin e gjetjes e vecanërisht me kategorizimin e saj si “neglizhencë institucionale”.

Oëndrimi i grupit të auditimit

Grupi i auditimit lexoi me vëmendje gjithë parashtrimet dhe observacionet e dërguara nuk përputhen me konstatimin e bërë. Nuk është trajtuar puna e njësive të kërkimit, por korrespondenca e mbajtur mes kryesisë dhe njësive si një detyrim funksional. Argumenti juaj nuk paraqet fakt të ri, arsye për të cilën observacioni nuk pranohet.



➤ **Raporti i veprimtarisë së Akademisë së Shkencave për vitin 2021 si dhe Programi Vjetor për vitin 2022.**

Në përputhje me Ligjin Nr.59/2019, në nenin 7 pika 4 e tij përcaktohet se Kryesia përgatit raportin përmbyllës të veprimtarisë së Akademisë e cila me pas kalon për miratim tek Asambleja.

Me vendimin Nr.9, datë 10.01.2022 është thirrur mbledhja e Asamblesë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, nga ku Kryesia e Akademisë në mbledhjen e datës 07.01.2022, bazuar në nenin 8, pika 3 e Ligjit si dhe në nenin 26, 28 dhe 29 të Statutit, thërret mbledhjen e Asamblesë, për miratimin e raportit vjetor përmbledhës, ecurisë dhe problematikave të saj si dhe miratimin për prioritetet e programit për vitin 2022.

Me vendimin Nr.10, datë 25.02.2022 është miratuar raporti për veprimtarinë e Akademisë së Shkencave si dhe raporti financiar për 2021 si dhe janë miratuar prioritetet për veprimtarinë e vitit 2022. Po ashtu është miratuar zgjedhja e dy akademikëve si anëtarë të jashtëm të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Në raportin vjetor shprehet se, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës dhe institucione të tjera shkencore vendase e më gjerë, ndërmorën iniciativën shkencore për hartimin dhe botimin e disa veprave madhore në fushën e albanologjisë, projekte që mbështeten financiarisht nga qeveritë respektive. Më 7 prill 2021 Asambleja e Akademisë miratoi projektin për hartimin e botimin e tri veprave madhore shkencore: Histori e shqiptarëve, Fjalor i madh i gjuhës shqipe dhe Enciklopedia shqiptare. Ku konkretisht me vendimin nr. 42 datë 13.12.2019 Kryesia ngriti grupin e punës për konceptimin, përgatitjen, propozimin dhe miratimin e platformës shkencore të Enciklopedisë shqiptare. Më pas, me vendimin nr. 54 datë 16.9.2021, për caktimin përfundimtar të bashkë drejtuesve të projekteve madhore në albanologji; të drejtuesve të nëngrupeve shkencore sipas periudhave/ fushave përkatëse dhe të anëtarëve të nëngrupeve; të detyrave, përgjegjësive dhe mënyrës së shpërblimit të tyre u caktuan edhe bashkëdrejtuesit e këtij projekti.

Me vendimin nr. 8 datë 2.2.2021, u ngrit grupi i punës për projektin ndërkademiq të “Fjalorit të madh të gjuhës shqipe”. Një nga detyrat kryesore të realizuara gjatë vitit 2021 ishte ngritja e kartotekës së posaçme të Fjalorit. Për këtë në fillim u bë organizimi i punës në 11 nëngrupe sipas fushave, duke përfshirë në to drejtuesit e projektit, redaktorët shkencorë, hartuesit, bashkëpunëtorët, si dhe forcat ndihmëse.

Njësia e kërkim-studimit NanoAlb. Në vitin 2020, Akademia e Shkencave me buxhetin e saj miratoi mbështetje financiare për pesë projekte të njësive NanoAlb për probleme të pandemisë së shkaktuar nga Covid 19. Më 4-8 tetor 2021 u zhvillua në Tiranë konferenca ndërkombëtare Trendet në Nanoteknologji. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion të audituesve të autorizuar të KLSH-së, evidentohet se në konferencë kanë marrë pjesë dhe paraqitën arritjet e tyre kërkimore shumë prej figurave të shquara në fushën e nanoshkencës dhe nanoteknologjisë nga gjithë bota.

➤ **Raporti Vjetor Për vitin 2021 dhe 2022 si dhe Programi për Veprimtarinë Vjetore të vitit 2022 dhe 2023.**

Raporti i kryesisë për veprimtarinë e Akademisë së Shkencave.

Për vitin 2022, tre kanë qenë projektet shkencore madhore miratuar prej tre vjetësh dhe përfshirë në marrëveshje bashkëpunimi me ASHAK-un. Vëmendjen më të madhe këtë vit e ka fituar projekti



Enciklopedia shqiptare. ASHSH përgatiti projektin e marrëveshjes ndërqeveritare, miratuar në Prishtinë më 20 qershor; rregulloren e përbashkët për ngritjen dhe funksionimin e redaksive të të tre niveleve, nënshkruar me ASHAK-un më 28 tetor, mbi protokollin për modalitetet e përdorimit të buxhetit dhe rregulloren teknike të redaksisë qendrore. Po ashtu, Njësia NanoAlb zgjeroni grupet e interesit dhe të pjesëmarrjes, organizoi Kongresin e dytë Ndërkombëtar NanoBallkan dhe ka ambicien për një kongres europian këtë vit. Kongresi Botëror i Nanoteknologjisë (Trends in Nanotechnology International Conference, TNT2022 NanoBalkan) u realizua më 4-8 tetor 2022. Janë krijuar njësi të reja kërkimore të përkohshme si, Instituti Kombëtar i Matematikës (IKM). Ka pasur zgjatje të afatit për njësinë ekzistuese NanoAlb dhe ngritjen e saj në shkallën e një qendre kërkimore afatgjatë. Qendra kërkimore e bioteknologji-gjenetikës ka nënshkruar një marrëveshje me Drejtorinë e Policisë së Shtetit.

Raporti përmbledhës i datës 06.02.2023, miratuar me urdhër shprehet se 3 projektet e mëdha të albanologjisë kanë ecur sipas pritshmërive. Kjo pasi, është përmbyllur puna përgatitore për fjalorin e madh të gjuhës shqipe, ndërkohë që është arritur të miratohet tërë kuadri nënligjor për organizimin e punës dhe mbështetjen financiare të projektit Enciklopedia Shqiptare.

Po ashtu është ofruar një mjedis pranë QSUNT-së dhe disa pajisje laboratorike, si dhe njësia e biogjenetikës sic shprehet në raport po kthehet në një qendër reale të kërkimit në fushën e bioshkencës. Në pjesën përbërëse të raportit, shprehet se dy institutet virtuale, në matematikë dhe fizikë si modele të vecanta të njësive po tregojnë efektivitetin e tyre, por nuk shprehen më konkretisht për punën e tyre.

Programi për veprimtarinë vjetore të Akademisë së Shkencave

Në zbatim të Ligjit Nr.53/2019, i ndryshuar, në nenin 7 pika 5, Asambleja miraton programin e punës për vitin pasardhës, si dhe programet afatgjata e strategjitë e zhvillimit.

Për vitin 2023, programi i miratuar me nr.140 prot., datë 28.02.2018 ka të planifikuara konferenca shkencore, kongrese, kuvende kryesore në nivel të Akademisë, në nivel të seksioneve, veprimtari shkencore në nivel njësie, qendrore dhe të komisioneve. Po ashtu projekte shkencore në fusha dhe sektorë të ndryshëm.

Programi bazë për 2023, përsëri i jep rëndësi angazhimit parësor, mbi realizimin e punëve të programuara për tre projekte madhore të albanologjisë. Për fjalorin e madh parashikohet të kryhet mbi 85% e punës, e cila në raportin përmbledhës shprehet se është përmbyllur puna përgatitore. Gjithashtu do të vazhdojë veprimtaria e njësive dhe realizimi i 12 projekteve dhe 3 studimeve të nisura.

➤ **Vendimet Qarkulluese.**

Në nenin 27, të Statutit përcaktohet se: *“Asambleja mund të marrë vendime qarkulluese, si rregull, për çështje urgjente dhe që kanë më shumë rol këshillues e ratifikues, si: për të përcaktuar një reagim apo qëndrim publik të ASH-së, për të formalizuar një detyrim të ligjit apo për të ratifikuar një marrëveshje kuadër, për shpalljen e vendeve të lira, osë për pjesëmarrje në një aktivitet apo forum për çështje të ndjeshme”.*

Gjatë auditimit të disa prej vendimeve qarkuluese janë konstatuar si më poshtë:

-Kryesia e ASHSH-së në përputhje me nenin 12, pika 1 d) thërret mbledhjet e Asamblesë. Në mbështetje të këtij përcaktimi, Kryesia, ka njoftuar mbledhjen e Asamblesë në datën 09.07.2021, ora 11:00, ku është dërguar dhe rendi i ditës. Grupi i auditimit konstaton se në rendin e ditës të miratuar nga kryetari me nr.421 prot., datë 17.06.2021, janë diskutuar edhe tematika jashtë rendit



të ditës, ku midis tyre janë miratuar disa amendime në Statut dhe ndryshime në rregulloren “Për çmimet shkencore që akordohen nga Akademia e Shkencave dhe për mënyrën e organizimit të konkurseve të tyre”, veprim ky në kundërshtim me nenin 7, pika 1 e Ligjit Nr.8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, ku përcaktohet se “Rendi i ditës, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe me ligj, kryetari vendos për rendin e ditës së çdo mbledhjeje. Rendi i ditës duhet të përfshijë ato çështje që i janë propozuar atij nga anëtarët e organit kolegjial me të drejtë vote dhe që janë në kompetencë të këtij organi. Kërkesa për ta futur një çështje në rendin e ditës duhet të behet me shkrim, të paktën 5 ditë përpara datës së vendosur për mbledhjen. Rendi i ditës duhet t’i shpërmdahet të gjithë anëtarëve, të paktën 48 orë përpara datës dhe kohës së mbledhjes.”

Gjithashtu konstatohet se vendimi i Asamblesë nr.47, datë 21.07.2021 i miratuar nga Kryetari është marrë në kundërshtim me nenin 27, pika 1 e Statutit, ku nuk përfshihen në vendime qarkulluese të Asamblesë ndryshimet e amendamenteve në Statut. Ky vendim është marrë në kundërshtim me përcaktimet statutore.

Gjatë auditimit është konstatuar se për mbledhjen e kryer në 09.07.2021 nuk ka një procesverbal të mbledhjes, kjo në kundërshtim me nenin 16 të Ligjit Nr.8480, datë 27.05.1999, duke pasur në vëmendje rëndësinë e mbledhjes për ndryshimet e ardhura të Statutit të institucionit. Mos mbajtja e procesverbalit të mbledhjeve është një fenomen i përhapur gjatë mbledhjeve të Asamblesë.

Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, vihet re se 12 prej kthim përgjigjeve të e-maileve nga ana e akademikëve nuk përkojnë me datën e cila ishte përcaktuar për mbledhje, por janë në tejkalim të atij afati. Po ashtu kthim përgjigjet elektronike nuk ishin të shoqëruara me një arsyetim të shkurtër me shkrim të votës “pro” ose “kundër”, kjo në kundërshtim me pikën 5 të nenit 26 të Statutit.

-Gjatë vitit 2022, ASHSH vendos të ndër marrë disa ndryshime në ligj.

Kryesia në një relacion të datës 29.08.2022, firmosur nga kryetari, vlerëson të bëhen disa ndryshime dhe saktësime në ligjin për Akademinë e Shkencave dhe ti propozohen kuvendit për miratim konkretisht neni 6 i Ligjit. Me vendimin Nr.50, datë 08.09.2022 është miratuar amendimi i propozuar nga kryesia për nenin 6 të Ligjit, nga ku dhe ngarkohet kryesia për komunikimin e mëtejshëm me kuvendin.

-Gjatë vitit 2021, Kryetari ka miratuar vendimin e Asamblesë Nr.49, datë 23.07.2021. Vendoset të miratohet ngritja dhe riorganizimi i rrjetit të instituteve të shkencave albanologjike ndërmjet kalimit pranë Akademisë së Shkencave të instituteve ekzistuese të Akademisë së Studimeve Albanologjike (ASA): të Institutit të Historisë, të Institutit të Gjuhësisë dhe Letërisë, të Institutit të Antropologjisë Kultururore dhe Studimeve për Artin, të Institutit të Arkellogjisë. Gjatë auditimit është konstatuar se nuk ka një relacion arsyetues nga Kryesia, mbi riorganizimin e këtyre instituteve, duke pasur në vëmendje se marrja e një vendimi qarkullues, formulohet dhe propozohet nga kryesia dhe më pas u përcillet anëtarëve për konfirmim, po ashtu nuk ka dokumentacion shoqëruar që konfirmon shprehjen e dakordësisë së anëtarëve në rrugë elektronike. Ky vendim është marrë në kundërshtim me nenin 27, pika 2 e Statutit.

-Vendime të tilla nuk përfshihen në fushën e vendimeve qarkulluese, pasi ato përfshijnë çështje të cilat kanë më shumë rol këshillues e ratifikues dhe jo riorganizim të instituteve, veprim ky në kundërshtim me nenin 27, pika 1 e Statutit.

-Me vendimin Nr.5, datë 29.01.2021, Kryesia shpall njoftimin për vendet e lira për konkurim për anëtarët e rinj në Asamblesë e ASHSH, ku shpall 5 vende të lira për pranimet e saj si akademikë të asociuar. Kryesia del me vendimin Nr.12, datë 02.02.2021 ku shpall përsëri të njëjtin vendim



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQPËRISË

me atë të datës 29.01.2021 ku ishte shpallur thirrja për vendet e lira për të kandiduar si anëtarë të Asamblesë. Pra ndodhur para faktit se ka dy vendime shpallje për të njëjtën procedurë. Në vijim të vendimit të parë, atij me Nr.05, datë 29.01.2021, Kryesia me shkresën Nr.85/1 prot., datë 02.02.2021, paraqet kriteret e plotësimit për kandidaturat, vendos afatet për paraqitjen e interesit për konkurim, afatin për shqyrtimin e plotësimit të kriterëve ligjore nga Komisioni Teknik, afatin e vlerësimit nga njësia bazë universitare a kërkimore, si dhe afatin e shqyrtimit të kandidaturave në komisionet dhe seksionet shkencore të ASH. Ndërkohë nuk ka një dokumentacion ku të jetë përcaktuar nga kryesia se kush do të jetë pjesë e komisionit teknik, kjo në kundërshtim me nenin 7, pika 6 e Statutit. Në vijimësi Kryesia del me vendimin Nr.20, datë 16.03.2021 për shtyrje afati të regjistrimit të kandidatëve që konkurojnë për pranim si anëtarë, por duke ju referuar vendimit të dytë me Nr.12, datë 02.02.2021, ku kërkohet të shtyhet afati deri më 31 mars 2021.

-Konstatohet një moskoherencë dhe mos përputhje mes vendimeve të Kryesisë për të njëjtin fakt. Me vendimin Nr.25, datë 07.04.2021 ka vendosur miratimin për vijimin e procedurës për kandidatët të cilët kanë aplikuar. Për këtë procedurë nuk ka më asnjë gjurmë dokumentacioni se cili ka qenë vazhdimi.

-Në vitin 2022, Kryesia del me Vendim Nr.22, datë 12.04.2022 për disa fusha të reja konkurimi për anëtarë të rinj të Asamblesë. Komisioni teknik i verifikimit me shkresën nr.452 prot., datë 21.06.2022, ka verifikuar dhe shqyrtuar dosjet e kandidaturave të paraqitura për konkurim. Në vijim të procedurës, Kryesia ka dalë me vendim Nr.62, datë 24.10.2022, ku vendos të miratojë vijimin e procedurës së konkurimit për kandidatët që plotësojnë kriteret e parashikuara dhe vendos të mbyllet ky proces brenda datës 25.11.2022. Me vendim Nr.01, datë 04.01.2023 është thërritur mbledhja vjetore e Asamblesë me datë 30.01.2023, ku në rendin e ditës ishte parashikuar zgjedhja e anëtarëve të rinj të Asamblesë. Nuk ka një procesverbal mbledhje, kjo në kundërshtim me nenin 16 të Ligjit Nr.8480/1999.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, është paraqitur observacion me shkresën nr. 959/6 prot., datë 02.04.2024 nga Kryetari i ASHSH S.Gj.

Pretendimet e paraqitura janë si më poshtë vijon:

- Rekomandimi është një detyrim statutor e si i tillë do të zbatohet edhe në të ardhmen. Ndërkohë statuti është zbatuar me rigorozitet e gjithë mangësitë a shkeljet e konstatuara nuk qëndrojnë; ato janë sqaruar me dokumente e fakte se janë të pasakta, me vërejtjet tona të mëparshme. Në parashtrim përmenden dhe vendime që nuk janë qarkulluese. Ka një mospërputhje midis vete gjetjes e rekomandimit. Për sa i takon konstatimit se janë marrë vendime qarkulluese “Për çështje urgjente...” kemi sqaruar e sqarojmë se: statuti lejon marrjen e vendimeve qarkulluese edhe për raste që vlerëson Asambleja prandaj thotë “si rregull”. - Për cdo vendim qarkullues, kur 1/3 e anëtarëve vlerësojnë se nuk duhet të jetë i tillë projekt vendimi tërhiqet. Deri me sot nuk ka pasur asnjë kontestim. - urgjenca ka kuptim relativ e në kushtet e Akademisë kur sipas statutit neni 26/1, po si rregull Asambleja mblidhet dy herë në vit, urgjenca kupton çështje që nuk mund të presin disa muaj.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Grupi i auditimit lexoi me vëmendje gjithë parashtrimet dhe observacionet e dërguara nuk përputhen me konstatimin e bërë. Argumenti juaj nuk paraqet fakt të ri, arsye për të cilën observacioni nuk pranohet.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

Titulli i gjetjes	Mangësi dhe parregullsi ne organizimin dhe funksionimin e Asamblese se ASH dhe Kryesisë, si dhe në dokumentimin e veprimtarisë së tyre.
Situata:	<ul style="list-style-type: none">✓ Në rendin e ditës të miratuar nga Kryetari i ASH me nr. 421 prot., datë 17.06.2021, nuk janë planifikuar diskutimet për miratimin e disa amendamenteve në Statut dhe në rregulloren “Për çmimet shkencore që akordohen nga Akademia e Shkencave dhe për mënyrën e organizimit të konkurseve të tyre”, veprim ky në kundërshtim me nenin 8, pika 1 e Ligjit Nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”.✓ Me Vendimin e Asamblesë nr. 47, datë 21.07.2021, vendim qarkullues, janë miratuar amendimet e Statutit, në kundërshtim me nenin 27, pika 1, të Statutit.✓ Është evidentuar se për mbledhjen e kryer në 09.07.2021 nuk ka një procesverbal të mbledhjes, kjo në kundërshtim me nenin 16 të Ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999, duke pasur në vëmendje rëndësinë e mbledhjes për ndryshimet e Statutit të institucionit.✓ Me Vendimin e Asamblesë nr. 49, datë 23.07.2021 është miratuar ngritja dhe riorganizimi i rjetit të instituteve të shkencave albanologjike ndërmjet kalimit pranë Akademisë së Shkencave të instituteve ekzistuese të Akademisë së Studimeve Albanologjike (ASA): të Institutit të Historisë, të Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë, të Institutit të Antropologjisë Kulturore dhe Studimeve për Artin, të Institutit të Arkeologjisë. Gjatë auditimit është konstatuar se <i>nuk ka një relacion arsyetues nga Kryesia, mbi riorganizimin e këtyre instituteve, duke pasur në vëmendje se marrja e një vendimi qarkullues, formulohet dhe propozohet nga kryesia dhe më pas u përcillet anëtarëve për konfirmim.</i> Po ashtu nuk ka dokumentacion shoqërues që konfirmon shprehjen e dakordësisë të anëtarëve në rrugë elektronike në kundërshtim me nenin 27, pika 2 e Statutit. Vendime të tilla nuk përfshihen në fushën e vendimeve qarkulluese, pasi ato përfshijnë çështje të cilat kanë më shumë rol këshillues e ratifikues dhe jo riorganizim të instituteve, veprim ky në kundërshtim me nenin 27, pika 1 e Statutit. <p>Me vendimin nr.5, datë 29.01.2021, Kryesia shpall njoftimin për 5 vendet e lira për konkurrim për anëtarët e rinj në Asamblenë e ASHSH. Me Vendimin nr.12, datë 02.02.2021 të Kryesisë është shpallur i njëjti objekt si Vendimi nr.5, datë 29.01.2021. <i>Konstatohet se ka dy vendime të Kryesisë së ASH me të njëjtën përmbajtje.</i> Në vijim të vendimit të parë, atij me nr.05, datë 29.01.2021, Kryesia me shkresën nr.85/1 prot., datë 02.02.2021, paraqet kriteret e plotësimit për kandidaturat, vendos afatet për paraqitjen e interesit për konkurrim, afatin për shqyrtimin e plotësimit të kriterëve ligjore nga Komisioni Teknik, afatin e vlerësimit nga njësia bazë universitare a kërkimore, si dhe afatin e shqyrtimit të kandidaturave në komisionet dhe seksionet shkencore të ASH. Ndërkohë kryesia nuk ka përcaktuar anëtarët e komisionit teknik, kjo në kundërshtim me nenin 7, pika 6 e Statutit. Në vijimësi Kryesia del me vendimin nr.20, datë 16.03.2021 për shtyrje afati të</p>



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

	regjistrimit të kandidatëve që konkurrojnë për pranim si anëtarë, por duke ju referuar vendimit të dytë me nr.12, datë 02.02.2021, ku kërkohet të shtyhet afati deri më 31 mars 2021. <i>Konstatohet një mungesë koherence dhe mos përputhje mes vendimeve të Kryesisë për të njëjtin fakt.</i> Me vendimin nr.25, datë 07.04.2021 është miratua për vijimin e procedurës për kandidatët të cilët kanë aplikuar. Për këtë procedurë nuk ka më asnjë gjurmë dokumentare mbi vijimin e procedurës. Nuk ka procesverbal mbledhjeje kjo në kundërshtim me nenin 16 të Ligjit nr.8480/1999.
Kriteri:	Nenin 7, pika 1 dhe neni 16, i Ligjit Nr.8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”. Nenin 27, pika 2 e Statutit. Nenin 7, pika 6 e Statutit.
Ndikimi/Efekti:	Mungesa e një dokumentacioni të plotë në mbështetje të marrjes së vendimeve qarkulluese.
Shkaku:	Mos zbatim i përcaktimeve të kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi	Të merren masa nga titullari i institucionit, që për të gjitha vendimet e Asamblesë dhe të Kryesisë së ASH të dokumentohet qartë dhe të protokollohen të gjitha materialet e veprimtarisë së saj si dhe të zbatohen përcaktimet statutores në fuqi për organizimin dhe funksionimin e Akademisë dhe Kryesisë së ASH.
Afati i zbatimit	Menjëherë.

Akademia e të Rinjve

Akademia e të Rinjve funksionin si organ këshillues e bashkëpunues pranë Akademisë, me qëllim inkurajimin e drejtpërdrejtë të veprimtarisë kërkimore-shkencore të kërkuesve të rinj dhe për vendosjen e një ure komunikimi dhe promovimi me ta. Akademia e të Rinjve ka deri në 20 anëtarë, të zgjedhur nga radhët e kërkuesve të rinj me gradën shkencore “doktor”. Anëtarët e Akademisë së të Rinjve përfshihen në komisionet e Akademisë, marrin pjesë në mbledhjet e seksioneve, si dhe një përfaqësi prej 3-4 personash nga radhët e tyre marrin pjesë në mbledhjen vjetore të Asamblesë, ku miratohet raporti, plani vjetor e projektbuxheti i Akademisë së Shkencave.

Akademia e të Rinjve funksionon si një organizëm autonom në bazë të një statuti të miratuar prej saj dhe me vendim të Kryesisë. Gjatë auditimit konstatohet, se nuk ka një statut mbi bazë të të cilës funksion, kjo në kundërshtim me nenin 20, pika 4 të Ligjit Nr.53/2019 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Akademia e të Rinjve është krijuar me vendim nr.14, datë 07.06.2019 “Për krijimin e Akademisë së të Rinjve pranë Akademisë së Shkencave dhe mbështetjen e studiuesve të rinj”, ku pjesë e saj kanë qenë fitues të cmimeve shkencore për kërkuesit e ri më të sukseshëm, që jepet nga Akademia e Shkencave, kërkues shkencor nën moshën 40 vjec që kanë gradën doktor të shkencave me veprimtari të certifikuar botuar në revista shkencore të WEB of SCIENCE. Mandati i antarëve ndërpritet në moshën 40 vjecare, nga ku 6 prej antarëve deri në 2023 kanë vazhuar të jenë pjesë e akademisë deri në vendimin nr.65, datë 16.11.2023 “Për përbërjen e komisionit për konkursin e pranimit të anëtarëve të rinj në Akademinë e të Rinjve”. Mandati i 6 prej antarëve ka vazhduar



mbi moshën e përcaktuar, kjo në kundërshtim me nenin 20, pikën 1 të Ligjit Nr.53/201, të ndryshuar. Me vendimin Nr.63, datë 16.11.2023 është miratuar “Karta themelore për Akademinë e të Rinjve të Shqipërisë”.

2. Mbi hartimin dhe Zbatimin e Buxhetit të Shtetit.

Hartimi i projekt Buxhetit dhe zbatimi i tij i ASHSH për vitin 2021, 2022, 2023 bazohet në Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Udhëzimin e Përhershëm të Ministrisë së Financave nr.7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”; Ligjin nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, Ligji nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”; Ligji nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”.

2021

Më 20.01.2021, nr. 45 prot., nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dërgohet detajimi i buxhetit të vitit 2021-2023 për shpenzimet korrente. Për vitin 2021 vendoset totali 115,950,000 lekë, për 2022 totali 107,500,000 lekë dhe për 2023 109,500,000 lekë.

Më 16.03.2021, nr. 195 prot., i është dërguar Ministrisë së Financave shkresa “Mbi rialokimin e fondit buxhetor për financimin e hartimit e botimit të tri veprave albanologjike dhe enciklopedike”. Kërkohet rialokimi i fondit prej 4,000 mijë lekë në art. 231 duke pakësuar fondin e shpenzimeve korrente të miratuar për këto projekte pa efekte shtesë për buxhetin. Në datën 07.04.2021, nr. 195/2 prot., Ministria e Financave dhe Ekonomisë i dërgon një shkresë Akademisë së Shkencave dhe Degës së Thesarit për miratimin e transferimeve të fondeve.

Më 30.04.2021, nr. 192/1 prot., Akademia e Shkencave dërgon pasqyrat e PBA 2022-24, Faza 1.

Më 31.08.2021, nr. 516/1 prot., Akademia e Shkencave dërgon pasqyrat e PBA 2022-2024 Faza 2.

Më 07.09.2021 është dërguar shkresa me nr. 559 prot., nga Akademia e Shkencave drejtuar Ministrisë së Financave mbi “Rialokim fondesh buxhetore për vitin 2021. Akademia e Shkencave kërkon rialokim të fondeve buxhetore nga art. 600, art. 601 dhe art. 606 në art. 602 dhe 605. Më 03.11.2021, nr 559/2 prot., Ministria e Financave dhe Ekonomisë miraton transferimin e kërkuar.

Raportet e Monitorimit

Raportet e monitorimit të buxhetit për vitin 2021 janë dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në zbatim të Udhëzimit nr. 22, datë 27.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”, konkretisht:

- Raporti i monitorimit 4–muor për zbatimin e buxhetit është dërguar me shkresën nr. 47, prot datë 16.06.2021, **konkretisht 17 ditë me vonesë**, në kundërshtim me afatin përcaktuar në Udhëzimin nr. 22, datë 27.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”.

- Raporti i monitorimit 8–muor për zbatimin e buxhetit është dërguar me shkresën nr. 417/1 prot., datë 28.09.2021.

- Raporti i monitorimit 12–muor për zbatimin e buxhetit të vitit 2022 është dërguar me shkresën nr. 179 prot., datë 28.02.2022.

Realizimi

Për sa i përket realizimi në terma sasiore dhe në vlerë absolute kundrejt treguesve të planifikuar dhe të pasqyruar në raportet e monitorimit të programit 01520 “Veprimtari Akademike”, në mënyrë të përmbledhur paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQPËRISË

Llog	Shpenzime Korrente	Fakti 2021	Plani PBA	Plani Fillestar 2022	Plani i rishikuar	Plani i periudhës /progresiv	Realizimi	Diferenca
		1	2	3	4	5	6	7=6-5
600	Paga	21,478	30,000	30,000	24,500	24,500	24,500	100%
601	Sigurime Shoqërore	3,341	4,500	4,500	3,950	3,950	3,949	100%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	41,149	50,050	50,050	153,550	153,550	61,797	40%
604	Transferta Korrente të Brendshme	820	1,000	1,000	1,000	1,000	123	12%
605	Transferta Korrente të Huaja	351	400	400	600	600	600	100%
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	25,801	30,000	30,000	28,484	28,484	28,274	99%
I	Totali i Shpenz. Korrente	92,940	115,950	115,950	212,084	212,084	119,243	56%
231	Kapitale të Trupëzuar F.B	1,843	1,000	1,000	5,000	5,000	4,745	95%
II	Totali Shpenzime Kapitale	1,843	1,000	1,000	5,000	5,000	4,745	95%
III	Shp. të ardhurat jashtë limiti	142	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	
IV	Shpenzime nga Sponsorizimet	898	1,500	1,500	1,500	1,277	1,190	93%
I+II+III+IV+V	Totali Përgjithshëm	95,823	118,450	118,450	218,584	218,361	125,178	57%

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të Akademisë së Shkencave

Programi 01520 “Veprimtari Akademike” është realizuar në masën **57%**, pra në vlerën 125,178 mijë lekë, kundrejt 218,361 mijë lekë të planit të periudhës/progresiv, ose me një mosrealizim në vlerën 91,753 mijë lekë kundrejt planit përfundimtar. Krahasuar me planin fillestar programi 01520 është realizuar në masën 105 %, me një **mbi realizim** në vlerën 6,728 mijë lekë kundrejt planit fillestar (për shkak të shtimit të fondeve në llogaritë ekonomike “Mallra dhe Shërbime të tjera”, “Transferta Korrente të Huaja”, “Kapitale të Trupëzuara F.B”)

- Shpenzimet korrente janë realizuar në masën 56 %, me një mos realizim në vlerën 92,841 mijë lekë kundrejt planit të rishikuar. Në shpenzimet totale të realizuara, shpenzimet korrente zënë peshën kryesore prej 95%.

Konkretisht në llogarinë 602 “Mallra e shërbime” , e cila zë dhe 72% të buxhetit, ka një mosrealizim prej 91,753 mije lekë. *Sipas E-mail të dërguar nga Akademia e Shkencave datë 21.12.2023 drejtuar Grupit të Auditimit ky mosrealizim ka ardhur si rrjedhojë e fondit të çelur nga fondi rezervë i Qeverisë në vlerën 100,000,000 leke për financimin e tre projekteve madhore “Enciklopedia e Shqiptarëve”, “Fjalori i madh i gjuhës shqipe” dhe “Historia e shqiptarëve” dhe të përealizuar brenda vitit. Financimi projektit filloi në shtator të vitit 2021 dhe gjatë kësaj periudhe nuk u realizua volumi i punës i parashikuar për vitin 2021. Mbi mosrealizimin prej **2 123 000 leke**, Akademia e Shkencave shprehet se ka ardhur si rrjedhojë e periudhës post-covid ku shumica e aktiviteteve u realizuan on-line.*

Në llogarinë 604 “Transferta Korrente të Brendshme” ka një mosrealizim prej 877 mijë lekë, ose 12% të fondit të përllogaritur. Llogaria 604 ka qenë në vitin 2020 820 mijë lekë, plani i PBA për vitin 2022 1,000 mijë lekë dhe realizimi 12%. Kjo tregon që llogaria 604 është një vlerë e fryrë.

Ky zë përfshin shpenzime për ekspedita studimore në kuadër të protokoll - marrëveshjeve midis ASH dhe ASHAK Kosovë. *Sipas e-mail drejtuar Grupit të Auditimit nga Akademia e Shkencave*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQPËRISË

datë 21.11.2023, ky mosrealizim është i pranishëm pasi nuk u zhvilluan ekspeditat e planfikuar si pasojë kufizimeve të COVID-19.

Duke qenë se COVID ka qenë i pranishëm që në vitin 2020, duhet të ishte marrë parasysh situata gjatë procedurës së Hartimit të Buxhetit.

- Shpenzimet kapitale janë realizuar në masën 95%, me një mos realizim në vlerën 255 mijë lekë kundrejt planit të rishikuar. Në shpenzimet totale të realizuara, shpenzimet kapitale zënë peshën prej 3,7%.

- Shpenzime nga Sponsorizimet janë realizuar në masën 93%, me një mos realizim në vlerën 87 mijë lekë. Gjithashtu në këtë llogari vihet re një ndryshim mes Planit të Rishikuar për vitin 2021 (1,500 mijë lekë) dhe Planit të Periudhës/progresiv (1,277 mijë lekë).

Për realizimin e regjestrave të performancës janë realizuar produktet me të dhëna si vijon:

Në mijë leke

Nr.	Kodi	Projekti	Plani fillestar 2022	Plani me ndryshime 2022	Realizimi	Diferenca
1	92201AA	Veprimtaria shkencore e Asamblesë së A.SH, seksioneve, komisioneve dhe personaliteteve në fushat e shkencës, në përputhje me misionin e saj, pagat dhe shpenzimet administrative	94,550	94,484	94 225	100%
2	92201AB	Veprimtaria shkencore akademike, Veprimtaria e seksioneve, njësitë kërkimore, komisioneve, veprimtaria promovuese (konferenca, seminare, ligjërata, kongrese) etj, veprimtaria botuese, veprimtari kërkimore studimore (projekte), konkurset e çmimeve për krijimtari	2,900	3,100	1,833	59%
3	18AF101	Pasurimi i Bibliotekës Shkencore	300	420	297	71%
4	18AF201	Blerje program kompjuterik për financën	0	0	0	0
5	18AF301	Blerje pajisje zyre dhe elektronike	700	952	919	97%
6	18AF401	Rikonstruksion i mjeteve elektrike dhe ndriçimit të sallës së mbledhjeve	0	0	0	0
7	M220078	Blerje Pajisje për Projektet në albanologji	0	3,628	3,529	97%
8	92201AC	Produkte kërkimore shkencore me nivel të lartë shkencor në fushat prioritare për kërkim dhe zhvillim të vendit dhe më gjerë (Botime dhe monografi) dhe publikimeve shkencore kombëtare/ndërkombëtare (revista "Journal of Natural and Technical Sciences" dhe "Studia Albanica"). Raportime të ASHSH për veprimtaritë e saj.	17,000	17,000	15,128	89%
9	92201AD	Konkurse shkencore të organizuara	1,500	1,500	1,453	97%
10	92201AE	Hartimi i Veprave madhore në albanologji	0	96,000	6,604	7%
		Totali	116,950	217,084	123,988	57%

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të Akademisë së Shkencave

2022

Më 05.01.2022, nr. 2 prot., Ministria e Financave dhe Ekonomisë i dërgon Akademisë së Shkencave shkresën "Mbi detajimin e buxhetit për vitet 2022-2024". Në datën 24.01.2022, nr. 2/2 Ministria e Financave dhe Ekonomisë dërgon të miratuar detajimin e fondeve buxhetore për shpenzimet korrente, konkretisht 151,800,000 lekë për vitin 2022, 127,500,000 lekë për vitin 2023, 109,500,000 lekë për vitin 2024. Më 23.03.2022, nr. 233 prot., (datat e protokollimit në ASH) MFE dërgon një shkresë "Mbi detajimin e ndryshimeve sipas Aktit Normativ Nr. 3, datë 12.03.2022". Sipas kësaj shkrese duhet dërguar brenda datës 18.03.2022 zyrtarisht dhe në mënyrë elektronike detajimi i shtesave dhe pakësimeve të planit të rishikuar të buxhetit për vitin 2022. Më 25.03.2022 Akademia e Shkencave dërgon "Detajimin e ndryshimeve sipas aktit normative nr. 3,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQPËRISË

datë 12.03.2022”. *Kjo shkresë është jashtë afatit të përcaktuar në shkresën fillestare të dërguar nga MFE. Më 28.04.2022, nr. 233/4 prot., Akademia e Shkencave i dërgon MFE shkresën për “Detajim pakësimi sipas AN nr.3, datë 12.03.2022”. Në po të njëjtën datë, me nr. 233/5 prot., dërgojnë Kërkesë për Rialokim fondi brenda shpenzimeve korrente të Programit 01520. Rialokimi kërkohet nisur nga realizimi i pritshëm për vitin 2022 në artikujt 600, 601 dhe 606 dhe moscënimin e realizimit të aktiviteteve kërkimore e shkencore të ASH. Më 05.05.2022, nr. 233/6 prot., MFE miraton ndryshimet.*

Më 29.04.2022, nr. 200/1 prot., Akademia e Shkencave dërgon pasqyrat e PBA 2023-2025 Faza 1. Më 31.08.2022, nr. 219/1 prot., ASH dërgon pasqyrat e PBA 2023-2025 Faza 2.

Në datën 05.08.2022, nr. 541 prot., MFE dërgon detajimin e ndryshimeve sipas Aktit Normativ Nr. 12, datë 29.07.2022 ku jep afatin deri më 03.08.2022 për të dërguar detajimin e shtesave dhe pakësimeve të planit të rishikuar të buxhetit për vitin 2022. Më 01.09.2022, nr. 573 prot., ASH dërgon detajimin e ndryshimeve, *duke mos respektuar afatin e përcaktuar në shkresën paraardhëse. Kjo aprovohet nga MFE më 07.09.2022, nr. 559/2 prot.*

Më 29.08.2022, nr. 569 prot., ASH i dërgon MFE kërkesën për rialokim fondi brenda artikullit 231 “Investime”. Kjo kërkesë u miratua më 13.09.2022, nr. 569/1 prot.

Më 12.10.2022, nr. 678 prot., ASH i dërgon MFE kërkesë për rialokim fondi brenda kodit të institucionit. Kjo miratohet nga MFE me shkresën datë 24.10.2022, nr. 675/1 prot.

Monitorimi

Raportet e monitorimit të buxhetit për vitin 2022 janë dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në zbatim të Udhëzimit nr. 22, datë 27.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”, konkretisht:

- Raporti i monitorimit 4–muor për zbatimin e buxhetit është dërguar me shkresën nr. 385 prot., datë 23.05.2022.

- Raporti i monitorimit 8–muor për zbatimin e buxhetit është dërguar me shkresën nr. 385/1 prot., datë 20.09.2022.

- Raporti i monitorimit 12–muor për zbatimin e buxhetit të vitit 2022 është dërguar me shkresën nr. 165 prot., datë 02.03.2023, **konkretisht 2 ditë më vonë** se afati i përcaktuar në Udhëzimin nr. 22, datë 27.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”.

Realizimi

Për sa i përket realizimi në terma sasiore dhe në vlerë kundrejt treguesve të planifikuar dhe të pasqyruar në raportet e monitorimit të programit 01520 “Veprimtari Akademike”, në mënyrë të përmbledhur paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

Llog	Shpenzime Korente	Fakti 2021	Plani PBA	Plani Fillestar 2022	Plani i rishikuar	Plani i periudhës /progresiv	Realizimi	Diferenca
		1	2	3	4	5	6	7=6-5
600	Paga	24,500	30,000	30,000	25,900	25,900	25,524	99%
601	Sigurime Shoqërore	3,950	4,500	4,500	4,287	4,287	4,181	98%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	61,796	86,700	86,700	73,580	73,850	73,568	100%
604	Transferta Korente të Brendshme	123	0	0	0	0	0	-
605	Transferta Korente të Huaja	600	600	600	600	600	581	97%
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	28,274	30,000	30,000	30,370	30,370	30,370	100%



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQPËRISË

I	Totali i Shpenz. Korente	119,243	151,800	151,800	134,737	134,737	134,224	100%
231	Kapitale të Trupëzuar F.B	4,745	1,000	1,000	9,200	9,200	9,007	98%
II	Totali Shpenzime Kapitale	4,745	1,000	1,000	9,200	9,200	9,007	98%
sIII	Shp. të ardhurat jashtë limiti	142	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	
IV	Shpenzime nga Sponsorizimet	1,190	1,050	1,050	7,546	7,546	1,799	24%
I+II+III+IV+V	Totali Përgjithshëm	125,178	153,850	153,850	151,483	151,483	143,030	94%

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të Akademisë së Shkencave

Për realizimin e regjesve të performancës janë realizuar produktet me të dhëna si vijon:

Në mijë leke

Nr.	Kodi	Projekti	Plani fillestar 2022	Plani me ndryshime 2022	Realizimi	Diferenca
1	92201AA	Veprimtaria shkencore të punonjësve të A.SH.SH në përputhje me misionin e saj	74,800	70,007	69,900	100%
2	92201AB	Produkte të kartave të eventeve për politikën shkencore dhe qeverisje (qendrore/vendore) të KSHT&I me impakt në K-ZH dhe prodhim	35,300	26,430	26,410	100%
3	18AF101	Pasurimi i Bibliotekës Shkencore	300	0	0	-
4	18AF301	Blerje pajisje zyre dhe elektronike	700	1,000	898	90%
5	M220078	Blerje pajisje elektronike (bioteknologji+nanoalb)	0	0	8,109	
8	92201AC	Produkte kërkimore shkencore me nivel të lartë shkencor në fushat prioritare për kërkim dhe zhvillim të vendit dhe më gjerë (Botime dhe monografi) dhe publikimeve shkencore kombëtare/ndërkombëtare (revista "Journal of Natural and Technical Sciences" dhe "Studia Albanica"). Raportime të ASHSH për veprimtaritë e saj.	12,000	12,000	11,997	100%
9	92201AD	Konkurse shkencore të organizuara	0	0	0	-
10	92201AE	Hartimi i Veprave madhore në albanologji	30,000	26,300	25,916	99%
		Totali	153,100	135,737	143,230	105%

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të Akademisë së Shkencave

2023

Më 04.01.2023, nr. 3 prot., i ASHSH dhe 28.12.2022 nr. 23774 prot. i MFE, Ministria e Financave dhe Ekonomisë i dërgon Akademisë së Shkencave shkresën "Mbi detajimin e buxhetit për vitet 2022-2024. Më 23.01.2023, nr. 3/1 prot., Ministria e Financave dhe Ekonomisë i dërgon Akademisë së Shkencave shkresën "Detajimi i shpenzimeve korente për vitet 2023-2025" ku totali për vitin 2023 është 179,000,000 lekë, për vitin 2024 109,500,000 lekë dhe për vitin 2025 109,500,000 lekë.

Më 20.06.2023 nr. 478/1 prot., MFE dërgon në shkresë "Mbi zbatimin e VKM-së nr. 302, datë 17.05.2023" ku miratohet akordimi i fondeve për vitin 2023. Në zërin e Akademisë së Shkencave shtohet 15,900,000 lekë dhe pakësohen nga Fondi Rezervë i KM e njëjta vlerë.

Më 22.11.2023, nr. 827/1 prot., MFE dërgon shkresën për Transferim Fondi për vitin 2023 ku miratohet riallokimi i tyre. Shtohen 3,000,000 lekë në kodin 92201AA dhe pakësohen në koodin 92201AE. Me shkresën e datës 30.11.2023, nr. 827/2 prot., MFE dërgon Miratimin e Limitit për shtesat dhe pakësimet në zërin Shpenzime Personeli dhe Shpenzime Operative dhe udhëzon që të bëhet në muajin nëntor.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

Më 28.04.2023, nr. 198/1 prot., Akademia e Shkencave dërgon pasqyrat e PBA 2024-2026, Faza 1. Më 30.08.2023, nr. 566/1 prot., Akademia e Shkencave dërgon formularët standartë të Projektbuxhetit për periudhën 2024-2026 (faza e dytë) si dhe relacionin shpjegues me kërkesat shtesë.

Raportet e monitorimit të buxhetit për vitin 2023 janë dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në zbatim të Udhëzimit nr. 22, datë 27.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”, konkretisht:

- Raporti i monitorimit 4–mujor për zbatimin e buxhetit është dërguar me shkresën nr. 425 prot., datë 23.05.2022.

- Raporti i monitorimit 8–mujor për zbatimin e buxhetit është dërguar me shkresën nr. 425/1 prot., datë 13.09.2023.

Në raportin “Mbi monitorimin e shpenzimeve të Akademisë së Shkencave për periudhën Janar-Gusht 2023” institucioni menaxhoi fondet buxhetore në programin “Veprimtari Akademike”, krahasuar me planin vjetor të miratuar me realizimin si më poshtë:

Në mijë lekë

Nr.	Emërtimi	Buxheti vjetor 2023	Fakti 8-Mujorit i vitit 2023	Në %
1	Paga (600)	34,000	22,797	67
2	Sigurime shoqërore (601)	5,047	3,541	70
3	Shpenzime korrente (602)	113,400	27,843	25
4	Transferta me jashtë (605)	600	496	83
5	Transferime të brendshme (606)	46,200	25,000	54
6	Investime (231)	10,000	752	8
	Totali i Shpenzimeve	209,247	80,429	38

Llogaria 602:

-Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2022 vihet re rënie me 1% (ishte 26%)

Llogaria 605:

-Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2021 vihet re rënie me 17% (ishte 100%)

-Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2022 vihet re rënie me 14% (ishte 97%)

Llogaria 606:

-Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2021 vihet re rënie me 7% (ishte 61%)

-Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2022 vihet re rënie me 12% (ishte 66%)

Llogaria 231:

-Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2022 vihet re rënie me 26% (ishte 64%)

Shpenzimet me fondet e buxhetit sipas limiteve të miratuara:

Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2022 vihet re rënie me 5% (ishte 43%)

Në milionë lekë

Nr.	Emërtimi	Fondi limit 8-mujori viti 2023	Fakti 8-Mujorit i vitit 2023	Në %
1	600-601	27,247	26,338	97
2	602-606	112,400	53,339	47
	Totali i Shpenzimeve	139,647	79,677	57

Llogaria 600-601:

-Në krahasim me periudhën Janar-Gusht 2022 vihet re rënie e realizimit me 3% (në 2022 ishte 50%).



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

Totali i shpenzimeve:

-Në krahasim me periudhën Janar-Gusht 2022, vihet re rënie e realizimit me 1% (në 2022 ishte 58%).

Shpenzimet faktike në nivel artikulli për periudhën 01.01.2023-30.11.2023 janë:

Llogaria Ekonomike	Buxheti vjetor miratuar			Shpenzimet faktike	Diferenca (3-4)	% realizimit
	Fillestar	Ndryshime te vitit	Plani me ndryshime			
1	2	3	4	5	6	7
	189 012 725	24 486 317	213 499 042	140,233,731	73,265,311	66
	189 000 000	23 847 000	212 847 000	139,590,407	73,256,407	66
	12 725	639 317	652 042	643,138	8 904	99
600	30 500 000	9 100 000	39 600 000	33,340,456	6,259,544	84
601	4 500 000	1 547 000	6 047 000	5,118,745	928,255	85
602	113 400 000	-3 000 000	110 400 000	51,646,533	58,753,467	47
602	10 000 000		10 000 000	8,906,270	1,093,730	89
602	36 400 000	0	36 400 000	25,918,723	10,481,277	71
602	12 000 000		12 000 000	297,427	11,702,573	2
602	55 000 000	-3 000 000	52 000 000	16,524,113	35,475,887	32
605	600 000		600 000	541,927	58,073	90
606	30 000 000	16 200 000	46 200 000	40,305,764	5,894,236	97
231	10 000 000	0	10 000 000	8,637,168	1,362,832	86
231	0	0	0	0	0	0
231	1 000 000	0	1 000 000	505,968	494,032	51
231	9 000 000	0	9 000 000	8,131,200	868,800	90
602	12,725	639,317	652,042	643,138	8,904	99

Duke qenë se kjo tabelë vlen vetëm për periudhën Janar-Nëntor 2023 ende nuk mund të gjykohet për % e realizimit.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi Nëpunësi Autorizues R.K dhe Përgjegjësja e Sektorit të Financës M.M.

Titulli i gjetjes nr. 1	Parregullsi në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Buxhetit të ASHSH.
Situata:	<p>Nga auditimi i hartimit dhe zbatimit të buxhetit të ASHSH u konstatuan mangësitë si më poshtë:</p> <p>-Për vitin 2021: Programi buxhetor i shpenzimeve në zërin 01520 “Veprimtari Akademi” është realizuar në masën 57%, pra në vlerën 125,178 mijë lekë, kundrejt 218,361 mijë lekë të planit të periudhës/progresive, ose me një mosrealizim në vlerën 93,183 mijë lekë kundrejt planit përfundimtar.</p> <p>Shpenzimet korrente janë realizuar në masën 56 %, me një mos realizim në vlerën 92,841 mijë lekë kundrejt planit të rishikuar. Në shpenzimet totale të realizuara, shpenzimet korrente zënë peshën kryesore prej 95%. Konkretisht në llogarinë 602 “Mallra e shërbime” ka një mosrealizim prej 91,753 mije lekë.</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

	<p>Në llogarinë 604 “Transferata Korrente të Brendshme” ka një mosrealizim prej 877 mijë lekë, ose 12% të fondit të përlogaritur. Llogaria 604 ka qenë në vitin 2020 në shumën 820 mijë lekë, plani i PBA për vitin 2022 në shumën 1,000 mijë lekë dhe realizimi 12%. Kjo tregon që 86% e llogarisë 604 nuk është realizuar, gjë që tregon problematika në planifikimin e buxhetit.</p> <p>-Raportet e monitorimit të buxhetit për vitin 2021 janë dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në zbatim të Udhëzimit nr. 22, datë 27.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”, por nuk janë zbatuar afatet e përcaktuara në Udhëzim, konkretisht:</p> <p>- Raporti i monitorimit 4–muor për zbatimin e buxhetit është dërguar me shkresën nr. 47, prot datë 16.06.2021, 17 ditë me vonesë, në kundërshtim me afatin përcaktuar në Udhëzimin nr. 22, datë 27.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”.</p> <p>-Raportet e monitorimit të buxhetit për vitin 2022 janë dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në zbatim të Udhëzimit nr. 22, datë 27.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”, konkretisht:</p> <p>- Raporti i monitorimit 12-muor për zbatimin e buxhetit të vitit 2022 është dërguar me shkresën nr. 165 prot., datë 02.03.2023, 2 ditë më vonë se afati i përcaktuar në Udhëzimin nr. 22, datë 27.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”.</p>
Kriteri:	<p>-Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 4</p> <p>- Ligji Nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenit 4, pika 23/1.</p> <p>Ligji nr. 53/2019 “Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë”.</p>
Ndikimi/Efekti:	<p>Rialokimet e shpeshta të fondeve buxhetore përgjatë vitit ushtrimor dhe realizimi buxhetit në masën 57% në vitin 2021, 94% në vitin 2022 japin indicie për mungesën e një planifikimi efektiv të buxhetit të ASHSH. Mungesa e një modeli për parashikimin e shpenzimeve buxhetore për vitin pasardhës sjell një parashikim jo real.</p> <p>Mungesa e korrektesisë së dërgimit të raporteve të monitorimit mund të sjellë vonesa në evidentimin e nivelit të realizimit të fondeve buxhetore të ASHSH në krahasim me planin e miratuar.</p>
Shkaku:	<p>Mungesa e harmonizimit të veprimtarisë së Kryesisë dhe Sektorit të Financës.</p> <p>Neglizhencë nga ana e strukturave përgjegjëse për mos-raportimin brenda afateve të përcaktuara.</p>
Rëndësia:	E mesme



Rekomandime:	<p>Të gjitha hallkat e ASHSH të bashkëpunojnë në fazën e hartimit të projektbuxhetit për të shmangur realizimin e tij në përqindje të ulët dhe rialokime të shpeshta gjatë vitit. Kjo mund të bëhet me anë të mbledhjeve të ndryshme mes Sektorëve, me anë të kërkesave të Njësive për projektet që do të zhvillohen të cilat duhet të dokumentohen.</p> <p>Strukturat përgjegjëse të ASHSH të marrin masa për përgatitjen brenda afateve të përcaktuara në ligj të raporteve të monitorimit 4 mujore dhe vjetore të zbatimit të buxhetit, të cilat i japin mundësinë institucionit të përmirësojë procesin e planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit.</p>
---------------------	--

3. Mbi pasqyrat financiare të Institucionit.

Për vitet objekt auditimi ky Institucion, organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit e ka të strukturuar brenda Sektorit të Financës.

Nga auditimi rezultoi se për vitet 2021 dhe 2022 mbajtja e kontabilitetit dhe mbyllja e llogarive vjetore në Akademinë e Shkencave është bërë në përputhje me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar me Udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në UMF nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Dokumentat justifikuese për kryerjen e veprimeve ekonomike, janë plotësuar konform dispozitave ligjore në fuqi. Gjithashtu janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të Ligjit “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”.

Bilanci ka të plotësuar aktiv-pasivin pasqyrat dhe anekset përkatëse dhe informacionin.

Pasqyrat financiare viti 2021 .

Regullshmëria e përgatitjes, dorëzimi dhe aprovimi i pasqyrave financiare vjetore.

Plotësimi i pasqyrave financiare, sipas udhëzimeve të Ministrisë së Financës: janë përfunduar dhe dërguar pasqyrat financiare vjetore në Degën e Thesarit me shkresën nr.247 prot, datë 25.03.2022 ku nga auditimi u konstatua se mungon konfirmimi nga dega e thesarit (nr.protokolli apo vula të vendosura nga thesari).

Pasqyrat Financiare të vitit 2021 janë përgatitur dhe dorëzuar në afatin e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë së Financave.

Llogaria vjetore e këtij viti përmban: Pasqyrën e Pozicionit Financiar (aktivi dhe pasivit të bilancit kontabël); Pasyrën e Performancës Financiare (shpenzimeve dhe të ardhurave të ushtrimit); Pasqyrën e Fluksit të mjeteve monetare; Pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto; Pyetësoarin dhe shënimet shpjeguese formati nr.5; Pasqyrën financiare të investimeve dhe burimeve të financimit formati nr.6; Pasqyra Gjendja dhe ndryshimet në Aktivet Afatgjata (kosto historike) formati nr. 7/a; Pasqyra Gjendja dhe ndryshimet në Aktivet Afatgjata (vlera neto) formati nr. 7/b; Pasqyra e numrit të punonjësve formati nr.8



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË
AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË**Nga verifikimi i pasqyrave financiare të vitit 2021 rezultoi:**

Për të parë në mënyrë më të detajuar se si kanë ndryshuar zërat e aktiveve, analizojmë tabelën më poshtë:

Në lekë

Aktive	Gjendja në celje të ushtrimit	Shtesa gjatë vitit 2021	Pakësime gjatë vitit 2021	Gjendja në mbyllje	Ndryshimi
Aktive Afatgjata Jomateriale	222,568		33,385	189,183	(33,385)
Studime dhe kërkime	222,568		33,385	189,183	(33,385)
Aktive Afatgjata Materiale	46,252,432			43,930,367	
Ndërtim edhe konstruksione	402,340,488	54,144,930	5,934,310	450,551,108	48,210,620
Instalime teknike, makineri dhe pajisje	127,244,100	3,801,300	8,824,809	122,220,591	(5,023,509)
Mjete transporti	20,915,618	-	5,856,549	15,059,069	(5,856,549)
Inventar Ekonomik	18,614,641	-	558,440	18,056,201	(558,440)
Totali	569,114,847	57,946,230	21,174,108	605,886,969	36,772,122

Burimi: Akademia e Shkencave, përpunoi grupi auditimit

Nga auditimi në lidhje me përbërjen e llogarisë së Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara u konstatua se, llogaria “Ndërtime e Konstruksione” zë peshën më të madhe prej afërsisht 74% ndaj totalit të Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara, pas saj vijon llogaria “Instalime teknike, makineri dhe pajisje” e cila zë peshën prej 20%, llogaria “Inventar ekonomik” me peshën prej 3.5% ndaj totalit të Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara dhe në fund me peshën më të vogël prej 2.5% ndaj totalit të Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara përfaqësohet llogaria “Mjete transporti”.

Gjendja e llogarive aktive në fund të vitit 2020, gjendja e tyre një vit më parë, por edhe diferenca midis dy periudhave (2021-2020), rezultuan si në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

Llog.	Emërtimi i llogarive të aktivitetit	2021	2020	Diferenca 2021 – 2020
A	AKTIVE	106,694,124	113,871,217	(7,177,093)
	I. Aktive Afatshkurtra	62,574,574	67,396,218	(4,821,644)
	1. Mjete Monetare dhe ekuivalente të tyre	90,263	216,582	(126,319)
531	Mjete Monetare në Arkë	2,971	2,971	--
520	Disponibilitete në Thesar	87,292	213,611	(126,319)
	2. Gjendje inventari	58,679,166	63,443,616	(4,764,450)
31	Materiale	1,868,954	4,279,033	(2,410,079)
32	Inventar i Imët	56,810,213	59,164,583	(2,354,370)
	3. Llogari të arkëtueshme	3,805,145	3,736,020	69,125
468	Debitorë të ndryshëm	11,344	11,344	-
4342	Të tjera operacione me shtetin	3,793,801	3,724,676	69,125
	II. Aktive Afatgjata	44,119,550	46,475,000	(2,355,450)
20	Aktive Afatgjata Jomateriale	189,183	222,568	33,385
203	Studime dhe kërkime	189,183	222,568	33,385
20	Aktive Afatgjata Materiale	43,930,367	46,252,432	(2,322,065)
212	Ndërtime e Konstruksione	31,643,349	32,205,082	(561,733)
214	Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune	1,403,345	1,996,606	(593,261)
215	Mjete transporti	2,190,104	2,737,630	(547,526)
218	Inventar ekonomik	8,693,570	9,313,114	(619,544)
	TOTALI I AKTIVIT	106,694,124	113,871,217	7,177,093

Burimi: ASH, përpunoi grupi auditimit

Zëri Aktive paraqitet për 106,694,124 lekë

Ky post është i barabartë me shumën e postit “Aktive afatshkurtra” plus “Aktive afatgjata”.

Aktive Afatshkurtra. Totali i kësaj rubrike përfaqëson vlerën neto të aktiveve afatshkurtra dhe pasqyrohet në shumën 62,574,574 lekë, e cila ka dalë si shumë e përgjithshme e llogarive “Mjeteve



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

monetare dhe ekuivalente të tyre” me “Gjendje inventarit qarkullues” dhe “Llogarive të arkëtueshme”.

Përbërës të këtij posti janë llogaritë:

1. Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre me vlerë 90,263 lekë e cila është pakësuar nga viti paraardhës me 126,319 lekë dhe përbëhet nga:

Llogaria 531 “Mjete monetare në Arkë” me vlerën prej 2,971 lekë, mbartur nga viti i shkuar me të njëjtën vlerë.

Kjo llogari përfaqëson arkën në valutë ku ndodhen 8,500 forinta hungareze si shlyerje e një paradhënie në valutë të cilën Banka e Kursimeve nuk e ka konvertuar. Kjo gjendje është e para vitit 2000.

Llogaria 520 “Disponibilitete në thesar” me vlerën prej 87,292 lekë, pakësuar nga viti shkuar me 126,319 lekë.

Kjo llogari përfaqëson shumën e papërdorur të fondeve të mbartura dhe financimet e vitit 2021 si më poshtë:

<i>Gjendje nga viti 2020 është:</i>	<i>213 611 lekë</i>
Sponsorizuar gjate vitit cdo muaj total	+ 1 063 568 lekë
Përdorur gjatë vitit	- 1 189 887 lekë
Shuma e mbetur 31.12.2021 për tu mbartur 2022	<i>87 292 lekë</i>

Kjo gjendje përputhet me situacionin vjetor 31.12.2021

Në aktiv llog. 520 “Disponibilitete në thesar” paraqitet gjendja e fondeve të trashëguara të mbetura si fonde të papërdorura përgjatë vitit, në vlerën 87,292 lekë.

Referuar UMF nr.8 datë 09.03.2018 “ Për procedurat e përgatitjes dhe paraqitjes të PF vjetore të NJQP” llogaria 520 “Disponibilitete në thesar” në kushtet e njësisë që po trashëgon të ardhura nga një vit ushtrimor në tjetrin, sipas kuadrit ligjor në fuqi, kjo llogari duhet të pasqyrohet për tepricën debitore të saj në aktivet e pasqyrës së pozicionit financiar dhe tepricat e llogarisë 520, “Disponibilitete në thesar” duhet të vërtetohen me aktrakordim me thesarin (gjurmë e cila mungon), ku duhet të paraqiten të strukturuar sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të paçelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grantit që trashëgohet).

Lidhja mes llogarisë 520 “disponibilitete në thesar”, llogarisë 85, “Rezultat i veprimtarisë ushtrimore” dhe llogarisë 12, “Rezultat i mbartur”.

Në mënyrë të detajuar, sikundër parashikohet në UMF nr.8 datë 09.03.2018 “ Për procedurat e përgatitjes dhe paraqitjes të PF vjetore të NJQP”:

- Llogaria 85 "Rezultati i ushtrimit nga funksioni" kur del me saldo kreditore, përfaqësohet si rubrikë më vete dhe përbën rezultatin nga viti ushtrimor si tepricë kreditore e kësaj llogarie në vlerën 4,677,158 lekë (Të ardhurat 120,588,901 – shpenzimet 125,266,059 = (4,677,158) lekë), **ndërsa kur del me saldo debitore, v.2021 pasqyron rezultatin negativ për të cilin duhen dhënë shpjegime në shënimet shpjeguese.** (Akti i rakordimit me thesarin si të ardhura nga sponsorizimet për vlerën 1,063,568 lekë ku mungon gjurma e mësipërme).

- Në pasivin e bilancit, formati nr. 2, Llog. Nr. 12 “Rezultati i mbartur nga funksionimi” paraqitet në vlerën 9,126,323 lekë dhe është një llogari që trashëgon fonde në fillim të vitit. Nga auditimi u konstatua se, në fillim të vitit ushtrimor, duhet të saktësohej pozicioni i çeljes së llogarive nga viti i mëparshëm (2020) dhe të realizohej transaksioni i transferimit të tepricës së llogarisë 85, “Rezultat i veprimtarisë ushtrimore” në llogarinë 12, “Rezultat i mbartur”.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

1. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi u konstatua se, referuar aktrakordimit të të ardhurave me thesarin për v.2021 rezultonte se total i mjeteve monetare që ngeleshin për tu trashëguar ishte 0.00 lekë, po ashtu mungonte gjurma e rakordimit të llogarisë 520 në këtë akt rakordimi duke mos paraqitur tepricat të strukturuar sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të paçelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grantit që trashëgohet). Sa më sipër rezulton moskryerje e këtyre veprimeve rregulluese dhe përmblyëse të fundit të periudhës nga ana e ASH, operuar në kundërshtim me *UMF nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes dhe paraqitjes të PF vjetore të NJQP”*.

Gjendje Inventari Qarkullues me vlerën 58,679,166 lekë.

Totali i llogarisë Gjendje inventari qarkulles ka pësuar një pakësim me 4,764,449.96 lekë nga viti i shkuar 2020. Nga krahasimi i të njëjtave poste për dy vitet, rezulton se diferenca e gjendjeve të inventarëve në fund të dy viteve, përputhet me efektin debitor të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjes së materialeve” në Pasqyrën e performancës.

Në përbërje të kësaj llogarie janë:

Llogaria 31 “Materiale” me vlerë 1,868,954 lekë, pakësuar nga viti i shkuar me 2,410,079 lekë, dhe pasqyron gjendjen e inventarit më datë 31.12.2020.

Ky pakësim ka ardhur si rrjedhojë e daljeve për efekt të funksionimit të aktivitetit të institucionit.

Nr.	Emërtimi	Gjendja në fillim	Blerje dhe hyrje	Dalje	Gjendja në fund
1.	Gjendja materialeve nga viti kaluar	4,279,033			
2.	Blerje materiale për funksionim		8,177,510		
3.	Shkarkuar gjatë vitit 2021			10,587,589	
4.	Gjendje në fund të vitit 2021				1,868,954
	Total	4,279,033	8,177,510	10,587,589	1,868,954

Burimi: ASH, përpunoi Grupi i Auditimit

Llogaria 32 “Inventar i imët” me vlerë 56,810,213 lekë, pakësuar nga viti i shkuar me 2,354,371 lekë.

Në përbërje të saj është kosto e dhurimit të librave në institucione të tjera si dhe në aktivitete promovuese dhe kopjet falas për autorët dhe kryesinë sipas Vendimit të Kryesisë:

Nr.	Emërtimi	Gjendja në fillim	Blerje dhe hyrje	Dalje	Gjendja në fund
1.	Gjendja botime nga viti kaluar	59,164,583			
2.	Blerje libra		3,108,600		
3.	Shkarkuar gjatë vitit 2021			5,462,971	
4.	Gjendje në fund të vitit 2021				
	Total	59,164,583	3,108,600	5,462,971	56,810,212

Burimi: ASH, përpunoi Grupi i Auditimit

Në total ndryshimi i gjendjes së materialeve është shtuar me 4,764,450 lekë, e bararbartë me llogarinë 63 evidentuar në pasqyrën e performancës financiare.

1. Llogari të arkëtueshme me vlerë 3,805,145 lekë e cila përbëhet nga:

Llogaria 4342 “Operacione me shtetin” me vlerë 3,793,801 lekë shtuar nga viti paraardhës me 69,125 lekë, *kjo llogari përfshin:*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

Saldo e llogarise 4342	3,793,801	
Detyrime ndaj furnitoreve		1,276,953
Pagat e muajit dhjetor 2021		1,630,072
Tatim mbi pagen dhjetor 2021		168,316
Sigurime shoqerore dhjetor 2021		603,684
Sigurim suplementar		44,475
Sigurime shendetsose		70,301
<i>Total</i>	<i>3,793,801</i>	<i>3,793,801</i>

Burimi: ASH, përpunoi Grupi i Auditimit

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” për 11,344 lekë, mbartur ndër vite dhe përfaqëson një detyrim të pashlyer UB Kamëz për blerje periodike.

Nga auditimi i dokumentacionit justifikues u konstatua se, vlera e mbartur daton prej vitit 2001 për blerje librash me vlerë totale 19,650 lekë por për shkak të periudhës kohore të largët prej ASH specifikohet se nuk disponohet dokumentacion justifikues i diferencës që është arkëtuar dhe është vijuar me regjistrimin në kontabilitet të vlerës 11,344 lekë mbi bazë historike.

Aktive Afatgjata. Totali i kësaj rubrike përfaqëson vlerën neto të aktiveve afatgjata dhe pasqyrohet në vlerën 44,119,550 lekë, e cila ka dalë si shumë e përgjithshme e llogarive “aktive afatgjata jomateriale” dhe “aktive afatgjata materiale”.

Përbërës të këtij posti janë llogaritë:

1. Llogaria 20 “Aktive Afatgjata Jomateriale” me vlerë totale prej 189,183 lekë pakësuar nga viti i shkuar me 33,385.20 lekë përbëhet nga:

Llogaria 202 “Studime dhe kërkime” me vlerë 189,183 lekë pakësuar nga viti i shkuar me 33,385.20 lekë dhe përfaqëson një studim “Studimi i rregullimit të tërësisë ujore të Shkodrës” në vlerën fillestare 308,053 lekë e mbartur prej shumë vitesh në pasqyra financiare.

Studimi daton prej vitit 2004 dhe vlera fillestare e tij ka qenë 308,053 lekë. Ky studim nuk është jetëzuar në asnjë moment dhe vijon të mbetet vetëm në letra. Prej Akademisë së Shkencave ka filluar të llogaritet amortizim i vlerës së studimit prej vitit 2019, praktik e cila vijon të kryhet ende. Aktualisht nuk është ndërmarrë asnjë nismë për vlerësimin e efektivitetit të këtij studimi (duke patur parasysh se periudha kohore që ka kaluar është relativisht e gjatë 19 vite) apo mundësinë për ta vendosur në zbatim apo jo referuar ndryshimeve që kanë ndodhur me vitet.

2. Llogaria 21 “Aktive Afatgjata Materiale” me vlerë totale prej 43,930,367 lekë pakësuar nga viti i shkuar me 1,532,215 lekë përbëhet nga:

Llogaria 212 “Ndërtime dhe konstruksione” në vlerën e 31,643,349 lekë, pakësuar nga viti shkuar me 561,733 lekë.

Në përbërje të kësaj llogarie përfshihet vlera e ndërtesës së institucionit prej 18,105,620 lekë si dhe një tendë me strukturë metalike në vlerën 655,200 lekë, po ashtu pjesë e llogarisë 212 është edhe fondi i bibliotekës shkencore respektivisht me vlerë 15,923,303 lekë (libra).

Nga auditimi rezultoi se në formatin nr.1, llogaria 212 “Ndërtime e konstruksione” paraqitet për vlerën 31,643,349 lekë (i zbërthyer në mënyrë analitike, përfshihet vlera e ndërtesës prej 18,105,620 lekë; vlera e një tendë me strukturë metalike prej 655,200 lekë; vlera e librave pjesë e fondit të librave shkencorë prej 15,923,303 lekë; (përgjatë vitit 2021 është kryer një shtesë me vlerë 297,177 lekë si rrjedhojë e blerjes por e përfshirë në këtë total).



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQPËRISË

Nga ana e Akademisë së Shkencave specifikohet se pjesë e inventarit të aseteve të ASH dhe pjesë e bilancit kontabël konkretisht në llogarinë 212 “Ndërtime e konstruksione” pasqyrohet edhe fondi i librave shkencorë.

- Në këto kushte është kryer një keqklasifikim i aktiveve, operuar me një kontabilizim jo korrekt duke përfshirë libra (pa grup/klasifikim në bazë të përdorimit) në llogarinë ekonomike 212 “Ndërtime e konstruksione”.

- Ky keqklasifikim bën që kjo llogari të mos pasqyrojë situatën reale të njësisë si dhe denatyrton pasqyrat financiare për sa i takon natyrës së klasifikimit të llogarive.

Po ashtu nga ana e ASH specifikohet se përgjatë vitit 2021 është kryer investim në vlerën 132,344 lekë për efekt të fondit të librave konkretisht blerje e librave shkencore. Kontabilizimi i kësaj vlere prej 132,344 lekë si pjesë e llog.212 “Ndërtime e konstruksione” si më lartë e theksuam, është e pa saktë dhe denatyrton llogarinë e aktiveve afatgjata.

Nga ana e ASH është kryer përlllogaritja e amortizimit në grup për aktivet, duke bërë që librat dhe ndërtesa të amortizohen me të njëjtën normë amortizimi.

Në këto kushte hasim në dy problematika, së pari llogaritje të amortizimit për libra ndërkohë që janë asete që nuk amortizohen dhe së dyti, edhe nëse do të ndodheshim në kushtet përjashtimore për këtë kategori (referuar SKK 5 pika 30, paragrafi II) sërish kemi përdorimin e të njëjtës normë për dy kategori të ndryshme.

Sa më sipër, operuar në kundërshtim me SKK 5 pika 30 e tij, e cila specifikon se ... *Vlera e amortizueshme e një elementi të AAM-së njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, si shpenzim në mënyrë sistematike përgjatë jetës së dobishme të këtij aktivi. Përjashtime bëjnë aktivet afatgjata materiale me jetë të dobishme pa afat si për shembull, toka (përveç minierave dhe vendeve të përdorura për groposje), punimet e artit me jetë afatgjatë, veprat e muzeve dhe librat të cilat nuk amortizohen.* (Punimet e artit të marra për qëllime projektimi, si dhe veprat e muzeve dhe librat, që duhet të zëvendësohen pas një periudhe kohe të caktuar, amortizohen gjatë jetës së tyre të dobishme).

Nga auditimi u konstatua se, nga ana e Akademisë së Shkencave 3 (tre) nga këto godina nuk rezultojnë të kenë gjurmë pasqyrimi në pasqyra financiare. Konkretisht bëhet fjalë për:

1. Salla e mbledhjeve, me sipërfaqe 180 m²
2. Zyrë dhe garazhe me sipërfaqe 299.25 m²
3. Godina e re Enciklopedia 352 m²

Gjendja e llogarive pasive në fund të vitit 2021, gjendja e tyre një vit më parë, si dhe diferenca midis dy periudhave (2021-2020), rezultuan si në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

Llog.	Emërtimi i llogarive të pasivit	2021	2020	Diferenca 2021-2020
B	DETYRIME	3,793,801	3,724,676	69,125
Klasa 4	Passive afatshkurtër	3,793,801	3,724,676	69,125
401-408	Furnitorë 401	1,276,953	1,787,377	(510,424)
42	Detyrime ndaj personelit	1,630,072	1,298,173	331,899
431	Detyrime ndaj Shtetit për tatim-taksa	168,316	135,963	32,353
435	Sigurime shoqërore	718,460	503,163	215,297
436	Sigurime shëndetsore			
C	FONDI I KONSOLIDUAR	102,900,323	110,146,542	(7,246,219)
101	Fonde bazë	92,395,104	97,191,483	(4,796,379)
105	Grante të brendshme kapitale	6,056,054	3,615,125	2,440,929
12	Rezultatet e mbartura	9,126,323	6,038,688	3,087,635



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQPËRISË

85	Rezultati i Veprimtarisë Ushtrimore	4,677,158	3,301,246	1,375,912
X	TOTALI I PASIVIT (A+B)	106,694,124	113,871,217	(7,177,093)

Burimi: ASH, përpunoi grupi auditimit

Duke analizuar pasivin e bilancit të këtij viti dhe duke e krahasuar me një vit më parë, rezultojnë llogaritë pasive janë më shumë se një vit më parë për 36,818,353 lekë, ndërsa me klasa dhe llogari rezultojnë si më poshtë:

Llogaria 12 “Rezultatet e mbartur” me vlerë totale prej 9,126,323 lekë, është shtuar për këtë vit dhe përfaqëson shumën e trashëguar nga viti i kaluar 213,611 lekë e cila është përdorur për vitin 2021.

Kjo llogari pasqyron rezultatin e viteve të kaluara mbetur të papërdorur me të drejta të paparashkrueshme për ta përdorur në vitin korrent. Ky rezultat duhet të jetë i argumentuar me të ardhurat në likuiditete në llogarinë financiare të disponibiliteteve, si dhe me të drejta të konstatuara por të pa arkëtuara në periudhat përkatëse ushtrimore.

2. Gjetje nga auditimi:

Për v.2021 llogaria 12 “Rezultatet e mbartur” me vlerë totale prej 9,126,323 lekë, përfaqëson shumën e trashëguar nga viti i kaluar prej 213,611 lekë. Në thelb kjo llogari pasqyron rezultatin e viteve të kaluara mbetur të papërdorur me të drejta të paparashkrueshme për ta përdorur në vitin korrent.

Nga auditimi u konstatua se, kjo vlerë nuk rezultonte e argumentuar me të ardhurat në likuiditete në llogarinë financiare të disponibiliteteve, si dhe me të drejta të konstatuara por të pa arkëtuara në periudhat përkatëse ushtrimore. Operuar në kundërshtim me UMF nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, faqe 32 *Funksionimi i llogarisë 12 ”Rezultati i mbartur”*.

Llogaria 85 “Rezultat i veprimtarisë ushtrimore” shtuar nga viti shkuar me vlerën 4,677,158 lekë dhe përfaqëson ndryshimin e gjendjes së inventarit për vitin ushtrimor 4,764,450 lekë dhe shumën e mbetur në thesar për tu trashëguar vitin e ardhshëm prej 87,292 lekë.

Pas përfundimit të të gjitha veprimeve të mbylljes, sipas procedurës kontabile, llogaria 85, “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” duhet të përfaqësojë, si tepricë kreditore, rezultatin financiar pozitiv nga funksionimi, që rrjedh kryesisht nga të ardhurat që njësisë i mbeten (sipas dispozitave ligjore përkatëse), për t’u trashëguar në vitin ushtrimor pasardhës dhe si tepricë debitorë, kjo llogari duhet të përfaqësojë rezultatin negativ nga aktiviteti i funksionimit, për të cilin duhet të jepjen sqarime në shënimet shpjeguese.

Llogaria 105 “Grant i Brendshëm Kapital” është shtuar me vlerën 6,054,056 lekë dhe përfaqëson, investimet nga blerjet në shumën 4,745,046 lekë si dhe shtesat respektive nga brenda institucionit në shumën 787,544 lekë që janë një tende konstruksion metalik prej 655,200 lekë, shtesë fondi i bibliotekës në llog 212 prej 132,344 lekë, si dhe dhurim nga institucione të tjera AMBU një fotokopje dhe një kompjuter prej 523,464 lekë.

Referuar Udhëzimit nr.5 datë 21.02.2022 “Disa ndryshime në Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018” Llogaritë 105 mbeten me tepricë në fund të periudhave ushtrimore vetëm në rastet kur këto grante janë burim për investimet në proces të institucioneve (të papërfunduara ose të pamarrë në dorëzim). Këto mbyllen (kapitalizohen) me fondet bazë në kohën kur investimi është përfunduar dhe marrë në dorëzim. Në rastin e ASH, në dokumentacionin justifikues të mbylljes së



zërave, vlera e kësaj llogarie paraqitet 6,054,056 lekë, çka do të thotë që veprimet kontabile të mbylljes nuk janë kryer pavarësisht se këto asete janë marrë në dorëzim.

Për v.2021 llogaria 105 “Grant i Brendshëm Kapital” është shtuar me vlerën 6,054,056 lekë dhe përfaqëson, investimet nga blerjet në shumën 4,745,046 lekë si dhe shtesat respektive nga brenda institucionit në shumën 787,544 lekë që janë një tende konstruksion metalik prej 655,200 lekë, shtesë fondi i bibliotekës në llog 212 prej 132,344 lekë, si dhe dhurim nga institucione të tjera AMBU një fotokopje dhe një kompjuter prej 523,464 lekë.

Nga auditimi u konstatua se, në fund të periudhës kontabile llogaria 105 “Grant i Brendshëm Kapital” mbetet me tepricë, pavarësisht faktit se këto grante nuk janë burim për investimet në proces të institucioneve (të papërfunduara ose të pamarrë në dorëzim), pra nga ana e ASH këto vlera nuk janë kapitalizuar me fondet bazë në kohën kur investimi është përfunduar dhe marrë në dorëzim. Operuar kështu në kundërshtim me Udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022“ Disa ndryshime në Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 pika 47 gërma e.

b. Auditimi i llogarive të të ardhurave dhe shpenzimeve

Llogaria 8420 “Derdhje të ardhura në buxhet” e cila përfaqëson të ardhurat e krijuara nga aktiviteti i Akademisë së Shkencave, kjo llogari evidenton transferimin e të ardhurave të realizuara nga institucioni në buxhet, ku pjesëmarrës në to është buxheti i shtetit, në përputhje me Udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018.

Konstatim: Nga auditimi u konstatua se, për v.2021 në veprimet kontabël për efekt të hartimit të pasqyrave financiare, mungonte kontabilizimi në trajtën e regjistrimit dyfish dhe llogarisë në formë T-je për llogarinë financiare 8420 “Derdhje të ardhura në buxhet” e cila përfaqëson të ardhurat e krijuara nga aktiviteti i Akademisë së Shkencave (shitje librave dhe dhënie e sallave me qera) të cilat referuar akt rakordimit me thesarin rezultojnë në vlerën 1,199,782 lekë.

Krahasimi mes pasqyrës së performancës dhe situacionit të shpenzimeve:

U konstatua se, vlerat e paraqitura në pasqyrën e performancës financiare në total *nuk përputhen* me vlerat e paraqitura në situacionin me degën e thesarit Tiranë, “Shpenzimet korrente” sipas pasqyrave paraqiten në vlerën 125,266,059 lekë kurse sipas situacionit të shpenzimeve me degën e thesarit vlera e tyre është 125,177,530 lekë.

Konstatim: Në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare nuk specifikohet se çfarë përfshihet në vlerën e rakorduar me thesarin dhe çfarë vlerash përfshihen në pasqyrat financiare dhe përse nuk rakordojnë këto shuma.

Në kundërshtim me UMF nr. 24128, dt. 27.12.2011 “Procesimi i transaksioneve në fund të vitit” dhe UMF nr. 2, dt. 06.02.2012 “Procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” “Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike” “Rakordimi mujor i shpenzimeve”:

172. Nëpunësi zbatues rakordon me strukturën përgjegjëse për thesarin deri në datën 5 të çdo muaji, mbi shpenzimet mujore/progresive që ka kryer njësia e qeverisjes së përgjithshme. Format i raportit përcaktohet nga struktura përgjegjëse për thesarin.

173. Pas rakordimit mujor të shpenzimeve, njësitë e qeverisjes së përgjithshme përgatisin raportet financiare për vendimmarrjen dhe struktura përgjegjëse për thesarin përgatit raportet financiare periodike të konsoliduara të qeverisë, të cilat publikohen nga Nëpunësi i Pare Autorizues në faqen e internetit të Ministrisë së Financave” dhe UMF nr. 46, dt. 24.12.2020 “Për procedurat e mbylljes



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2020” pika 34 “Degët e thesarit gjenerojnë ... informacionin financiar disponibël/pasqyrat financiare vjetore për njësitë e qeverisjes së përgjithshme. Ky informacion shërben si referencë për nëpunësit zbatues gjatë procesit të hartimit të pasqyrave financiare të institucioneve që përfaqësojnë, të dhënat përfundimtare të cilat i pasqyrojnë në sistemin informatik të qeverisë nëpërmjet strukturës përgjegjëse të thesarit në të degë në zbatim të manualeve përkatës”.

Sa i takon rakordimit të vlerave mes situacionit të shpenzimeve të paraqitura në akt-rakordimin me degën e thesarit Tiranë, “Shpenzimet korrente” dhe ato të pasqyruara në pasqyrat financiare për llogaritë e shpenzimeve për vitin 2021, u konstatua një diferencë prej 88,529 lekë.

Sipas pasqyrës së performancës financiare paraqiten në vlerën 125,266,059 lekë kurse sipas akt rakordimit me degën e thesarit vlera e tyre është 125,177,530 lekë.

Nga auditimi u konstatua se, shpenzimet sipas pasqyrës së performancës financiare paraqiten në vlerën 125,266,059 lekë kurse sipas akt rakordimit me degën e thesarit vlera e tyre është 125,177,530 lekë.

- Në pasqyrat financiare mungon shpjegimi dhe nuk tregohet se çfarë përfshihet në shifrat e rakorduara me thesarin dhe çfarë vlerash përfshihen në deklaratat financiare; si dhe shpjegimi se përse këto shuma rezultojnë me diferenca. Sa më lart është në kundërshtim me UMF nr. 24128, datë 27.12.2011 “Procesimi i transaksioneve në fund të vitit” dhe UMF nr. 9, datë 20.03.2018 “Procedura standarde e zbatimit të buxhetit”, Kreu III, “Procedurat për kryerjen e shpenzimeve publike”, nënkapitulli “Marrja e angazhimeve dhe kryerja e shpenzimeve publike” dhe UMF nr. 8, dt. 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 37 – 39.

Pasqyra krahasuese si më poshtë:

Në lekë

Nr. llog.	SHPENZIMET E USHTRIMIT	Pasqyrat financiare	Rakordimi me thesarin	Diferenca
60	I. Shpenzime Korrente			
600	Paga, shpërblime e të tjera personeli	24,924,192	24,500,000	(424,192)
601	Kontrib.te sig.shoq.e shendets.	4,007,474	3,949,426	(58,048)
602	Mallra dhe shërbime te tjera	62,871,808	62,986,322	114,514
604	Transferime korrente të brendshme		122,740	122,740
605	Transferta korrente me jashtë	602,387	559,887	(42,500)
606	Transferta për buxh. familjare e individë	28,095,748	28,274,109	178,361
231	Investime për AAGJ materiale		4,745,046	4,745,046
	<i>Totali faktik</i>	<i>120,501,609</i>	<i>125,137,530</i>	<i>4,635,921</i>
	<i>Totali sipas Bilancit kontabël</i>	<i>125,266,059</i>		

Burimi ASH, përpunuar nga Grupi i Auditimit

3. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi mbi rakordimin zë për zë të vlerave mes situacionit të shpenzimeve dhe ato të pasqyruara në pasqyrat financiare rezulton se, nga ana e ASH në totalin e llogarisë së shpenzimeve operohej:

- duke shtuar edhe llogarinë 63 “Ndryshim i gjendjes së inventarit” në total të shpenzimeve dhe
- në pasqyrën e performancës financiare (PASH) nuk rezultonte me vlerë llogaria 604 “Transferime korrente të brendshme” ndërkohë që në situacionin e thesarit kjo llogari përmban vlerë (konkretisht 122,740 lekë)



9.1 Nga krahasimi mes pasqyrave dhe situacionit të shpenzimeve, u konstatua se ndryshim tjetër ishte sa i takon veprimeve me llogarinë 231, llogari e cila në pasqyra financiare (në shënime shpjeguese nuk jepet informacion se për çfarë është çelur kjo llogari apo për çfarë është përdorur) rezulton pa vlerë ndërkohë në situacionin me thesarin përmban vlerë (konkretisht, 4,745,046 lekë). Të gjitha këto ndryshime bëjnë që në total këto dy pasqyra të mos kuadrojnë duke diferencuar me vlerën faktike 4,635,921 lekë pasqyruar më tepër në situacionin me thesarin, referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion.

Mbi të ardhurat:

4. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i dokumentacionit justifikues mbi të ardhurat (konkretisht pasqyra e performancës financiare (PASH) dhe akt rakordimi me thesarin, u konstatua se:

- në akt rakordim nuk paraqiten ndarazi (në klasifimin buxhetor me nr.710 9600 të ardhura nga qerata) megjithëse janë gjeneruar të ardhura prej dhënies me qera të sallës “Aleks Buda”;
- sa i takon pjesës së institucionit, pra vlera që institucioni do të mbaj për vete referuar përqindjeve, rezulton se për v.2021 këto vlera nuk janë mbajtur por janë derdhur 100% në favor të buxhetit të shtetit, ndërkohë që referuar përqindjeve këto vlera duhet të mbaheshin nga vet institucioni. Sa më sipër mënyra e pasqyrimit të llogarive cënon transparencën në qarkullimin e fondeve, si dhe nuk operohet në përputhje me UMF nr.8 datë 09/03/2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar.

Pasqyrat financiare viti 2022 .

Regullshmëria e përgatitjes, dorëzimi dhe aprovimi i pasqyrave financiare vjetore.

Plotësimi i pasqyrave financiare, sipas udhëzimeve të Ministrisë së Financës: janë përfunduar dhe dërguar pasqyrat financiare vjetore në Degën e Thesarit me shkresën nr.208 prot, datë 13.03.2022 ku nga auditimi u konstatua se mungon konfirmimi nga dega e thesarit (ekstremitetet e vendosura nga thesari).

Pasqyrat Financiare të vitit 2022 janë përgatitur dhe dorëzuar në afatin e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë së Financave.

Llogaria vjetore e këtij viti përmban: Pasqyrën e Pozicionit Financiar (aktivi dhe pasivit të bilancit kontabël); Pasyrën e Performancës Financiare (shpenzimeve dhe të ardhurave të ushtrimit); Pasqyrën e Fluksit të mjeteve monetare (Cash Flow); Pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto; Pyetësorin dhe shënimet shpjeguese formati nr.5; Pasqyrën financiare të të investimeve dhe burimeve të financimit formati nr.6; Pasqyra Gjendja dhe ndryshimet në Aktivet Afatgjata (kosto historike) formati nr. 7/a; Pasqyra Gjendja dhe ndryshimet në Aktivet Afatgjata (vlera neto) formati nr. 7/b; Pasqyra e numrit të punonjësve formati nr.8.

Konstatim:

Nga auditimi u konstatua se, për të dy vitet (v.2021 dhe v.2022) në pasqyra financiare mungonte konfirmimi nga dega e thesarit (nr.protokolli apo vula të vendosura nga thesari).

- Për v.2021 pasqyrat financiare janë nënshkruar nga znj.L.T punonjëse e ASH por jo zyrtarisht në këtë pozicion, shkresa për komandim në detyrë ka dal me Urdhër nr.1 datë 19.01.2022 “Për komandim të përkohshëm në detyrë”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË
AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQPËRISË***Nga verifikimi i pasqyrave financiare të vitit 2022 rezultoi:***

Për të parë në mënyrë më të detajuar se si kanë ndryshuar zërat e aktiveve, analizojmë tabelën më poshtë:

Në lekë

Aktive	Gjendja në celje të ushtrimit	Shtesa gjatë vitit 2022	Pakësime gjatë vitit 2022	Gjendja në mbyllje	Ndryshimi
Aktive Afatgjata Jomateriale	308,053		147,247	160,806	(147,247)
Studime dhe kërkime	308,053		147,247	160,806	(147,247)
Aktive Afatgjata Materiale	74,802,806			48,519,908	26,282,898
Ndërtim edhe konstruksione	40,630,887	93,449		30,154,631	(10,476,256)
Instalime teknike, makineri dhe pajisje	6,655,211	229,200		1,351,876	(5,303,335)
Mjete transporti	5,643,416	-		1,752,083	(3,891,333)
Inventar Ekonomik	21,873,291.60	8,892,380		15,261,319	(6,611,972.6)
Totali				48,680,713	(147,247)

Burimi: Akademia e Shkencave, përpunoi grupi auditimit

Gjendja e llogarive aktive në fund të vitit 2022, gjendja e tyre një vit më parë, por edhe diferenca midis dy periudhave (2022-2021), rezultuan si në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

Llog.	Emërtimi i llogarive të aktivitetit	2022	2021	Diferenca 2022 – 2021
A	AKTIVE	125,058,856	106,694,124	18,364,732
	I. Aktive Afatshkurtra	76,378,142	62,574,574	13,803,568
	1. Mjete Monetare dhe ekuivalente të tyre	5,749,233	90,263	5,658,970
531	Mjete Monetare në Arkë	2,971	2,971	0
520	Disponibilitete në Thesar	5,746,262	87,292	5,658,970
	2. Gjendje inventari	62,940,188	58,679,166	4,261,022
31	Materiale	8,745,501	1,868,954	6,876,547
32	Inventar i Imët	54,194,687	56,810,213	(2,615,526)
	3. Llogari të arkëtueshme	7,688,722	3,805,145	3,883,577
468	Debitorë të ndryshëm	11,344	11,344	0
4342	Të tjera operacione me shtetin	7,677,378	3,793,801	3,883,577
	II. Aktive Afatgjata	48,680,714	44,119,550	4,561,164
20	Aktive Afatgjata Jomateriale	160,806	189,183	(28,377)
203	Studime dhe kërkime	160,806	189,183	(28,377)
20	Aktive Afatgjata Materiale	48,680,714	43,930,367	4,750,347
212	Ndërtime e Konstruksione	30,154,631	31,643,349	(1,488,718)
214	Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune	1,351,876	1,403,345	(51,469)
215	Mjete transporti	1,752,083	2,190,104	(438,021)
218	Inventar ekonomik	15,261,319	8,693,570	6,567,749
	TOTALI I AKTIVIT	125,058,856	106,694,124	18,364,732

Burimi: MEPI, përpunoi grupi auditimit/

Zëri Aktive paraqitet për 125,058,856 lekë

Ky post është i barabartë me shumën e postit “Aktive afatshkurta” plus “Aktive afatgjata”.

Aktive Afatshkurtra. Totali i kësaj rubrike përfaqëson vlerën neto të aktiveve afatshkurta dhe pasqyrohet në shumën 76,378,142 lekë, e cila ka dalë si shumë e përgjithshme e llogarive “Mjeteve monetare dhe ekuivalente të tyre” me “Gjendje e inventarit qarkullues” dhe “Llogarive të arkëtueshme”.

Përbërës të këtij posti janë llogaritë:



1. Mjete monetare dhe ekuivalentet të tyre me vlerë 5,749,233 lekë e cila është shtuar nga viti shkuar me 5,571,678 lekë dhe përbëhet nga:

Llogaria 531 “Mjete monetare në Arkë” me vlerën prej 2,971 lekë, mbartur me të njëjtën vlerë. Kjo llogari përfaqëson arkën në valutë ku ndodhen 8500 forinta hungareze si shlyerje e një paradhënie në valutë të cilat Banka e Kursimeve nuk e ka konvertuar. Kjo gjendje është e para vitit 2000.

6. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i pasqyrave financiare u konstatua i njëjti fenomen për të dy vitet objekt auditimi (v.2021 dhe v.2022) i pranisë së vlerave në llogarinë 531 “Mjete monetare në Arkë” të mbartura prej vitesh në pasqyrat e institucionit (viti i nisjes së rregjistrimit të kësaj vlere daton përpara v.2000). Kjo llogari përfaqëson arkën në valutë ku ndodhen 8,500 forinta hungareze si shlyerje e një paradhënie në valutë të cilën Banka e Kursimeve nuk e ka konvertuar.

Vijimi i mbajtjes së kësaj vlere, pa asnjë vlerë për ASH dhe pa efekt financiar vetëm sa fryn fiktivisht gjendjen e llogarisë 531 “Mjete monetare në Arkë”.

Sa më sipër operuar në kundërshtim me Ligji nr.83/2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022 “Mbi ndryshimin e udhëzimit numër. 8, datë 09/03/2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” dhe Udhëzimi nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në NjSP”.

Llogaria 520 “Disponibilitete në thesar” me vlerën prej 5,746,262 lekë, shtuar nga viti shkuar me 5,571,678 lekë.

Kjo llogari përfaqëson të ardhurat e papërdorura gjatë vitit 2022 nga sponsorizimet e projektit “Cobbis” në shumën 17,725 lekë dhe granti i dhënë nga AKKSHI për 5 projekte viti 2022-2023 në shumën 5,728,537 lekë (diferenca e çeljes gjatë vitit 2022 në vlerën 6,535,894 lekë me vlerën e përdorur 807,357 lekë). Vlera e pashpenzuar gjatë vitit 2022 mbartet në vitin 2023 sipas projekteve.

Në aktiv llog. 520 “Disponibilitete në thesar” paraqitet gjendja e fondeve të trashëguara (për v.2022 kjo vlerë rezulton në 5,746,262 lekë) të cilat pasqyrohen si fonde të mbetura pa përdorur nga vlera e sponsorizimeve dhe granteve të marra përgjatë vitit. Në total, këto grante dhe sponsorizime të marra përgjatë v.2022 rezultojnë në 6,535,894 lekë, njëkohësisht kjo llogari ka patur gjendje prej vitit të shkuar (v.2021) vlerën prej 87,292 lekë, çka do të thotë që totali i kësaj llogarie të rezultonte në 6,640,911 lekë. Përgjatë vitit janë shpenzuar 807,357 lekë dhe kjo llogari duhet të mbyllet në vlerën 5,833,554 lekë. Referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion grupit të audituesve shtetëror rezulton se:

- Llogaria 520 “Disponibilitete në thesar” nuk gjen pasqyrim në aktrakordimin me thesarin;
✓ Njësitë të cilat trashëgojnë të ardhura nga një vit ushtrimor në tjetrin, sipas kuadrit ligjor në fuqi, nuk do të kryejnë mbylljen e llogarisë së disponibiliteteve në thesar dhe kjo llogari do të pasqyrohet për tepricën debitore të saj në aktivet e pasqyrës së pozicionit financiar. Gjithashtu, llogaria 520 nuk mbyllet edhe për gjendjen e mjeteve në ruajtje, si dhe për sponsorizimet e tjera të trashëgueshme.

✓ Tepricat e llogarisë 520, “Disponibilitete në thesar” duhet të vërtetohen me aktrakordim me thesarin, një kopje e të cilit i bashkëngjitet llogarisë vjetore. Në aktrakordim, tepricat duhet të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

paraqiten të strukturuar sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të paçelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grantit që trashëgohet).

- Kjo vlerë nuk rezulton e pasqyruar me kundërparti edhe në pasivin e bilancit, ku duhet të figurojë e paraqitur për efekt diferenca nga përdorimi i sponsorizimeve (Aktrakordimet me thesarin) në llogarinë 85 “Rezultati i ushtrimit”, kurse diferenca si rezultat i ushtrimit të mëparshëm duhet të pasqyrohet në llogarinë 12 “Rezultat i mbartur”.

✓ Sa i takon zbërthimit në trajtën e regjistrimit dyfish të llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar”, kjo llogari ku duhet të figurojë e paraqitur për efekt diferencash nga përdorimi i sponsorizimeve në llogarinë 85 “Rezultati i ushtrimit” kurse diferenca si rezultat i ushtrimit të mëparshëm duhet të pasqyrohet në llogarinë 12 “Rezultat i mbartur”.

✓ Llogaria 85 “Rezultati i ushtrimit nga funksioni” kur del me saldo kreditore, përfaqësohet si rubrikë më vete dhe përbën rezultatin nga viti ushtrimor si tepricë kreditore e kësaj llogarie në vlerën 10,007,283 lekë (Të ardhurat 145,568,093 – shpenzimet 135,560,810 = 10,007,283 lekë). (Akti i rakordimit me thesarin si të ardhura nga sponsorizimet rezulton për vlerën 922,548 lekë).

- Në pasivin e bilancit, formati nr. 2, Llog. Nr. 12 “Rezultati i mbartur nga funksionimi” paraqitet në vlerën 9,126,323 lekë kur në fakt duhet të paraqitet për vlerën 79,643,724 lekë. Në fillim të vitit ushtrimor, duhet të saktësohet pozicioni i çeljes së llogarive nga viti i mëparshëm (2021) dhe të realizohet transaksioni i transferimit të tepricës së llogarisë 85, “Rezultat i veprimtarisë ushtrimore” në llogarinë 12, “Rezultat i mbartur” .

7. Gjetje nga auditimi:

✓ Për v.2022 llogaria 520 “Disponibilitete në thesar” nuk gjen pasqyrim në aktrakordimin me thesarin, (vlera e llogarisë 520 rezulton në 5,746,261.73 lekë).

- Kjo vlerë nuk rezulton e pasqyruar me kundërparti në pasivin e bilancit kontabël ku duhet të figurojë e paraqitur për efekt diferenca nga përdorimi i sponsorizimeve.

Gjendje Inventari Qarkullues me vlerën 62,940,188 lekë.

Totali i llogarisë Gjendje inventari qarkulles ka pësuar një shtim me 4,261,022 lekë nga viti i shkuar 2021. Nga krahasimi i të njëjtave poste për dy vitet, rezulton se diferenca e gjendjeve të inventarëve në fund të dy viteve, përputhet me efektin debitor të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjes së materialeve” në Pasqyrën e performancës.

Në përbërje të kësaj llogarie janë:

Llogaria 31 “Materiale” me me vlerë 8,745,501 lekë, shtuar nga viti i shkuar me 6,876,547 lekë, dhe pasqyron gjendjen e inventarit më datë 31.12.2022.

Ky shtim ka ardhur si rrjedhojë e blerjes së materialeve “kite e reagente” për projektin Nanoalb të cilat nuk janë përdorur në vlerën 7,986,120 lekë dhe deri në 31.12.2022 rezultojnë në vlerën 7,986,120 lekë.

Nr.	Emërtimi	Gjendja në fillim	Blerje dhe hyrje	Dalje	Gjendja në fund
1.	Gjendja materialeve nga viti kaluar				
2.	Blerje materiale për veprimtarin	1,598,054	2,603,095	3,656,860	544,289
3.	Blerje kite për Nanoalb projekti		7,986,120		7,986,120
4.	Blerje karburant	270,900	1,386,208	1,442,016	215,092
	Total	1,868,954	11,975,423	5,098,876	8,745,501



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

Burimi: ASH, përpunoi Grupi i Auditimit

Konstatim: Nga auditimi u konstatua se, sa i takon përbërjes së llogarisë 31 “Materiale” zë më zë, çelja e gjendjes së botimeve në fillim të vitit 2022 nuk korrespondon me mbylljen e të njëjtit zë për v.2021.

Konkretisht, për v.2021 gjendja në mbyllje rezultonte 1,868,954 lekë ndërkohë kjo vlerë referuar dokumentacionit justifikues të v.2022 rezulton në çelje e njëjta vlerë por jo për të njëjtat destinacione sikundër janë paraqitur në v.2021.

Referuar v.2022 kjo vlerë përbëhet nga a) blerje materiale për funksionim me çelje 1,598,054 lekë dhe b) blerje karburanti me vlerë në çelje 270,900 lekë ndërkohë referuar v.2021 vlera paraqet gjendjen e materialeve nga funksionimi në fund të vitit.

Llogaria 32 “Inventar i imët” me vlerë 54,194,687 lekë, pakësuar nga viti i shkuar me 2,615,526 lekë.

Në përbërje të saj është botimi i librave në shumën 2,960,760 lekë. Pakësimi ka ardhur si rrjedhojë e dhurimeve në shumën 5,576,286 lekë.

Nr.	Emërtimi	Gjendja në fillim	Blerje dhe hyrje	Dalje	Gjendja në fund
1.	Gjendja botime nga viti kaluar	56,810,213			
2.	Blerje botime sipas kontratës		2,960,760		
3.	Shkarkuar dhurime gjatë vitit 2022			5,576,286	
4.	Gjendje në fund të vitit 2022				54,194,687
	Total	56,810,213	2,960,760	5,576,286	54,194,687

Burimi: ASH, përpunoi Grupi i Auditimit

8. Gjetje nga auditimi

Nga auditimi u konstatua se, grupi auditimit nuk merr dot siguri të arsyeshme mbi saktësinë dhe vërtetësinë dhe për lëvizjet e llogarive e vlerave të paraqitura në llogaritë 218 “Inventar ekonomik”, 31 “Materiale” dhe 32 “Inventar i imët” të pasqyrës së pozicionit financiar, për arsye sepse proces inventarizimi për periudhën 2021-2022 nuk është kryer.

Për këtë arsye grupi auditimit vendosi të kryente procedurën e verifikimit në terren lidhur me llogaritë 31 “Materiale” dhe 32 “Inventar i imët” për projektet NanoAlb dhe Bioteknologji.

Me qëllim kontrollin e sigurisë së vlerave të sipërcituara nga ana e grupit të auditimit u krye verifikim në terren për të kryqëzuar të dhënat sintetike dhe ato analitike të llogarive 218 “Inventar ekonomik”, 31 “Materiale” dhe 32 “Inventar i imët” si dhe auditim i dokumentacionit justifikues mbështetës:

✓ *Sa i takon marrëdhënies që Akademia e Shkencave ka me njësitë kërkimore studimore referuar Statutit të vet si dhe Ligjit Organik specifikohet se:*

- Ligji nr. 53/2019 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”

Neni 19 “Njësitë e kërkim studimit”

1. Sipas nevojave, detyrave e problemeve në fushën e kërkimit, në përmbushje të rolit të saj, pranë Akademisë mund të ngrihen njësi të kërkimit studimit me aktivitet afatshkurtër e afatgjatë.

2. Këto njësi janë autonome në realizimin e detyrave të tyre, mbajnë marrëdhënie me Kryesinë e Kryetarit dhe raportojnë pranë tyre.



3. Sipas rëndësisë, problemeve e kohëzgjatjes, këto njësi ngrihen me akte të Asamblesë apo të Kryesisë për njësitë me afat deri në 2 vjet dhe me vendim të Këshillit të Ministrave për njësitë e tjera.

4. Objekti i tyre, financimi, shtrirja, veprimtaria dhe përbërja përcaktohen në aktet përkatëse që dalin për ngritjen e tyre.

- Statuti i ASH miratuar me Vendim të Asamblesë së ASH nr.22 datë 18.10.2019

Neni 44 “Njësitë Afatshkurtra”.

2. Njësitë që ngrihen me vendim të Kryesisë, pas konfirmimit nga Asambleja ose seksioni përkatës. Vendimi i ngritjes së tyre përcakton qartë qëllimin, detyrat që ka njësia, kohën e aktivitetit, aktin përfundimtar që duhet nxjerrë si dhe kujt i drejtohet ky akt për rekomandim apo zbatim. Vendimi përmban edhe mbështetjen financiare e logjistike të njësisë dhe vendin e ushtrimit të aktivitetit.

Për këtë u shqyrtuan marrëveshjet bashkëpunuese mes palëve,

- Marrëveshja mes Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Universitetit të Tiranës.

Marrëveshja e Bashkëpunimit mes UT dhe ASH lidhur më 11.12.2020; prot me nr.634 prot në ASH, specifikohet se:

Neni 2 “Qëllimi”

Marrëveshja ka për qëllim rregullimin e bashkëpunimit ndër institucional mes Palëve, si dhe midis strukturave përbërëse të tyre; përcaktimin e prioriteteve themelore të bashkëpunimit dhe mënyrën e zbatimit të tyre, mbështetur në legjislacionin në fuqi e në parime të gjithëpranuara dhe në interesa të përbashkëta.

Neni 4 “Drejtimit Kryesore të Bashkëpunimit”

...Palët bashkëpunojnë në kryerjen e studimeve të përbashkëta;

...Palët bashkëpunojnë për aplikimin dhe zbatimin e projekteve të përbashkëta shkencore;

Neni 5 “Bashkëpunime të veçanta”

Paragrafi 3 specifikon ... ASH garanton përfshirjen e ekspertëve të UT në njësitë e reja të kërkimit shkencor ngritur pranë saj, UT rekomandon e propozon përfshirjen e ekspertëve më cilësorë, ato bashkëpunojnë në drejtimin e realizimin e veprimtarisë së tyre.

Neni 6 “shkëmbimi i botimeve dhe i informacionit”

Paragrafi 3 ... Palët informojnë rregullisht njëra tjetrën për marrëveshje dy ose shumë palëshe me interes të ndërsjelltë”.

Marrëveshja e Bashkëpunimit mes QSUNT dhe ASH lidhur më 06.05.2022; protokolluar me nr.1203/1 prot në ASHSH, specifikohet se:

Neni 2 “Qëllimi”

Marrëveshja/a ka për qëllim rregullimin e marrëdhënieve mes palëve gjatë kohëzgjatjes së kësaj marrëveshje, në mënyrë që secila palë të realizojë detyrimet e veta.

Neni 2 “Objekti”

Në marrëveshjet midis tyre, palët bien dakort, që ish laboratorit imunologjik pranë QSUNT-së që ndodhet në godinën e spitalit të sëmundjeve të brendshme, i cili administrohet nga QSUNT së bashku me aparaturat dhe asetet në gjendje aktuale, t’i kalojë ASH-së për përdorim për qëllime kërkimore shkencore të lidhura veçanërisht, me pandeminë e shkaktuar nga Covid 19.

Neni 6 “Të drejtat dhe detyrimet e QSUNT”

QSUNT merr përsipër të:



a) Vendos në dispozicion të ASH ambientet e ish laboratorit të imunologjisë, si dhe aparatura e asete sipas inventarit të fundit të cilat janë aktualisht në këto mjedise, pa kundërshtim.

Neni 7 “Të drejtat dhe detyrimet e ASH”

ASH ka të drejtë:

a) Të përdorë pajisjet sipas inventarit bashkangjitur dhe në përfundim të marrëveshjes të dorëzojë ambientet e dhëna në përdorim sipas termave të marrëveshjes së bashkëpunimit.

8.1 Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi u konstatua se, fillimisht, kartelë inventari vendosur në dispozicion të grupit të auditimit, përmes së cilës QSUNT i kalonte pajisje ASH ishte pa specifikime teknike, si numri i elementëve, emërtesa dhe kode apo numra serie respektive për çdo pajisje duke pamundësuar verifikimin e artikujve fizik me ata në kartel inventar.

Por nga dokumentacioni i mëvonshëm u konstatua se, kjo listë përmbante të dhëna numër serial dhe emërtesë të artikujve respektiv.

Sa i takon vitit 2023 nuk ka një rinovim të marrëveshjes, megjithëse nga ana e ASH janë dërguar 2 shkresa drejtuar QSUNT për rinovim marrëveshje, ajo me nr.303 prot., dt 14.04.2022 dhe nr.0374/1 prot., dt.24.07.2023.

8.2. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i dokumentacionit (marrëveshjet dypalëshe, relacione mbi projekte) vendosur në dispozicion, u konstatua se:

- Në të dy marrëveshjet (me UT dhe QSUNT) nuk specifikohet si do të operohet për pronësinë intelektuale në përfundim të projektit/studimit.
- Në të dy marrëveshjet (me UT dhe QSUNT) dhe më tej në projekte nuk specifikohet personi koordinator.
- Në të dy rastet, në marrëveshje nuk rregullohet mënyra e raportimit mbi kostot e projekt/studimeve për secilën fazë.
- Në projektet “NanoAlb” dhe “Imunologji” është operuar në kundërshtim me Statutin e ASH, neni 45, pika 2 e tij duke mos specifikuar vendin se ku do të kryhen studimet/projektet dhe ku do të jenë vendosur pajisjet që do të përdoren për efekt studimi, kjo gjë nuk parashikohet as në marrëveshjen e bashkëpunimit.
- Nga ana e secilit prej projekteve respektive, mungon gjurma e raportimit për kostot e secilit stadë/fazë projekti në ASH.
- Nga ana e secilit prej projekteve fituese mungon një analizë paraprake kosto përfitim, në ato raste ku për shkak të natyrës specifike ndeshet pamundësi për parashikim të përfitimit nuk ka as një analizë kostoike të detajuar përpara përzgjedhjes.

Mbi projektet fituese:

Nga auditimi i dokumentacionit justifikues mbi projektet fituese u konstatua se:

✓ Me Vendim të Kryesisë nr.20 datë 08.02.2020 u miratua “Ngritja e njësisë së kërkim studimit në fushën e bioshkencës, bioteknologjisë dhe gjenetikës”.

Pika 3 e Vendimit specifikon se, objekt i punës së njësisë është realizimi i angazhimeve të përcaktuara në platformat dhe programin e punës bashkangjitur vendimit.

Referuar planit të veprimit, pika 2 dhe 3 e tij, specifikohet se:



2. për periudhën shkurt mars 2020 do të kryhet nënshkrimi i bashkëpunimit me universitete, institute dhe qendra për vazhdimin e zyrtarizuar të njohjes me grupet kërkimore në fushën e Bioteknologjive dhe Gjenetikës.

- Referuar raportit të veprimtarisë së njësisë së kërkim studimit në fushën e bioshkencës, bioteknologjisë dhe gjenetikës gjatë vitit 2020, pika 2 nuk është arritur.

- Në relacion specifikohet:

Me anë të kërkesa zyrtare, u mundësua bashkëpunim i ASH me institucione të ndryshme shkencore dhe universitete;

Pas nënshkrimit të marrëveshjeve të Bashkëpunimit Shkencor të ASH me UT, UBT, UPT UMT,

3. për periudhën mars prill 2020 do të kryhen vizita në laboratorët për njohjen me funksionimin e tyre....

9. Nga auditimi u konstatua:

- Referuar raportit të veprimtarisë së njësisë së kërkim studimit në fushën e bioshkencës, bioteknologjisë dhe gjenetikës gjatë vitit 2020, pika 3 nuk ka gjurmë justifikuese të kryerjes së saj

- Në relacion specifikohet:

Sipas planit, për hartimin e Database dhe të një faqe Web të Njësisë fillimisht u hartua skeda si model, me informacion për grupet kërkimore që do të punojnë në fushën e bioteknologjisë dhe gjenetikës.

U identifikuan rreth 32 grupe dhe deri në fund të dhjetorit u dërguan 25 skeda, gjurmë e cila mungon.

- Në Vendimin nr.47 datë 14.07.2020, janë specifikuar vetëm koordinatorët e projekteve dhe jo përbërja specifike me emra nominale e njësisë.

Nga ana e kësaj njësie u propozuan 2 projekte:

✓ Me Vendim të Kryesisë nr.43 datë 18.12.2019 u miratua “Ngritja e njësisë së kërkim studimit në fushën e nanoshkencës dhe nanoteknologjisë”.

Pika 2 e Vendimit specifikon përbërjen e njësisë nga drejtuesi shkencor, dy anëtar dhe një koordinator.

Pika 3 e Vendimit specifikon se, objekt i punës së njësisë është realizimi i angazhimeve të përcaktuara në projektin e paraqitur nga akad. A.M.

NanoAlb është një njësi virtuale e cila funksionon me grupe kërkimore të vogla të shpërndara fizikisht në universitete e institucione të ndryshme.

9.1 Nga auditimi u konstatua:

Nga auditimi u konstatua:

- mungesë e gjurmës se cilat janë këto institucione apo universitete (përmes një listimi të emrave të tyre) në të cilat po shtrihet veprimtaria e NanoAlb dhe janë të shpërndara pajisjet e financuara nga ana e ASH.

Nga ana e ASH është mbajtur marrëveshja e bashkëpunimit me UT (sipër trajtuar; me nr.634 prot, dt 11.12.2020) ndërkohë referuar informacionit të dërguar në Kryesi (i cili është pa ekstremitete) specifikohen se në workshopin e parë të NanoAlb zhvilluar më 23.01.2020 paraqitet një tabelë përmbledhëse me grupet e punës dhe institucionet ku anëtar të grupeve janë të punësuar dhe ushtrojnë veprimtarinë e tyre, të cilat janë: Universiteti Epoka, Universiteti i Prishtinës, Universiteti Tiranës (FSHN). Ku për Universitetin Epoka nuk ka gjurmë të një marrëveshje bashkëpunimi.



Për sa më sipër, nga ana e përfaqësuesve të KLSH u krye një inspektim në terren, për të cilin u mbajtën dhe Akt Verifikimi nr 1 dhe Akt Verifikimi nr.2.

Përgjatë këtij inspektimi nga ana e ASH u shoqëruam me përgjegjësen e financës dhe magazinierin, ndërkohë në laboratorin e QSUNT mungonte koordinatori dhe në dy nga laboratorët e FSHN nuk ishin përfaqësuesit për shkak të një konference ku ishin pjesëmarrës.

9.2 Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi në terren u konstatua se:

- Në Akademinë e Shkencave nuk raportohet (pranë Sektorit të Financës) mbi kostot që ka shkuar secila fazë e studimit, si dhe mungon një preventiv i nevojave financiare (respektive nga secili projekt për secilën fazë) me qëllim zgjatjen ose jo të vijueshmërisë së tyre;

- Akademia e Shkencave, Sektori Financës dhe Magazina, nuk bëjnë hyrje e më pas shpërndarje tek personat/njësitë përgjegjëse të materialeve / pajisjeve të punës. Praktika e evidentuar në (FSHN) rezultoi se pajisjet merren në dorëzim drejtpërdrejtë nga operatori ekonomik tek studiuesi/personi që do e ketë në ngarkim, duke anashkaluar ASH.

✓ Për projektin NanoAlb

- në njërin prej laboratorëve të FSHN (L.V) u konstatua prania e 10 nga 17 materialet e specifikuar në kartelën personale të personit që i kishte në ngarkim, dhe pjesa tjetër rezultoi se mbahej në ambiente private jashtë ambienteve laboratorike të FSHN (7 me vlerë totale prej 373,200 lekë referuar kartelës personale vendosur në dispozicion) prej një tjetër personi (informacion ky i padisponuar për sektorin e financës dhe magazinën e ASH) i cili nuk figuronte me kartelë në ASH, (sa më sipër mbajtur Akt Verifikimi nr.1 dhe Akt Verifikimi nr.2 datë 06.12.2023)

- Në laboratorin tjetër K.XH (po prap FSHN) u konstatua, mbajtja e pajisjeve studimore në kuti, të përdorura të pahapura, sikundër rasti i potenciostatit.

✓ Për Bioteknologjinë

- Të gjitha aparatat, me përjashtim të frigoriferit, ishin të pafurnizuara me rrymë elektrike në momentin e kryerjes së verifikimit.

- Sa i takon inventarit të imët (kite/reagente) nuk arrihej të kryej verifikimi dhe kryqëzimi i informacionit për shkak se, mungonte një listë inventari e artikujve të ndodhur në ato ambiente (u gjetën kuti të produkteve, por në mungëse të listës së inventarit nuk arrihej të kryhej kryqëzimi me produktet e paraqitur në aktin e marrjes në dorëzim).

- Në përfundim të projektit nuk del një material përmbledhës apo Studim i cili të jetë pronë e Akademisë së Shkencave apo një dokument përmbyllës justifikues të veprimtarisë në favor autorsie të ASH.

Problematikat e mësipërme çenojnë në këto kushte vërtetësinë e pasqyrave financiare dhe saktësinë e llogarive analitike të paraqitura në to.

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi Drejtuesi i laboratorit G.S si dhe M.M në cilësinë e përgjegjësit të Financës dhe F.B në cilësinë e Magazinierit si përfaqësues të Akademisë së Shkencave.

***Observacion i paraqitur nga ana e subjektit me shkresën nr.896/35 prot., datë 29.03.2024
protokolluar në KLSH me nr.959/6 prot., datë 02.04.2024***



Në njërin prej laboratorëve të FSHN (zj.L.V) u konstatua prania e 10 nga 17 materialet e specifikuar në kartelën personale të personit (inventar i imët) që i kishte në ngarkim dhe pjesa tjetër rezultoi se mbahej në ambiente private jashtë ambjentëve laboratorike të FSHN (7 me vlerë totale prej 373,200 lekë referuar kartelës personale vendosur në dispozicion) prej një tjetër personi (informacion ky i padisponuar për sektorin e financës dhe magazinën e ASHSH).

Pretendimi i subjektit:

Fillimisht sqarojmë se ky projekt (projekti NANOBIOTOX), i vlerësuar si fitues nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë në vendimin nr. 31 datë 27.05.2022 (dokumenti bashkëlidhur), bazohet në bashkëpunimin midis 2 grupeve kërkimore shkencore të regjistruara në njësinë NanoAlb, grupit kërkimor “Nanotoxicity and Biomarkers of Effect” (Nanotoksiciteti dhe biomarkerët e efektit) dhe grupit kërkimor “Nanotechnology in pharmaceutical and medicine – applications group” (Nanoteknologjia në farmaceutikë dhe mjekësi – grup aplikativ) dhe tre partnerëve të huaj të cilët marrin pjesë me vetëfinancim (dokumenti bashkëlidhur), si një ndër kriteret e detyrueshëm të thirrjes 2nd NanoAlb Ignite Projects (dokumenti bashkëlidhur). Në kuadër të bashkëpunimit midis këtyre dy grupeve, Akademia e Shkencave të Shqipërisë ka lidhur një marrëveshje bashkëpunimi si me Universitetin e Tiranës ashtu dhe me Albanian University më datë 18.12.2020 (dokumenti bashkëlidhur).

Vlen për t’u theksuar se grupi kërkimor “Nanotoxicity and Biomarkers of Effect”, është i vendosur pranë Departamentit të Biologjisë, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, UT. Ndërsa grupi kërkimor “Nanotechnology in pharmaceutical and medicine – applications group” është i vendosur pranë Departamentit të Farmacisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Albanian University (dokumenti bashkëlidhur).

Në mungesë të një hapësire fizike të dedikuar për njësinë NanoAlb dhe grupeve kërkimore përbërëse të saj, aktiviteti kërkimor shkencor i këtyre të fundit zhvillohet pranë institucioneve ku anëtarët e grupeve janë të punësuar, ku për projektin NANOBIOTOX janë Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Albanian University. Ky informacion është i përshkruara saktësisht në projekt-propozimin që në momentin e aplikimit për financim pranë njësisë NanoAlb në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë (dokumenti bashkëlidhur).

Në lidhje me gjetjet e grupit të auditimit gjatë vizitës në laboratorin pranë Departamentit të Biologjisë, FSHN, nuk jemi dakord me konstatimin e grupit të kontrollit për praninë e vetëm 10 nga 17 materialet e specifikuar në kartelë (inventar i imët) sepse:

1. Grupi i auditimit nuk përfundoi kontrollin për 17 materialet e specifikuar në kartelë (dokument bashkëngjitur) por ndërpreu verifikimin në materialin numër 11, përkatësisht Amersham Protran Nitrocellulose Western Blotting Membranes.

2. Grupit të auditimit ju shpjegua se 3 materialet e para të kartelës (përkatësisht (1) Liposome me PEG, (2) Carbomer 940 dhe (3) Cyclodextrin and derivatives), janë pranë laboratorit të grupit kërkimor të NanoAlb “Nanotechnology in pharmaceutical and medicine – applications group” i drejtuar nga Prof. asoc. K.Sh, pranë Albanian University, sepse për të përmbushur objektivin 3 të projektit NANOBIOTOX është e nevojshme ekspertiza e këtij grupi kërkimor. Për realizimin e punës kërkimore shkencore, grupit të drejtuar nga Prof. asoc. K.Sh i nevojiten materialet në fjalë. Për të verifikuar gjendjen e këtyre 3 materialeve, grupit të auditimit i është ofruar një pikë kontakti me grupin partner të njësisë NanoAlb i vendosur në Albanian University, ofertë e cila u refuzua.

3. Materialet e listuara nga pika 4 deri në 11, i janë treguar fizikisht grupit të auditimit.



4. 6 materialet e fundit të listuara në kartelë (nga pika 12 deri 17) nuk u kërkuar për verifikim nga grupi i auditimit, pavarësisht pranisë së tyre në laborator.

5. Gjatë kontrollit nuk u mbajt asnjë procesverbal, të firmosur nga të 3 palët prezente, mbi mungesën e materialeve në laborator dhe aq më pak të listoheshin 7 materialet e pretenduara si në mungesë në projektraportin e grupit të auditimit.

6. Në projektraport, grupi i auditimit ka përcaktuar një dëm ekonomik me vlerë totale 373,200 lekë për 7 materiale të kartelës, pa specifikuar se cilët ndër 17 artikujt në listë nuk kanë qenë fizikisht në laborator.

Si përfundim, theksojmë se të gjitha materialet e blera me fondet e projektit NANOBIO TOX janë ende në gjendje në laboratorët e 2 grupeve kërkimore partnere dhe anëtare të njësisë NanoAlb, sipas planprogramit të projektit të dorëzuar në njësinë NanoAlb, në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë.

Në mbështetje të sqarimeve të mësipërme, bashkëngjitur janë dokumentat e mëposhtme:

1- Vendimi i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë për të financuar projektin NANOBIO TOX të mbështetur në bashkëpunimin midis 2 grupeve kërkimore anëtare të njësisë NanoAlb;

2- 2nd NanoAlb Ignite Projects (thirrja për aplikime);

3- Paraqitja në faqen zyrtare të njësisë NanoAlb i 2 grupeve kërkimore “Nanotoxicity and Biomarkers of Effect” dhe “Nanotechnology in pharmaceutical and medicine – applications group”;

4- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Albanian University;

5- Skedat përkatëse të 2 grupeve kërkimore të regjistruara në njësinë NanoAlb me vendndodhjet përkatëse;

6- Projekti NANOBIO TOX ku tregohen grupet kërkimore NanoAlb partnere dhe roli i secilës në përmbushjen e objektivave;

7- Lista e materialeve të specifikuar për projektin NANOBIO TOX.

Oëndrimi Grupit të Auditimit:

Risjellim në vëmendjen tuaj se, në asnjë moment nga nisja e auditimit e deri pas mbajtjes së Akt Verifikimeve nr.1 dhe nr.2 datë 06.12.2023 prej përfaqësuesve të ASH nuk na u specifikua dhe vendos në dispozicion dokumentacion për ekzistencën e marrëveshjes me Albanian University. Në vijim të objeksionit tuaj, po ju rikujtojmë se, edhe gjatë ushtrimit të inspektimit në terren prej përfaqësuesve tuaj nuk disponohej informacion mbi këtë bashkëpunim dhe nuk na u sqarua se përse këto materiale mbaheshin në ambiente private.

Pavarësisht kërkesës së vazhdueshme të grupit të auditimit u vijua në mosdijeni (referuar email datë 19.12.2023 ora 11:39)

Grupit të auditimit nuk iu ofrua kontakt, por iu propozua të kryhej inspektim në terren në ambientet e një biznesi privat (ish UFO) ku përfaqësuesit e autorizuar të KLSH specifikuan se, operojnë në mbështetje të Ligjit nr.154 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe nuk e kishin tagrin për ta kryer në atë momentin procesin e inspektimit. referohu Neni 6 “Fusha e Veprimit” nga ana e personit shoqëruar u vijua me mosdijeni dhe mosargumentim të situatës.

Në mbyllje të inspektimit në ambientet e ASH u mbajtën Akt Verifikimet nr.1 dhe 2 pas të cilëve u krye ballafaqimi përsëri në këto ambiente, mes përfaqësuesve të KLSH dhe znj.M.M, znj.M.V dhe z.K.Xh.



Artikujt me mungesë sikundër check-uar bashkarisht dhe dakortësuar nga ana juaj rezultuan:

Q1466,Q1489,Q1470,Q1557,Q1558,Q1561,Q1563

Referuar observacionit të paraqitur, në kushtet e mospjelljes së dokumentacionit të ri justifikues observacioni nuk pranohet.

Sa më sipër observacioni nuk pranohet.

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” për 11,344 lekë, mbartur ndër vite dhe përfaqëson një detyrim të pashlyer UB Kamëz për blerje periodike.

10. Gjetje nga auditimi:

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” për të dy vitet objekt auditimi (v.2021, v.2022) mbartet në vlerën 11,344 lekë dhe përbëhet nga debitorë të viteve të kaluara.

Nga auditimi i dokumentacionit justifikues u konstatua se, vlera e mbartur daton prej vitit 2001 dhe është kryer për blerje librash me shumë totale prej 19,650 lekë. Për shkak të periudhës kohore të largët prej ASH specifikohet se nuk disponohet dokumentacion justifikues i diferencës që është arkëtuar. Dhe është vijuar me regjistrimin në kontabilitet të vlerës 11,344 lekë mbi bazë historike. Përgjatë kësaj periudhe prej Akademisë së Shkencave nuk janë ndërmarrë nisma për të kërkuar në rrugë ligjore dhe administrative arkëtimin e të drejtave mbi debitorët operuar në kundërshtim me gërmat “g” dhe “gj”, neni 12, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

Aktive Afatgjata. Totali i kësaj rubrike përfaqëson vlerën neto të aktiveve afatgjata dhe pasqyrohet në vlerën 46,680,714 lekë, e cila ka dalë si shumë e përgjithshme e llogarive “aktive afatgjata jomateriale” dhe “aktive afatgjata materiale”.

Përbërës të këtij posti janë llogaritë:

1. Llogaria 20 “Aktive Afatgjata Jomateriale” me vlerë totale prej 160,806 lekë pakësuar nga viti i shkuar me 28,377 lekë dhe përbëhet nga:

Llogaria 202 “Studime dhe kërkime” me vlerë 160,806 lekë. Kjo llogari përfaqëson një studim mbi “Studimi i rregullimit të tërësisë ujore të Shkodrës” në vlerën fillestare 308,053 lekë e mbartur prej shumë vitesh në pasqyrat financiare.

11. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi u konstatua fenomen i mbartur për të dy vitet, llogaria 202 “Studime dhe projekte” përmban Studimin mbi “Studimi i rregullimit të tërësisë ujore të Shkodrës” dhe daton prej vitit 2004 ku vlera fillestare e tij ka qenë 308,053 lekë. Ky studim nuk është jetëzuar në asnjë moment dhe vijon të mbetet vetëm në letra, prej Akademisë së Shkencave ka filluar të llogaritet amortizim i vlerës së studimit prej vitit 2019, praktik e cila vijon të kryhet ende.

Aktualisht nuk është ndërmarrë asnjë nismë për vlerësimin e efektivitetit të këtij studimi (duke patur parasysh se periudha kohore që ka kaluar është relativisht e gjatë 19 vite) apo mundësinë për ta vendosur në zbatim apo jo referuar ndryshimeve që kanë ndodhur me vitet.

2. Llogaria 21 “Aktive Afatgjata Materiale” me vlerë totale prej 48,519,908 lekë shtuar nga viti i shkuar me 4,561,164 lekë përbëhet nga:



Llogaria 212 “Ndërtime dhe konstruksione” në vlerën e 30,154,631 lekë, pakësuar nga viti me 1,488,718 lekë, kjo për shkak të amortizimit vjetor në vlerën 1,582,167 lekë dhe një shtesë prej 93,449 lekë në fondin e librave.

Në përbërje të kësaj llogarie përfshihet vlera e ndërtesës së institucionit prej 24,707,584 lekë dhe fondi i bibliotekës shkencore respektivisht me vlerë 16,016,752 lekë.

Aktualisht institucioni i Akademisë së Shkencave ushtron aktivitetin e vet në mesin e qendrore, "Monument kulture i kategorisë së I-rë", "Libri Akademik" në krah të Akademisë së Shkencave, "Salla e mbledhjeve Aleks Buda" ndërmjet Akademisë së Shkencave dhe Kuvendit të Republikës së Shqipërisë ku zhillohen seancat plenare, në "Godinen e Re-Enciklopedia" ngjitur ndërtesës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë ku zhvillohen seancat plenare.

Për mesin e qendrore "Monument Kulture, kategoria I", Akademia e Shkencave ka nënshkruar kontratën e qerasë me bashkëpronarët referuar certifikatës "Për vërtetimin e pronësisë", me nr. 1453831, zonë kadastrale 8150, numër pasurie 1:86, volumni 40, faqe 120, lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (data e lëshimit të certifikatës 40/12/1899); kontrata të cilat rezultojnë të jenë nënshkruar mes palëve, që nga vitit 1996 e në vijim.

12. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi rezultoi se në formatin nr.1, Zëri “Ndërtime e konstruksione” (llog. 212) për vlerën 30,154,631 lekë i zbërthyer në mënyre analitike (përfshihet vlera e ndërtesës prej 24,707,584 lekë; vlera e fondit të librave pjesë e fondit të librave shkencorë prej 15,923,303 lekë; si dhe kalimi i librave për në bibliotekë nga magazina sipas FD dt.17.06.2021 me vlerë 93,448.8 lekë).

Për periudhën objekt auditimi u konstatua fenomen i mbartur ku nga ana e Akademisë së Shkencave specifikohet se pjesë e inventarit të asetëve të ASH dhe pjesë e bilancit kontabël konkretisht në llogarinë 212 “Ndërtime e konstruksione” pasqyrohet edhe fondi i librave shkencorë. Mbatja e këtij zëri si pjesë e inventarit të “Ndërtime e konstruksione” në vlerën 132,344 lekë është e pa saktë dhe denatyon llogarinë e aktiveve afatgjata (Në rastin e blerjes së librave shkencorë këto vlera në përfundim të investimit ti shtoheshin vlerës së investimit për të cilin janë kryer.)

- Në këto kushte operuar me një kontabilizim jo korrekt duke përfshirë zërin e aktiveve “libra” në llogarinë ekonomike 212 “Ndërtime e konstruksione”, duke bërë një keqklasifikim të aktiveve. Ky keqklasifikim bën që kjo llogari të mos pasqyrojë situatën reale të njësisë si dhe denatyon pasqyrat financiare përsa i takon natyrës së klasifikimit të llogarive.

- Po ashtu nga ana e ASH specifikohet se përgjatë vitit 2022 është kryer kalim në llogarinë 212 edhe vlera e librave nga magazina në bibliotekë me vlerë totale prej 93,448.8 lekë, sa më sipër operuar në kundërshtim me Udhezimi MFE nr 8, i ndryshuar, Pasqyra F1 rreshti 50, dhe pasqyrave 7/qa dhe 7/b

13. Gjetje nga auditimi:

Nga ana e ASH, për të dy vitet objekt auditimi (v.2021 dhe v.2022) është vijuar me llogaritjen e amortizimit në grup për aktivet, duke bërë që librat dhe ndërtesa të amortizohen me të njëjtën normë amortizimi.

Në këto kushte hasim në dy problematika, së pari llogaritje të amortizimit për libra ndërkohë që janë asete që nuk amortizohen dhe së dyti, edhe nëse do të ndodheshim në kushtet përjashtimore për këtë kategori (referuar SKK 5 pika 30, paragrafi II) sërish kemi përdorimin e të njëjtës normë për dy kategori të ndryshme.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQPËRISË

Sa më sipër operuar në kundërshtim me SKK 5 pika 30 e tij, e cila specifikon se ... *Vlera e amortizueshme e një elementi të AAM-së njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, si shpenzim në mënyrë sistematike përgjatë jetës së dobishme të këtij aktivi. Përrjashtime bëjnë aktivet afatgjata materiale me jetë të dobishme pa afat si për shembull, toka (përveç minierave dhe vendeve të përdorura për groposje), punimet e artit me jetë afatgjatë, veprat e muzeve dhe librat të cilat nuk amortizohen. (Punimet e artit të marra për qëllime projektimi, si dhe veprat e muzeve dhe librat, që duhet të zëvendësohen pas një periudhe kohe të caktuar, amortizohen gjatë jetës së tyre të dobishme).*

Referuar Listës së Inventarit të Pronave të Paluajtshme Shtetërore, miratuar me VKM nr.440 datë 16.06.2005, ndryshuar me VKM nr.248 datë 09.05.2018: Llogaria 212 “Ndërtime e konstruksione” përbëhet nga 4 objekte detajuar në:

1. Akademia e Shkencave Tiranë, me sipërfaqe 1128.25 m²
2. Salla e mbledhjeve, me sipërfaqe 180 m²
3. Zyrë dhe garazhe me sipërfaqe 299.25 m²
4. Godina e re Enciklopedia 352 m²

Të cilat janë në përgjegjësi administrimi të Akademisë së Shkencave.

Nga auditimi u konstatua se, nga ana e Akademisë së Shkencave 3 (tre) nga këto godina nuk rezultojnë të kenë gjurmë pasqyrimi në pasqyra financiare. Konkretisht bëhet fjalë për:

1. Salla e mbledhjeve, me sipërfaqe 180 m²
2. Zyrë dhe garazhe me sipërfaqe 299.25 m²
3. Godina e re Enciklopedia 352 m²

14. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi u konstatua se,

- Nga ana e ASH godinat e kaluara në përgjegjësi administrimi me Listën e Inventarit të Pronave të Paluajtshme Shtetërore miratuar me VKM nr.440 datë 16.06.2005, i ndryshuar me VKM nr.248 datë 09.05.2018, nuk rezultojnë të kenë gjurmë pasqyrimi në pasqyra financiare, me përjashtim të godinës “Akademia e Shkencave” me sipërfaqe prej 1,128.25 m².
- Nga ana e ASH për godinën “Akademia e Shkencave” me sipërfaqe prej 1,128.25 m² prej vitit 1996 paguhet qira mujore tek pronarët e truallit, ndërkohë kjo ndërtesë me VKM është në përgjegjësi administrimi të Akademisë së Shkencave.
- Referuar të dhënave vendosur në dispozicion grupit të auditimit rezulton se, vlera totale e paguar nga ana e ASH për qera të godinës rezulton në 134,629,243.04 lekë, si më poshtë vijon:

1 USD - 1 ALL		detyrimi faktik	vlera e paguar
104.5	1996	627,000	558,030
148.93	1997	1,787,160	1,590,572.4
150.64	1998	1,807,680	1,608,835.2
137.69	1999	1,652,280	1,470,529.2
143.71	2000	2,874,200	2,558,038
137.04	2001	3,288,960	2,927,174.4
138.28	2002	3,417,716	3,041,767.24
108.69	2003	3,521,556	3,134,184.8
94.58	2004	3,064,392	2,727,308.9
97.33	2005	3,153,492	2,806,607.9
93.67	2006	3,034,908	2,701,068.1
83.03	2007	2,690,172	2,394,253.1



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQPËRISË

90.96	2008	2,947,104	2,622,922.6
93.98	2009	3,044,952	2,710,007.3
104.95	2010	3,400,380	3,026,338.2
105.08	2011	3,404,592	3,030,086.9
106.57	2012	3,452,868	3,073,052.5
102.38	2013	3,317,112	2,952,229.7
113.64	2014	3,681,936	3,276,923.0
126.64	2015	4,103,136	3,651,791.0
	2016	6,914,580	6,153,976.2
	2017	13,829,160	9,956,995.2
	2018	13,829,160	9,956,995.2
	2019	13,829,160	11,339,911.2
	2020	13,829,160	11,339,911.2
	2021	13,829,160	11,339,911.2
	2022	13,829,160	11,339,911.2
	2023	13,829,160	11,339,911.2
		161,990,296	134,629,243.04

Gjendja e llogarive pasive në fund të vitit 2022, gjendja e tyre një vit më parë, si dhe diferenca midis dy periudhave (2022-2021), rezultuan si në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

Llog.	Emërtimi i llogarive të pasivit	2022	2021	Diferenca 2022-2021
B	DETYRIME	7,677,378	3,793,801	3,883,577
Klasa 4	Pasive afatshkurtër	7,677,378	3,793,801	3,883,577
401-408	Furnitorë 401	4,922,831	1,276,953	3,645,878
42	Detyrime ndaj personelit	1,847,975	1,630,072	217,903
431	Detyrime ndaj Shtetit për tatim-taksa	197,861	168,316	29,545
435	Sigurime shoqërore	628,378	718,460	(90,082)
436	Sigurime shëndetsore	80,333		80,333
C	FONDI I KONSOLIDUAR	117,381,478	102,900,323	14,481,155
101	Fonde bazë	98,159,167	92,395,104	5,764,063
105	Grante të brendshme kapitale	9,215,029	6,056,054	3,158,975
12	Rezultatet e mbartura		9,126,323	(9,126,323)
85	Rezultati i Veprimtarisë Ushtrimore	10,007,283	4,677,158	5,330,125
X	TOTALI I PASIVIT (A+B)	125,058,856	106,694,124	18,364,732

Burimi: ASH, përpunoi grupi auditimit

Llogaria 85 “Rezultat i veprimtarisë ushtrimore” shtuar nga viti shkuar me vlerën 5,330,125 lekë dhe përfaqëson ndryshimin e gjendjes së inventarit për vitin ushtrimor 4,261,021 lekë dhe shumën e mbetur në thesar për tu trashëguar vitin e ardhshëm prej 5,746,262 lekë.

Konstatim: Sa i takon llogarisë 85 “Rezultat i veprimtarisë ushtrimore” nga auditimi u konstatua se mungon gjurma e rakordimit të kësaj vlerë me degën e thesarit Tiranë.

Llogaria 105 “Grant i Brendshëm Kapital” është shtuar me vlerën 3,158,975 lekë dhe përfaqëson rritjen e aktiveve afatgjatë, ku për vitin 2022 shtesën e AQT në vlerën 9,215,028.8 lekë, fonde të cilat duhet të kishin kontabilizuar në aktiv pasi janë bërë hyrje dhe nuk janë AQT në proces.

15. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i dokumentacionit justifikues vendosur në dispozicion audituesve shtetëror të KLSH-së, për të dy vitet objekt auditimi u has i njëjti fenomen sa i takon veprimeve kontabël me llogarinë 105 “Grant i Brendshëm Kapital”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

Nga auditimi u konstatua se, kjo vlerë nuk rezultonte e argumentuar me të ardhurat në likuiditete në llogarinë financiare të disponibiliteteve, si dhe me të drejta të konstatuara por të pa arkëtuara në periudhat përkatëse ushtrimore. Kjo llogari për të dy vitet ka mbetur e hapur në vlera (v.2022 në vlerën 9,215,029 lekë dhe për v.2021 në vlerën 6,056,054 lekë) duke operuar kështu në kundërshtim me Udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022 “Disa ndryshime në Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 Llogaritë 105 mbeten me tepriçë në fund të periudhave ushtrimore vetëm në rastet kur këto grante janë burim për investimet në proces të institucioneve (të papërfunduara ose të pamarrë në dorëzim). Këto mbylljen (kapitalizohen) me fondet bazë në kohën kur investimi është përfunduar dhe marrë në dorëzim. Në rastin e ASH, në dokumentacion justifikues të mbylljes së zërave, vlera e kësaj llogarie paraqitet 6,054,056 lekë.

Llogaritë e detyrimeve afatshkurtëra, në vlerën 7,677,378 lekë shtuar këtë vit me vlerën prej 3,883,577 lekë si më poshtë:

Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, është shtuar këtë vit me 3,645,878 lekë dhe përfaqëson shumën e papaguar ndaj furnitorit “Toptani” për qira ndërtese, për shkak të pagesave ndaj pronarëve që për vitin 2022 janë bërë të pjesshme.

Shqyrtimi i llogarive të debitorëve “Furnitorë e llogari të lidhura me to” (llog. 401-408) ka të bëjë në thelb me kontrollin e origjinës dhe të natyrës së tyre: për këtë qëllim, përzgjedhëm për të kontrolluar rregullshmërinë e operacioneve të origjinës së tepriçave të regjistruara në kontabilitet kontratat e qerasë me qëllim që të sigurohemi se këto operacione kanë të bëjnë me kuadrin normal të lidhjeve të furnitorit me klientin, dhe të sigurohemi nëse shumat përkatëse janë transferuar në llogaritë e debitorëve sipas natyrës së operacioneve.

16. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i kontratave të qerasë u konstatua, prania dhe nënshkrimi i 6 kontratave me parregullsi sa i takon ekstremiteteve dhe përfaqësimit të palës së Akademisë së Shkencave, konkretisht në rolin e përfaqësuesit të ASH specifikuar në kontratë figuron z.Sh.S me cilësinë e Kryetar i Akademisë së Shkencave, ndërkohë faktikisht personi në fjalë ka qenë i ngarkuar me rolin e Nënpunësit Autorizues me shkresën nr.9/1 prot., datë 10.01.2020.

- me nr.repertori 1037, nr. Koleksioni 340, lidhur më 16.03.2021 me afat 01.01.2020 -31.12.2022
- me nr.repertori 625, nr. Koleksioni 209, lidhur më 24.02.2020 me afat 01.01.2020 -31.12.2021
- me nr.repertori 690, nr. Koleksioni 230, lidhur më 27.02.2020 me afat 01.01.2020 -31.12.2021
- me nr.repertori 626, nr. Koleksioni 210, lidhur më 24.02.2020 me afat 01.01.2020 -31.12.2021
- me nr.repertori 392, nr. Koleksioni 130, lidhur më 05.02.2020 për një ndryshim në kontratën me nr.repertori 431, nr. Koleksioni 156, lidhur më 06.04.2018 me afat 01.01.2020 -31.12.2022
- me nr.repertori 1821, nr. Koleksioni 552, lidhur më 28.05.2020 me afat 01.01.2020 -31.12.2021

b. Auditimi i llogarive të të ardhurave dhe shpenzimeve

Në këtë format janë përfshirë shpenzimet faktike nga 1 Janari deri me 31 Dhjetor 2020. Pra situacionit vjetor i është zbritur pagesa e detyrimeve që kanë qenë për muaj dhjetor, deri më 31 Dhjetor 2020 në bilancin kontabël dhe i janë shtuar detyrimet të cilat kanë ngelur si detyrim nga 31.12.2019.

Në lekë

		Viti 2022	Viti 2021	Diferenca 2022-2021
B	Shpenzimet	135,560,810	125,266,059	
600	LPAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJSEVE	25,704,022	24,924,192	779,830



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQPËRISË

6001	Paga, personel i perhershëm	25,704,022	24,924,192	779,830
601	IN.FONTRIBUTE TE SIGURIMEVE	4,238,531	4,007,474	231,057
6010	Kontributi i Sigurimeve Shoqërore	3,799,939	3,585,570	214,369
6011	Kontributi i Sigurimeve Shendetesore	438,592	421,903	16,689
602	III.BLERJE MALLRA E SHERBIME	78,993,380	62,871,808	16,121,572
6020	Materiale zyre e te pergjitheshme	10,994,115	7,563,510	3,430,605
6021	Materiale dhe sherbime special	2,960,760	3,422,350	461,590
6022	Sherbime nga te trete	2,984,307	4,458,191	1,473,884
6023	Shpenzime transporti	1,503,519	745,299	758,220
6024	Shpenzime udhetimi	3,573,996	2,166,233	1,407,763
6025	Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	639,407	1,364,960	725,553
6026	Shpenzime per qeramarrje	7,609,286	8,053,680	444,394
6029	Shpenzime te tjera operative	48,727,990	35,097,585	13,630,405
605	Transferita korrente me jashtëm	580,659	602,387	21,728
6053	Transferime për Institucione Jofitimprurëse të Huaja	580,659	602,387	21,728
606	Transferime per buxhetet familjare e individ	30,305,240	28,095,748	2,209,492
6060	Transferita të paguara nga ISSH dhe ISKSH	30,305,240	28,095,748	2,209,492
63	VIII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT	(4,261,021)	4,764,450	9,025,471
85	Teprica ose Deficiti periudhës	10,007,283	(4,677,158)	5,330,125
TOTALI				

Burimi: ASH, përpunoi Grupi Auditimit

Nga auditimi u konstatua se mungonte gjurmë e Llogarisë 8420 “Derdhje të ardhura në buxhet” e cila përfaqëson të ardhurat e krijuara nga aktiviteti i Akademisë së Shkencave (shitje librave dhe dhënie e sallave me qera) të cilat referuar akt rakordimit me thesarin rezultojnë në vlerën 1,544,512 lekë.

Kjo llogari evidenton transferimin e të ardhurave të realizuara nga institucioni në buxhet, ku pjesëmarrës në to është buxheti i shtetit, në përputhje me Udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022“ Disa ndryshime në Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018.

Krahasimi mes pasqyrës së performancës dhe situacionit të shpenzimeve:

U konstatua se, vlerat e paraqitura në pasqyrën e performancës financiare në total *nuk përputhen* me vlerat e paraqitura në situacionin me degën e thesarit Tiranë, “Shpenzimet korrente” sipas pasqyrave paraqiten në vlerën 135,560,810 lekë kurse sipas situacionit të shpenzimeve me degën e thesarit vlera e tyre është 145,029,777 lekë.

Konstatim: Në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare nuk specifikohet se çfarë përfshihet në vlerën e rakorduar me thesarin dhe çfarë vlerash përfshihen në pasqyrat financiare dhe përse nuk rakordojnë këto shuma.

Në kundërshtim me UMF nr. 24128, dt. 27.12.2011 “Procesimi i transaksioneve në fund të vitit” dhe UMF nr. 2, dt. 06.02.2012 “Procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” “Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike” “Rakordimi mujor i shpenzimeve”:

172. Nëpunësi zbatues rakordon me strukturën përgjegjëse për thesarin deri në datën 5 të çdo muaji, mbi shpenzimet mujore/progresive që ka kryer njësia e qeverisjes së përgjithshme. Format i raportit përcaktohet nga struktura përgjegjëse për thesarin.

173. Pas rakordimit mujor të shpenzimeve, njësitë e qeverisjes së përgjithshme përgatisin raportet financiare për vendimmarrjen dhe struktura përgjegjëse për thesarin përgatit raportet financiare periodike të konsoliduara të qeverisë, të cilat publikohen nga Nëpunësi i Pare Autorizues në faqen e internetit të Ministrisë së Financave” dhe UMF nr. 46, dt. 24.12.2020 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2020” pika 34 “Degët e thesarit gjenerojnë ... informacionin financiar disponibël/pasqyrat financiare vjetore për njësitë e qeverisjes së



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

përgjithshme. Ky informacion shërben si referencë për nëpunësit zbatues gjatë procesit të hartimit të pasqyrave financiare të institucioneve që përfaqësojnë, të dhënat përfundimtare të cilat i pasqyrojnë në sistemin informatik të qeverisë nëpërmjet strukturës përgjegjëse të thesarit në degë në zbatim të manualeve përkatës”.

17. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi u konstatua fenomen i përsëritur për të dy vitet, (2021 – 2022) mbi rakordimin e vlerave mes situacionit të shpenzimeve të paraqitura në akt-rakordimin me degën e thesarit Tiranë, “Shpenzimet korrente” dhe ato të pasqyruara në pasqyrat financiare për llogaritë e shpenzimeve. Për v.2021 shpenzimet sipas pasqyrës së performancës financiare paraqiten në vlerën 125,266,059 lekë kurse sipas akt rakordimit me degën e thesarit vlera e tyre është 125,177,530 lekë. Për vitin 2022, konkretisht, u konstatua një diferencë prej 9,468,967 lekë. Sipas pasqyrës së performancës financiare paraqiten në vlerën 135,560,810 lekë kurse sipas akt rakordimit me degën e thesarit vlera e tyre është 145,029,777 lekë.

- Në relacionin e pasqyrave financiare apo në shënimet shpjeguese, mungon argumentimi dhe nuk tregohet se çfarë përfshihet në shifrat e rakorduara me thesarin dhe çfarë vlerash përfshihen në deklaratat financiare, si dhe mungon shpjegimi se përse këto shuma rezultojnë me diferenca. Sa më lart është në kundërshtim me UMF nr. 24128, datë 27.12.2011 “Procesimi i transaksioneve në fund të vitit” dhe UMF nr. 9, datë 20.03.2018 “Procedura standarde e zbatimit të buxhetit”, Kreu III, “Procedurat për kryerjen e shpenzimeve publike”, nënkapitulli “Marrja e angazhimeve dhe kryerja e shpenzimeve publike” dhe UMF nr. 8, dt. 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 37 – 39.

Pasqyra krahasuese si më poshtë:

Në lekë

Nr. llog.	SHPENZIMET E USHTRIMIT	Pasqyrat financiare	Rakordimi me thesarin	Diferenca
60	I. Shpenzime Korrente			
600	Paga, shpërblime e të tjera personeli	25,704,022	25,523,555	180,467
601	Kontrib.te sig.shoq.e shendets.	4,238,531	4,181,299	57,232
602	Mallra dhe shërbime te tjera	78,993,380	75,367,664	3,618,463
604	Transferime korrente të brendshme			
605	Transferita korrente me jashtë	580,659	580,659	-
606	Transferita për buxh. familjare e individë	30,305,240	30,370,000	(98,592)
231	Investime për AAGJ materiale		9,006,600	
	<i>Totali faktik</i>		<i>145,029,777</i>	<i>5,207,945</i>
		<i>139,821,832</i>	<i>136,023,177</i>	
	<i>Totali sipas Bilancit kontabël</i>			

Burimi ASH, përpunuar nga Grupi i Auditimit

18. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi mbi rakordimin total të vlerave mes situacionit të shpenzimeve dhe ato të pasqyruara në pasqyrat financiare për v.2022 rezulton se:

- Nga ana e ASH në totalin e llogarisë së shpenzimeve, me qëllim nxjerrjen e rezultatit final të tyre, operohej duke shtuar edhe llogarinë 63 “Ndryshim i gjendjes së inventarit”, referuar UMF nr.8 datë 09.03.2018 i ndryshuar, pika paragrafi III, faqe 68 specifikohet se ...Llogaria 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”. Kjo kategori ka veçori për sektorin publik, se nuk është



element që ndikon në rezultat, por nëpërmjet operacioneve të transferimit ndikon sipas rastit në shtesë apo pakësim të fondeve bazë të institucioneve.

- Sa i takon veprimeve me llogarinë 231 llogari e cila në pasqyra financiare rezulton pa vlerë në situacionin me thesarin përmban vlerë (konkretisht 9,006,600 lekë).

Të gjitha këto ndryshime bëjnë që në total këto dy pasqyra të mos na kuadrojnë duke çeduar me vlerën faktike prej 5,207,945 lekë pasqyruar më tepër në situacionin me thesarin, referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion.

Dhe referuar shifrave të raportuara kjo diferencë figuron në vlerën 9,468,967 lekë më pak pasqyruar në PASH.

Mbi të ardhurat:

19. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i dokumentacionit justifikues mbi të ardhurat (konkretisht pasqyra e performancës financiare (PASH) dhe akt rakordimi me thesarin, u konstatua se në akt rakordimin me thesarin sa i takon pjesës së institucionit që ai do të mbaj, referuar përqindjeve të parashikuara, figuron 100% e të ardhurave të sponsorizimeve dhe 100% e të ardhurave nga grantet korrente të brendshme mbahen nga institucioni.

Në vlerë absolute 7,458,442 lekë. Mbi këtë fenomen prej institucionit argumentohet se këto janë fonde që janë mbartur/trashëguar në llogari të ASH, por mungon gjurma dokumentare e vërtetimit të këtij transaksioni.

Sa më sipër, nga ana e ASH, për të dy vitet objekt auditimi, të ardhurat e trashëguara nuk rakordohen me degën e thesarit dhe mungon argumentimi i tyre në formatin e akt rakordimit.

Operuar sa më sipër në kundërshtim me UMF nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në NjQP”, i ndryshuar.

Vlerësimi nëse aktivi dhe pasivi janë llogaritur drejtë dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse si dhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare.

Viti 2022

Nga auditimi u konstatua se, për v.2022 formati 7 “ndryshime në gjendjen e aktiveve” nuk pasqyrojnë vlerat reale të aktiveve, po ashtu hartimi i tij përmbante pasaktësi të shumta sa i takon vlerave. Në të gjitha rastet e aktiveve u konstatua amortizim mbi shtesa kur vlerë shtese nuk kishte dhe po ashtu u konstatua se, teprica në mbyllje e vitit pararendës nuk rakordonte me tepricën në mbyllje të vitit aktual.

Si rrjedhojë përmes pasqyrave financiare nuk arrihej sigurimi i informacionit të plotë mbi situatën e aktiveve dhe ndryshimet që kishin pësuar përgjatë vitit.

Përsa i përket rakordimit të pasqyrave financiare për vitin 2022:

*Nga auditimi konstatohet se, “Teprica në mbyllje” **nuk rakordon** me shumën që figuron në postin përkatës të llogarive financiare (520) për ushtrimin e mbyllur në aktiv të bilancit.*

*U konstatua mpspërputhje mbi barazimin e vlerës totale të **Formatit nr.6** “Investimet dhe Burimet e financimit”. Balanca mes burimeve për investime dhe shpenzimeve për investime duhet të jetë si rregull më e madhe ose e barabartë me zero, dhe për ASH është 0.*

**20. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi u konstatua se, përmes pasqyrave financiare nuk arrihej sigurimi i informacionit të plotë mbi situatën e aktiveve dhe ndryshimet që kishin pësuar përgjatë vitit. Për v.2022 formati 7 “Ndryshime në gjendjen e aktiveve” nuk pasqyronte vlerat reale të aktiveve, po ashtu hartimi i tij përmbante pasaktësi të shumta sa i takon vlerave.

Në të gjitha rastet e aktiveve u konstatua amortizim mbi shtesa kur vlerë shtese nuk kishte dhe po ashtu u konstatua se, teprica në mbyllje e vitit pararendës nuk rakordonte me tepricën në mbyllje të vitit aktual.

**Observacion i paraqitur nga ana e subjektit me shkresën nr.896/35 prot., datë 29.03.2024
protokolluar në KLSH me nr.959/6 prot., datë 02.04.2024**

Së pari, Thuhet se kjo pasqyrë nuk pasqyronte vlerat reale të aktiveve, gjë që nuk pranohet nga ana jonë. Tepricat në mbyllje të vitit 2021 në pasqyrën 7.a kol. 11, përputhet me çeljen më 01.01.2022 koll. 1

Siç shihet nga pasqyrat, viti 2021, pasqyra 7.a mbyllet me vlerën totale 75.110.859 lekë dhe viti 2022 çelet me po këtë vlerë.

Së dyti, Thuhet se llog. është llogaritur amortizimi edhe për shtesat e aktiveve që janë shtuar gjatë vitit kur shtesa nuk ka. Kjo gjë nuk qëndron pasi siç shihet në pasqyrën 7.a të vitit 2022 shtesat e aktiveve janë 9 215 029 lekë, nga të cilat:

1. Nga blerjet me fond investimesh 9,006,600 lekë
 2. Nga sponsorizime nga të tretë 114,980 lekë
 3. Nga brenda institucionit 93,449 lekë
- Totali 9,215,029 lekë

Së treti, sipas udhëzimit të MF nr. 8 datë 09.03.2018 amortizimi llogaritet për të gjitha aktivet, me normat respektive sipas grupeve të aktiveve, që do të thotë që nuk bëhet përjashtim për ato aktive që janë shtuar përgjatë vitit. Mbi to llog. amortizim me normën respektive dhe në raport me muajt e përdorimit duke filluar nga data e blerjes së aktivitetit. Sipas pasqyrës së amortizimit bashkëlidhur, kemi përlllogaritur amortizimin edhe për aktivet që janë gjendje para vitit ushtrimor në çelje të vitit dhe për shtesat e konstatuara gjatë vitit. Sqarojmë sërish se kjo pasqyrë përputhet me formatin 7/b të pasqyrave financiare. Mendoj që është lapsus nga ana juaj që teprica në mbyllje e vitit pararendës nuk rakordonte me tepricën në mbyllje të vitit aktual. E kundërta është e vërtetë që teprica në mbyllje e vitit pararendës përputhet me tepricën në çelje të vitit aktual. (shih pasqyrat e bilancit.) Po kështu, për vitin 2021 pasqyra 7.b, mbyllet me vlerën neto 44.119.550 lekë dhe viti 2022 çelet po me të njëjtën shumë, teprica neto kollona e tretë 44.119.550 lekë. Në pasqyrën e amortizimit që ua kemi vënë në dispozicion është evidentuar që amortizimi është llog. për aktivet gjendje që nga fillimi i vitit, por edhe për shtesat e aktiveve që janë shtuar gjatë vitit 2022. Amortizimi për shtesat është bërë në përputhje me datën e blerjes dhe është llogaritur për muajin që pason futjen e aktivitetit në përdorim.

Qëndrimi Grupit të Auditimit:

Sa i takon observimit të mësipërm, sjell prej jush edhe me shkresën nr.886/22 datë 22.01.2024 risjellim në vëmendjen tuaj se:

Sikundër ktheyr përgjigje në fazën e PRA dhe diskutuar verbalisht në prani të grupit të auditimit dhe vendosur disa herë në dijeni përfaqësuesit e institucionit, jemi në kushtet e amortizimit të shtesave, kur vlera shtesash nuk ka.

Konkretisht:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQPËRISË

Nr. referencë	Nr. Llogarje	EMERTIMI	Tëprica në fillim			Shtesat gjatë vitit		Paksimet gjatë vitit		Tëprica në fund		
			Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Tëprica Neto	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Tëprica Neto
a	b	c	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1	20	I. AAGJ/JO MATERIALE	308,053	85,485	222,568	0	33,385	0	0	308,053	118,870	189,183
2	201	Prime të emisionit dhe rimbursimet të huaja			0					0	0	0
3	202	Studime dhe kërkime	308,053	85,485	222,568		33,385			308,053	118,870	189,183
4	203	Koncesione, patenta, licenca e tjerë ngjashme			0					0	0	0
5	21-28	II. AAGJ/ MATERIALE	72,300,276	26,047,844	46,252,432	6,056,054	4,824,504	3,553,524	0	74,802,806	30,872,438	43,930,367
6	210	Toka, Troje, Terene	0		0					0	0	0
7	211	Pyje, Kullota, Plantacione	0		0					0	0	0
8	212	Ëdheime e Konstrukione	39,546,226	7,341,144	32,205,082	1,084,661	1,646,394			40,630,887	8,987,538	31,643,349
9	213	Rruge, rrjete, vepra ujore	0		0					0	0	0
10	214	Instalime teknike, makineri, pajisje	6,834,391	4,837,785	1,996,606	143,040	414,081	322,220		6,656,211	5,251,866	1,403,345
11	215	Mjete transporti	5,643,416	2,905,789	2,737,627		547,526			5,643,416	3,453,312	2,190,104

AAGJ JM llogaria 202 “studime dhe kërkime”, gjatë vitit nuk ka patur shtesa, ndërkohë rezultojnë amortizim i shtesës me vlerë 28,377 lekë;

AAGJ M llogaria 215 “mjete transporti”, gjatë vitit nuk ka patur shtesa, ndërkohë rezultojnë amortizim i shtesës me vlerë 438,021 lekë;

(e njëjta situatë edhe për v.2021)

Si më sipër, keni kryer një argumentim të veprimit të ndërmarr dhe nuk keni paraqitur të evidencat justifikuese të situatës.

Në kushtet e mosparaqitjes së dokumentacionit të ri justifikues, e për pasojë mosndryshimin e gjendjes së evidentuar mbajmë të njëjtin qëndrim.

Si më sipër observacioni nuk pranohet.

Si më sipër, u konstatuan mospërputhje përse i përket kësaj llogarie.

-Auditimi për barazimin e vlerës totale të **Formatit nr.8** “Numri i punonjësve dhe fondi i pagave”, siguron një informacion të saktë mbi numrin e punonjësve, ndryshimet e ndodhura gjatë vitit, fondin e pagave, shpërblimet suplementare dhe shpërblime të tjera, kontributet për Sigurimet Shoqërore dhe Tatimet e të ardhurave personale. Është plotësuar nga burimet njerëzore pjesa për gjendjen në fillim, lëvizjet dhe gjendjen në fund të punonjësve, ndërsa pjesa për fondin e pagave është e plotësuar sipas të dhënave nga pasqyra e shpenzimeve.

Kjo pasqyrë është e rakorduar me të dhënat e paraqitura në llogarinë 600 të formatit nr.2 Shpenzime të Shfrytëzimit.

Si më sipër, nuk u konstatua mospërputhje përse i përket këtyre llogarive.

Mbyllja e bilancit për vitin 2021 në përgjithësi është në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 neni 6, me VKM nr. 248, datë 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël” si dhe Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në NjQP”.

Veprimet për vitin 2021 janë azhurnuar periodikisht, janë kontabilizuar në ditarët, ku llogaritë në përgjithësi janë në pozicionin e duhur dhe në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 neni 6, si dhe UMF nr. 14, datë 28.12.2006, UMF nr. 26, datë 27.12.2007.

Regjistri i aktiveve.

Nga auditimi i regjistrit të aktiveve të ASH, u konstatua se institucioni nuk ka regjistër për aktivet që institucioni ka në pronësi apo përdorim. Regjistri nuk është hartuar në varësi të llojit të aktiveve, si dhe grupit përkatës brenda llojit. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 të MFE datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pika 26, 28 dhe 30 ku citohet se ...“Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo kanë administrim, përfshi dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura. Regjistri mbahet në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar”; 28. “Regjistri i aktiveve të një njësie, duhet të përfshijë si aktivet afatgjata ashtu edhe aktivet



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

afatshkurtra material dhe monetare si dhe të specifikojë aktivet të cilat gjenden në pronësi të njësisë”; 30. “Formati i regjistrit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në varësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.”

21. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi u konstatua se, nga ana e institucionit nuk ka gjetur zbatim Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kapitulli III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pikat 26, 28, 30 sa i takon hartimit të regjistrit të aktiveve.

Mbi Projektet e Mbështetura financiarisht nga ASH

NanoAlb – IgniteProjects

✓ Me Vendim të Kryesisë nr.31 datë 27.05.2022 janë miratuar “Projektet shkencore të qendrës kërkimore të Nanoteknologjisë NanoAlb pranë ASHSH për periudhën 2022-2023”

Bashkangjitur Vendimit janë 5 propozimet për projekte, të cilat pas marrjes së vlerësimit të projektpropozimeve janë konvertuar në projektet fituese (**nuk ka një relacion apo procedurë mbi kalimin në këtë fazë**).

Buxheti për v.2022 për këto 5 projekte referuar tabelës përbledhëse shoqëruese të propozimprojekteve rezulton në 4,847,160 lekë. (**për këtë referuar një tabelë përmbledhëse me shkrim dore që është specifikuar si shtojcë 1**)

Të 5 (pesë) këto projekte janë në proces dhe asnjë nuk është finalizuar deri në 31.12.2023

QSUNT - Imunologjia

✓ Me Vendim të Kryesisë nr.33 datë 07.05.2020 janë miratuar “2 Projektet shkencore mbi virusin SARS COV2 dhe ndikimin e tij Covid 19 në Shqipëri”, këto si pjesë e njësisë kërkimore shkencore të imunologjisë.

Bashkangjitur Vendimit është një preventiv paraprak i shpenzimeve financiare për realizimin e njërit studim ” Studimi epidemiologjik i gjendjes imunitare ndaj virusit SARS COV 2 në popullatën në Shqipëri”, **por mungon një buxhet i parashikuar për efekt studimi referuar shtrirjes kohore të tij**.

Në të specifikohet një total 19.000 Euro si një parashikim paraprak i përgjithshëm.

Situata e projekteve të mbështetura financiarisht nga ASHSH paraqitur përmbledhtazi rezulton si më poshtë vijon:

Projekte me financim nga Akademia e Shkencave 2020-2022

Qendra Bio Teknologjike						
Nr.	Titulli i projektit	Drejtuues i projektet dhe Stafit	Njësia / Komisioni Seksioni	Periudha	Status	Kosto/lekë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQPËRISË

1	Studimi seroepidemiologjik i gjendjes imunitare ndaj virusit SARS-COV-2 ne popullaten shqiptare SEROIMUNE	Prof.Dr. G.S Prof.Asoc. A.Y	Komisioni i Mjekesise	2020-2022	Miratuar VKA 33 dt 07.05.2020 Përfunduar 2022 – faza 4 2021 – faza 3 2020 – faza 1+2	TC mjekë (përhershem) për v.2022 4,057,979 + TC blerje 12,019,800 + Staf mjekësor QSh 150,000 Total v.2022 16,227,779 TC v.2021 6,388,764 TC v.2020 1,546,949
---	---	--------------------------------	-----------------------	-----------	--	--

Projekte me financim nga Akademia 2022-2023

NanoAlb						
Nr	Titulli i projektit	Drejtes i projektit dhe Staf	Njësia / Komisioni Seksioni	Periudha	Status	Kosto/lekë
1	Përgatitja dhe karakterizimi i nanofibrave elektrofibra të pastër PVA dhe matricës PVA/MMT për të kapsuluar një vaj esencial të bimës mjekësore shqiptare për aplikime biomjekësore PvaNANOMat	P.M A.H N.F A.N.H A.A. R/ B	Qendra Kërkimore Nanoteknologjike NanoAlb	2022-2023	Ne proces	Realizim periudha 2022-2023 deri me 29.12.2023 total 1,393,090 lekë nga të cilat: Pajisje 662,400 lekë dhe 672,480 lekë materiale dhe 58,210 lekë pjesmarrje në konferencë (Fee)
2	Zhvillimi i një sensori të ri elektrokimik për kontrollin e cilësisë së mjaltit Eksperimentim në gjetjen e modifikuesit dhe mënyrës së modifikimit HMF-Sens	L.B M.V R.M	Qendra Kërkimore Nanoteknologjike NanoAlb	2022-2023	Ne proces	Realizim periudha 2022-2023 total 1,758,611 lekë nga të cilat: 49,571 lekë shpenzime udhëtim e dieta 380,400 lekë pajisje 1,328,640 lekë materiale.
3	Studimi i bashkëveprimit nano-bionanopjesëzave dhe nanomaterialeve të modifikuara me organizmat e gjallë dhe qelizat e tyre duke përdorur eksperimente in-vivo dhe modelet kompjuterike NANOBIOTOX	L.V K.Sh C.F M.P I.L	Qendra Kërkimore Nanoteknologjike NanoAlb	2022-2023	Ne proces	Realizim periudha 2022-2023 total 1,712,310 lekë nga të cilat: 186,030 lekë dhe Materiale 1,526,280 lekë
4	Nanosensor për certifikimin e verërave vendase dhe të importuara bazuar në antioksidantët e tyre totalë CERTËINE	K.Xh A.B M. O.Z	Qendra Kërkimore Nanoteknologjike NanoAlb	2022-2023	Ne proces	Realizimi 2022-2023 total 2,086,320 lekë nga te cilat: 1,260,000 lekë pajisje 826,320 lekë materiale.
5	Drejt krijimit të Njesisë së Biosensorëve pranë Grupit të Bioteknologjive Molekulare, NanoAlb - Përdorimi i biosensorëve me qeliza të plota dhe elektrokimike për të matur toksicitetin e ujit dhe tokës në bregdetin shqiptar BIOSENSTOXIC	A.B L.B Prof. Dr. R.M	Qendra Kërkimore Nanoteknologjike NanoAlb	2022-2023	Ne proces	Realizim periudha 2022-2023 total 2,097,908 lekë nga të cilat: Shpenzime udhëtim e dieta 201,308 lekë Pajisje 1,394,400 lekë dhe Materiale 502,200 lekë
Njësia e Arkeologjisë ArkeoBylis						
Nr	Titulli i projektit	Drejtes i projektit dhe Staf	Njësia / Komisioni	Periudha	Status	Kosto/lekë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

		<i>Seksioni</i>				
6	ArkeoBylis – gërmime metoda gjeofizike i agorasë së Bylisit	N.C	Njesia ArkeoBylis	2021	Përfunduar	951,820
7	ArkeoBylis – gërmime metoda gjeofizike i agorasë së Bylisit	N.C	Njesia ArkeoBylis	2022	Përfunduar	912,614
Qendra Bio Teknologjike						
8	Përzgjedhja e materialit bimor të kumbullës, të kontrolluar nga viruset sipas protokollit, për krijimin e impiantit pilot nëpërmjet shëndetësisimit dhe mikroshumimit, në funksion të fillimit të certifikimit të materialit mbjellës (Projekt Pilot në Rrjet). VITROCERT 2 – 2022	Prof. J.M Akad. E.K Prof. Asoc. V.S Prof. A.B Prof. M.C Dr. E.P	Qendra Bioteknologji & Gjenetikë	2022	Përfunduar	867,600 nga të cilat (753,600 materiale 99,000 dieta 15,000 karburant)

Projekte për vitin 2023 financuar nga Akademia e Shkencave

Qendra Bio Teknologjike						
Nr	Titulli i projektit	Drejtes i projektit dhe Stafit	Njesia / Komisioni Seksioni	Periudha	Status	Kosto
1	Ngritja e Kriobankës, e para në Shqipëri për konservimin e materialit gjenetik të specieve dru frutore autoktone në Laboratorin e ri të Qendres CRYOFRUIT	Akad. E.K Prof. Asoc. V.S Dr. E.P Prof. Asoc. F.C	Qendra Bioteknologji & Gjenetikë	2023	Ne proces	Realizim deri me 29.12.2023 total <u>1,232,280 lekë</u> materiale dhe pajisje
2	Përzgjedhja e materialit bimor të kumbullës, të kontrolluar nga viruset sipas protokollit, për krijimin e impiantit pilot nëpërmjet shëndetësisimit dhe mikroshumimit, në funksion të fillimit të certifikimit të materialit mbjellës (Projekt Pilot në Rrjet). VITROCERT 2 – 2023	Prof. J.M Msci. L.Xh Akad. E.K Prof. Asoc. V.S Prof. A.B Prof. M.C Dr. E.P Dr. R.S Msci.A.R	Qendra Bioteknologji & Gjenetikë	2023	Ne proces	Realizim deri më 29.12.2023 total <u>1,456,198 lekë</u> nga të cilat: 50,000 lekë honorare 228,754 lekë udhëtim e dieta 1,142,400 lekë materiale dhe 35,044 lekë org konference
3	Ngritja e nje banke kombetare te ADN ne popullaten shqiptare per studime gjenetike ne kete popullate dhe organizimi i nje regjistri kombetar dhuruesish te qelizave staminale per nevojat e transplantit te ketyre qelizave ne Shqiperi ADN CeLLSTAM	Akad G.S Akad I.M Prof Z.Y Prof Asoc I.Q Stafi laboratorik	Qendra Bioteknologji & Gjenetikë	2023-2024	Ne proces	Shpenzime për projektin deri me 29.12.2023 total <u>13,501,927 lekë</u> nga të cilat: Mjeke (QSUNT) 5,380,327 lekë Pajisje 4,188,000 lekë Materiale 3,933,600 lekë
Komisioni Fizik – Kimi						
4	Vlerësimi i shpërndarjes së Hg në sedimentet e Gjirit të Vlorës dhe përcaktimi i Hg në peshq, midhje dhe bimë Hg Vlorë	B.B A.Sh M.V N.B P.Ko	Komisioni i Fizikë-Kimisë	2023-2024	Ne proces	Shpenzime deri me date 29.12.2023 total <u>591,790 lekë</u> nga të cilat : 269,910 lekë honorare 75,880 lekë shpenzime udhëtim e dieta dhe pajisje 246,000 lekë
Komisioni i perhershëm i inxhinierise						



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

5	Nje platforme e perbashket per energjine elektrike ne sistemin elektroenergetik te Shqiperise dhe Kosoves PPEE-SESHK	Prof. Dr. R.B Prof. M.Ç	Komisioni i perhershem i inxhinierise	2023	Ne proces	Shpenzime te projektit deri me date 29.12.2023 188,270 lekë nga të cilat: 165,120 lekë honorare dhe 23,150 lekë materiale org konference
Njësia e Arkeologjisë ArkeoBylis						
6	Projekti për kërkimet arkeologjike përmes metodave fotogrametrike dhe gjeofizike në Bylis (Vazhdimi i dokumentimit dhe verifikimi i rezultateve të prospeksionit gjeofizik i agorasë së Bylisit) ArkeoBylis 2023	Prof. N.C	Njësia kërkimore e përkohshme e arkeologjisë së zbatuar "Arkeo-Bylis"	2023	Përfunduar	957,000

Nga auditimi u konstatua se, për periudhën objekt auditimi deri më 31.12.2023 është realizuar finalizimi i 3 projekteve, si më poshtë vijnë:

1. Projekti “Studimi sero-epidemiologjik i Gjendjes imunitare ndaj virusit SARS-CoV-2 në popullatën shqiptare”

Nga auditimi i kryer mbi raportin e dërguar në ASHSH u konstatua se:

- ✓ në metodën dhe testin e përcaktuar nga ana e ekipit të punës specifikohet:
 - Studimi pilot kryhet në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut, përmes së cilës u siguruan mostra serumi nga dhurues të gjakut gjatë dy periudhave kohore, maj 2018 dhe fund maj 2020.
- ✓ në propozimet për kryerjen e studimit, përcaktuar nga ana e ekipit të punës, specifikohet:
 - të pajisen qendrat shëndetësore me tubat dhe materialet e tjerë të konsumit, si dhe trajnohet nga një infermiere për marrje gjaku në çdo qendër.
- ✓ në kostot e studimit, përcaktuar nga ana e ekipit të punës, specifikohet:
 - është e nevojshme të kontraktohen në studim me kohë të pjesshme 5 ekspertë klinike nga çdo qendër shëndetësore për një pagesë rreth 20,000 lekë për person.
 - Gjithashtu të kontraktohen për kohë të pjesshme 5 koordinatorë në terren dhe 2 eksperte laboratorit për një pagesë për rreth 10,000 lekë për person.
- ✓ në projekt propozimim për studim në fazën e tretë të projektit sipërcituar, në pjesën e rëndësishme së studimit specifikohet:
 - faza e tretë e studimit do të gjeneroj të dhëna të rëndësishme për vendimmarrjen e masave të mëtejshme epidemiologjike, sidomos të atyre vendimeve që kanë të bëjnë me masat shtrënguese të distancimit social. Nga ana tjetër, njohja dinamike e seroprevalencës së antitropave anti SARS CoV-2 do të jetë mjaft e dobishme dhe për përcaktimin e strategjisë që duhet ndjekur për aplikimin e vaksinës në të ardhmen
 - të dhënat e studimit kanë vlerë jo vetëm për të vlerësuar marrjen e masave dhe parashikimin e tyre me qëllim pengimin dhe kufizimin e infeksionit, por dhe për të vlerësuar nevojat reale për aplikimin e vaksinës dhe mënyrën e implementimit të fushatës vaksinale.
- ✓ në projekt propozimim për studim në fazën e katërt të projektit sipërcituar, specifikohet:
 - rezultatet e studimit janë publikuar në Forumin Shkencor të 1 Nëntorit dhe dy revista ndërkombëtare me faktor impakti.



Nga auditimi i dokumentacionit financiar lidhur me projektin “Studimi seroepidemiologjik i Gjendjes imunitare ndaj virusit SARS-CoV-2 në popullatën shqiptare” u konstatua se:

- për vitin 2020 totali shpenzimeve që janë kryer për efekt të këtij programi janë:

- a) për materiale, kite 1,297,219 lekë

- b) për honorare 187,000 lekë+ TAP 15% = 220,000 lekë

- për vitin 2021 totali shpenzimeve që janë kryer për efekt të këtij programi janë:

- a) për materiale, kite 3,711,504 lekë

- b) për honorare 127,500 lekë + TAP 15% = 150,000 lekë

- për vitin 2022 totali shpenzimeve që janë kryer për efekt të këtij programi janë:

- c) për pajisje Lab-bioteknologjie 3,770,880 lekë

- d) për honorare 127,500 lekë + TAP 15% = 150,000 lekë

✓ Në total kosto e projektit sero-epidemiologjik, sipas dokumentacionit vendosur në dispozicion rezulton në 9,299,603 lekë nga ku 520,000 lekë janë dhënë për honorare dhe 8,779,603 lekë janë dhënë për furnizim me bazë materiale të tyre.

Ndërkohë referuar të dhënave ekonomike të shpenzuara nga ana e ASH rezulton në 24,165,492 lekë, me një diferencë prej 14,865,889 lekë më tepër të pambuluara me dokumentacion.

Nga auditimi u konstatua se, dy nga tre urdhër shpenzimet rezultonin pa gjurmë të dokumentit të aktit të marrjes në dorëzim, operuar në kundërshtim me UMF nr.30 datë 27.12.2011 “Menaxhimin i Aktiveve të NJSP”, pika 32 dhe 43.

Në një urdhër shpenzim akti i marrjes në dorëzim ishte pa firmë të Magazinierit, operuar në kundërshtim me UMF nr.30 datë 27.12.2011 “Menaxhimin i Aktiveve të NJSP”, pika 43.

Sa i takon procedurës së kalimit të materialeve dhe kiteve nga magazina në qendra shëndetësore dhe persona përkatës mungon gjurma dokumentare e nxjerrjes së aktiveve nga magazina, operuar në kundërshtim me UMF nr.30 datë 27.12.2011 “Menaxhimin i Aktiveve të NJSP”, pika 38.

22. Gjetje nga auditimi:

- Nga auditimi u konstatua se, totali shpenzimeve për financimin e këtij projekti, referuar urdhër shpenzimeve vendosur në dispozicion grupit të auditimit rezultonte në vlerën prej 9,299,603 lekë përdorur për materiale dhe kite.

Sa i takon dokumentacionit vendosur në dispozicion grupit të auditimit u konstatua se,

- dy nga tre urdhër shpenzimet rezultonin pa dokument të aktit të marrjes në dorëzim, operuar në kundërshtim me UMF nr.30 datë 27.12.2011 “Menaxhimin i Aktiveve të NJSP”, pika 32 dhe 43.

- Në një urdhër shpenzim akti i marrjes në dorëzim ishte pa firmë të Magazinierit, operuar në kundërshtim me UMF nr.30 datë 27.12.2011 “Menaxhimin i Aktiveve të NJSP”, pika 43.

- Sa i takon procedurës së kalimit të materialeve dhe kiteve nga magazina në qendra shëndetësore dhe persona përkatës mungon gjurma dokumentare e nxjerrjes së aktiveve nga magazina, operuar në kundërshtim me UMF nr.30 datë 27.12.2011 “Menaxhimin i Aktiveve të NJSP”, pika 38.

22.1 Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi mbi raportet e dërguar në ASH nga ana e ekipit të punës për projektin “Studimi sero-epidemiologjik i Gjendjes imunitare ndaj virusit SARS-CoV-2 në popullatën shqiptare” u konstatua se:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

✓ Studimi pilot kryhej në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut, përmes së cilës u siguruan mostra serumi nga dhurues të gjakut, nga auditimi i raportit të vendosur në dispozicion (muajt nëntor – dhjetor) nga Njësia Bioteknologjisë Gjenetike dhjetor 2021) specifikohet se ... *mostrat e analizuara janë ato të marra nga Banka Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut.*

Rrjedhimisht kjo sjell mospërputhje mes objektit të kryerjes së studimit për të cilin janë blerë materiale për testimin e gjakut, pasi këto mostra janë marr të gatshme nga QKTGJ dhe nuk argumentohet nevoja e blerjes së pajisjeve dhe materialeve për kryerjen e testeve apo të pagimit të infermiereve për marrjen e gjakut nga pacientët.

✓ Referuar raportit specifikohet se ..Qendrat shëndetësore u pajisën me tuba dhe materiale të tjerë të konsumit, si dhe *u trajnuar nga një infermiere për marrje gjaku në çdo qendër*, sa më sipër mungon:

- gjurma e dokumentimit të trajnimeve të kryera si dhe
- dokumenti i nxjerrjes së aktiveve nga magazina e ASH në QSH;

✓ për efekt studimi specifikohet nevoja e kontraktimit me kohë të pjesshme të 5 ekspertë klinike nga çdo qendër shëndetësore për një pagesë rreth 20,000 lekë për person, si dhe 5 koordinatorë në terren dhe 2 eksperte laboratorit për një pagesë për rreth 10,000 lekë për person.

- nga auditimi u konstatua se mungon gjurma e kryerjes së përzgjedhjes së personave sipërcituar
- ndërkohë vlera financiare e akorduar për këtë qëllim rezulton në 490,000 lekë.

✓ Në projekt studim specifikohet se, ... *Faza e tretë e studimit do të gjeneroj të dhëna të rëndësishme për vendimmarrjen e masave të mëtejshme epidemiologjike, sidomos të atyre vendimeve që kanë të bëjnë me masat shtrënguese të distancimit social. Nga ana tjetër, njohja dinamike e seroprevalencës së antitropave anti SARS CoV-2 do të jetë mjaft e dobishme dhe për përcaktimin e strategjisë që duhet ndjekur për aplikimin e vaksinës në të ardhmen; të dhënat e studimit kanë vlerë jo vetëm për të vlerësuar marrjen e masave dhe parashikimin e tyre me qëllim pengimin dhe kufizimin e infeksionit, por dhe për të vlerësuar nevojat reale për aplikimin e vaksinës dhe mënyrën e implementimit të fushatës vaksinale.*

- Nga auditimi u konstatua mungesë e gjurmës së mbajtjes së një ***korrespondence me institucionet përgjegjëse*** (Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Instituti Shëndetësor Publik apo institucione të tjera të cilat u morrën me menaxhimin e pandemisë) për të koordinuar punën apo dhënë orientime/sygjerime për vijimësinë mbi bazën e studimit.

Observacion i paraqitur nga ana e subjektit me shkresën nr.896/35 prot., datë 29.03.2024 protokolluar në KLSH me nr.959/6 prot., datë 02.04.2024

Pretendimi i subjektit:

Njësia e biogjenetikës u ngrit në kushtet e pandemisë Covid-19, nga Asambleja e Kryesia me vendimin nr.20, datë 28.02.2020, nr. 202 prot., datë 28.02.2020, konform kompetencës së tyre ligjore neni 19, për të ngritur njësi të kërkim-studimit në bazë të ligjit të ASH. Ajo u ngrit me një objekt të caktuar, përfshirë ndjekjen e problemeve që lidheshin me pandeminë, bazuar në rekomandimet e tri komisioneve të përhershme të përbërë nga rreth 50 akademikë e profesorë, mjekë të linjës së parë, për nevojën e studimit të imunitetit të fituar nga popullata në Shqipëri.

Për realizimin e projektit iu kërkua qeverisë e ministrisë së Shëndetësisë të vihej në dispozicion, si pjesë e njësisë, laboratorit i imunologjisë dhe personeli i tij mjekësor. Pra, personeli mjekësor



ekzistues u bë pjesë e njësisë dhe siç e kërkon ligji u caktua me vendim edhe masa e pagesës për ta.

Njësia paraqiti studimin Sero-epidemiologjik të gjendjes imunitare ndaj virusit Sars-cov-2 shoqëruar me preventivin përkatës, ku parashikoheshin shpenzimet për kitet, personelin ndihmës e për shërbime të tjera. Për drejtuesit e projektit nuk parashikohej shpërblim. Pagesat janë bërë në bazë të preventivit dhe akteve nënligjore, për një punë të lavdërueshme veçanërisht nga personeli mjekësor të kryer në kushtet kur si marrja e gjakut edhe kryerja e analizave shoqërohej me rrezik të madh, deri të jetës.

Në këto kushte, kur tërë strukturat e ASH dhe gjithë strukturat bashkëpunuese të Ministrisë së Shëndetësisë e kanë vlerësuar këtë punë të personelit mjekësor, e ato kanë kryer me përgjegjësi e kompetencë detyrën e tyre sipas projektit e vendimeve të kryesisë e të Asamblesë, e janë paguar në nivel të homologëve të tyre, e jo për vështirësi, nuk ka asnjë shkak ligjor për të kthyer pagesën. Rezultatet e studimit “Seroprevalenca e infeksionit COVID-19 në popullatën shqiptare” janë komunikuar gjerësisht në katër konferenca shkencore të organizuara nga Akademia e Shkencave, ku janë ftuar dhe kanë marrë pjesë rregullisht përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë, Instituti i Shëndetit Publik, Universiteti i Mjekësisë, Universiteti i Tiranës, Delegacioni i Organizatës Botërore të Shëndetësisë si dhe përfaqësues të mediave dhe organizatave jo-qeveritare. Konkluzionet e studimit u janë komunikuar rregullisht institucioneve përkatëse dhe publikut dhe me konferenca shtypi si dhe me anë të mediave të shkruara apo ato vizive të komunikimit publik. Trajtimet shkencore të këtyre konkluzioneve janë botuar në 4 artikuj shkencorë në revista shkencore ndërkombëtare me impakt faktor, ndërsa tre artikuj të tjerë shkencorë janë në proces publikimi ose përpunimi.

Pra, impakti i këtij studimi ka qenë jo vetëm kombëtar, por dhe ndërkombëtar dhe i certifikuar nga ekspertë dhe shkencëtarë që kanë bërë recensionet e artikujve shkencorë të botuar.

Në të gjithë materialet shkencore të botuara Akademia e Shkencave e Shqipërisë referohet si institucioni ku është kryer studimi dhe që e ka financuar atë.

Është e njohur botërisht që autorët e publikimeve shkencore janë me emër të veçantë, dhe atyre u bashkangjiten dhe institucionet ku ata punojnë si dhe ai institucion ku kryhet studimi.

Njihet botërisht se treguesit më të rëndësishëm të produktivitetit dhe efektivitetit të çdo veprimtarie apo projekti kërkimor-shkencor janë cilësia dhe numri i artikujve shkencorë që botohen në shtypin shkencor kombëtar apo ndërkombëtar të akredituar dhe me impact factor.

Numri prej katër artikujsh të tillë të botuar deri tani në shtypin ndërkombëtar me nivel të lartë shkencor është treguesi objektiv më i rëndësishëm që mat dhe tregon nivelin e lartë të produktivitetit dhe të efektivitetit të projektit të ASHSH “Seroprevalenca e infeksionit COVID-19 në popullatën shqiptare”.

Rezultatet shkencore të këtij studimi kanë kaluar një proces recensionimi nga ekspertë ndërkombëtarë, të cilët kanë kryer “peer review” e rezultateve të tij. Kjo është prova më bindëse e efektivitetit të këtij projekti që është unik të paktën në Europën Lindore pasi është i vetmi studim që ka ndjekur zhvillimin dinamik të imunitetit kolektiv në një popullatë konkrete siç është popullata shqiptare nga maj-qershori i vitit 2020 kur ai ishte 7.5% deri në gusht 2022 kur rezultoi 94%.

Këto të dhëna, si dhe mjaft të tjera më të hollësishme të studimit janë mjaft të rëndësishme edhe në aspektin operativ pasi duke njohur konkretisht përhapjen reale të gjendjes imunitare të popullatës sipas grup-moshave të ndryshme si dhe nivelin cilësor të këtij imuniteti bëhet e mundur



marrja e masave konkrete efektive për përballimin e infeksionit nëpërmjet strategjive vaksinale dhe masave të tjera anti-epidemike.

Është e qartë që bashkëpunimi me institucionet përgjegjëse dhe korrespondenca me ato ka qenë rregullisht dhe në vijimësi siç edhe i përmendëm më lart.

Qëndrimi Grupit të Auditimit:

Risjellim në vëmendjen Tuaj se, ne asnjë moment nuk jemi shprehur mbi aktivitetin shkencor, konstatimet janë kryer mbi bazën e dokumentacionit të vendosur në dispozicion dhe inspektimit në terren.

Referuar observacionit të paraqitur, është kryer një argumentim i veprimeve dhe nuk keni paraqitur të dhëna justifikuese të situatës.

Gjetja i referohet komunikimit dhe marrëdhënies zyrtare ndërinstitucionale ndërmjet njësisë përkatëse të Akademisë së Shkencave dhe institucioneve të ngarkuara për menaxhimin e situatës së shkaktuar nga Sars-Cov-19.

Sa më sipër në kushtet e sjelljes së dokumentacionit justifikues (forumet ku janë përfaqësuar materialet) pranohet pjesërisht

Sa më sipër observacioni pranohet vetëm pjesa e rezultateve të prezantuara.

***Observacion i paraqitur nga ana e subjektit me shkresën nr.896/35 prot., datë 29.03.2024
protokolluar në KLSH me nr.959/6 prot., datë 02.04.2024***

Pretendimi i subjektit:

Konstatimi në këtë pikë nuk është i saktë sepse ai nuk merr parasysh metodologjinë specifike se si realizohen bashkëpunimet shkencore dhe metodologjitë kërkimore në këto studime:

Me Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjaku bashkëpunimi është institucional sepse si Shërbimi i Imunologjisë ashtu dhe kjo qendër janë pjesë e Departamentit të Mjekësisë Laboratorike të Universitetit të Mjekësisë dhe shkëmbimet e mostrave biologjike dhe të informacionit shkencor midis shërbimeve universitare janë normë e aktivitetit kërkimor të institucionit universitar.

Gjithashtu duhet të qartësohet se nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjaku është marrë jo më shumë se 7 për qind e mostrave biologjike nga rreth 6000 individë që janë marrë gjithsej në studim gjatë gjithë projektit. Studimi i këtyre mostrave ka pasur objekt të njëjtë dhe të vetëm si për të gjithë individët e tjerë të studiuar seroprevalencën e virusit SARS-CoV-2 me anë të studimit të antitropave specifike për këtë virus. Kjo ishte e nevojshme se duhet të studioheshin mostra gjaku të marra edhe para pandemisë që të krahasoheshin me ato aktuale. Nga kjo qendër janë marrë vetëm kampione gjaku dhe i gjithë përpunimi laboratorik është bërë në Laboratorin e Qendrës Kërkimore të Bioteknologjisë dhe Gjenetikës (QKBGJ) të ASHSH me materialet dhe reagentët e prokuruar nga Akademia e Shkencave dhe i realizuar nga personeli i po kësaj qendre.

Konkretisht, nga QKBGJ i janë dërguar Qendrës së Gjaku, tubat e marrjes së mostrave të gjaku (të nevojshëm për transportimin e tij në kushtet e optimale sipas protokollit studimor) si dhe formularët dhe ato janë kthyer po në Laboratorin e QKBGJ për procesim laboratorik dhe përpunim të mëtejshëm të të dhënave. Pra përpunimi i plotë laboratorik i mostrave të gjaku është bërë me materialet e konsumit të Laboratorit të Qendrës së Bioteknologjisë dhe Gjenetikës të prokuruar nga ASHSH.

Prandaj konkluzioni i mësipërm për “mospërputhje midis objektit të studimit” nuk qëndron në asnjë aspekt.

***Qëndrimi Grupit të Auditimit:***

Referuar observacionit të paraqitur, në kushtet e mungesës së dokumentacionit të ri justifikues observacioni nuk merret në konsideratë.

Sa më sipër observacioni nuk pranohet.

***Observacion i paraqitur nga ana e subjektit me shkresën nr.896/35 prot., datë 29.03.2024
protokolluar në KLSH me nr.959/6 prot., datë 02.04.2024***

Mungon gjurma e kryerjes së përzgjedhjes së personave të kontraktuar me kohë të pjesshme për efekt studimi, ku vlera financiare e akorduar për këtë qëllim rezulton në 3,099,760 lekë.

- Mungon gjurma e dokumentimit të trajnimeve të kryera për çdo infermier për marrje gjaku në çdo qendër.

- Në kushtet e mungesës së dokumentacionit justifikues bazë dhe të domosdoshëm të kryerjes së pagesës nga Akademia e Shkencave drejt stafit mjekësor të përfshirë në projekt, vlera prej 3,099,760 lekë, përbën dëm ekonomik.

Pretendimi i subjektit:

Për sa citohet *Mungon gjurma e kryerjes së përzgjedhjes së personave të kontraktuar me kohë të pjesshme për efekt studimi, ku vlera financiare e akorduar për këtë qëllim rezulton në 3,099,760 lekë, sqarojmë si vijon:*

Në periudhën në fjalë ishte në fuqi rregullore “Mbi kriteret e përgjithshme e të veçanta dhe procedurat e pranimit të personelit në strukturën dhe organikën bazë të Akademisë së Shkencave, si dhe në strukturat e ngritura pranë saj”, me nr. 537/1 prot., datë 5.10.2020.

Në nenin 14 “Pranimet me afat të kufizuar”, pika b) specifikohet se “Për deri tre muaj për plotësimin e nevojave të ngutshme të krijuara nga vakancat në strukturën administrative bazë”.

Përzgjedhja e tyre është bazuar në kualifikimin më të lartë profesional të tyre dhe prandaj si rregull ato ishin drejtori dhe kryeinfermierja e Qendrës Shëndetësore, të cilët ishin dhe personat më të kualifikuar që u morën direkt me studimin.

Trajnimi i tyre specifik për protokollin studimor të projektit u realizua që në fillim me dorëzimin e protokollit dhe, bashkëpunimi me to ishte i vazhdueshëm gjatë gjithë aktivitetit kërkimor. (pra këtu nuk bëhet fjalë për trajnim profesional, pasi mjekët dhe infermierët e përzgjedhur ishin dhe janë personeli më i kualifikuar, siç përshkruhet dhe më sipër. Bëhet fjalë për instruktimin e tyre në zbatim të protokollit të bashkëpunimit).

Kjo është reflektuar si në protokollin e punës kërkimore që u hartua që në fillim në kuadër të projektit, ashtu dhe në procesverbalet e marrjes në dorëzim të materialeve si dhe të instruktimit-trajnitimit të personelit si dhe në formularët e plotësuar gjatë studimit, materiale të cilët janë aprovuar nga Komisioni i Mjekësisë i ASHSH.

Shpërblimi njëherësh prej 20,000 lekë për mjekun dhe 10,000 për infermierin e çdo qendre shëndetësore u krye për bashkëpunimin tyre në marrjen e të dhënave dhe mostrave të gjakut të individëve që u morën në studim për Qendrat Shëndetësore që bashkëpunuan. Ky shpërblim është në fakt simbolik duke pasur parasysh volumin shumë të madh të punës që u realizua.

Vlera financiare prej 3,099,760 lekë (vlerësuar si dëm ekonomik) cituar si akordim për pagesën e personave të kontraktuar me kohë të pjesshme për efekt studimi, sqarojmë se me shkresën nr. 809 prot, datë 09.12.2022 nga drejtuesi i Qendrës është paraqitur projekt-buxheti i projektit “*Studimi sero-epidemiologjik i gjendjes imunitare ndaj virusit SARS-CoV-2 në popullatën shqiptare*” në të cilin specifikohet vlera 150 000 lekë për pagesë të stafit mjekësor të qendrave shëndetësore, në



bazë të të cilit është bërë edhe lidhja e kontratave dhe pagesa e tyre (paraqitur pranë jush gjatë periudhës së auditimit dhe pranuar). Pjesa tjetër prej 2,940,000 lekë është për materiale konsumi dhe të tjera pagesa operative që janë realizuar për blerje kite dhe reagentë për këtë projekt gjatë vitit 2022 dhe nuk ka të bëjë me pagesën e mjekëve dhe infermiereve të kontraktuar me kohë të pjesshme. Siç shihet, është një vlerë krejt minimale (150,000 lekë), shpenzuar sipas akteve nënligjore, për një punë voluminoze të kryer. Kjo shkresë ju është vënë në dispozicion gjatë auditimit.

Përfundimisht mund të themi se rezultatet shkencore të këtij projekti, të reflektuara në katër artikuj shkencore në revista shkencore ndërkombëtare deri tani dhe tre të tjerë në proces, si dhe në mjaft referime në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare etj. janë një pasuri kombëtare e shkencës shqiptare që ka pasuruar fondin e njohurive të shkencës kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e infeksionit Covid-19. Rezultatet origjinale të këtij studimi janë pjesë e fondit shkencor ndërkombëtar pasqyruar në bazën e të dhënave shkencore ndërkombëtare.

Mendojme se duke u bazuar sa më lart, nuk mund të mos konkludojmë se ky projekt duhet të gjykohet nga produkt i tij i përgjithshëm si një projekt shumë i suksesshëm dhe me efektivitet të lartë pavarësisht se u realizua me një buxhet modest dhe në kushte jo optimale dhe emergjente.

Në këto kushte, kur tërë strukturat e ASH-së dhe tërë strukturat bashkëpunuese të Ministrisë së Shëndetësisë e kanë vlerësuar këtë punë të personelit mjekësor, e ato e kanë kryer me përgjegjësi e kompetencë detyrën e tyre sipas projektit e vendimeve të Kryesisë e të Asamblesë, e janë paguar në nivel të homologëve të tyre, e jo për vështirësi, nuk ka asnjë shkak ligjor për të kthyer pagesën.

Qëndrimi Grupit të Auditimit:

Referuar observacionit të paraqitur, sjellim në vëmendjen tuaj se: Këto materiale (*shkresën nr. 809 prot, datë 09.12.2022* janë vendosur në dispozicion me observacionet e dyta, të projekt raportit dhe jo gjatë periudhës së auditimit).

Referuar saj për v.2020 janë paguar 150,000 lekë honorarë për punonjësit e kontraktuar, ndërkohë referuar Raportit datë 25.06.2020 kryer në zbatim të VKA nr.33 datw 07.05.2020 kostot e studimit për honorare për punonjësit e kontraktuar parashikohen të jenë 170,000 lekë. Sa më sipër ka një mospërputhje mes kostos së paraqitur në v.2020 me atë të paraqitur në shkresën nr.809 datë 09.12.2022 të v.2022.

Po ashtu referuar VKA nr.33 dt 07.05.2020 si dhe shkresës nr.809 prot., dt 09.12.2022 në asnjë paragraf nuk specifikohet vlera e pagesës së mjekëve dhe infermiereve (konkretisht 10,000 lekë dhe 20,000 lekë).

Gjithashtu sqarojmë se, në observacion është paraqitur lista emërore e pjesshme (vetëm 5 drejtues dhe 3 infermiere), ndërkohë që në studim janë parashikuar 5 drejtues dhe 5 infermiere. Kjo listë emërore nuk shoqërohet me dokumentacionin justifikues të kryerjes së pagesave (Urdhër shpenzime apo mandpagesa).

Sa më sipër observacioni merret pjesërisht në konsideratë, për vlerën e kiteve dhe pajisjeve dhe jo për honorarët e cila parashikohet si dëm ekonomik në vlerën **490,000 lekë**.

Referuar “Observacion i paraqitur nga ana e ASHSH me shkresën nr.886/22 prot., datë 22.01.2024 protokolluar në KLSH me nr.959/4 prot., datë 22.01.2024” specifikohet se: personat e përfshirë në studim nga poliklinikat u përzgjedhën me kriteret si vijon:

- 1 – Drejtuesi i Poliklinikës si ekspert klinike dhe
- 2 – Personeli i mesmë i caktuar prej tij.

Pagesat për vitin 2021 janë si vijojnë:

5 ekspertë nga 20,000 = 100,000 lekë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

5 koordinatorë nga 10,000 = 50,000 lekë

2 ekspertë laboratorit nga 10,000 = 20,000 lekë

Gjithsej = 170,000 lekë për vitin

Kjo pagesë është përsëritur dy vjet rresht, prandaj shuma e përgjithshme është 340,000 lekë.

(150,000 lekë v.2022 + 340,000 lekë v.2020 dhe 2021=490,000).

Sa më sipër observacioni pranohet pjesërisht (vetëm vlera e kiteve).

✓ Rezultatet e studimit janë publikuar në Forumin Shkencor të 1 Nëntorit dhe dy revista ndërkombëtare me faktor impakti, ku në të dy rastet këto botime janë në emër të personave të cilët janë marr me studimin dhe jo të Akademisë së Shkencave.

✓ Referuar Urdhër Shërbimeve vendosur në dispozicion, totali i kostos së projektit është 10,518,822 lekë.

Bashkangjitur Vendimit është një preventiv paraprak i shpenzimeve financiare për realizimin e njërit studim “Studimi epidemiologjik i gjendjes imunitare ndaj virusit SARS COV 2 në popullatën në Shqipëri”, **por mungon një buxhet i parashikuar për efekt studimi referuar shtrirjes kohore të tij.**

Në të specifikohet një total 19.000 Euro si një parashikim paraprak i përgjithshëm.

**Observacion i paraqitur nga ana e subjektit me shkresën nr.896/35 prot., datë 29.03.2024
protokolluar në KLSH me nr.959/6 prot., datë 02.04.2024**

Nga rishikimi dhe analizimi dhe njëherë i shpenzimeve të sipërcituara për projektin “Studimi sero-epidemiologjik i Gjendjes imunitare ndaj virusit SARS-CoV-2 në popullatën shqiptare”, sqarojmë:

Përsa i përket vlerës totale të këtij projekti, realizuar për vitet 2020-2022 në shumën 24,241,178 lekë (8,320,453 lekë materiale + 6,662,925 lekë pagesë për punojësit kërkimor të laboratorit të QKBGJ + 550,000 lekë për mjekë e infermierë me kohë të pjesshme të qendrave shëndetësore (QSH) nënvizojmë se:

Pas saktësimit të vlerave të realizuara për projektin sipërcituar vlerat prej **7,879,800 lekë** blerje pajisje viti 2022 dhe **828,000 lekë** blerje kite, nuk janë realizuar në kuadër të projektit të sipërcituar, por në kuadër të ngritjes së Qendrës së bioteknologjisë dhe gjenetikës, miratuar me Vendimin e Kryesisë nr. 2, datë 10.01.2022 “Për ngritjen Qendrës Kërkimore Shkencore të Bioteknologjisë dhe Gjenetikës” dhe sipas kërkesave për blerje nr.100/1, datë 04.02.2022 dhe nr. 436 prot., datë 13.06.2022 nga bashkëdrejtuesit e Qendrës dhe miratuar nga Titullari i Institucionit (bashkëlidhur).

Bazuar në kërkesën sipërcituar është bërë edhe kërkesa drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për rialokim fondi (pakësim artikulli 602 dhe shtim artikulli 231). Fondi për blerjen e këtyre pajisjeve është miratuar me Aktin Normativ nr.12, datë 29.07.2022 (konstatuar edhe nga grupi auditit).

Kështu që vlera reale e Projektit “Studimi sero-epidemiologjik i gjendjes imunitare ndaj virusit SARS-CoV-2 në popullatën shqiptare”, realizuar për periudhën 2020 - 31.12.2022 është **15,533,378 lekë (8,320,453 lekë blerje kite + 7,212,925 lekë pagesë për punonjësit kërkimorë të Laboratorit të QKBGJ-së dhe mjekët e infermierët të Qendrave Shëndetësore që u kontraktuan me kohë të pjesshme dhe bashkëpunuan për projektin.**

**Shpenzimet e kryera janë bërë sipas akteve e nënakteve ligjore bazë për këtë projekt.**

Mund të themi se ky projekt është shembull i efektivitetit të lartë të një aktiviteti kërkimor shkencor i kryer në ASHSH me një total shpenzimesh modeste prej **15,533,378 lekë** për të gjitha fazat e tij. Për sa më sipër, konkluzioni i KLSH-së si më lart se kemi të bëjmë me “Shpenzim jo efektiv të buxhetit të shtetit” për projektin “Studimi sero-epidemiologjik i gjendjes imunitare ndaj virusit SARS-CoV-2 në popullatën shqiptare” **nuk qëndron**.

Oëndrimi Grupit të Auditimit:

Sjellim në vëmendjen tuaj se, auditimi është kryer mbi bazën e dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga ana juaj, argumentimet dhe ballafaqimet si gjatë fazës së kryerjes së auditimit në terren edhe pas sjelljes së observacioneve të para po prapë janë kryer mbi dokumentacionin vendosur në dispozicion. Referuar pretendimit tuaj, saktësimi i vlerave është kryer pas mbylljes së auditimit dhe në kushtet e mosparaqitjes së dokumentacionit të ri për verifikimin e pretendimeve tuaja, sa më sipër nuk merret në konsideratë.

Sa më sipër observacioni nuk pranohet.**2. Projekti “ArkeoBylis – gjurmime metoda gjeofizike i agorasë së Bylisit”**

Nga auditimi i kryer mbi dokumentacionin e vendosur në dispozicion rezultonte prania e Vendimit nr.64 datë 03.10.2022 për miratimin e projektit “Për zbatimin e metodave gjeofizike në kërkimet arkeologjike faza e dytë, arkeobylylis 2022 (zona arkeologjike Bylis)” dhe Vendimit nr.54 datë 18.09.2023 për miratimin e projektit “Për kërkimet arkeologjike përmes metodave fotogrametrike dhe gjeo fizike në Bylis, faza e tretë, arkeobylylis 2023 (zona arkeologjike Bylis)”.

Ndërkohë dokumentacioni përmbante disa mangësi si më poshtë vijojnë:

✓ Mungonte gjurma e një relacioni mbi këtë projekt përpara miratimit të tij, si dhe mungonte gjurma e objektivave të studimit dhe se çfarë do të arrihej përmes tij.

✓ në kostot e studimit, v.2022 përcaktuar nga ana e drejtuesit të projektit, specifikohet:

- përbërja me 3 persona (N.C, S.M dhe O.C, ku akomodim ishte parashikuar për 2 persona dhe dieta parashikuar për 3 persona)

- nga auditimi i urdhër shpenzimeve rezultoj se, për vitin 2022 personat që ishin paguar me honorare dhe dieta brenda vendit ishin të tjerë nga ata të parashikuar në buxhetin e projektit. Kjo me argumentimin e ASHSH se, janë punëtorë të marrë për të realizuar punën në terren, por ndërkohë grupit të auditimit nuk iu vendos në dispozicion asnjë gjurmë dokumentare e numrit apo emrave të këtyre personave.

➤ Totali i kostos së projektit për vitin 2022 rezultonte në 985,000 lekë ku:

a) pagesa për honorare 127,500 lekë + TAP 15% = 150,000 lekë

b) pagesa për akomodim 120,000 lekë;

c) dieta brenda vendit 150,000 lekë;

d) konsulencë topografike 470,834 lekë + TVSH 20% = 565,000 lekë

ku në pagesat për dieta dhe honorare vetëm në një rast u evidentua emri i vetëm një anëtari të grupit të punës, për personat e tjera nuk rezultonte gjurmë justifikuese se cilët ishin dhe çfarë përfaqësonin apo çfarë roli do të luanin.

✓ në kostot e studimit, v.2023 përcaktuar nga ana e drejtuesit të projektit, specifikohet:

- përbërja me 4 persona (N.C, J.P, A.M dhe O.C, ku akomodim dhe dieta parashikuar për 4 persona)



nga auditimi i urdhër shpenzimeve rezultoi se, për vitin 2023 personat që ishin paguar me honorare dhe dieta brenda vendit ishin të tjerë nga ata të parashikuar në buxhetin e projektit.

➤ Totali i koston së projektit për vitin 2023 rezultonte në 887,400 lekë ku:

a) pagesa për honorare 486,200 lekë + TAP 15% = 572,000 lekë;

b) pagesa për akomodim 180,000 lekë;

c) dieta brenda vendit 175,000 lekë;

✓ Në raportin e dërguar në ASHSH për veprimtarinë e projektit Arkeobyilis 2023 nuk rezulton që ky raport të përmbajë ekstremitete dhe nuk rezulton asnjë rezultat final i dokumentuar nga ky projekt.

✓ Rezultatet e studimit nuk kanë gjurmë të publikimit të tyre.

✓ Nga auditimi u konstatua prania e urdhër shpenzimit nr.622 datë 28.12.2021 pagesë honorare për Arkeo Bylis me vlerën 22,610 lekë.

Referuar praktikës shoqëruese u konstatua, prania e relacionit shtesë mbi ekspeditën arkeologjike Bylis 2021 të kryer për periudhën 30 shtator – 21.10.2021 ku specifikohet se...*procedurat e zhvillimit të punimeve i kemi sqaruar në relacionin e kryer, gjurma e të cilit mungon.*

✓ Mungon edhe Vendim i Kryetarit mbi miratimin e projektit për v.2021

U konstatua, mungesë e informacionit lidhur me personat/punëtorët që ishin pjesë e këtij studimi, si në numër personash po ashtu edhe në trajtë nominale për të verifikuar se për cilët është kryer pagesa. Në relacion evidentohet vetëm grupi i punës i përbërë nga 3 anëtar dhe nuk jepet argumentim mbi numrin total që do të merret me këtë projekt, ndërkohë që në relacion specifikohet pagesa e një punëtori shtesë.

✓ Në total kosto e projektit Arkeo-Bylis, sipas dokumentacionit vendosur në dispozicion rezulton në 1,895,010 lekë, ndërkohë referuar të dhënave ekonomike të shpenzuara nga ana e ASHSH rezulton në 2,821,434 lekë, me një diferencë prej 926,424 lekë më tepër të pambuluara me dokumentacion.

23. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i dokumentacionit justifikues mbi projektin “ArkeoBylis – gërmime metoda gjeofizike i agorasë së Bylisit” u konstatua se:

- Mungonte gjurma e një relacioni mbi këtë projekt përpara miratimit të tij, si dhe mungonte gjurma e objektivave të studimit dhe se çfarë do të arrihej përmes tij;
- Nga auditimi i urdhër shpenzimeve rezultoj se, për v.2022 dhe v.2023 personat që ishin paguar me honorare dhe dieta brenda vendit ishin të tjerë nga ata të parashikuar në buxhetin e projektit;
- Mungesë e informacionit lidhur me personat/punëtorët që ishin pjesë e këtij studimi, si në numër personash po ashtu edhe në trajtë nominale për të verifikuar se për cilët është kryer pagesa;
- Në raportin e dërguar në ASHSH për veprimtarinë e projektit Arkeobyilis 2023 nuk rezulton që ky raport të përmbajë ekstremitete;
- Nuk është finalizuar ende rezultati përfundimtar i dokumentuar nga ky projekt.

**Observacion i paraqitur nga ana e subjektit me shkresën nr.896/35 prot., datë 29.03.2024
protokolluar në KLSH me nr.959/6 prot., datë 02.04.2024**

Për sa më sipër ju sqarojmë se, në bazë të Ligjit dhe Statutit të Akademisë, Njësia kërkimore Arkeobyilis, objekt i punës së të cilës është projekti i sipërcituar, është ngritur me VKA nr. 52, datë 05.08.2021, me nr. 484/3 prot. Për vitet 2022-2023, puna e Njesisë (projekti) ka vazhduar në bazë



të vendimeve nr. 64, datë 31.10.2022, me nr. 672/1, datë 31.10.2022 dhe vendimi nr. 48, datë 11.09.2023 me nr. 640/2 prot., datë 11.09.2023. (bashkëlidhur vendimet)

Projekti ArkeoBylis është paraqitur si bashkëpunim trevjeçar (2021-2023) midis Njesisë ArkeoBylis të Akademisë së Shkencave dhe Institutit të Arkeologjisë të Akademisë së Studimeve Albanologjike. Në projekt u angazhuan edhe studentët e Fakultetit të Arkitekturës të Universitetit Politeknik të Tiranës.

Synimi i projektit ka qenë rifillimi i gërmimit arkeologjik të cisternës së stadiumit nëpërmjet shoqërimit të gërmimit me restaurimin in situ, i cili do të siguronte integritetin e monumentit nëpërmjet rivendosjes së blloqeve të rrëzuara të mureve anësore dhe rikonstruksionit të harqeve, si dhe lirimit të sipërfaqes për vazhdimin e gërmimit.

Aspekti i dytë i rëndësishëm i projektit ishte aplikimi i metodave joinvazive të kërkimit arkeologjik, nëpërmjet aplikimit të teknologjisë gjeofizike, në identifikimin e anomalive që reflektohen nga prezenca e strukturave ndërtimore nëntokësore. Kjo do të thotë që në vend të kryerjes tradicionale të sondazheve në kërkim të monumenteve të mbuluara nga depozitimet, metodë e kushtueshme dhe jo gjithmonë rezultative, këto struktura do të identifikoheshin nëpërmjet prospeksionit gjeofizik, duke kursyer kohë dhe shpenzime të tepërta financiare. Objektivi i këtij kërkimi ishte tempulli i perandorit August, që dëshmohej nga gjetja e pjesëve arkitektonike dhe mbishkrimit të tij, të shpërndara në një hapësirë prej rreth 4 ha. Sondazhet e kryera që prej viteve '80 në kërkim të këtij tempulli kanë qenë pa rezultat, prandaj kërkimi gjeofizik ishte metoda e vetme me mundësi pozitive.

Një aspekt i tretë i projektit ishte krijimi i një dokumentacioni të ri në formatin 3D të vitit arkeologjik, ku të vendoseshin të gjithë monumentet e zbuluara, si dhe monumentet në kërkim e sipër.

Projekti u paraqit njëkohësisht në Akademinë e Shkencave, që mori përsipër shpenzimet për prospeksionin gjeofizik dhe hartografinë 3D, si dhe shpenzimet korente të udhëtimit dhe qëndrimit për arkeologët pjestarë të projektit. Instituti i Arkeologjisë mori përsipër shpenzimet për fuqinë punëtore.

Projekti, pasi u miratua nga Kryesia e Akademisë së Shkencave dhe nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë, u miratua edhe nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale në Ministrinë e Kulturës, duke hapur rrugën e zbatimit të tij përgjatë tre viteve.

Në bazë të raportit mbi rezultatet e kërkimeve të viteve 2020, si parapërgatitje e projektit të viteve 2021-2023 si synime të projektit janë shënuar:

- Vazhdimi i gërmimit të cisternës së stadiumit, i filluar që në vitin 1989.
- Restaurimi dhe konsolidimi i cisternës krahas gërmimit.
- Vazhdimi i gërmimit në tarracën e poshtme të agorasë dhe gjetja e tempullit romak.
- Fotografim ajror me dron dhe prospeksion gjeofizik.
- Vazhdimi i dokumentimit dixhital 3D i qytetit antik.

Ndërsa si objektiva përfundimtare të projektit janë shënuar:

- Dokumentimi i plotë i materialit të nxjerrë nga gërmimet dhe studimet në Bylis me anë të metodave bashkëkohore teknologjike dhe grafike.
- Përftimi me anë të gërmimit të plotë dhe të restaurimit të një monumenti të rrallë për arkitekturën e lashtë, siç është rasti i cisternës së stadiumit.
- Gjetja e tempullit romak në tarracën e poshtme të agorasë.
- Botimi i plotë i rezultateve të gërmimit në Bylis, i dokumentimit të materialit dhe i restaurimit.



Kryesisë së Akademisë i është paraqitur çdo vit kërkesa për financimin vjetor të projektit, që përmbante gjithmonë shpenzimet për dieta dhe udhëtime për arkeologët dhe ndihmësit e tyre, për pagesën e teknikëve të restaurimit dhe dokumentimit, si dhe shpenzimet për aplikimin e teknologjisë për gjeofizikën dhe aerofotografimin.

Shpenzimet për të parat janë dokumentuar përmes fletëshërbimeve, pagesave elektronike të hotelit, si dhe borderove të pagesave të fuqisë punëtore. Për këto të fundit është dorëzuar gjithmonë listëprezenca e mbajtur nga njeri prej anëtarëve të ekipit, vërtetimet bankare të punëtorëve, si dhe fotokopja e kartave të identitetit.

Për punimet gjeofizike, që deri më sot janë kryer në Shqipëri nga ekipe të huaja (Apolloni, Butrint, Lezhë, Armen etj.) që zotërojnë aparatura dhe programe specifike, u bë përpjekja e parë me sukses që të realizohen nga një ekip shqiptar mbi bazën e një kontrate shërbimi. Sipas saj me një kosto prej 400 000 lekë do të bëhej prospeksioni gjeofizik i një sipërfaqe prej 4000 m² në tarracën veriperëndimore të agorasë, ku kërkohej tempulli i Augustit. Punimet u kryesuan nga prof. P.A dhe dr. J.P, që dorëzuan hartat dhe raportin përkatës. Mbi bazën e tij u bë verifikimi i anomalive gjatë ekspeditave të viteve 2022 dhe 2023, që dha rezultatin pozitiv me zbulimin e tempullit të Augustit.

Në fund të çdo ekspedite është dorëzuar raporti i rezultateve të ekspeditës, së bashku me dokumentacionin grafik dhe me listën e gjetjeve, sipas një protokollit të përcaktuar nga Instituti i Arkeologjisë. Në Akademinë e Shkencave është depozituar çdo vit një informacion mbi rezultatet e kërkimeve në Seksionin e Shkencave Shoqërore.

Ka pasur edhe një raport final mbi kërkimet gjeofizike i paraqitur nga prof. Perparim Aliaj më 13.12.2022. (bashkëlidhur)

Janë bërë për çdo vit prezantime publike të rezultateve të kërkimeve në sesionin shkencor të përvitshëm që organizohet rregullisht në muajt mars, apo prill nga Instituti i Arkeologjisë. Rezultatet e kërkimit gjeofizik janë prezantuar në një leksion akademik në sallën “Aleks Buda” të Akademisë së Shkencave nga prof. P.A.

Rezultati më konkret i projektit është gjetja e tempullit të Augustit, që po kërkohej me shpenzime të rreth 15 sondazheve në një hapësirë prej 4000 m² që prej viteve ‘80.

Raporti final i projektit po përpunohet dhe do të paraqitet pranë Akademisë në muajt në vijim.

Qëndrimi Grupit të Auditimit:

Nga auditimi u konstatua se mungon Vendim i Kryetarit mbi miratimin e projektit për v.2021 – është sjell me observacionet e reja.

Nuk ka asnjë rezultat final të dokumentuar nga ky projekt, apo gjurmë e publikimit të rezultateve të studimit- sjellë me observacion “Raport tetor 2021 mbi punimet elektrometrike të kryera në ndihmë të kërkimeve arkeologjike në bylis”, Relacion mbi Zhvillimin e ekspeditës në Bylis 7-27.11.2022, Referuar në 26.01.2023 në Konferencë në Akademi të Shkencave.

Në kushtet e paraqitjes së disa evidencave të reja justifikuese observacioni merret parasysht pjesërisht (vetëm pjesët e sipërcituara).

Sa më sipër observacioni pranohet pjesërisht

3. Projekti “Përzgjedhja e materialit bimor të kumbullës, të kontrolluar nga viruset sipas protokollit, për krijimin e impiantit pilot nëpërmjet shëndetësimin dhe mikroshumimit, në funksion të fillimit të certifikimit të materialit mbjellës (Projekt Pilot në Rrjet). VITROCERT



Nga auditimi i kryer mbi dokumentacionin e vendosur në dispozicion rezultonte prania e korrespondencës përmes postës elektronike të drejtuesit të projektit dhe anëtarëve, me përfaqësues të ASH.

- Nga auditimi u konstatua, mungesë e gjurmës së miratimit apo nxjerrjes së një Vendimi nga ana e Kryetarit /Kryesisë për miratimin e projektit.

✓ Në buxhetin e miratuar për këtë projekt mungonte relatimi apo argumentimi se çfarë përfaqësonte në vetvete ky projekt si dhe mungonte gjurma e objektivave të studimit apo se çfarë synohej të arrihej përmes tij.

✓ Në koston e studimit, për v.2022 e cila ishte në trajtën e një tablele dhe nuk përmbante gjurmë të përcaktimit/përlllogaritjes së kryer nga ana e drejtuesit të projektit, specifikohet:

- përbërja e grupit të punës me 4 persona (pa emra nominale ku akomodimi dhe dietat janë për 4 persona) dhe studimi do të kryhej në mes të muajit prill.

- përbërja e grupit të punës me 5 persona (pa emra nominale ku akomodimi dhe dietat janë për 5 persona) dhe studimi do të kryhej në fillim të muajit maj.

Totali parashikuar për tu shpenzuar/financuar nga ASH shkonte në 906,030 lekë.

Referuar Urdhër shpenzimeve pagesat e kryera rezultojnë:

➤ Totali i koston të projektit për vitin 2022 rezultonte në 852,600 lekë ku:

a) pagesa për blerje materiale, reagente, kimikate 753,600 lekë;

b) dieta brenda vendit 99,000 lekë;

c) diferenca prej 15,000 lekë është pagesa për karburant.

✓ Në total kosto e projektit pilot Vitrocert, rezulton në 867,600 lekë.

24. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi mbi dokumentacionin justifikues lidhur me projektin pilot “Përzgjedhja e materialit bimor të kumbullës, të kontrolluar nga viruset sipas protokollit, për krijimin e impiantit pilot nëpërmjet shëndetësimit dhe mikroshumimit, në funksion të fillimit të certifikimit të materialit mbjellës, VITROCERT” u konstatua se:

- Grupi i punës nuk ishte parashtruar qysh në fazën e parë, me emra nominal dhe përgjegjësi konkrete të gjithësecilit;

- Nuk ka gjurmë dokumentare të takimeve të kryera në kuadër të propozimit të këtij projekti, por është mbajtur vetëm një korrespondencë via email mes drejtuesit të projektit dhe ASH;

- Në përfundim të fazës së parë, “Vitrocert 2 - 2022” nuk rezulton gjurmë dokumentare e rezultatit final të dokumentuar nga ky projekt, por rezultuan 2 (dy) raportime për vitin 2022, ndërkohë mungojnë për vitin 2023 raportimet.

ASH për periudhën 2020-2023, ka mbështetur financiarisht 12 projekte, 3 nga të cilët kanë përfunduar dhe 9 janë në proces.

Projektet e përfunduar kanë një kosto totale prej 27,852,526 lekë, referuar të dhënave të ASH, ndërkohë që vlera e projekteve në proces rezulton në 23,920,796 lekë, vlerë e cila pritet të rritet në fazat në vijim.

***Observacion i paraqitur nga ana e subjektit me shkresën nr.896/35 prot., datë 29.03.2024
protokolluar në KLSH me nr.959/6 prot., datë 02.04.2024.***



Për sa i përket projektit pilot VITROCERT të ndarë në dy faza (Vitrocet -2022 dhe VITROCERT -2023-2024), që është realizuar fillimisht nga Njësia e Përkohshme e kërkim-studimit “Bioteknologji & Gjenetikë” dhe më vonë nga Qendra me të njëjtin emër pranë Akademisë së Shkencave, projekti realizohet në Rrjet grupesh kërkimore në universitete dhe institucione të tjera shkencore dhe me biznesin privat, mbasi objektivi kryesor i i projektit është përgatitja e fazës shkencore që i paraprin skemës së certifikimit implementimi i së cilës do të garantonte rritjen e cilësisë së produkteve të fidanishteve, duke iu siguruar bimë të garantuara nga ana shëndetësore dhe gjenetike. Ky synim vlerësohet me rëndësi kombëtare për ekonominë, si dhe një nga kërkesat ligjore të tregut Evropian, sidomos tani kur Shqipëria ndodhet në fillimin e procesit të anëtarësimit në BE.

Në të dy fazat (janë paraqitur dy projekte sipas viteve) theksohet qëllimi dhe objektivat, argumentimi i detajuar i domosdoshmërisë së realizimit të projektit, grupet kërkimore me personelin përkatës, me detyrat e mirëpërcaktuara dhe me metodologjinë e kërkimit shkencor. Gjithashtu theksohen rezultatet e pritshme dhe përfituesit nga realizimi i projektit. Janë paraqitur dhe preventivët për realizimin e tenderave për blerjen e kiteve, reaktivave etj., të domosdoshëm për realizimin e kërkimit nga grupet e ndryshme kërkimore.

Të gjitha aktivitetet e grupit kompleks përfundojnë në fitimin e një produkti bioteknologjik, fidanë të drufrutorëve të certifikuar të kumbullës autoktone, si model dhe për varietete të tjera autoktone të drurëve frutorë.

Theksojmë se përpara vendimit për realizimin e projektit, është diskutuar si në Kryesi, në Seksionin e Shkencave Natyrore dhe Teknike, por edhe me specialistët e frutikulturës, biznesmenët etj. në një Workshop organizuar në Qendrën e transferimit të teknologjive bujqësore, Vlorë pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në shtator 2021.

Gjithashtu, në Ëorkshop-in “Gjendja aktuale dhe sfidat e integritimit në BE për certifikimin e fidanëve të drufrutorëve në Shqipëri”, i organizuar më 26 qershor 2023 në Akademinë e Shkencave u paraqitën rezultate paraprake të projektit dhe u miratua një Deklaratë drejtuar institucioneve legjislativë dhe ekzekutive, të lidhura me fillimin e ngritjes së sistemit të certifikimit për drurët frutorë autoktonë në Shqipëri dhe me detyrë imediatë të ngritjes së një grupi teknik, kryesisht kërkimor me specialistë që kanë përvoja në hallka të ndryshme të certifikimit si mbështetje për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe institucionet, që e kanë detyrim ligjor sistemin e certifikimit.

Konkretisht janë realizuar takime me zv. Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe me specialistë të Drejtorisë së Politikave dhe Programeve të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural.

Projekti vazhdon dhe deri në fund të 2024 do të fitohet produkti final (fidanë të certifikuar gjenetikisht edhe nga ana fitosanitare).

Qëndrimi Grupit të Auditimit:

Nga ana e ASH në fazën e terrenit por edhe në kthimin e observacioneve të parë, me shkresën nr.886/22 prot., datë 22.01.2024 konstatohet se dokumentacionet justifikuese të vendosura në dispozicion kanë qenë pjesor.

Kështu sikundër në kthimin e parë të përgjigjes, është vendosur në dispozicion vetëm Vendimi nr. 2, dt. 10.01.2022 për ngritjen e Qendrës "Biotech&Gjenetike" bashkangjitur nuk ka relacion..

Me observacionet e dyta, nga ana juaj janë sjell fakte dhe dokumenta të reja.

Kështu:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

- Për projektin pilot “Vitrocet” mungon gjurma e miratimit nga ana e Titullarit/Kryesisë –sjellë me observacione Vendimi 14 datë 11.04.2023.
 - Nuk ka një preventiv të bashkëshoqëruar me relacionin argumentues të këtij projekti- sjellë me observacione.
 - Grupi i punës nuk ishte parashtruar qysh në fazën e parë, me emra nominal dhe përgjegjësi konkrete të gjithësecilit;- sjellë me observacion skeda e raportimit të projektit- e cila mban datë 30.12.2022.
 - Nuk ka gjurmë dokumentare të takimeve të kryera në kuadër të propozimit të këtij projekti, por është mbajtur vetëm një korrespondencë via email mes drejtuesit të projektit dhe ASH;
 - Në përfundim të fazës së parë, “Vitrocet 2 - 2022” nuk rezulton gjurmë dokumentare e rezultatit final të dokumentuar nga ky projekt- sjellë Raport i 12.12.2022, skeda e raportimit të projektit datë 30.12.2022 dhe për v.2023 mungojnë të dhëna të raportimit.
- Në kushtet kur nuk keni paraqitur pjesërisht evidenca të reja justifikuese të situatës observacioni merret parasysh pjesërisht (vetëm pjesa sipërcituar).

Sa më sipër observacioni pranohet pjesërisht.

Observacion i paraqitur nga ana e subjektit me shkresën nr.896/35 prot., datë 29.03.2024 protokolluar në KLSH me nr.959/6 prot., datë 02.04.2024

Për projektin pilot “Përzgjedhja e materialit bimor të kumbullës, të kontrolluar nga viruset sipas protokollit, për krijimin e impiantit pilot nëpërmjet shëndetësimit dhe mikroshumimit, në funksion të fillimit të certifikimit të materialit mbjellës” VITROCET shpenzimet financiare të fazës së parë janë kryer në bazë të Vendimit të Kryesisë nr. 2, datë 10.01.2022 “Për ngritjen Qendres Kërkimore Shkencore të Bioteknologjisë dhe Gjenetikës” në të cilin pika 7 e tij, miraton edhe fondin 10 milion lekë për materiale e pajisje bazë laboratorike. Vendimi shoqërohet nga Relacioni i përgatitur nga akad. E.K (bashkëlidhur), që më parë i është dërguar edhe Këshillit të Ministrave me shkresën nr. prot. 680, datë 2.11.2021. Në këtë relacion është bërë edhe argumentimi i nevojave buxhetore funksionimit e kësaj qendre për vitin 2022 (16 milion lekë) nga të cilat 10 milion vetëm për bazë laboratorike.

Për vitin 2022 vlera 906 030 lekë si projekt buxhet miratuar nga Titullari i Institucionit është pjesë e vlerës totale të miratuar sipas VKA sipërcituar, si projekt në kuadër të Qendrës Kërkimore Shkencore të Bioteknologjisë dhe Gjenetikës.

Në vlerën e realizuar 2 323 798 lekë {(867 600 lekë (2022) + 1 456 198 lekë (2023)} për projektin pilot “Përzgjedhja e materialit bimor të kumbullës, të kontrolluar nga viruset sipas protokollit, për krijimin e impiantit pilot nëpërmjet shëndetësimit dhe mikroshumimit, në funksion të fillimit të certifikimit të materialit mbjellës” VITROCET, për vitet 2022-2023 sqarojme se:

Nga Kryetari i ASH është bërë miratimi i preventivit të shpenzimeve për këtë projekt viti 2022, në vlerën 906 030 lekë i cili është realizuar në vlerën 867 600 lekë (bashkëlidhur).

Në këtë preventiv janë të analizuar të gjithë zërat e shpenzimeve (blerje materiale, reagentë, duke përfshirë edhe personin bashkëpunëtor në këtë kërkim: M.C FBM-UBT, AB FSHN-UT dhe V.S FSHN-UT, destinacionin për udhëtimet brenda vendit në zonat ku do të kryhet studimi marrja e materialit për studim dhe shpenzimet (akomodim, dieta, karburant) që do të kryhen në këtë studim. Shpenzimet për këtë projekt pilot janë kryer në zbatim të preventivit (procedurës së prokurimit për blerjen e reagentëve).



Likuidimi i shpenzimeve të udhëtimit është kryer sipas autorizimit të miratuar të parashikuar në preventiv.

Këto likuidime për vitin 2022 (867 600 lekë) janë vënë në dispozicion të auditit, të përputhura në vlerë sipas tabelës përmbledhëse, të cilën e keni paraqitur edhe në materialin Projekt – Raport fq. 82-85.

Më datë 30.12.2022 Drejtuesi i Projektit E.K ka dërguar pranë SSHNT relacion me e-mail mbi realizimin e kësaj faze të projektit.

Për vitin 2023 vazhdimi i këtij projekti është bërë në zbatim të VKA nr.14, datë 11.04.2023 miratuar në vlerën 1 645 626 lekë (viti 2023) realizuar 1 456 198 lekë dhe 458 456 lekë (miratuar viti 2024).

Po kështu kjo vlerë totale është e miratuar nga Kryetari i ASH edhe në formën e projektit të paraqitur nga drejtuesi i tij E.K. Ky dokumentacion (VKA nr.14, datë 11.04.2023 shoqëruar me preventivin e miratuar) ju është vënë në dispozicion nga ana jonë dhe po e ridërgojmë sërish bashkëlidhur këtij material.

Në total, Projekti pilot VITROCERT 2022-2023 është realizuar në vlerën 2 323 798 lekë.

Mbështetur në rëndësinë që ka projekti, produktin e studimit të arritur deri më tani, siç e analizuam më lart, shpenzimet mjaft modeste të kryera sipas të gjitha rregullave, arrijmë në konkluzionin se konstatimi i KLSH si më lart se kemi të bëjmë me “shpenzim jo efektiv të buxhetit të shtetit”, nuk qëndron.

Oëndrimi Grupit të Auditimit:

Në kushtet e mungesës së dokumentacionit të ri justifikues që do të ndryshoj situatën, observacioni nuk merret në konsideratë.

Sa më sipër observacioni nuk pranohet.

Marrëdhënia që ASH ka me njësitë/qendrat që financon:

✓ *Sa i takon marrëdhënies që Akademia e Shkencave ka me njësitë kërkimore studimore referuar Statutit të vet si dhe Ligjit Organik specifikohet se:*

- Ligji nr. 53/2019 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”

Neni 19 “Njësitë e kërkim studimit”

1. Sipas nevojave, detyrave e problemeve në fushën e kërkimit, në përmbushje të rolit të saj, pranë Akademisë mund të ngrihen njësi të kërkimit studimit me aktivitet afatshkurtër e afatgjatë.

2. Këto njësi janë autonome në realizimin e detyrave të tyre, mbajnë marrëdhënie me Kryesinë e Kryetarin dhe raportojnë pranë tyre.

3. Sipas rëndësisë, problemeve e kohëzgjatjes, këto njësi ngrihen me akte të Asamblesë apo të Kryesisë për njësitë me afat deri në 2 vjet dhe me vendim të Këshillit të Ministrave për njësitë e tjera.

4. Objekti i tyre, financimi, shtrirja, veprimtaria dhe përbërja përcaktohen në aktet përkatëse që dalin për ngritjen e tyre.

- Statuti i ASHSH miratuar me Vendim të Asamblesë së ASH nr.22 datë 18.10.2019

Neni 44 “Njësitë Afatshkurtra”

2. Njësitë që ngrihen me vendim të Kryesisë, pas konfirmimit nga Asambleja ose seksioni përkatës. Vendimi i ngritjes së tyre përcakton qartë qëllimin, detyrat që ka njësia, kohën e aktivitetit, aktin



përfundimtar që duhet nxjerrë si dhe kujt i drejtohet ky akt për rekomandim apo zbatim. Vendimi përmban edhe mbështetjen financiare e logjistike të njësisë dhe vendin e ushtrimit të aktivitetit.

Nga ana e grupit të auditimit u gjykua nevoja e kryerjes së një verifikimi të dytë në terren, me dy përfaqësues të grupit të auditimit nga ku rezultoi se:

- Akademia e Shkencave, në rolin e njësisë financuese të projekteve kërkimore/shkencore nuk përmbante një databazë me të dhëna konkrete se në cilat laboratore (publike/private) kryhen studimet, e për pasojë nuk dispononte informacion konkret dhe të besueshëm lidhur me vendin se ku ndodhen materialet/pajisjet e dhëna për qëllime studimore.
- Grupi auditimit, pas përpunimit të të dhënave të grumbulluara, arriti të hartoj një përmbledhje mbi laboratorët ku po kryhet aktualisht punë kërkimore-shkencore si më poshtë vijon:
 1. Departamenti i Inxhinierisë Fizike, Universiteti Politeknik i Tiranës
 2. Departamenti i Kimisë, FSHMN, Universiteti i Prishtinës
 3. Departamenti i Biologjisë FSHN, Universiteti i Tiranës
 4. Departamenti i Kimisë, FSHN, Universiteti i Tiranës
 5. Departamenti i Bioteknologjisë, FSHN, Universiteti i Tiranës
 6. Departamenti i Mbrojtjes së Bimëve, Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit, UBT
 7. Laboratori Immunologjisë në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”

Mbi laboratorin e Immunologjisë në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”

Mbi përdorimin e këtij laboratorit është lidhur një marrëveshje bashkëpunimi (e cila nuk rezulton e rinovuar për v.2023) konkretisht:

- Marrëveshje Bashkëpunimi me QSUNT nr.209 datë 19.03.2021

Në vijim të saj mbajtur procesverbal datë 11.06.2021 në laboratorin e Immunologjisë mbi dorëzimin për përdorim të inventarit të këtij laboratorit, personelit që do të kryejë shërbimin në këtë ambient, konkretisht znj.M.K, znj.E.Sh, znj.J.D në prezencë të magazinierit. Bashkangjitur lista e inventarit me 63 artikuj, nga të cilët 28 inventar i imët dhe 35 pajisje.

Nga auditimi në terren:

- A. Nga verifikimi në terren i listës së inventarit bashkangjitur marrëveshjes u konstatua se,
- fizikisht në zyrat e laboratorit dhe magazinë ndodheshin 33 artikuj (27 pajisje dhe 6 inventar i imët) nga 63 në listë. Konkretisht mungonin 8 pajisje dhe 22 inventar i imët)
 - Nga auditimi u konstatua se, një pjesë e artikujve ndodheshin në magazinën e laboratorit, të cilat ishin jashtë funksionit dhe kishin kohë që nuk përdorreshin. Por mungonte një relacion lidhur me to, ku të specifikohet kjo gjë.

B. Në terren u krye verifikim i artikujve që rezultojn të blera gjatë vitit 2023 nga ana e ASHSH për projektin e Immunologjisë, sipas urdhër shpenzimeve nr.672 datë 17.11.2023; nr.658 dt 16.11.2023 dhe fletë dalje nr.198 datë 20.12.2023 për të cilën mungon urdhër shpenzimi.

Sa më sipër rezultoi se,

- ✓ Për U.Sh nr.672 dt 17.11.2023 me fletë dalje nr.28 dt 14.11.2023 me vlerë 4,188,000 lekë
- Grupi auditimit nuk arrin të marrë siguri të arsyeshme mbi pajisjen “Sistem real time PCR me 384 puse” në është ajo realisht, me atë që është specifikuar në fletë dalje.



Kjo për shkak se, grupi i marrjes në dorëzim nuk është shprehur mbi specifikimet teknike të pajisjes, po ashtu grupi auditimit nuk arrin dot të identifikoj pajisjen pasi mungojnë të dhënat specifike të saj në dokumentat e prokurimit.

- ✓ Për U.Sh nr.658 dt 16.11.2023 me fletë dalje nr.41 dt 27.10.2023 me vlerë 1,786,200 lekë
 - Në procesverbalin e marrjes në dorëzim mungojnë firmat e grupit të marrjes në dorëzim të artikujve, po ashtu dhe mungon shprehja e grupit lidhur me verifikimin e cilësisë së mallit të lëvruar.
- ✓ Për fletë dalje nr.198 dt 20.12.2023 me vlerë 85,800 lekë
 - Nga verifikimi artikuj “Komplet për mbledhje dhe ruajtje të pështymës” 200 copë në momentin e verifikimit nuk ndodheshin në ambientet e laboratorit.
 - Në aktin e marrjes në dorëzim, grupi punës nuk shprehet mbi cilësinë e mallit të lëvruar, nëse është e njëjtë me atë për të cilën është shpallur kontraktori, po ashtu mungonte vlerësimi nëse artikujt përputhen me standartet dhe të gjitha parametrat në cilësi dhe sasi, të kërkuara sipas DST dhe nënshkruara në kontratë.
 - Grupi i punës për marrjen në dorëzim nuk shprehet për mënyrën sesi është verifikuar apo testuar cilësia e mallrave të lëvruara, po ashtu nuk shprehen në kraht të artikujve të marr mbi specifikimet e tyre për të krahasuar me ato të cilat janë kërkuar në DST.
 - Akti marrjes në dorëzim nuk është nënshkruar nga ana e Operatorit Ekonomik dhe nuk rezulton prania e një përfaqësuesi nga ana e OE.
 - Nuk rezulton gjurmë dokumentare verifikuese e kalimit/transferimit të pajisjeve nga magazina e ASH në laboratorët e personave që i marrin në dorëzim,
 - Nga auditimi i praktikës rezultoi se, akt dorëzimi i mallrave përmban nënshkrimin e z. G.S dhe është dokument i nxjerr nga “K” sh.p.k çka vërteton dërgimin e mallrave drejtpërdrejt tek personi që i merr në ngarkim pa bërë hyrje njëherë në magazinën e ASH.

Sa më sipër, operuar në kundërshtim me:

- ✓ UMF nr.30 datë 27.12.2011 Menaxhimi i aktiveve të NJSP, kapitulli III. Rregjistri i aktiveve dhe dokumentimi i levizjes se tyre,
pika 37 ku specifikohet... *Hyrja e aktiveve në magazinë dokumentohet në çdo rast me fletëhyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre. Fletëhyrjet lëshohen nga magazinieri, pasi të jetë bërë më parë verifikimi fizik i sasisë, i cilësisë dhe i çmimit.*
Po ashtu, sikundër pika 42 parashikon ... *Titullari i njësisë miraton urdhërin për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe të dokumentacionit shoqërues.*
- ✓ VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” neni 77 pika 6 ku parashikohet se, ... *Autoriteti kontraktor para pagimit të faturës së mallit, duhet të kontrollojë ... cilësinë e mallit të lëvruar , nëse është e njëjtë me atë për të cilën është shpallur kontraktori”.*
 - Kërkesa e kryer nga ana e drejtuesit të projektit drejtuar ASH nuk përmbante ekstremite (nr. Protokollin dhe datë) në kundërshtim me ligjin nr.9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat”, në “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”.
 - Sa i takon transportimit të aktiveve rezultoi se mungon gjurma dokumentare e justifikimit të tyre, operuar në kundërshtim me UMF nr.30 datë 27.12.2011 Menaxhimi i aktiveve të NJSP, kapitulli III. Rregjistri i aktiveve dhe dokumentimi i levizjes se tyre, pika 51...
Transportuesi ka përgjegjësinë e dërgimit të aktiveve nga dërguesi tek marrësi brenda afatit dhe pa dëmtim. Transporti i aktiveve kryhet në bazë të dokumentave përkatëse që janë plotësuar për



çdo dërgesë dhe në përputhje me urdhërin dhe dispozitat e caktuara. Dokumenti bazë që konfirmon transportin e aktiveve është Fletë-ngarkesa. Transportuesi merr në ngarkesë aktivet me anë të një fletë-dalje që plotësohet nga dërguesi dhe nënshkruhet nga të dy palët (furnitori dhe transportuesi).

- Totali i blerjeve të financuara nga ASH për efekt të studimit/projektit “*Studimi seroepidemiologjik i gjendjes imunitare ndaj virusit SARS-COV-2 ne popullatën shqiptare SEROIMUNE*” referuar Urdhër Shpenzimeve vendosur në dispozicion si më poshtë vijon:

- U.Sh nr.672 dt 17.11.2023 me vlerë 4,188,000 lekë për pajisje elektronike laboratorike dhe

- U.Sh nr. 658 dt 16.11.2023 me vlerë 1,786,200 lekë për materiale, ndërkohë është edhe

- F.D nr 198 datë 20.12.2023 për materiale me vlerë 85,800 lekë

Pra totali i shpenzuar për efekt të studimit rezulton në 6,060,000 lekë me një diferencë prej 2,061,600 lekë më pak nga sa është raportuar shifra pranë grupit të auditimit (mallra 1,872,000 lekë nga 3,933,600 lekë) .

Sa i takon verifikimit të sasive respektive të materialeve, u konstatua problematikë në verifikimin e sasive të reagenteve kimike, për arsye të njësive matëse të tyre (dl/ml).

25. Gjetje nga auditimi:

Nga verifikimi në terren i kryer në laboratorin e Imunologjisë në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, referuar listës së inventarit bashkangjitur marrëveshjes u konstatua se:

- fizikisht në zyrat e laboratorit dhe magazinë ndodheshin 33 artikuj (27 pajisje dhe 6 inventar i imët) nga 63 në listë. Konkretisht mungonin 8 pajisje dhe 22 inventar i imët)

- një pjesë e artikujve ndodheshin në magazinën e laboratorit, të cilat ishin jashtë funksionit dhe kishin kohë që nuk përdorreshin, por mungonte një relacion lidhur me to, ku të specifikohesh kjo gjë.

- Në aktin e marrjes në dorëzim, grupi punës nuk shprehet mbi cilësinë e mallit të lëvruar, nëse është e njëjtë me atë për të cilën është shpallur kontraktori, po ashtu mungonte vlerësimi nëse artikujt përputhen me standartet dhe të gjitha parametrat në cilësi dhe sasi, të kërkuara sipas DST dhe nënshkruara në kontratë.

- Grupi i punës për marrje në dorëzim nuk shprehet për mënyrën sesi është verifikuar apo testuar cilësia e mallrave të lëvruara, po ashtu nuk shprehen në krahasim të artikujve të marr mbi specifikimet e tyre për të krahasuar me ato të cilat janë kërkuar në DST.

- Akti marrjes në dorëzim nuk është nënshkruar nga ana e Operatorit Ekonomik dhe nuk rezulton prania e një përfaqësuesi nga ana e OE.

- Nuk rezulton gjurmë dokumentare verifikuese e kalimit/transferimit të pajisjeve nga magazina e ASH në laboratorët e personave që i marrin në dorëzim, por akt dorëzimi i mallrave përmban nënshkrimin e z. G.S dhe është dokument i nxjerr nga “K” sh.p.k çka vërteton dërgimin e mallrave drejtpërdrejt tek personi që i merr në ngarkim pa bërë hyrje njëherë në magazinën e ASH.

- Grupi auditimit nuk arrin të marr siguri të arsyeshme mbi pajisjen “Sistem real time PCR me 384 puse” në është ajo realisht, me atë që është specifikuar në fletë dalje. Kjo për shkak se, grupi i marrjes në dorëzim nuk është shprehur mbi specifikimet teknike të pajisjes, po ashtu grupi i auditimit nuk arrin dot të identifikojë pajisjen pasi mungojnë të dhënat specifike të saj në dokumentat e prokurimit.

- Nga verifikimi artikuj “Komplet për mbledhje dhe ruajtje të pështymës” 200 copë në momentin e verifikimit nuk ndodheshin në ambientet e laboratorit.

Sa më sipër operuar në kundërshtim me:



- ✓ UMF nr.30 datë 27.12.2011 Menaxhimi i aktiveve të NJSP, kapitulli III. Rregjistri i aktiveve dhe dokumentimi i levizjes se tyre, pika 37 ku specifikohet... Hyrja e aktiveve në magazinë dokumentohet në çdo rast me fletëhyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre. Fletëhyrjet lëshohen nga magazinieri, pasi të jetë bërë më parë verifikimi fizik i sasisë, i cilësisë dhe i çmimit.
- Po ashtu, sikundër pika 42 parashikon ... Titullari i njësisë miraton urdhërin për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe të dokumentacionit shoqërues.
- ✓ VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” neni 77 pika 6 ku parashikohet se, ... Autoriteti kontraktor para pagimit të faturës së mallit, duhet të kontrollojë ... cilësinë e mallit të lëvruar , nëse është e njëjtë me atë për të cilën është shpallur kontraktori”.
- Kërkesa e kryer nga ana e drejtuesit të projektit drejtuar ASH nuk përmbante ekstremite (nr. Protokollit dhe datë) në kundërshtim me ligjin nr.9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat”, në “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”.
 - Sa i takon transportimit të aktiveve rezultoj se, mungon gjurma dokumentare e justifikimit të tyre, operuar në kundërshtim me UMF nr.30 datë 27.12.2011 Menaxhimi i aktiveve të NJSP, kapitulli III. Rregjistri i aktiveve dhe dokumentimi i levizjes se tyre, pika 51...
 - Sa i takon verifikimit të sasive respektive të materialeve, u konstatua problematikë në verifikimin e sasive të reagenteve kimike, për arsye të njësive matëse të tyre (dl/ml).

Laboratori UPT

Në terren u krye verifikim i artikujve që rezultojn të blera gjatë vitit 2023 nga ana e ASH për projektet e Qendrës Kërkimore Teknologjike NanoAlb, konkretisht projektin/studimin “*Përgatitja dhe karakterizimi i nanofibrave elektrofibra të pastër PVA dhe matricës PVA/MMT për të kapsuluar një vaj esencial të bimës mjekësore shqiptare për aplikime biomjekësore*” sipas fletë daljes nr.23 datë 20.09.2023 dhe u konstatua prania fizike e tyre.

- Në aktin e marrjes në dorëzim u konstatua fenomeni i njëjtë i të gjitha blerjeve të kryera, ku artikujt nuk përmbanin të dhëna mbi specifikimit teknike të tyre apo të dhëna identifikuese (bar kode) për secilin produkt.
- Grupi auditimit nuk arrin të marr siguri të arsyeshme mbi pajisjet e blera gjatë vitit 2023, nëse janë të njëjta me ato që janë kërkuar, kjo për shkak se nuk arrin dot të identifikohen pajisjet pasi mungojnë të dhënat identifikuese të tyre (bar kode apo të dhëna të tjera).
- Në aktin e marrjes në dorëzim, grupi punës nuk shprehet mbi cilësinë e mallit të lëvruar, nëse është e njëjtë me atë për të cilën është shpallur kontraktori, po ashtu mungonte vlerësimi nëse artikujt përputhen me standartet dhe të gjitha parametrat në cilësi dhe sasi, të kërkuara sipas DST dhe nënshkruara në kontratë.
- Grupi i punës për marrje në dorëzim nuk shprehet për mënyrën sesi është verifikuar apo testuar cilësia e mallrave të lëvruara, po ashtu nuk shprehen në kraht të artikujve të marrë mbi specifikimet e tyre për të krahasuar me ato të cilat janë kërkuar në DST.
- Akti marrjes në dorëzim nuk është nënshkruar nga ana e Operatorit Ekonomik dhe nuk rezulton prania e një përfaqësuesi nga ana e OE.
- Nuk rezulton gjurmë dokumentare verifikuese e kalimit/transferimit të pajisjeve nga magazina e ASHSH në laboratorët e personave që i marrin në dorëzim.



- Nga auditimi i praktikës rezultoi se, akt dorëzimi i mallrave përmban nënshkrimin e z. P.M dhe është dokument i nxjerr nga “K” sh.p.k çka vërteton dërgimin e mallrave drejtpërdrejt tek personi që i merr në ngarkim pa bërë hyrje njëherë në magazinën e ASHSH.
- Data e akt dorëzimit është 18.09.2023 ndërkohë fletëdalja nga ana e ASHSH është 20.09.2023 çka dëshmon se veprimet e hyrje daljes në magazinë janë fiktive.
- Operuar në kundërshtim me UMF nr.30 datë 27.12.2011 Menaxhimi i aktiveve të NJSP, kapitulli III. Rregjistri i aktiveve dhe dokumentimi i levizjes se tyre, pika 37 ku specifikohet... *Hyrja e aktiveve në magazinë dokumentohet në çdo rast me fletëhyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre. Fletëhyrjet lëshohen nga magazinieri, pasi të jetë bërë më parë verifikimi fizik i sasisë, i cilësisë dhe i çmimit.*
- Po ashtu, sikundër pika 42 parashikon ... *Titullari i njësisë miraton urdhërin për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe të dokumentacionit shoqërues.*
- Sa më sipër operuar edhe në kundërshtim me neni 77 pika 6 e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku parashikohet se, ... *Autoriteti kontraktor para pagimit të faturës së mallit, duhet të kontrollojë ... cilësinë e mallit të lëvruar , nëse është e njëjtë me atë për të cilën është shpallur kontraktori”.*
- Kërkesa e kryer nga ana e drejtuesit të projektit drejtuar ASHSH nuk përmbante ekstremite (nr. Protokollit dhe datë) në kundërshtim me ligjin nr.9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat”, në “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”.
- Pajisja “homogjenizer” copë 1, me vlerë 300,000 lekë, rezultonte ende e pa vënë në përdorim për shkak të sensitivitetit të saj dhe veçantisë që ka për tu instaluar dhe bërë funksionale.
- Sa i takon transportimit të aktiveve rezultoi se, mungon gjurma dokumentare e justifikimit të tyre, operuar në kundërshtim me UMF nr.30 datë 27.12.2011 Menaxhimi i aktiveve të NJSP, kapitulli III. Rregjistri i aktiveve dhe dokumentimi i levizjes se tyre, pika 51... *Transportuesi ka përgjegjësinë e dërgimit të aktiveve nga dërguesi tek marrësi brenda afatit dhe pa dëmtim. Transporti i aktiveve kryhet në bazë të dokumentave përkatëse që janë plotësuar për çdo dërgesë dhe në përputhje me urdhërin dhe dispozitat e caktuara. Dokumenti bazë që konfirmon transportin e aktiveve është Fletë-ngarkesa. Transportuesi merr në ngarkesë aktivet me anë të një fletë-dalje që plotësohet nga dërguesi dhe nënshkruhet nga të dy palët (furnitori dhe transportuesi).*
- Totali i blerjeve të financuara nga ASHSH për efekt të studimit/projektit “Përgatitja dhe karakterizimi i nanofibrave elektrofibra të pastër PVA dhe matricës PVA/MMT për të kapsuluar një vaj esencial të bimës mjekësore shqiptare për aplikime biomjekësore, PvaNANOMat” referuar Urdhër Shpenzimeve rezulton në 662,400 lekë për pajisje dhe 329.04 lekë për lëndë të parë punimi (reagente kimike) për v.2023, ndërkohë magazina e v.2022 përmbante reagente kimike me vlerë 343,440 lekë, e përbëhej vetëm nga reagente. Nga auditimi u konstatua problematikë në verifikimin e sasive të reagenteve kimike, për arsye të njësisive matëse të tyre (dl/ml).

26. Gjetje nga auditimi:

Nga verifikimi në terren i kryer në laboratorin e fizikës në Univeristetin Politeknik të Tiranës, u konstatua se:

- Nga auditimi i praktikave dokumentare për projektin/studimin “Përgatitja dhe karakterizimi i nanofibrave elektrofibra të pastër PVA dhe matricës PVA/MMT për të kapsuluar një vaj esencial



të bimës mjekësore shqiptare për aplikime biomjekësore” në aktin e marrjes në dorëzim u konstatua fenomeni i njëjtë i të gjitha blerjeve të kryera, ku artikujt nuk përmbanin të dhëna mbi specifikimet teknike të tyre apo të dhëna identifikuese (bar kode) për secilin produkt.

- Në aktin e marrjes në dorëzim, grupi punës nuk shprehet mbi cilësinë e mallit të lëvruar, nëse është e njëjtë me atë për të cilën është shpallur kontraktori, po ashtu mungonte vlerësimi nëse artikujt përputhen me standartet dhe të gjitha parametrat në cilësi dhe sasi, të kërkuara sipas DST dhe nënshkruara në kontratë.

- Grupi i punës për marrje në dorëzim nuk shprehet për mënyrën sesi është verifikuar apo testuar cilësia e mallrave të lëvruara, po ashtu nuk shprehen në kraht të artikujve të marr mbi specifikimet e tyre për të krahasuar me ato të cilat janë kërkuar në DST.

- Akti marrjes në dorëzim nuk është nënshkruar nga ana e Operatorit Ekonomik dhe nuk rezulton prania e një përfaqësuesi nga ana e OE.

- Nuk rezulton gjurmë dokumentare verifikuese e kalimit/transferimit të pajisjeve nga magazina e ASH në laboratorët e personave që i marrin në dorëzim,

- Nga auditimi i praktikës rezultoj se, akt dorëzimi i mallrave përmban nënshkrimin e drejtuesit të projektit/studimit dhe është dokument i nxjerr nga “K” sh.p.k çka vërteton dërgimin e mallrave drejtpërdrejt tek personi që i merr në ngarkim pa bërë hyrje njëherë në magazinën e ASH.

- Data e akt dorëzimit është 18.09.2023 ndërkohë fletëdalja nga ana e ASHSH është 20.09.2023 çka dëshmon se veprimet e hyrje daljes në magazinë janë fiktive.

Operuar në kundërshtim me UMF nr.30 datë 27.12.2011 Menaxhimi i aktiveve të NJSP, kapitulli III. Rregjistri i aktiveve dhe dokumentimi i levizjes se tyre,

pika 37 ku specifikohet... *Hyrja e aktiveve në magazinë dokumentohet në çdo rast me fletëhyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre. Fletëhyrjet lëshohen nga magazinieri, pasi të jetë bërë më parë verifikimi fizik i sasisë, i cilësisë dhe i çmimit.*

Po ashtu, sikundër pika 42 parashikon ... *Titullari i njësisë miraton urdhërin për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe të dokumentacionit shoqërues.*

Sa më sipër operuar edhe në kundërshtim me neni 77 pika 6 e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku parashikohet se, ... *Autoriteti kontraktor para pagimit të faturës së mallit, duhet të kontrollojë ... cilësinë e mallit të lëvruar , nëse është e njëjtë me atë për të cilën është shpallur kontraktori”.*

- Kërkesa e kryer nga ana e drejtuesit të projektit drejtuar ASH nuk përmbante ekstremite (nr. Protokollit dhe datë) në kundërshtim me ligjin nr.9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat”, në “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”.

- Pajisja “homogjenizer” copë 1, me vlerë 300,000 lekë, rezultonte ende e pa vënë në përdorim për shkak të sensitivitetit të saj dhe veçantisë që ka për tu instaluar dhe bërë funksionale.

- Sa i takon transportimit të aktiveve rezultoi se, mungon gjurma dokumentare e justifikimit të tyre, operuar në kundërshtim me UMF nr.30 datë 27.12.2011 Menaxhimi i aktiveve të NJSP, kapitulli III. Rregjistri i aktiveve dhe dokumentimi i levizjes se tyre, pika 51...

Transportuesi ka përgjegjësinë e dërgimit të aktiveve nga dërguesi tek marrësi brenda afatit dhe pa dëmtim. Transporti i aktiveve kryhet në bazë të dokumentave përkatëse që janë plotësuar për çdo dërgesë dhe në përputhje me urdhërin dhe dispozitat e caktuara. Dokumenti bazë që konfirmon transportin e aktiveve është Fletë-ngarkesa. Transportuesi merr në ngarkesë aktivet me anë të një fletë-dalje që plotësohet nga dërguesi dhe nënshkruhet nga të dy palët (furnitori dhe transportuesi).



- Totali i blerjeve të financuara nga ASH për efekt të studimit/projektit “Përgatitja dhe karakterizimi i nanofibrave elektrofibra të pastër PVA dhe matricës PVA/MMT për të kapsuluar një vaj esencial të bimës mjekësore shqiptare për aplikime biomjekësore, PvaNANOMat” referuar Urdhër Shpenzimeve rezulton në 662,400 lekë për pajisje dhe 329.04 lekë për lëndë të parë punimi (reagente kimike) për v.2023, ndërkohë magazina e v.2022 përmbante reagente kimike me vlerë 343,440 lekë, e përbëhej vetëm nga regaente. Nga auditimi u konstatua problematikë në verifikimin e sasive të reagenteve kimike, për arsye të njësisive matëse të tyre (dl/ml).

Laboratori FSHN

Në terren u krye verifikim i artikujve që rezultonin të blera gjatë vitit 2023 nga ana e ASHSH për projektet e Qendrës Kërkimore Teknologjike NanoAlb, konkretisht projektin/studimin “Drejt krijimit të Njesisë së Biosensorëve pranë Grupit të Bioteknologjive Molekulare, NanoAlb - Përdorimi i biosensorëve me qeliza të plota dhe elektrokimike për të matur toksicitetin e ujit dhe tokës në bregdetin shqiptar, BIOSENSTOXIC”, sipas fletë daljes nr.22 datë 20.09.2023 dhe u konstatua prania fizike e tyre.

- Në aktin e marrjes në dorëzim u konstatua fenomeni i njëjtë i konstatuar në të gjitha blerjet, që artikujt nuk përmbanin të dhëna mbi specifikimit teknike të tyre apo të dhëna identifikuese për secilin.

- Në relacionin e grupit të marrjes në dorëzim mungon nënshkrimi nga ana e Operatorit Ekonomik dhe nuk rezulton prania e një përfaqësuesi nga ana e OE.

- Nga auditimi i praktikës rezultoi se, akt dorëzimi i mallrave përmban nënshkrimin e personit që i ka marr në dorëzim dhe është dokument i nxjerr nga “K” sh.p.k çka vërteton dërgimin e mallrave drejtpërdrejt tek personi që i merr në ngarkim pa bërë hyrje njëherë në magazinën e ASHSH.

Sa më sipër, operuar në kundërshtim me

✓ UMF nr.30 datë 27.12.2011 Menaxhimi i aktiveve të NJSP, kapitulli III. Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i levizjes se tyre,

pika 37 ku specifikohet... *Hyrja e aktiveve në magazinë dokumentohet në çdo rast me fletëhyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre. Fletëhyrjet lëshohen nga magazinieri, pasi të jetë bërë më parë verifikimi fizik i sasisë, i cilësisë dhe i çmimit.*

Po ashtu, sikundër pika 42 parashikon ... *Titullari i njësisë miraton urdhërin për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe të dokumentacionit shoqërues.*

✓ VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” neni 77 pika 6 ku parashikohet se, ... *Autoriteti kontraktor para pagimit të faturës së mallit, duhet të kontrollojë ... cilësinë e mallit të lëvruar, nëse është e njëjtë me atë për të cilën është shpallur kontraktori”.*

- Kërkesa e kryer nga ana e drejtuesit e projektit drejtuar ASHSH nuk përmbante ekstremitete (nr. Protokollin dhe datë) në kundërshtim me ligjin nr.9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat”, në “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”.

- Sa i takon transportimit të aktiveve rezultoj se, mungon gjurma dokumentare e justifikimit të tyre, operuar në kundërshtim me UMF nr.30 datë 27.12.2011 Menaxhimi i aktiveve të NJSP, kapitulli III. Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i levizjes se tyre, pika 51...

Transportuesi ka përgjegjësinë e dërgimit të aktiveve nga dërguesi tek marrësi brenda afatit dhe pa dëmtim. Transporti i aktiveve kryhet në bazë të dokumentave përkatëse që janë plotësuar për



çdo dërgesë dhe në përputhje me urdhërin dhe dispozitat e caktuara. Dokumenti bazë që konfirmon transportin e aktiveve është Fletë-ngarkesa. Transportuesi merr në ngarkesë aktivet me anë të një fletë-dalje që plotësohet nga dërguesi dhe nënshkruhet nga të dy palët (furnitori dhe transportuesi).

- Totali i blerjeve të financuara nga ASHSH për efekt të studimit/projektit “Drejt krijimit të Njesisë së Biosensorëve pranë Grupit të Bioteknologjive Molekulare, NanoAlb - Përdorimi i biosensorëve me qeliza të plota dhe elektrokimike për të matur toksicitetin e ujit dhe tokës në bregdetin shqiptar, BIOSENSTOXIC” referuar Urdhër Shpenzimeve rezulton në 1,394,400 lekë për pajisje. Ndërkohë magazina e v.2022 përmbante reagente kimike me vlerë 502,200 lekë, e përbëhej vetëm nga reagente. Nga auditimi u konstatua problematikë në verifikimin e sasive të reagenteve kimike, për arsye të njësive matëse të tyre (dl/ml).

27. Gjetje nga auditimi:

Nga verifikimi në terren i kryer në laboratorin e fizikës në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, u konstatua se:

- Nga auditimi i praktikave dokumentare për projektin/studimin “Drejt krijimit të Njesisë së Biosensorëve pranë Grupit të Bioteknologjive Molekulare, NanoAlb - Përdorimi i biosensorëve me qeliza të plota dhe elektrokimike për të matur toksicitetin e ujit dhe tokës në bregdetin shqiptar, BIOSENSTOXIC”.

- Në aktin e marrjes në dorëzim u konstatua fenomeni i njëjtë i konstatuar në të gjitha blerjet, që artikujt nuk përmbanin të dhëna mbi specifikimit teknike të tyre apo të dhëna identifikuese për secilin.

- Në relacionin e grupit të marrjes në dorëzim mungon nënshkrimi nga ana e Operatorit Ekonomik dhe nuk rezulton prania e një përfaqësuesi nga ana e OE.

- Nga auditimi i praktikës rezultoj se, akt dorëzimi i mallrave përmban nënshkrimin e personit që i ka marr në dorëzim dhe është dokument i nxjerr nga “K” sh.p.k çka vërteton dërgimin e mallrave drejtpërdrejt tek personi që i merr në ngarkim pa bërë hyrje njëherë në magazinën e ASH.

Sa më sipër, operuar në kundërshtim me:

✓ UMF nr.30 datë 27.12.2011 Menaxhimi i aktiveve të NJSP, kapitulli III. Rregjistri i aktiveve dhe dokumentimi i levizjes se tyre,

pika 37 ku specifikohet... *Hyrja e aktiveve në magazinë dokumentohet në çdo rast me fletëhyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre. Fletëhyrjet lëshohen nga magazinieri, pasi të jetë bërë më parë verifikimi fizik i sasisë, i cilësisë dhe i çmimit.*

Po ashtu, sikundër pika 42 parashikon ... *Titullari i njësisë miraton urdhërin për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe të dokumentacionit shoqërues.*

✓ VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” neni 77 pika 6 ku parashikohet se, ... *Autoriteti kontraktor para pagimit të faturës së mallit, duhet të kontrollojë ... cilësinë e mallit të lëvruar, nëse është e njëjtë me atë për të cilën është shpallur kontraktori”.*

- Kërkesa e kryer nga ana e drejtuesit e projektit drejtuar ASH nuk përmbante ekstremitete (nr. Protokolli dhe datë) në kundërshtim me ligjin nr.9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat”, në “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”.

- Sa i takon transportimit të aktiveve rezultoi se, mungon gjurma dokumentare e justifikimit të tyre, operuar në kundërshtim me UMF nr.30 datë 27.12.2011 Menaxhimi i aktiveve të NJSP, kapitulli III. Rregjistri i aktiveve dhe dokumentimi i levizjes se tyre, pika 51...



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQPËRISË

Transportuesi ka përgjegjësinë e dërgimit të aktiveve nga dërguesi tek marrësi brenda afatit dhe pa dëmtim. Transporti i aktiveve kryhet në bazë të dokumentave përkatëse që janë plotësuar për çdo dërgesë dhe në përputhje me urdhërin dhe dispozitat e caktuara. Dokumenti bazë që konfirmon transportin e aktiveve është Fletë-ngarkesa. Transportuesi merr në ngarkesë aktivet me anë të një fletë-dalje që plotësohet nga dërguesi dhe nënshkruhet nga të dy palët (furnitori dhe transportuesi).

- Totali i blerjeve të financuara nga ASH për efekt të studimit/projektit “Drejt krijimit të Njësive së Biosensorëve pranë Grupit të Bioteknologjive Molekulare, NanoAlb - Përdorimi i biosensorëve me qeliza të plota dhe elektrokimike për të matur toksicitetin e ujit dhe tokës në bregdetin shqiptar, BIOSENSTOXIC” referuar Urdhër Shpenzimeve rezulton në 1,394,400 lekë për pajisje. Ndërkohë magazina e v.2022 përmbante reagente kimike me vlerë 502,200 lekë, e përbëhej vetëm nga reagente.
- Nga auditimi u konstatua problematikë në verifikimin e sasive të reagenteve kimike, për arsye të njësive matëse të tyre (dl/ml).

Titulli i Gjetjes 1:	Llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm"
Situata:	<p>Nga ana e ASH, për të dy vitet objekt auditimi, të ardhurat e trashëguara nuk rakordohen me degën e thesarit dhe mungon argumentimi i tyre në formatin e akt rakordimit.</p> <p>Sa më sipër rezulton se nuk janë kryer veprimet rregulluese dhe përmyllëse të fundit të periudhës nga ana e ASH duke operuar në kundërshtim me UMF nr.8 datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore të Njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar.</p> <p>Për vitin 2021 llogaria 12 “Rezultatet e mbartur” me vlerë totale prej 9,126,323 lekë, nuk rezultonte e argumentuar me të ardhurat në likuiditete në llogarinë financiare të disponibiliteteve, si dhe me të drejta të konstatuara por të pa arkëtuara në periudhat përkatëse ushtrimore në kundërshtim me UMF nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Paragrafi Funksionimi i llogarisë 12 “Rezultati i mbartur”.</p>
Kriteri:	- Udhëzimi nr.5 datë 21.02.2022 “Mbi ndryshimin e udhëzimit numër. 8, datë 09/03/2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.
Ndikimi/Efekti:	Mbartje e vlerave ndër vite.
Shkaku:	Mos pasqyrim real dhe i saktë zërave në pasqyrat financiare.
Rekomandimi:	Nga ana e Akademisë së Shkencave, sektori financës, të merren masa për kontabilizimin në trajtën e regjistrimit dyfish me kundërparti diferencat nga përdorimi i sponsorizimeve në llogarinë 85 “Rezultati i ushtrimit”, kurse diferenca si rezultat i ushtrimit të mëparshëm të pasqyrohen në llogarinë 12 “Rezultat i mbartur”, për një pasqyrim më të drejtë të kundërpartisë së disponibiliteteve në thesar, me qëllim që të parandalohen gabimet apo parregullsitë e mundshme në interpretimin e llogarive të pasqyrave financiare.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

	Nga ana e Akademisë së Shkencave, sektori financës në kushtet kur llogaria 12 “Rezultat i mbartur” pasqyron rezultatin e viteve të kaluara mbetur të përdorur me të drejta të paparashikueshme për ta përdorur në vitin korrent, të merren masa për të kryer argumentimin e saj si dhe me të drejta të konstatuara por të pa arkëtuara në periudhat përkatëse ushtrimore.
Rëndësia:	E mesme
Afati zbatimit:	Menjëherë dhe në vijimësi.

Titulli i Gjetjes 2:	Llogaria 202 “Studime dhe Kërkime”
Situata:	Nga auditimi u konstataa fenomen i mbartur për të dy vitet, llogaria 202 “Studime dhe projektme” e cila përmban vlerën e “Studimit të rregullimit të tërësisë ujore të Shkodrës” që daton prej vitit 2004 ku vlera fillestare e tij ka qenë 308,053 lekë. Ky studim nuk është jetëzuar në asnjë moment, prej Akademisë së Shkencave ka filluar të llogaritet amortizim i vlerës së studimit prej vitit 2019, praktik e cila vijon të kryhet ende. Aktualisht nuk është ndërmarrë asnjë nismë për vlerësimin e efektivitetit të këtij studimi (duke patur parasysh se periudha kohore që ka kaluar është relativisht e gjatë 19 vite) apo mundësinë për ta vendosur në zbatim apo jo referuar ndryshimeve që kanë ndodhur me vitet.
Kriteri:	- Udhëzimi nr.5 datë 21.02.2022 “Mbi ndryshimin e udhëzimit numër. 8, datë 09/03/2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.
Ndikimi/Efekti:	Pasaktësi në kontabilizimin e vlerave në pasqyrat financiare.
Shkaku:	Mos pasqyrim real dhe i saktë i zërave në pasqyrat financiare.
Rekomandimi:	Nga ana e Akademisë së Shkencave të merren masat për të parë mundësinë e jetëzimit të studimeve dhe projektmeve referuar ndryshimeve që kanë ndodhur me vitet. Gjithashtu të merren masa për të vendosur autorësinë mbi studimet e kryera rast pas rasti duke aplikuar parashikimet ligjore për të drejtat e autorit.
Rëndësia:	E lartë
Afati zbatimit:	Menjëherë dhe në vijimësi.

Titulli i Gjetjes 3:	Ndërtime e Konstruksione
Situata:	Nga auditimi u konstataa fenomen i përsëritur lidhur me veprimet kontabile në formatin nr.1, Zëri “Ndërtime e konstruksione” (llog. 212). Nga ana e Akademisë së Shkencave specifikohet se pjesë e inventarit të asetëve të ASH dhe pjesë e bilancit kontabël konkretisht në llogarinë 212 “Ndërtime e konstruksione” pasqyrohet edhe fondi i librave shkencorë (për vitin 2021 kjo llogari e cila paraqitet për vlerën 31,643,349 lekë, është shtuar dhe kontabilizuar edhe për vlerën e një investimi prej 132,344 lekë për efekt të fondit të librave, konkretisht blerje e librave shkencore).



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQPËRISË

	<p>Në këto kushte, nga ASH është kryer një keq klasifikim i aktiveve, duke përfshirë libra (pa grupim/klasifikim në bazë të përdorimit) në llogarinë ekonomike 212 “Ndërtime e konstruksione”;</p> <p>- Ky keq klasifikim bën që kjo llogari të mos pasqyrojë situatën reale të njësisë si dhe denatyrton pasqyrat financiare për sa i takon natyrës së klasifikimit të llogarive.</p> <p>-Po ashtu nga ana e ASH specifikohet se, përgjatë vitit 2022 është kryer kalim në llogarinë 212 edhe vlera e librave nga magazina në bibliotekë me vlerë totale prej 93,448.8 lekë.</p>
Kriteri:	<p>- Udhëzimi nr.5 datë 21.02.2022 “Mbi ndryshimin e udhëzimit numër. 8, datë 09/03/2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”,</p> <p>- SKK 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale”, i përmirësuar.</p>
Ndikimi/Efekti:	Pasaktësi në klasifikimin dhe kontabilizimin e vlerave në pasqyrat financiare.
Shkaku:	Mos pasqyrim real dhe i saktë zërave në pasqyrat financiare dhe denatyrim i zërave.
Rekomandimi:	<p>- Nga ana e Akademisë së Shkencave, Sektori i Financës, të merren masa të kryhen sistemimet përkatëse kontabile dhe rishikimet e nevojshme mbi klasifikimin e aktiveve dhe përshtatjes së tyre me klasifikimet korrekte referuar SKK 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Jomateriale, si dhe UMF në 8, datë 09/03/2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.</p>
Rëndësia:	E lartë
Afati zbatimit:	Menjëherë

Titulli i Gjetjes 4:	<i>Pronat e Paluatjshme Shtetërore</i>
Situata:	<p>Nga auditimi u konstatua se, ndërtesat e kaluara në përgjegjësi administrimi ASH-së sipas Listës së Inventarit të Pronave të Paluatjshme Shtetërore miratuar me VKM nr.440 datë 16.06.2005, ndryshuar me VKM nr.248 datë 09.05.2018, nuk rezultojnë të regjistruara në pasqyra financiare, përveç ndërtesës “Akademia e Shkencave” me sipërfaqe prej 1,128.25 m² dhe vlerë 18,105,620 lekë e pasqyruar në kontabilitetin e ASH.</p> <p>- Nga ana e ASH për godinën “Akademia e Shkencave” me sipërfaqe prej 1,128.25 m², prej vitit 1996 me kontrata vjetore, detyrimi qirave mujore për pronarët e truallit dhe ndërtesës deri në muajin nëntor 2023 është në vlerën 161,990,296 lekë dhe në fakt është paguar në vlerën 134,629,243.04 lekë. Kjo ndërtesë me VKM e mësipërme është në përgjegjësi administrimi të Akademisë së Shkencave.</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

Kriteri:	- Udhëzimi nr.5 datë 21.02.2022 “Mbi ndryshimin e udhëzimit numër. 8, datë 09/03/2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, - SKK 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale”, i përmirësuar.
Ndikimi/Efekti:	Pasaktësi në kontabilizimin e vlerave në pasqyrat financiare.
Shkaku:	Mos pasqyrim real dhe i saktë zërave në pasqyrat financiare.
Rekomandimi:	Nga ana e Akademisë së Shkencave, të merren masa për të sqaruar pronësitë e aktiveve që ajo disponon, duke vendosur një korrespondencë me ASHK dhe të rifreskohen kartelat/hartat treguese të saj, të specifikohen qartazi kufijtë e pasurive të paluajtshme që janë dokumentuar aktet e fitimit të pronësisë apo posedimit rast pas rasti. - Sa i takon pagesave periodike për qera ambientesh, në varësi të përgjigjes që do të merret nga ASHK pas kryerjes së një analize tregu, kosto përfitim të vlerësohet dhe gjykohet mundësia, për gjetje/investim të një ambienti të ri ku mund të ushtrohet plotësisht aktiviteti i këtij Institucioni.
Rëndësia:	E lartë
Afati zbatimit:	Menjëherë dhe në vijimësi.

Titulli i Gjetjes 5:	Shpenzimet korrente
Situata:	<p>Nga auditimi u konstatua fenomen i përsëritur për të dy vitet, (2021 – 2022) mbi rakordimin e vlerave mes situacionit të shpenzimeve paraqitura në akt-rakordimin me degën e thesarit Tiranë, “Shpenzimet korrente” dhe ato të pasqyruara në pasqyrat financiare për llogaritë e shpenzimeve. Për vitin 2021 u konstatua diferencë prej 88,529 lekë dhe për vitin 2022 u konstatua një diferencë prej 9,468,967 lekë.</p> <p>- Në relacionin e pasqyrave financiare apo në shënimet shpjeguese, mungon argumentimi lidhur me shifrat e rakorduara me thesarin dhe vlerat që përfshihen në deklaratat financiare, si dhe mungon shpjegimi mbi këto diferenca. Sa më lart është në kundërshtim me UMF nr. 24128, datë 27.12.2011 “Procesimi i transaksioneve në fund të vitit” dhe UMF nr. 9, datë 20.03.2018 “Procedura standarde e zbatimit të buxhetit”, Kreu III, “Procedurat për kryerjen e shpenzimeve publike”, nënkapitulli “Marrja e angazhimeve dhe kryerja e shpenzimeve publike” dhe UMF nr. 8, dt. 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 37 – 39.</p> <p>Nga auditimi mbi rakordimin zë për zë të vlerave mes situacionit të shpenzimeve dhe ato të pasqyruara në pasqyrat financiare rezulton se:</p> <p>✓ për të dy vitet nga ana e ASH në totalin e llogarisë së shpenzimeve operohej duke shtuar edhe llogarinë 63 “Ndryshim i gjendjes së inventarit” në total të shpenzimeve me qëllim nxjerrjen e rezultatit final të tyre;</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQPËRISË

	<p>✓ për vitin 2021 në pasqyrën e performancës financiare (PASH) nuk rezultonte me vlerë llogaria 604 “Transferime korrente të brendshme” ndërkohë që në situacionin e thesarit kjo llogari përmban vlerë (konkretisht 122,740 lekë).</p> <p>Nga krahasimi mes pasqyrave dhe situacionit të shpenzimeve, u konstatua ndryshim tjetër ishte sa i takon veprimeve me llogarinë 231, llogari e cila në pasqyra financiare rezulton pa vlerë (në shënime shpjeguese nuk jepet informacion se për çfarë është çelur kjo llogari apo për çfarë është përdorur) ndërkohë në situacionin me thesarin përmban vlerë (konkretisht, 4,745,046 lekë).</p>
Kriteri:	- Udhëzimi nr.5 datë 21.02.2022 “Mbi ndryshimin e udhëzimit numër. 8, datë 09/03/2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.
Ndikimi/Efekti:	Pasaktësi në kontabilizimin e vlerave në pasqyrat financiare.
Shkaku:	Mos pasqyrim real dhe i saktë zërave në pasqyrat financiare.
Rekomandimi:	Nga ana e Sektorit të Financës të kryet rakordimi dhe unifikimi i vlerave të paraqitura në pasqyrat financiare me vlerat e paraqitura në aktet e rakordimit me degën e thesarit duke argumentuar në shënimet shpjeguese se çfarë përfshihet në shifrat e rakorduara me thesarin dhe çfarë vlerash përfshihen në deklaratat financiare.
Rëndësia:	E mesme
Afati zbatimit:	Periodikisht dhe çdo muaj.

Titulli i Gjetjes 6:	Të ardhurat korrente
Situata:	<p>Nga auditimi i dokumentacionit justifikues mbi të ardhurat (konkretisht pasqyra e performancës financiare (PASH) dhe akt rakordimi me thesarin, u konstatua se:</p> <p>✓ Për vitin 2021 në akt rakordim nuk paraqiten të ndara (në klasifikimin buxhetor me nr.710 9600) të ardhura nga qerata megjithëse janë gjeneruar të ardhura prej dhënies me qera të sallës së Akademisë së Shkencave.</p> <p>Për vitin 2022 në akt rakordimin me thesarin për pjesën takuese, referuar përqindjeve të parashikuara, figuron 100% e të ardhurave të sponsorizimeve dhe 100% e të ardhurave nga grantet korrente të brendshme mbahen nga institucioni. Në vlerë absolute 7,458,442 lekë. Këto janë fonde që janë mbartur/trashëguar në llogari të ASH, por mungon gjurma dokumentare e vërtetimit të këtij transaksioni.</p>
Kriteri:	- Udhëzimi nr.5 datë 21.02.2022 “Mbi ndryshimin e udhëzimit numër. 8, datë 09/03/2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.
Ndikimi/Efekti:	Pasaktësi në kontabilizimin e vlerave në pasqyrat financiare.
Shkaku:	Mos pasqyrim real dhe i saktë zërave në pasqyrat financiare.
Rekomandimi:	Nga ana e Akademisë së Shkencave, sektori i financës, të merren masat: - Për paraqitje në akt rakordimin të të ardhurave dhe shpenzimeve financiare me thesarin të paraqiten në mënyrë të detajuara të ardhurat e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

	<p>krijuara nga institucioni sipas burimit të tyre dhe natyrës, në përputhje me UMF nr.8 datë 09/03/2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar dhe të rakordohen të ardhurat e trashëguara me degën e thesarit.</p> <p>- në formatin e akt rakordimit, të përshtaten dhe pasqyrohen përqindjet respektive reale të të ardhurave që derdhen në buxhet dhe atyre që mban vet institucioni.</p>
Rëndësia:	E lartë
Afati zbatimit:	Menjëherë dhe në vijimësi.

Titulli i Gjetjes 7:	Formati 7
Situata:	<p>Nga auditimi u konstatua se, për vitin 2022 formati 7 “Ndryshime në gjendjen e aktiveve” nuk pasqyron vlerat reale të aktiveve, po ashtu hartimi i tij përmban pasaktësi të shumta sa i takon vlerave. Në të gjitha rastet e aktiveve u konstatua amortizim mbi shtesa <u>kur vlerë shtese nuk kishte</u> dhe po ashtu teprica në mbyllje e vitit pararendës <u>nuk rakordon</u> me tepricën në mbyllje të vitit aktual. Si rrjedhojë përmes pasqyrave financiare nuk arrihet sigurimi i informacionit të plotë mbi situatën e aktiveve dhe ndryshimet që kishin pësuar përgjatë vitit.</p>
Kriteri:	<p>- Udhëzimi nr.5 datë 21.02.2022 “Mbi ndryshimin e udhëzimit numër. 8, datë 09/03/2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.</p>
Ndikimi/Efekti:	Pasaktësi në kontabilizimin e vlerave në pasqyrat financiare.
Shkaku:	Mos pasqyrim real dhe i saktë zërave në pasqyrat financiare.
Rekomandimi:	<p>Nga ana e Akademisë së Shkencave të merren masa për të kryer kontabilizimet në përputhje me faktet reale, në mënyrë që të pasqyrohet situata faktike e njësisë. Duke evidentuar shtesa/pakësime dhe vetëm në rastet kur ka shtesa të kryhen veprime amortizimi mbi vlera reale, në përputhje me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018, i ndryshuar me UMF nr.5 datë 21.02.2022.</p>
Rëndësia:	E mesme
Afati zbatimit:	Menjëherë dhe në vijimësi.

Titulli i Gjetjes 8:	Regjistri i aktiveve
Situata:	<p>Nga auditimi u konstatua se, nuk është hartuar regjistri i aktiveve, në varësi të llojit të tyre si dhe grupit përkatës brenda llojit përfshirë datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

	Sa më lart në zbatim të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kapitulli III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pikat 26, 28, 30 sa i takon hartimit të regjistrit të aktiveve.
Kriteri:	- UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 26, 28, 30, - Udhëzimi nr.5 datë 21.02.2022 “ Mbi ndryshimin e udhëzimit numër. 8, datë 09/03/2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, - SKK 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale”, i përmirësuar.
Ndikimi/Efekti:	Paraqitje jo e plotë e pozicionit financiar.
Shkaku:	Mungesa e nxjerrjes së një regjistri të plotë të aktiveve.
Rekomandimi:	Nga ana e Akademisë së Shkencave të merren masa për hartimin e regjistrit të aktiveve, në varësi të llojit të tyre si dhe grupit përkatës brenda llojit në përputhje dhe zbatim me Udhëzimin nr. 30 të MFE datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.
Rëndësia:	E lartë
Afati zbatimit:	Menjëherë dhe në vijimësi.

Titulli i Gjetjes 9:	Rakordimi i të ardhurave
Situata:	<p>Nga auditimi u konstatua se: Nga ana e ASH, për të dy vitet objekt auditimi, të ardhurat e trashëguara nuk rakordohen me degën e thesarit dhe mungon argumentimi i tyre në formatin e akt rakordimit.</p> <p>Sa më sipër rezulton se nuk janë kryer veprimet rregulluese dhe përmbyllëse të fundit të periudhës nga ana e ASH duke operuar në kundërshtim me UMF nr.8 datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore të Njësitë të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar.</p> <p>Për vitin 2021 llogaria 12 “Rezultatet e mbartur” me vlerë totale prej 9,126,323 lekë, nuk rezultonte e argumentuar me të ardhurat në likuiditete në llogarinë financiare të disponibiliteteve, si dhe me të drejta të konstatuara por të pa arkëtuara në periudhat përkatëse ushtrimore në kundërshtim me UMF nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Paragrafi Funksionimi i llogarisë 12 ”Rezultati i mbartur”.</p>
Kriteri:	- Udhëzimi nr.5 datë 21.02.2022 “Mbi ndryshimin e udhëzimit numër. 8, datë 09/03/2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.
Ndikimi/Efekti:	Pasaktësi në kontabilizimin e vlerave në pasqyrat financiare.
Shkaku:	Moskryerje e veprimeve rregulluese dhe përmbyllëse të fundit të periudhës, si dhe mos argumentim i llogarive dhe vlerave të pasqyruara në to me kundërpartitë respektive.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

Rekomandimi:	<p>Nga ana e Akademisë së Shkencave, sektori financës, të merren masa për kontabilizimin në trajtën e regjistrimit dyfish me kundërparti diferencat nga përdorimi i sponsorizimeve në llogarinë 85 “Rezultati i ushtrimit”, kurse diferenca si rezultat i ushtrimit të mëparshëm të pasqyrohen në llogarinë 12 “Rezultat i mbartur”, për një pasqyrim më të drejtë të kundërpartisë së disponibiliteteve në thesar, me qëllim që të parandalohen gabimet apo parregullsitë e mundshme në interpretimin e llogarive të pasqyrave financiare.</p> <p>Nga ana e Akademisë së Shkencave, sektori financës në kushtet kur llogaria 12 “Rezultat i mbartur” pasqyron rezultatin e viteve të kaluara mbetur të papërdorur me të drejta të paparashikueshme për ta përdorur në vitin korrent, të merren masa për të kryer argumentimin e saj si dhe me të drejta të konstatuara por të pa arkëtuara në periudhat përkatëse ushtrimore.</p>
Rëndësia:	E lartë
Afati zbatimit:	Menjëherë dhe në vijimësi

Titulli i Gjetjes 10:	Mjete monetare në Arkë
Situata:	Nga auditimi i pasqyrave financiare u konstatua i njëjti fenomen i përsëritur për të dy vitet objekt auditimi (viti 2021 dhe viti 2022) i pranisë së vlerave në llogarinë 531 “Mjete monetare në Arkë” të mbartura prej vitesh në pasqyrat e institucionit (viti i nisjes së regjistrimit të kësaj vlere daton përpara vitit 2000). Kjo llogari përfaqëson arkën në valutë ku ndodhen 8,500 forinta hungareze si shlyerje e një paradhënie në valutë të cilën Banka e Kursimeve nuk e ka konvertuar.
Kriteri:	<ul style="list-style-type: none">- Ligji nr.83/2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,- Udhëzimi nr.5 datë 21.02.2022 “Mbi ndryshimin e udhëzimit numër. 8, datë 09/03/2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”,- Udhëzimi nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në NjSP”.
Ndikimi/Efekti:	Mbartje e vlerave ndër vite
Shkaku:	Mos pasqyrim real i zërave në pasqyrat financiare.
Rekomandimi:	Nga ana e Akademisë së Shkencave, të merren masat për të vlerësuar mundësinë e konvertimit të valutës së huaj me monedhën vendase duke shmangur në këto kushte mbajtjen e saj pa vlerë dhe efekt financiar.
Rëndësia:	E mesme
Afati zbatimit:	Menjëherë dhe në vijimësi.

Titulli i Gjetjes 11:	Kontrata qera ambienti
Situata:	Nga auditimi u konstatua, prania dhe nënshkrimi i 6 kontratave me parregullsi sa i takon ekstremiteve dhe përfaqësimit të palës së Akademisë së Shkencave, konkretisht në rolin e përfaqësuesit të ASH



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

	specifikuar në kontratë figuron <u>z. Sh.S</u> me cilësinë e <u>Kryetar i Akademisë së Shkencave</u> , ndërkohë faktikisht personi në fjalë ka qenë i ngarkuar me rolin e Nënpunësit Autorizues sipas shkresës më nr.9/1 prot., datë 10.01.2020.
Kriteri:	- Udhëzimi nr.5 datë 21.02.2022 “Mbi ndryshimin e udhëzimit numër. 8, datë 09/03/2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, - Udhëzimi nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në NjSP”.
Ndikimi/Efekti:	Pasaktësi në kontabilizimin e vlerave në pasqyrat financiare.
Shkaku:	Mos pasqyrim real dhe i saktë zërave në pasqyrat financiare.
Rekomandimi:	Nga ana e Akademisë së Shkencave të merren masa për të rifreskuar kontratat me probleme duke patur parasysh nënshkrimet dhe protokollimin si ekstremite të domosdoshme të një dokumenti për të plotësuar kriteret e zyrtarizimit, si dhe formalizimin e veprimet referuar fakteve aktuale.
Rëndësia:	E mesme
Afati zbatimit:	Menjëherë dhe në vijimësi.

Titulli i Gjetjes 12:	<i>Marrëveshjet mes ASH me QSUNT dhe UT</i>
Situata:	<p>Nga auditimi u konstatua se, sa i takon vitit 2023 nuk është rinovuar marrëveshja mes QSUNT dhe ASHSH, megjithëse nga ana e ASHSH janë dërguar 2 shkresa drejtuar QSUNT për rinovim marrëveshje.</p> <p>Në të dy marrëveshjet e lidhura (UT dhe QSUNT) nuk specifikohet si do të operohet për pronësinë intelektuale në përfundim të projektit/studimit, dhe më tej në projekte nuk specifikohet personi koordinator, gjithashtu nuk rregullohet mënyra e raportimit mbi kostot e projekt/studimeve për secilën fazë;</p> <p>Në projektet “NanoAlb”, “Imunologji” dhe marrëveshjet e bashkëpunimit nuk specifikohet vendi se ku do të kryhen studimet/projektet dhe ku do të jenë vendosur pajisjet që do të përdoren për efekt studimi, në kundërshtim me Statutin e ASHSH, neni 45, pika 2.</p> <p>Në secilin prej projekteve respektive, mungon gjurma e raportimit për kostot e secilës fazë projekti në ASH;</p> <ul style="list-style-type: none">- Për projektet fituese mungon analiza paraprake kosto përfitim, shoqëruar me një analizë kostoje të detajuar përpara përzgjedhjes.
Kriteri:	- Udhëzimi nr.5 datë 21.02.2022 “Mbi ndryshimin e udhëzimit numër. 8, datë 09/03/2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. - Udhëzimi nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në NjSP”, - Statuti i ASH miratuar me Vendim të Asamblesë së ASH nr.22 datë 18.10.2019. - Marrëveshja e Bashkëpunimit mes UT dhe ASH lidhur më 11.12.2020; prot me nr.634 prot.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

	<ul style="list-style-type: none">- Marrëveshja e Bashkëpunimit mes QSUNT dhe ASH lidhur më 06.05.2022; protokolluar me nr.1203/1 prot.- Vendimet e Asamblesë dhe Kryesisë rast pas rasti.
Ndikimi/Efekti:	Problematika në zbatimin e marrëveshjes
Shkaku:	Mos parashikim i qartë i të gjithë klauzolave rregulluese të aspekteve financiare dhe të pronësisë intelektuale.
Rekomandimi:	<ul style="list-style-type: none">- Nga ana e Akademisë së Shkencave të merren masat për të rivendosur edhe njëherë korrespondencën me QSUNT për rinovim të marrëveshjes.- Në bashkëpunim me njësitë kërkimore studimore apo qendrat të cilat kryejnë studime/projekte, të administrohet praktika dokumentare që përbën gjurmë auditimi.- Të rregullohet baza ligjore dhe rregullatore sa i takon pronësisë intelektuale në përfundim të projekteve/studimeve që financohen nga ASH.- Në çdo projekt/studim të specifikohet qartazi se cili do të jetë koordinator i projektit/studimit dhe cili do të jetë personi që do të marrë në dorëzim artikujt/mallrat.- Në çdo rast të parashikohet specifikisht mënyra e raportimit të kostos, në mënyrë të tillë që të mund të parashikohen në mënyrë reale nevojat e ardhshme dhe të justifikohen dhe argumentohen në mënyrë korrekte dhe të plotë shpenzimet për efekt të veprimtarive të këtyre projekte/studimeve.- Në çdo studim/projekt Drejtoria e Projekteve të marrë masa për të krijuar një data bazë të plotë duke theksuar vlerat e projektit për çdo vit, si dhe duke specifikuar vendin se ku po kryhet studimi dhe se ku janë shpërndarë pajisjet e financuara nga ASH për efekt të studimit.- Në mënyrë periodike (sikundër të vendoset pas një analize të kryer nga ana e Sektorit të Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e Projekteve) të kryhen raportime mbi kostot respektive për secilin projekt/studim.- Në momentin e shprehjes së interesit për financimin e një studimi/projekti të parashikohet edhe kosto totale dhe e detajuar e këtij studimi/projekti në trajtën e një preventivi të nevojave financiare (respektive nga secili projekt për secilën fazë).- Në rastet kur kërkohet vijueshmëria e studimit/projektit përtej afatit fillestar të miratuar, të detajohen kostot shtesë dhe të analizohet përfitimi, me qëllim justifikimin e vijueshmërisë ose jo të tyre.
Rëndësia:	E lartë
Afati zbatimit:	Menjëherë dhe në vijimësi.

Titulli i Gjetjes 13:	Listim i vendndodhjes ku kryhen studime/kërkimet
Situata:	ASH nuk ka informacion, në trajtën e një databaze (listë emërore) se ku po kryhej puna studimore prej grupeve kërkimore apo vendndodhjen e materialeve/pajisjeve.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

	<p>✓ rasti i njësisë kërkimore studimore në fushën e bioshkencës, bioteknologjisë dhe gjenetikës nga ana e së cilës janë propozuar 2 projekte për vitin 2020, u konstatua mungesë e gjurmës se cilat janë institucionet apo universitetet (përmes një listimi të emrave të tyre) në të cilat po shtrihet veprimtaria e NanoAlb dhe janë të shpërndara pajisjet e financuara nga ana e ASH). Operuar në kundërshtim me vetë relacionin e veprimtarisë pikën 3 të tij.</p> <p>Nga auditimi u konstatua se në përfundim të projektit nuk del një material përmbledhës apo Studim i cili të jetë pronë e Akademisë së Shkencave apo një dokument përmbyllës justifikues të veprimtarisë në favor autorësie të ASH.</p>
Kriteri:	<ul style="list-style-type: none">- Udhëzimi nr.5 datë 21.02.2022 “Mbi ndryshimin e udhëzimit numër. 8, datë 09/03/2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.- Udhëzimi nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në NjSP”,- Statuti i ASH miratuar me Vendim të Asamblesë së ASH nr.22 datë 18.10.2019.- Marrëveshja e Bashkëpunimit mes UT dhe ASH lidhur më 11.12.2020; prot me nr.634 prot.- Marrëveshja e Bashkëpunimit mes QSUNT dhe ASH lidhur më 06.05.2022; protokolluar me nr.1203/1 prot.- Vendimet e Asamblesë dhe Kryesisë rast pas rasti.
Ndikimi/Efekti:	Problematika në monitorimin e veprimtarisë së laboratorëve / projekteve nga ana e impaktit financiar.
Shkaku:	Mungesë e dokumentimit të bashkëpunimit mes institucioneve apo njësisive.
Rekomandimi:	<p>Nga ana e Akademisë së Shkencave të merren masat:</p> <ul style="list-style-type: none">- për çdo bashkëpunim që kryhet me institucione publike apo private, brenda dhe jashtë vendit të jetë e dokumentuar prania e marrëveshjeve respektive të lidhura;- nga ana e drejtorisë përgjegjëse për projektet/studimet ashtu sikundër specifikohen në raportet e veprimtarisë së njësisë, të kryhen vizita monitorime në laboratorët apo ambientet e punës, për njohjen me funksionimin e tyre;- për të dokumentuar dhe formalizuar pronësinë intelektuale sa i takon projekte/studimeve.
Rëndësia:	E lartë
Afati zbatimit:	Menjëherë dhe në vijimësi.
Titulli i Gjetjes 14:	<i>Verifikimi në terren në FSHN dhe QSUNT</i>
Situata:	Nga verifikimi në terren i kryer në laboratorin e <i>Imunologjisë në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”</i> , referuar listës së inventarit bashkangjitur marrëveshjes u konstatua se:



- Nga verifikimi në laborator i pajisjeve të marra në përdorim nga QSUT nuk u arritën të evidentoheshin 8 pajisje dhe 22 inventar i imët si pasojë e mungesës së etiketave me kodet përkatëse.

- një pjesë e artikujve që ndodheshin në magazinën e laboratorit, ishin jashtë funksionit dhe kishin kohë që nuk përdoreshin. Por mungonte një relacion lidhur me to, ku të specifikoheshin kjo gjë.

a. Nga verifikimi në terren i kryer në laboratorët e *Imunologjisë në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, laboratorin e fizikës në Universitetin Politeknik të Tiranës, laboratorin e fizikës Fakultetin e Shkencave të Natyrës* u konstatuan si më poshtë vijojnë:

- Për blerjet e realizuara rishtazi (viti 2023) mungojnë të dhënat identifikuese specifike të tyre (bar kode apo të dhëna të tjera specifike),

- Në aktin e marrjes në dorëzim, grupi punës nuk shprehet mbi cilësinë e mallit të lëvruar, nëse është e njëjtë me atë për të cilën është shpallur kontraktori, po ashtu mungonte vlerësimi nëse artikujt përputhen me standardet dhe të gjitha parametrat në cilësi dhe sasi, të kërkuara sipas DST dhe nënshkruara në kontratë.

- Grupi i punës për marrje në dorëzim nuk shprehet për mënyrën sesi është verifikuar apo testuar cilësia e mallrave të lëvruara, po ashtu nuk shprehen në kraht të artikujve të marrë mbi specifikimet e tyre për të krahasuar me ato të cilat janë kërkuar në DST.

- Akti i marrjes në dorëzim nuk është nënshkruar nga ana e Operatorit Ekonomik dhe nuk rezulton prania e një përfaqësuesi nga ana e OE.

Sa më sipër operuar në kundërshtim me UMF nr.30 datë 27.12.2011 Menaxhimi i aktiveve të NJSP, pika 37 dhe pika 42, si dhe si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” neni 77 pika 6.

b. *Laboratori Imunologjisë QSUNT:*

- Grupi i marrjes në dorëzim nuk është shprehur mbi specifikimet teknike të pajisjes, “Sistem real time PCR me 384 puse” po ashtu grupi i auditimit nuk arrin të identifikojë pajisjen për shkak të mungesës së të dhënave specifike me vlerë totale 4,188,000 lekë.

- 200 copë /artikuj “Komplet për mbledhje dhe ruajtje të pështymës” në momentin e verifikimit nuk ndodheshin në ambientet e laboratorit por i dispononte studiuesi, i cili ishte në proces mbledhje mostrash në terren, me vlerë totale 84,000 lekë.

c. *Laboratori i fizikës UPT:*

Nga auditimi i praktikave dokumentare për projektin/studimin “Përgatitja dhe karakterizimi i nanofibrave elektrofibra të pastër PVA dhe matricës PVA/MMT për të kapsuluar një vaj esencial të bimës mjekësore shqiptare për aplikime biomjekësore”

- Pajisja “homogjenizer” copë 1, me vlerë 300,000 lekë, rezultonte e pavënë në përdorim, blerë me faturë numër 1444, datë 18.09.2023, është bërë hyrje në magazinën e ASH.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

Kriteri:	<ul style="list-style-type: none">- Udhëzimi nr.5 datë 21.02.2022 “Mbi ndryshimin e udhëzimit numër. 8, datë 09/03/2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.- Udhëzimi nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në NjSP”,- Statuti i ASH miratuar me Vendim të Asamblesë së ASH nr.22 datë 18.10.2019.- Marrëveshja e Bashkëpunimit mes UT dhe ASH lidhur më 11.12.2020; prot me nr.634 prot.- Marrëveshja e Bashkëpunimit mes QSUNT dhe ASH lidhur më 06.05.2022; protokolluar me nr.1203/1 prot.- Vendimet e Asamblesë dhe Kryesisë rast pas rasti.
Ndikimi/Efekti:	Problematika në zbatimin e marrëveshjes
Shkaku:	Mos parashikim i qartë i të gjithë klauzolave rregulluese të aspekteve financiare dhe të pronësisë intelektuale.
Rekomandimi:	<p>Nga ana e Akademisë së Shkencave të merren masat:</p> <ul style="list-style-type: none">- Për të vlerësuar pajisjet e ndodhura në laboratorin e QSUNT sa i takon funksionalitetit të tyre, e më tej përpilimin e një relacioni lidhur me to.- Të identifikojë në mënyrë specifike çdo artikull/pajisje në mënyrë që të jetë lehtësisht e evidentueshme.- Plotësim dhe dokumentim i praktikave dokumentare të bashkëpunimit me njësitë kërkimore studimore dhe qendrat e kërkimit në zbatim të UMF nr.30 dt. 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” dhe UMF nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të NjQP”, i ndryshuar.- Në bashkëpunim me njësitë e kërkim studimit dhe qendrat kërkimore dhe studimore të zyrtarizohet korrespondenca dhe mënyra e raportimit mbi aktivitetet e tyre kur preket ana financiare.
Rëndësia:	E lartë
Afati zbatimit:	Menjëherë dhe në vijimësi.

Titulli i Gjetjes 15:	Verifikimi në terren i projekteve fituese dhe atyre finalizues
Situata:	<p>Nga auditimi në terren për projektet e financuara nga Akademia u konstatua se:</p> <ul style="list-style-type: none">- Në Akademinë e Shkencave në 3 raste, rezulton që nuk kanë gjetur zbatim përcaktimet e nenit 45 “Njësitë afatshkurtra”, pika 2 i Statutit të ASH miratuar me Vendim të Asamblesë nr. 22, datë 18.10.2019, i ndryshuar, pasi nuk ka raportime mbi statusin e secilës fazë të studimit, si dhe mungon një preventiv për të argumentuar nevojat financiare (respektive nga secili projekt për secilën fazë) me qëllim miratimin e vijueshmërisë apo jo të tyre; <p>Për projektet e Qendrës Kërkimore Nanoteknologjike NanoAlb, që shtrijnë veprimtarinë përkatësisht në laboratorët e Fakultetit të Shkencave të</p>



	<p>Natyres, laboratorin e Fizikës në Universitetin Politeknik të Tiranës dhe në disa universitete në Kosovë, referuar të dhënave vendosur në dispozicion të audituesve rezulton se janë kryer 5 projekte, për periudhën 2022-2023 të cilët mbajnë statusin në proces, me vlerë totale të shpenzimeve deri në fund të vitit 2023 prej 9,048,239 lekë.</p> <p>1.1 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi raportet e dërguar në ASH nga ana e ekipit të punës mbi projektin “<i>Studimi sero-epidemiologjik i Gjendjes imunitare ndaj virusit SARS-CoV-2 në popullatën shqiptare</i>”, drejtuar nga z. G.S, <u>përfunduar</u> të 4 fazat e studimit me kosto totale prej 24,163,492 lekë:</p> <ul style="list-style-type: none">- Mungon gjurma e administruar e komunikimit me institucionet përgjegjëse (Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Instituti Shëndetit Publik apo institucione të tjera të cilat u morën me menaxhimin e pandemisë) për të koordinuar punën apo dhënë orientime/sugjerime referuar studimit, përcaktuar në projekt propozimin për studimin “Faza e III e studimit të seroprevalencës së antitropave, anti-SARS-CoV-2 si dhe e përgjigjes imunitare ndaj këtij virusi në popullatën shqiptare”, datë 05.11.2020; pika 1 “Rëndësia e studimit”, paragrafi 2. <p>1.2 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi dokumentacionin justifikues lidhur me projektin pilot “<i>Përzgjedhja e materialit bimor të kumbullës, të kontrolluar nga viruset sipas protokollit, për krijimin e impiantit pilot nëpërmjet shëndetësimit dhe mikroshumimit, në funksion të fillimit të certifikimit të materialit mbjellës, VITROCERT</i>” drejtuar prej zj.E.K, udhëheqëse e projektit, kosto paraprake e tij deri në fund të vitit 2023 është 2,323,798 lekë. Ka përfunduar faza e parë në v.2022 me vlerë 867,600 lekë ka vijuar me statusin në proces faza e dytë deri fund vitit 2023 me vlerën 1,456,198 lekë u konstatua se:</p> <ul style="list-style-type: none">- Në përfundim të fazës së parë, “Vitrocet 2 - 2022” <u>nuk rezulton gjurmë dokumentare e rezultatit final (raport)</u> nga ky projekt. <p><i>Në kushtet e mungesës së dokumentacionit justifikues bazë, argumentues dhe të domosdoshëm në aspektin e dokumentimit financiar vlera prej 23,387,530 lekë (21,063,732 lekë për projektin e Seroimunologjisë, 2,323,798 lekë për projektin Vitrocet) përbëjnë shpenzim jo efektiv të buxhetit të shtetit.</i></p>
<p>Kriteri:</p>	<ul style="list-style-type: none">- Udhëzimi nr.5 datë 21.02.2022 “Mbi ndryshimin e udhëzimit numër. 8, datë 09/03/2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.- Udhëzimi nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në NjSP”,- Statuti i ASH miratuar me Vendim të Asamblesë së ASH nr.22 datë 18.10.2019.- Marrëveshja e Bashkëpunimit mes UT dhe ASH lidhur më 11.12.2020; prot me nr.634 prot.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

	<ul style="list-style-type: none">- Marrëveshja e Bashkëpunimit mes QSUNT dhe ASH lidhur më 06.05.2022; protokolluar me nr.1203/1 prot.- Vendimet e Asamblesë dhe Kryesisë rast pas rasti.
Ndikimi/Efekti:	Problematika në zbatimin e marrëveshjes.
Shkaku:	Mos parashikim i qartë i të gjithë klauzolave rregulluese të aspekteve financiare dhe të pronësisë intelektuale.
Rekomandimi:	<p>Nga ana e Akademisë së Shkencave të merren masat:</p> <ul style="list-style-type: none">- Të analizohen pagesat në vlerën 21,063,732 lekë, të kryera për “<i>Studimi sero epidemiologjik të gjendjes imunitare ndaj virusit SARS-COV-2 në popullatën shqiptare</i>” SEROIMUNE, duke argumentuar nevojat dhe nxjerrjen e përgjegjësive konkrete.- Të analizohen pagesat e kryera deri në fund të vitit 2023 në vlerën prej 2,323,798 lekë për projektin pilot “<i>Përzgjedhja e materialit bimor të kumbullës, të kontrolluar nga viruset sipas protokollit, për krijimin e impiantit pilot nëpërmjet shëndetësimin dhe mikroshumimit, në funksion të fillimit të certifikimit të materialit mbjellës, “VITROCERT”</i>”, duke dokumentuar gjurmë dokumentare e rezultatit final (raport) nga ky projekt.- Në bashkëpunim me njësitë e kërkim-studimit dhe qendrat kërkimore e studimore të unifikohet dhe normohet mënyra e raportimit të aktiviteteve, ku në mënyrë të veçantë të raportohet sipas dokumentacionit për pjesën financiare të ecurisë së projekteve kërkimore-shkencore që zbatohen nga ana e ASH.- Të rishqyrtohet kuadri ligjor e nënligjor, aktet rregulluese për të riparë dhe formalizuar pronësinë intelektuale sa i takon projekteve/studimeve të zbatuara me fondet e ASH dhe jo vetëm, dhe që hartohen nga ana e stafit shkencor.
Rëndësia:	E lartë
Afati zbatimit:	Menjëherë dhe në vijimësi.

Titulli i Gjetjes 16:	ArkeoBylis
Situata:	<p>Nga auditimi i dokumentacionit justifikues mbi projektin “ArkeoBylis – gërmime metoda gjeofizike i agorasë së Bylisit” drejtuar nga z.N.C, udhëheqës i projektit, me kosto totale prej 2,821,434 lekë u konstatua se:</p> <ul style="list-style-type: none">- Mungesë e informacionit lidhur me personat/punëtorët që ishin pjesë e këtij studimi, si në numër personash po ashtu edhe në trajtë nominale për të verifikuar se për cilët është kryer pagesa.- Në raportin e dërguar në ASH për veprimtarinë e projektit ArkeoBylis 2023 nuk rezulton që ky raport të përmbajë ekstremitete të regjistrimit (vetëm nënshkrimi i drejtorit ekzekutiv pa numër protokollit, datë).- Nuk ka <u>asnjë rezultat final të dokumentuar</u> nga ky projekt, apo gjurmë e publikimit të rezultateve të studimit. <p><i>Në kushtet e mungesës së dokumentacionit justifikues bazë dhe të domosdoshëm vlera prej 2,821,434 lekë përbën përdorim jo efektiv të fondeve të buxhetit të shtetit.</i></p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

Kriteri:	- Udhëzimi nr.5 datë 21.02.2022 “Mbi ndryshimin e udhëzimit numër. 8, datë 09/03/2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. - Udhëzimi nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në NjSP”, - Statuti i ASH miratuar me Vendim të Asamblesë së ASH nr.22 datë 18.10.2019. - Vendimet e Asamblesë dhe Kryesisë rast pas rasti.
Ndikimi/Efekti:	Problematika në monitorimin e veprimtarisë së laboratorëve / projekteve nga ana e impaktit financiar.
Shkaku:	Mungesë e dokumentimit të bashkëpunimit mes institucioneve apo njësisive.
Rekomandimi:	Nga ana e Akademisë së Shkencave të merren masat për analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjësive, plotësimin dhe dokumentimin e praktikave dokumentare duke shmangur mangësitë dhe boshllëqet ligjore si dhe argumentim, dokumentim dhe justifikim të veprimtarisë kërkimore / studimore e cila financohet prej buxhetit Akademisë së Shkencave, rrjedhimisht buxheti i shtetit.
Rëndësia:	E lartë
Afati zbatimit:	Menjëherë dhe në vijimësi.

Titulli i Gjetjes 17:	<i>Mungesë e artikujve të inventarit të imët në njërin nga laboratorët e FSHN-së</i>
Situata:	Për projekte të <i>Qendrës Kërkimore Nanoteknologjike NanoAlb</i> , që shtrinë veprimtarinë e vet në <i>laboratorët e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, laboratorin e Fizikës në Universitetin Politeknik të Tiranës dhe universitete në Kosovë</i> , referuar të dhënave vendosur në dispozicion rezultojnë se janë 5 projekte, për periudhën 2022-2023 të cilët kanë mbajtur statusin në proces, me vlerë totale të shpenzimeve deri në fund të vitit 2023 prej 9,048,239 lekë. - Në njërin prej laboratorëve të FSHN (zj. L.V) u konstatua prania e 10 nga 17 materialet e specifikuar në kartelën personale të personit (inventar i imët) që i kishte në ngarkim dhe pjesa tjetër rezultoi se mbahej në ambiente private jashtë ambienteve laboratorike të FSHN (7 me vlerë totale prej 373,200 lekë referuar kartelës personale vendosur në dispozicion) prej një tjetër personi (informacion ky i padisponuar për sektorin e financës dhe magazinën e ASHSH).
Kriteri:	- Udhëzimi nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në NjSP”, - Kartelat e inventarit rast pas rasti; - Statuti i ASH miratuar me Vendim të Asamblesë së ASH nr.22 datë 18.10.2019, - Vendimet e Asamblesë dhe Kryesisë rast pas rasti.
Ndikimi/Efekti:	Dëm ekonomik në buxhetin e shtetit.
Shkaku:	Mungesë e argumentimit ku janë përcaktuar shkaqet, arsyet, përgjegjësitë ligjore dhe financiare.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

Rekomandimi:	Akademia e Shkencave të vlerësojë dhe analizojë vlerën prej 373,200 lekë e cila rezulton e paargumentuar, ku të përcaktohen shkaqet, arsyet, përgjegjësitë ligjore dhe financiare. Të ndiqen të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës nga personat përfitues.
Rëndësia:	E lartë
Afati zbatimit:	Menjëherë dhe në vijimësi.

Titulli i Gjetjes 18:	<i>Mungesë e gjurmës së kryerjes së përzgjedhjes së personave të kontraktuar me kohë të pjesshme për efekt studimi.</i>
Situata:	<p>Nga auditimi mbi raportet e dërguara në ASHSH nga ana e ekipit të punës mbi projektin “<i>Studimi sero-epidemiologjik i Gjendjes imunitare ndaj virusit SARS-CoV-2 në popullatën shqiptare</i>”, <u>përfunduar</u> të 4 fazat e studimit me kosto totale prej 24,163,492 lekë, u konstatua se:</p> <ul style="list-style-type: none">- për studimin pilot mostrat e analizuara janë ato të marra nga Banka Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut, rrjedhimisht kjo sjell mospërputhje mes objektivit të kryerjes së studimit për të cilin janë blerë materiale për testimin e gjakut;- mungon gjurma e kryerjes së përzgjedhjes së personave të kontraktuar me kohë të pjesshme për efekt studimi, ku vlera financiare e akorduar për këtë qëllim rezulton në 490,000 lekë;- mungon gjurma e dokumentimit të trajnimeve të kryera për çdo infermiere për marrje gjaku në çdo qendër. <p><i>Në kushtet e mungesës së dokumentacionit justifikues bazë dhe të domosdoshëm të kryerjes së pagesës nga Akademia e Shkencave drejt stafit mjekësor të përfshirë në projekt, vlera prej 490,000 lekë, përbën dëm ekonomik.</i></p>
Kriteri:	<ul style="list-style-type: none">- Udhëzimi nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në NjSP”- Dosja e projektit- Statuti i ASH miratuar me Vendim të Asamblesë së ASH nr.22 datë 18.10.2019- Vendimet e Asamblesë dhe Kryesisë rast pas rasti.
Ndikimi/Efekti:	Dëm ekonomik në buxhetin e shtetit.
Shkaku:	Mungesë e dokumentacionit justifikues bazë dhe të domosdoshëm të kryerjes së pagesës nga Akademia e Shkencave drejt stafit mjekësor të përfshirë në projekt.
Rekomandimi:	Akademia e Shkencave të vlerësojë dhe analizojë vlerën 490,000 lekë e cila rezulton e paargumentuar, ku të përcaktohen shkaqet, arsyet, përgjegjësitë ligjore dhe financiare. Të ndiqen të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës nga personat përfitues.
Rëndësia:	E lartë
Afati zbatimit:	Menjëherë dhe në vijimësi.

**4. Mbi administrimin e pronës shtetërore. Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare:****a. Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve monetare të kryera.**

Janë mar me zgjedhje disa veprime me arkën, për vitin 2021 qershor, gusht, tetor, për vitin 2022 maj, korrik, gusht, nëntor, për vitin 2023:

Në përgjithësi veprimet e kryera me arkën kanë numër rendor rritës dhe vijues me data e kryera, bashkëlidhur kanë dokumentacionin justifikues. U audituan me zgjedhje veprimet e kryera me arkën dhe u konstatuan mangësitë si më poshtë:

Nga auditimi u konstatua se:

Qershor 2021

Mandat pagesa nr. 9, datë 14.06.2021 është kryer pagesa prej 490 euro ndaj B.H për mbulimin e shpenzimeve dietave për udhëtimin 9-11 qershor në Kosovë. Bashkëlidhur praktikës është Autorizimi, Ftesa edhe 4 Urdhër – Sherbimet përkatëse. Nga auditimi rezulton se vlerën e dietave i është paguar shoferit për të katër personat.

Mandat pagesa nr. 10, datë 02.06.2021 është kryer pagesa prej 14,025 lekë ndaj L.T, pagesë për lyerjen e godinës, bashkëlidhur janë memo e kërkesës për lyerje, pa datë, Aktmarrëveshje 26.05.2021 e lidhur midis Kancelarit dhe 3 punëmarrësve, Urdhër pagese pa nr. pa datë, Bordero pagese pa datë firmosur nga Kancelari dhe Shefe e finances dhe jo nga specialistja L.T.

Gusht 2021

Janë kryer 2 veprime për pagesë dietash jashtë vendit.

Tetor 2021**Arka lekë**

Mandat arkëtimi nr. 11, datë 22.10.2021, është arkëtuar vlera 10,000 lekë për qera salle për aktivitetin e zhvilluar në datën 10 shtator 2021. (gati 2 muaj më vonë) në kundërshtim me pikën 64 të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, konkretisht:

“Veprimet me para në dorë kryhen për transaksionet financiare në formën e paradhënies për udhëtime e dieta, gjithashtu edhe për arkëtimin e të ardhurave në vlera më të vogla se 1000 leke.”

Arka USD

Mandat pagesa nr.1, datë 13.10.2021 është kryer pagesa prej 525 USD ndaj akademikut të jashtëm për rimbursim bilete për ardhjen nga SHBA për pjesëmarrjen në aktivitetin e organizuar nga akademja, bashkëlidhur praktikës Urdhri i brendshëm nr. 544/2, datë 08.10.2021 “Për rimbursim bilete”, Autorizim kryerje shpenzimi pa nr, pa datë, Programi i aktivitetit nr. 544, datë 18.08.2021 dhe bileta.

Maj 2022

Mandat pagesa nr. 17 – 18, datë 10.05.2022 janë dhënë parapagim ndaj E.P dhe Sh.S në vlerat 1697 euro dhe 280 euro, për pjesëmarrje në aktivitete jashtë vendit, për këtë veprim nuk ka autorizim nga nëpunësi autorizues. Pas kthimit nga shërbimi janë plotësuar dokumentat justifikuese. Nga auditimi rezulton se E.P ka pasur shpenzime 510 euro dhe duhet të kthente në arkë 1187 euro, por me mandat arkëtimin nr.4, datë 16.05.2022 ka kthyer 867 euro (ose 320 euro



më pak). Ndërkohë shpenzimet e Sh.S kanë qenë 722 euro nga të cilat ka marrë paradhënie 280 euro dhe me Mandat pagesën nr. 19, datë 16.05.2022 i është paguar 122 euro (ose 320 euro me pak).

Mandat pagesat 20-22, datë 20.05.2022 janë dhënë paradhënie respektivisht 240 euro, 200 euro dhe 432 euro pa autorizimin e nepunesit autorizues. Nga auditimi i dokumentacionit jositifikues të praktikës së shërbimit konstatohet se në urdhër – shërbimin rezulton se paradhënia ka qenë 500 euro dhe për të kthyer 67 euro.

Mandat pagesat 23-24, datë 26.05.2022 janë dhënë paradhënie nga 50 euro pa autorizimin e nepunesit autorizues dhe bashkëlidhur urdhërshërbimi që sipas të cilin rezulton se nuk është dhënë paradhënie dhe duhet të marrë rimbursim shpenzimesh.

Mandat pagesat 27, datë 30.05.2022 janë dhënë paradhënie 50 euro pa autorizimin e nepunesit autorizues dhe bashkëlidhur urdhërshërbimi që sipas të cilin rezulton se nuk është dhënë paradhënie dhe duhet të marrë rimbursim shpenzimesh.

Mandat pagesat 26, datë 27.05.2022 janë dhënë paradhënie 80 euro pa autorizimin e nepunesit autorizues dhe bashkëlidhur urdhërshërbimi që sipas të cilin rezulton se nuk është dhënë paradhënie dhe duhet të marrë rimbursim shpenzimesh.

Korrik 2022

Kryer 1 pagesë për dieta.

Gusht 2022

Mandat pagesat 38, datë 27.05.2022 janë dhënë paradhënie 80 euro pa autorizimin e nepunesit autorizues.

Nëntor 2022

Mandat pagesat 67, datë 22.11.2022 janë dhënë paradhënie 300 euro pa autorizimin e nepunesit autorizues.

Mandat pagesat 68-69, pagesë rimbursim biletash për akademik të ftuar në total 1165 euro.

Shkurt 2023

Mandat pagesat 6, datë 28.02.2023 janë dhënë paradhënie 180 euro pa autorizimin e nepunesit autorizues për udhëtim e akademikut Asc. S.C.

Qershor 2023

Mandat pagesat 48, datë 21.06.2023 janë dhënë paradhënie 200 euro pa autorizimin e nepunesit autorizues.

Mandat pagesat 49, datë 21.06.2023 pagesë rimbursim biletash për akademik të ftuar në total 400 euro.

Gusht 2023

Mandat pagesat 57, datë 14.08.2023 janë dhënë paradhënie 150 euro pa autorizimin e nepunesit autorizues.

Si përfundim:



- Në të gjitha rastet është dhënë paradhënie për punonjësit e dërguar me shërbim jashtë vendit pa urdhërin e nëpunësit autorizues.
- Bashkëlidhur praktikave programe aktivitetesh pa data, pa nr. protokolli dhe të pa plotësuar mbi kostot e tyre apo edhe datat e aktiviteteve.
- Në asnjë rast nuk ka relacion mbi aktivitetin që është kryer.
- Janë kryer rimbursim biletash avioni për akademikë të ftuar kur vet akademia zhvillon procedura prokurimi për blerje biletash.
- Nuk ka dokumenta justifikimi bashkëlidhur për çdo mandat pagesë dhe mandat arkëtim por janë lidhur bashkë për një aktivitet.
- Janë kryer veprime arktimi mbi limit 1,000 lekë.
- Urdhërshërbimet të pa rakorduara pasi janë tërhequr vlerat monetare nga 1 person.
- Nga kryqëzimi të dhënave me pasqyrat financiare u konstatua mungesë e gjurmës së paraqitjes së paradhënies. Nuk kryhet veprimi i kthimit të paradhënies pas kthimit nga aktiviteti.

Veprimet e mësipërme në udhëzim nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, konkretisht:

Veprimet që kryejnë strukturat e Nepunesit Zbatues:

52. Strukturat e Nepunesit Zbatues para marrjes në dorezim të dokumentave nga personat me përgjegjesi materiale, kryejnë kontrollin paraprak të tyre. Ky kontroll përfshin kontrollin e rregullshmërisë së jashtme, kontrollin nga pikpamja e zbatimit të ligjshmërisë dhe kontrollin e saktësisë së veprimeve aritmetike.

“Dokumentimi i vlerave monetare dhe letrave me vlere

62. Veprim arke është shërbimi i arkëtimit dhe i pagesës me para në dorë që bëhet në të gjitha nivelet e njesise publike, në bazë të mandatarkëtimit ose të mandatpagesës.

63. Veprimet me para ne dore kryhen vetem brenda limitit ditor te arkes, te miratuar nga Nepunesi i Pare Autorizues me propozim te Sistemit te Thesarit, me akte te vecanta sipas specifikave te njesive publike.

64. Veprimet me para ne dore kryhen per transaksionet financiare ne formen e paradhenies per udhetime e dieta, gjithashtu edhe per arketimin e te ardhurave ne vlera me te vogla se 1000 leke.

66. Paradhenia shlyhet menjëherë pas mbarimit të afatit të caktuar nga Nepunesi Zbatues, duke paraqitur dokumente justifikuese për shpenzimet e kryera tek Nepuensi Zbaties ose i deleguari i tij. Kur paradhënia nuk shlyhet në afatin e caktuar, bëhet menjëherë ndalimi nga paga e punonjesit. Paradhënia tjetër nuk jepet pa u shlyer ajo që është dhënë më parë.

67. Për veprimet e arkës mbahen llogari kontabile te arkes nga sektori i finances dhe libër arke nga punonjesi i caktuar me përgjegjesine e levizjes se vlerave monetare.

68. Dokumentet e arkës shqyrtohen, kontrollohen dhe nënshkruhen nga personat e poshtëshënuar: a. mandatarkëtimi nënshkruhet nga personi përgjegjes per vlerat monetare, nga punonjesi qe kryen derdhjen dhe nga nepunesi zbatues ose i deleguari i tij; b. mandatpagesa nënshkruhet nga nepunesi zbatues ose i deleguari i tij, nga marrësi i parave dhe nga personi përgjegjes per levizjen e vlerave monetare. c. Nepunesi Autorizues ose i deleguari i tij, nënshkruan mandatpagesën kur nuk ka një dokument tjetër urdhërues të nënshkruar prej tij.

**Veprime me bankën**

Me Urdhër Shpenzimin nr. 504 datë 01.12.2021 është kryer pagesa prej 400,000 lekë ndaj J.P, për konsulencë topografike, bashkëlidhur pagesës:

- Autorizim shpenzimi, pa nr. Prot., pa datë, i kancelarit
- Kontratë shërbimi nr. 489/5, datë 30.09.2021 e lidhur midis Akademisë Shkencave me prfaqses Prof. Dr. N.C dhe J.P.
- Preventivi i shpenzimeve pa datë, pa nr. Prot.
- Procesverbal negociimi pa datë. Pa nr. Protokolli, dhe pjesërisht i pa plotësuar.
- Fatura tatimore.

Me Urdhër Shpenzimin nr. 518, datë 02.12.2021 është kryer pagesa prej 29,750 lekë ndaj z. I.Y, pagesë honorari.

Me Urdhër Shpenzimin nr. 519, datë 03.12.2021 është kryer pagesa prej 61,710 lekë ndaj M.V, K.Xh, bashkëlidhur nuk ka asnjë dokumentacion mbi dokumentimin e punës së kryer.

Me Urdhër Shpenzimin nr. 521, datë 02.12.2021 është kryer pagesa prej 24,429 lekë ndaj O.C, bashkëlidhur nuk ka asnjë dokumentacion mbi dokumentimin e punës së kryer.

(Dokumentacioni u vendos në dispozicion vetëm për vitin 2022)

Me Urdhër Shpenzimin nr. 524, datë 02.12.2021 është kryer pagesa prej 84,000 lekë ndaj “F” shpk, bashkëlidhur pagesës:

- Autorizim shpenzimi, pa nr. prot., pa datë, i kancelarit (pushim kafeje, koktejl)
- Fatura bashkëlidhur
- Plani i organizimit të konferencës

Me Urdhër Shpenzimin nr. 528, datë 03.12.2021 është kryer pagesa prej 29,750 lekë ndaj V.Xh, bashkëlidhur listë prezenca për punonjësën G.V.

Me Urdhër Shpenzimet nr. 533, 534, 536, 537 datë 07.12.2021 është kryer pagesa ndaj “G” shpk në vlerat 83,750 lekë, 73,125 lekë, 273,125 lekë, 40,625 lekë për shpenzime pritje + akomodim, bashkë lidhur pagesës, Autorizimi i Shpenzimit, Urdhri nr. 56, datë 03.11.2021 “Për ngritjen e grupit të punës për përgatitjet e kuvendit ndërkombëtar të studimeve albanologjike”, bashkëlidhur nuk ka asnjë dokument që verteton se kush u akomodua në hotel edhe zhvillimin e aktivitetit.

Me Urdhër Shpenzimit nr. 540, datë 07.12.2021 është kryer pagesa ndaj “The P.” shpk në vlerën 4,037,578 lekë, Autorizimi i Shpenzimit, Urdhri nr. 56, datë 03.11.2021 “Për ngritjen e grupit të punës për përgatitjet e kuvendit ndërkombëtar të studimeve albanologjike”, bashkëlidhur nuk ka asnjë dokument që verteton se kush u akomodua në hotel edhe zhvillimin e aktivitetit.

Me Urdhër Shpenzimin nr. 549, datë 09.12.2021 është kryer pagesa prej 57,000 lekë ndaj E.C për akomodimin në hotel të S.M, bashkëlidhur pagesës vetëm autorizim shpenzimi dhe fatura.

Me Urdhër Shpenzimin nr. 550, datë 09.12.2021 është kryer pagesa prej 57,000 lekë ndaj E.C për akomodimin në hotel të N.C, bashkëlidhur pagesës vetëm autorizim shpenzimi dhe fatura.

Me Urdhër Shpenzimin nr. 312 – 316, datë 19.07.2022 janë kryer pagesat honorare në vlerat 69,275 lekë, 14,025 lekë, 252,450 lekë, 79,475 lekë, 71,994 lekë, bashkëlidhur pagesave është dokumentacioni justifikues të zhvillimit të veprimtarisë së komisioneve përkatëse.

Veprimet e mësipërme në Udhëzim nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, konkretisht:

**Veprimet që kryejnë strukturat e Nepunesit Zbatues:**

52. Strukturat e Nepunesit Zbatues para marrjes në dorezim të dokumentave nga personat me përgjegjësi materiale, kryejnë kontrollin paraprak të tyre. Ky kontroll përfshin kontrollin e rregullshmërisë së jashtme, kontrollin nga pikpamja e zbatimit të ligjshmërisë dhe kontrollin e saktësisë së veprimeve aritmetike.

“Dokumentimi i vlerave monetare dhe letrave me vlerë

62. Veprim arke është shërbimi i arkëtimit dhe i pagesës me para në dorë që bëhet në të gjitha nivelet e njesive publike, në bazë të mandatarkëtimit ose të mandatpagesës.

63. Veprimet me para në dorë kryhen vetëm brenda limitit ditor të arkës, të miratuar nga Nepunesi i Pare Autorizues me propozim të Sistemit të Thesarit, me akte të vecanta sipas specifikave të njesive publike.

64. Veprimet me para në dorë kryhen për transaksionet financiare në formën e paradhenies për udhetime të dieta, gjithashtu edhe për arketimin e të ardhurave në vlera me të vogla se 1000 leke.

66. Paradhenia shlyhet menjëherë pas mbarimit të afatit të caktuar nga Nepunesi Zbatues, duke paraqitur dokumente justifikuese për shpenzimet e kryera tek Nepunesi Zbatues ose i deleguari i tij. Kur paradhenia nuk shlyhet në afatin e caktuar, bëhet menjëherë ndalimi nga paga e punonjesit. Paradhenia tjetër nuk jepet pa u shlyer ajo që është dhënë më parë.

67. Për veprimet e arkës mbahen llogari kontabile të arkës nga sektori i financës dhe libër arke nga punonjesi i caktuar me përgjegjësinë e levizjes së vlerave monetare.

68. Dokumentet e arkës shqyrtohen, kontrollohen dhe nënshkruhen nga personat e poshtëshënuar:
a. mandatarkëtimi nënshkruhet nga personi përgjegjës për vlerat monetare, nga punonjesi që kryen derdhjen dhe nga nepunesi zbatues ose i deleguari i tij; b. mandatpagesa nënshkruhet nga nepunesi zbatues ose i deleguari i tij, nga marrësi i parave dhe nga personi përgjegjës për levizjen e vlerave monetare. c. Nepunesi Autorizues ose i deleguari i tij, nënshkruan mandatpagesën kur nuk ka një dokument tjetër urdhëruar të nënshkruar prej tij.

Titulli i Gjetjes:	Parregullsi në lidhje me veprimet me arkën
Situata:	<p>Nga auditimi i veprimeve me arkën u konstatuan parregullsitë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none">-Në të gjitha rastet është dhënë paradhenia për shërbime-dieta pa autorizimin e nëpunësit autorizues.-Bashkëlidhur praktikave programe aktivitetesh pa data, pa nr. protokollit dhe të pa plotësuar mbi kostot e tyre apo edhe datat e aktiviteteve.-Në asnjë rast nuk ka relacion mbi aktivitetin që është kryer.-Janë kryer rimbursime biletash avioni për akademikë të ftuar kur vetë Akademia zhvillon procedura prokurimi për blerje biletash (1565 euro dhe 525 usd), vlerë e cila përbën shpenzim jo efektiv të buxhetit të shtetit, pasi nuk janë përdorur fondet me ekonomikitet.-Nuk ka dokumente justifikimi bashkëlidhur për çdo mandat pagesë dhe mandat arkëtim por janë lidhur bashkë për një aktivitet.-Arkëtim 10,000 leke nga arka.-Urdhërshërbimet të pa rakorduara.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

	<p>Nga rakordimi i të dhënave me pasqyrat financiare u konstatua mungesë e gjurmës së paraqitjes së paradhënies. Nuk kryhet veprimi i kthimit të paradhënies pas kthimit nga aktiviteti.</p> <p>Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikat 52-72 të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe përbëjnë shpenzim jo efektiv.</p>
Kriteri:	<p><i>Veprimet që kryejnë strukturat e Nepunesit Zbatues:</i></p> <p><i>52. Strukturat e Nepunesit Zbatues para marrjes në dorezim të dokumentave nga personat me përgjegjesi materiale, kryejnë kontrollin paraprak të tyre. Ky kontroll përfshin kontrollin e rregullshmërisë së jashtme, kontrollin nga pikpamja e zbatimit të ligjshmërisë dhe kontrollin e saktësisë së veprimeve aritmetike.</i></p> <p><i>“Dokumentimi i vlerave monetare dhe letrave me vlerë</i></p> <p><i>62. Veprim arke është shërbimi i arkëtimit dhe i pagesës me para në dorë që bëhet në të gjitha nivelet e njesise publike, në bazë të mandatarkëtimit ose të mandatpagesës.</i></p> <p><i>63. Veprimet me para në dorë kryhen vetëm brenda limitit ditor të arkës, të miratuar nga Nepunesi i Pare Autorizues me propozim të Sistemit të Thesarit, me akte të vecanta sipas specifikave të njesive publike.</i></p> <p><i>64. Veprimet me para në dorë kryhen për transaksionet financiare në formën e paradhënies për udhetime e dieta, gjithashtu edhe për arketimin e të ardhurave në vlera me të vogla se 1000 leke.</i></p> <p><i>66. Paradhënia shlyhet menjëherë pas mbarimit të afatit të caktuar nga Nepunesi Zbatues, duke paraqitur dokumente justifikuese për shpenzimet e kryera tek Nepuensi Zbatues ose i 12 deleguari i tij. Kur paradhënia nuk shlyhet në afatin e caktuar, bëhet menjëherë ndalimi nga paga e punonjesit. Paradhënia tjetër nuk jepet pa u shlyer ajo që është dhënë më parë.</i></p> <p><i>67. Për veprimet e arkës mbahen llogari kontabile të arkës nga sektori i finances dhe libër arke nga punonjesi i caktuar me përgjegjesinë e levizjes së vlerave monetare.</i></p> <p><i>68. Dokumentet e arkës shqyrtohen, kontrollohen dhe nënshkruhen nga personat e poshtëshënuar: a. mandatarkëtimi nënshkruhet nga personi përgjegjës për vlerat monetare, nga punonjesi që kryen derdhjen dhe nga nepunesi zbatues ose i deleguari i tij; b. mandatpagesa nënshkruhet nga nepunesi zbatues ose i deleguari i tij, nga marrësi i parave dhe nga personi përgjegjës për levizjen e vlerave monetare. c. Nepunesi Autorizues ose i deleguari i tij, nënshkruan mandatpagesën kur nuk ka një dokument tjetër urdhëruar të nënshkruar prej tij.</i></p>
Ndikimi/Efekti:	Urdhërshpenzime të pa rakorduara, pa dokumentacion të plotë.
Shkaku:	Praktika jo të plota
Rekomandimi:	Akademia e Shkencave të marrë masa për analizimin e veprimeve financiare të kryera me arkën si dhe plotësimin e saktë dhe të plotë të dokumentacionit justifikues për çdo veprim të kryer me arkën, minimizimin e arkëtimeve që kryen dhe respektimin e limitit, mos kryerjen e rimbursimeve për biletat e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

	avionit për akademikët e ftuar por blerjen e tyre nga vetë Akademia nëpërmjet procedurave të prokurimit. Akademia e Shkencave të marrë masa për plotësimin e një dokumentacioni të plotë, justifikues për çdo shërbim jashtë vendit, si dhe kthimin e paradhënies konform ligjit.
Rëndësia:	E mesme
Afati zbatimit:	Menjëherë

Titulli i gjetjes	Parregullsi në lidhje me dokumentacionin justifikues në veprimet me bankën.
Situata:	Nga auditimi me zgjedhje i praktikave të pagesave me bankë u konstatuan mangësi në lidhje me dokumentacionin justifikues bashkëlidhur pagesave, konkretisht: -Pagesa e koordinatorëve të projekteve pa relacionin e punës së kryer (3 koordinator dhe pagesa mujore për të tre dhe periudhën objekt auditimi 1,901,892 lekë), në kundërshtim me pikën 3 të nenit 5 të kontratave respektive të punës “Ofertuesi i shërbimit duhet të raportojë për shërbimin e kryer në përfundim të afatit të kontratës”. -Pagesa për konsulencë topografike me dokumentacion jo të plotë dhe pa procedurë prokurimi në vlerën 400,000 lekë . -Kryerja e pagesave për akomodim në hotel pa specifikuar dhe identifikuar personat e akomoduar. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikat 52-72 të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.
Kriteri:	Udhëzim nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.
Ndikimi/Efekti:	Dokumentacion jo i plotë justifikues.
Shkaku:	Amulli në administrimin e dokumentacionit.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandime:	Akademia e Shkencave të vlerësojë dhe analizojë vlerën 2,301,892 lekë e cila rezulton e paargumentuar, ku të përcaktohen shkaqet, arsyet, përgjegjësitë ligjore dhe financiare. Të ndiqen të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës nga personat përfitues.
Afati:	Menjëherë dhe në vijimësi.

Observacion i paraqitur nga ana e subjektit me shkresën nr. 886/35, datë 29.03.2024, protokolluar në KLSH me nr. 959/6, datë 02.04.2024

Ku pretendoni se:

Me krijimin e qendrës u caktuan edhe 2 bashkëkoordinatorë me të cilët Akademia e Shkencave ka nënshkruar kontratat respektive me kohë të pjesshme sipas kohëzgjatjes së veprimtarisë së njësisë dhe buxhetit të akorduar për këtë njësi. Koordinatorët e NanoAlb nuk janë thjesht



koordinatorë, por janë anëtarë të njësisë e pagesa e tyre është përcaktuar në aktin e krijimit të njësisë sic e kërkon dhe autorizon ligji 53/2019, neni 19.

Raportimi i tyre është konform kontratës që siç citohet edhe nga vetë kontrolli “*..ata duhet të raportojnë në mbyllje të kontratës*”, e jo çdo muaj, çka është bërë.

Ndërkohë veprimtaria e njësisë NanoAlb nuk verifikohet nga financat por nga Asambleja, seksionet e kryesia dhe siç del nga vetë ky pr/raport i auditimit, raportimi i veprimtarive të NanoAlb përbëjnë pjesë të rëndësishme të raportit vjetor të Akademisë për tërë periudhën, **e në këto kushte nuk ka asnjë bazë rekomandimi për dëmshpërblim.**

Tre Koordinatorët për të cilët flitet në gjetjen e mësipërme, janë punonjës (me kohë të pjesshme) ku 2 prej tyre i përkasin Qendrës kërkimore NanoAlb dhe 1 (një) i përket Institutit të Fizikës (virtual). Siç u shpjegua dhe më sipër 2 (dy) kërkuesit e NanoAlb janë anëtarë të njësisë kërkimore dhe aktualisht kryejnë dhe detyrën e koordinorit krahas asaj të kërkuesit, ndërsa Koordinatori i Institutit të Fizikës kryen të njëjtën detyrë, atë të Koordinatorit.

Po kështu dhe koordinatori i Institutit të Fizikës, organizon, ndjek e zbaton çdo veprimtari që zhvillon ky institut.

Përbërja zgjedhja/rekrutimi i drejtuesve dhe anëtarëve të tyre si dhe e personelit ndihmës, përcaktohen e vendosen me vendim të Kryesisë e Asamblesë, në përputhje me ligjin 53/2019 “Për Akademinë e Shkencave të Shqipërisë”, me Statutin e Akademisë së Shkencave dhe me aktet e veçanta miratuar në zbatim të tyre. Referuar parashikimeve në rregulloren e brendshme administrative të ASH-së, marrja në punë e tyre dhe nënshkrimi i këtyre kontratave (*kopje të të cilave ju i keni*) është bazuar në nenet 66, pika 3 dhe 67, pika 3 të kësaj rregulloreje.

Të tre koordinatorët janë paguar për punën e bërë me kohë të pjesshme, në bazë të kontratave përkatëse, raportet e punës vjetore e mujore, pagesë e cila jepet bazuar në vendimet e kryesisë, e drejtë që ja jep ligji nr.59/2019 “Për Akademinë e Shkencave të Shqipërisë”, neni 19 dhe Statuti i saj.

Në protokollin e ASH janë të dokumentuara raportimet vjetore pranë Seksioneve shkencore të Akademisë së Shkencave:

- Raportim i periudhës 01.01.2020-31.12.2020, nr. Prot 7., datë 06.01.2021
- Raportim i periudhës 01.01.2021-31.12.2021, nr. Prot. 7, datë 07.01.2022
- Raportim i periudhës 01.01.2022-31.12.2022, nr. Prot. 14, datë 09.01.2023
- Raportim i periudhës 01.01.2023-31.12.2023, nr. Prot. 341, datë 08.03.2024

➤ Për studime të fushës arkeologjike, në mënyrë specifike për vrojtme gjeofizike në ndihmë të tyre, me qëllim vijimin e punës së këtij projekti i cili do të kishte impakt të gjerë në vendin tonë lidhur me të dhënat arkeologjike, u kërkua nga njësia kërkimore-studimore “Arkeo-Bylis”, konsulenca topografike për prospeksionin gjeofizik të një sipërfaqe prej 4000 m² në tarracën veriperëndimore të agorasë, ku kërkohet tempulli i Augustit.

Gjithashtu theksojmë se për studime të tilla të veçanta shkencore që kërkojnë teknologji të nivelit të lartë procedura prokurimi bën përjashtim. Referuar ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, specifikisht neni 7, “**Përjashtimet e veçanta**”, **përcaktohet në pikën 1, germa ë): “Shërbimet e kërkimit dhe zhvillimit, rezultatet e të cilave shfrytëzohen nga të gjithë, përveç rasteve kur përfitimet i shkojnë vetëm autoritetit ose entit kontraktor për përdorimin prej tij për çështjet e brendshme dhe me kusht që shërbimi i kryer të paguhet plotësisht nga ky autoritet ose ent kontraktor”.**



Nisur nga rëndësia shkencore e studimit gjeofizik, sipërcituar, shërbimi i kryer për këtë kërkim, ka patur rezultate të cilat shfrytëzohen nga të gjithë. Këto rezultate janë bërë publike në rang kombëtar duke bërë të mundur ***zbulimin që në ditën e parë të punës ku u gjet një mbishkrim i shek. III p. Kr. që përmban emrat e zyrtarëve kryesorë të Bylisit, Prytanyukin dhe Strategun, dhe më pas me zbulimin e shkallares së tempullit të Augustit.***

Duke qenë se dr. J.P, si person fizik me numër identifikimi (NUIS) L61511022E ofronte shërbime të konsulencës në punime topografike gjeologjike minerare dhe në fushën studimore në Shqipëri dhe se bashkëpunëtorët e tij janë disa nga inxhinieret gjeofizike më të shquar në Shqipëri dhe në rang ndërkombëtar, të cilët kanë një eksperiencë shumë-dekadëshe në vrojtimet e studimet gjeofizike, e në veçanti në ato elektrometrike në kërkimin e mineraleve të dobishme, ne gjeologji inxhinierike, hidrogeologji, arkeologji, problemet e ndotjes dhe ruajtjes së mjedisit, gjeofiziken inxhinierike, etj., u vijua me nënshkrimin e kontratës për realizimin e këtij shërbimi. Grupi gjeofizik ishte i pajisur me aparatura të veçanta elektrometrike të prodhuara në Francë e Kanada, të cilat nevojiten për kryerjen e vrojtimeve në ndihmë të arkeologjisë. Po kështu, ky grup përdor një metodikë unike të vrojtimet, e cila është regjistruar në Kanada si markë e regjistruar me emrin “RM”. Për sa i përket programeve të përpunimit të vrojtimeve gjeofizike, grupi ka në përdorim software-in “O.M” prodhuar nga kompania Kanadeze G, i cili është më i avancuari sot në botë në fushën e gjeofizikes jo-hidrokarbure. Puna e grupit gjeofizik u mbështet me punime topografike të cilësisë së lartë, si rievime të sipërfaqeve të objekteve arkeologjike me rezolucion të detajuar me dron (1.5 – 2.5 cm), trasime / piketime profilash e lidhje gjeodezike me precision të lartë etj.

Për sa i përket kostove të punimeve gjeofizike e topografike të kryera në Parkun Arkeologjik të Bylisit, duhet thënë se ato kanë qenë disa herë më të ulëta se sa kostot respektive të kompanive të huaja që mund të angazhoheshin në këto studime.

Ndodhur në këto kushte u lidh kontrata me këtë person fizik, për kryerjen e studimit shkencor vrojtime gjeofizike në ndihmë të studimeve arkeologjike.

Verifikimet e studimeve gjeofizike të viteve 2021 e 2022 kanë treguar një efektivitet mjaft të lartë zbulimi të objekteve arkeologjike në Parkun Arkeologjik të Bylisit, të cilat janë kryer në bashkëpunimin e ngushtë midis specialistëve gjeofizikë dhe arkeologëve të njohur të vendit tonë.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Për sa i përket pagesës së koordinatorëve ju sqarojmë se është e vërtetë që janë të punësuar sipas Statutit por marrëdhënia me ta rregullohet sipas një kontrate pune dhe nuk janë përmbushur detyrimet kontraktuale. Merret parasysh vetëm për O.C vetëm për një vit për vlerën 293,148 lekë. Raportet e tjera që përmenden në observacionin tuaj nuk u vendosën në dispozicion.

Për sa i përket shërbimit topografik që nuk është prokuruar arsyetimi juaj nuk është i bazuar ligjërisht.

Për sa më sipër observacioni pranohet pjesërisht.

Blerjet me vlera të vogla

Për komisionet e prokurimit

Me Urdhrin nr. 6, datë 03.02.2021 “Për krijimin e komisionit të prokurimit me vlera të vogla” është ngritur komisioni i përbërë nga:



1. V.Xh, Kryetar (Përgjegjëse e Sektorit të Financës)
2. E.M, Anëtar
3. A.B, Anëtar

Me Urdhrin nr. 55, datë 21.09.2021 “Një ndryshim në komisionin e prokurimit me vlera të vogla”:

1. V.Xh zvendësohet nga O.Ç (Përgjegjëse e Sektorit të Financës)

Me Urdhrin nr. 104/2, datë 30.12.2021 “Mbi zgjatjen e afatit për komisionin e blerjeve të vogla” ka vijuar punën komisioni.

Nga auditimi konstatohet se për periudhën 30.12.2021 deri në ngritjen e komisionit të ri për prokurimet me vlera të vogla datë 16.02.2022, komisioni ka funksionuar me dy anëtarë pasi O.Ç (Përgjegjëse e Sektorit të Financës) është larguar nga detyra me dorëheqje më datë 31.12.2021 dhe komisioni ka qenë me dy anëtarë.

Nga auditimi i praktikave të blerjeve me vlera të vogla për këtë periudhë konstatohet se në 3 raste O.Ç ka vazhduar dhe ka hyrë në sistem dhe ka kryer 3 procedura prokurimi me vlera të vogla me gjithë etapat e tyre në sistemin e APP edhe pasi është larguar nga detyra dhe ka shkëputur marrëdhëniet financiare me Akademinë e Shkencave më datë 31.12.2021 sipas shkresës nr. 780/1, datë 31.12.2021 “Ndërprejten e marrëdhënieve të punës për shkak të dorëheqjes” në kundërshtim me me Neni 12 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues” të ligjit nr. 10 296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Vendimin nr. 16 datë 24.03.2022 “Për miratimin e rregullores së brendshme administrative të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë neni 44 “Specialist për Financë” pika b. Këto procedura janë:

1. Shtypje materialesh promovuese, procedurë e zhvilluar në 26.01.2022.
2. Printime materialesh, procedurë e zhvilluar 04.02.2022.
3. Siguracion pasurie për ASHSH, procedurë e zhvilluar në 07.02.2022.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi R.K (Kancelar) dhe O.Ç.

Me Urdhrin nr. 4, datë 16.02.2022 “Për krijimin e komisionit të prokurimit me vlera të vogla” është ngritur komisioni i përbër nga:

1. A.B, Kryetar
2. V.V, Anëtar
3. E.M, Anëtar

Me Urdhrin nr. 6, datë 23.01.2023 “Për krijimin e komisionit të prokurimit me vlera të vogla” është ngritur komisioni i përbër nga:

1. A.B, Kryetar
2. E.M, Anëtar
3. V.V, Anëtar

Me Urdhrin nr. 22, datë 05.04.2023 “Për krijimin e komisionit të prokurimit me vlera të vogla” është ngritur komisioni i përbër nga:

1. M.M, Kryetar (Përgjegjëse e Sektorit të Financës)
2. E.M, Anëtar
3. V.V, Anëtar

Nga auditimi konstatohet se në tre raste në komisionin e prokurimit me vlera të vogla kryetar i komisionit është caktuar Përgjegjësi i Sektorit të Financës (Nëpunës Zbatues) në kundërshtim me



Neni 12 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues” të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, pasi nëpunësi zbatues është përgjegjës për kontrollin e dokumentacionit të pagesave. Nëpunësi Zbatues është përgjegjës për mbikëqyrjen e komponentëve të kontrollit dhe pranimin ose jo të dokumentacionit, bazuar në kontrollet pas faktit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi; h. mbajtjen e sistemit të kontabilitetit, raportimit për vendimmarrjen, në funksion të realizimit të objektivave, kontabilizimin e plotë, të saktë dhe në kohë të të gjitha transaksioneve, si dhe përgatitjen e pasqyrave financiare të njësisë, në përputhje me rregullat e miratuara nga Ministria e Financave. *Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi R.K (Kancelar), O.Ç, M.M.*

Për regjistrat e prokurimit (parashikim/realizim)

Për vitin 2021

Konstatimi 1: Me Shkresën nr. 49, datë 21.01.2021 “Dërgohet regjistri i parashikimit të prokurimeve për vitin 2021”, ku konstatohet se:

Janë parashikuar 19 procedura me blerje me vlera të vogla me fond limit total 8,016,000 lekë dhe me ndryshimet e regjistrat të parashikimeve janë 28 procedura me fond limit të parashikuar 11,406,000 lekë

Janë realizuar 63 procedura me fond realizimi 6,267,926 lekë.

Për vitin 2022

Konstatimi 2: Nga auditimi konstatohet se u vendos në dispozicion regjistri i parashikimit të blerjeve të vogla i pa miratuar.

Në këtë regjistër janë parashikuar 33 blerje me vlera të vogla me fond limit 9,938,900 lekë dhe me ndryshimet e regjistrat të parashikimeve janë 38 procedura me fond limit 10,538,900 lekë

Janë realizuar 63 procedura me fond realizimi 6,217,485 lekë.

Për vitin 2023

Konstatimi 3: Me Shkresën nr. 48, datë 23.01.2023 “Dërgohet regjistri i parashikimit të prokurimeve për vitin 2023”, ku konstatohet se:

Në këtë regjistër janë parashikuar 15 blerje me vlera të vogla me fond limit 6,358,700 lekë dhe me ndryshimet e regjistrat të parashikimeve janë 28 procedura me fond limit 10,522,730 lekë

Janë realizuar 58 procedura me fond realizimi 6,564,843 lekë.

Nuk ka një akt shkresor për miratimin e regjistrat të parashikimit për periudhën janar – prill 2021 në kundërshtim me nenin 4 të Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe pikat 3 ,4 të nenit 3 “Regjistri i parashikimeve të procedurave të prokurimit publik” të Vendimit Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” për periudhën vijuese.

Nuk kanë të dokumentuar procesin e mbledhjes së kërkesave nga sektorët përkatës për hartimin e regjistrat të parashikimit për periudhën janar – prill 2021 në kundërshtim me nenin 4 të Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe pikat 1 dhe 2 të nenit 3 “Regjistri i parashikimeve të procedurave të prokurimit” të Vendimit Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” për periudhën vijuese.



Nga verifikimi ne sistemin e APP për hedhjen në sistem të regjistrit rezulton se:

Për vitin 2021

Datë 14.01.2021 janë hedhur në sistem 15 procedura prokurimi

Datë 15.01.2021 janë hedhur në sistem 4 procedura prokurimi

Në total në muajin janar janë çelur në sistem dhe janë parashikuar 19 procedura

Për vitin 2022

Datë 19.01.2022 është hedhur në sistem 1 procedurë

Datë 25.01.2022 janë hedhur në sistem 17 procedura

Në total në muajin janar janë çelur në sistem dhe janë parashikuar 18 procedura

Për vitin 2023

Datë 12.01.2023 është hedhur në sistem 1 procedurë

Datë 13.01.2023 janë hedhur në sistem 4 procedura

Datë 16.01.2023 janë hedhur në sistem 5 procedura

Datë 17.01.2023 është hedhur në sistem 1 procedurë

Datë 18.01.2023 janë hedhur në sistem 2 procedura

Datë 30.01.2023 është hedhur në sistem 1 procedurë

Në total në muajin janar janë çelur në sistem dhe janë parashikuar 14 procedura

Nga auditimi rezulton se në sistemin e APP nuk është hedhur një regjistër fillestar parashikimi por janë hedhur në ditë të ndryshme dhe janë shtuar zërat më vonë në kundërshtim me nenin 4 të Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe pika 4 të nenit 3 “Regjistri i parashikimeve të procedurave të prokurimit publik” të Vendimit Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” për periudhën vijuese.

Për sa i përket modifikimit të regjistrit të parashikimeve konstatohet se ndryshimi bëhet rast pas rasti duke shtuar nga një procedurë prokurimi dhe është ndryshuar 13 herë për vitin 2021, 8 herë për vitin 2022 dhe 16 herë në vitin 2023 dhe në asnjë rast nuk ka një argumentim mbi këto ndryshime në rast se vijnë për arsye që nuk kanë qenë të mundura të parashikohen në kohën e hartimit të regjistrit dhe nuk një miratim nga titullari i autoritetit kontraktor për këto ndryshime nuk janë dërguar në Degën e Thesarit në kundërshtim me nenin 4 të Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe pikën 7 të nenit 3 “Regjistri i parashikimeve të procedurave të prokurimit publik” të Vendimit Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” për periudhën vijuese.

Nga auditimi i regjistrit të parashikimeve dhe ndryshimeve të tij u konstatua se regjistri i parashikimeve nuk hartohet duke bazuar në nevojat konkrete të institucionit duke pare se sa herë ndryshon brenda vitit si dhe përqindjet e realizimit për vitin 2021 realizimi 55%, për vitin 2022 realizimi 59% dhe 2023 realizimi 62.4%. Kur janë shtuar zëra të rinj ka disa raste që përsëriten të çka tregon që planifikimi nuk ka qenë bazuar në nevoja konkrete.

Për Blerjet e Vogla

Blerje materiale anticovid-19



Kjo procedurë nis me Procesverbalin mbi Argumentimin e Fondit limit nënshkruar nga L.T, B.Sh, S.P i cili nuk ka datë. Komisioni duke u bazuar në testimin e tregut dhe në bazë të prokurimeve të mëparshme pothuaj me të njëjtat parametra teknik për të marrë tregues për cmimet e këtij shërbimi duke përshkruar të gjitha ofertat përcaktoi fondin me vlerë 120,000 lekë. Prokurimet e mëparshme, ofertat nuk janë bashkëlidhur këtij procesverbali, ndaj përlllogaritja nuk mund të konsiderohet e dokumentuar. Kjo bie në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 për “Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 76, pika 2 “AK përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet”.

Më pas u nënshkrua nga Kancelari R.K Urdhri i Prokurimit nr. 14, datë 15.02.2021 për “Blerjet me Vlera të Vogla” me objekt “Blerje materiale mbrojtëse dhe desinfektuese për Covid-19”. Në këtë procedurë kërkohen 3000 copë masa kirurgjikale. Ndër të tjera specifikohet se afati i lëvrimit të mallrave do të jetë jo më vonë se 1 ditë kalendarike.

Në Ftesën për Ofertë specifikohet se data e zhvillimit do të jetë 17.02.2021, ora 10:00. Në datën 17.02.2021, printuar nga SPE gjendet klasifikimi përfundimtar, ku janë kualifikuar 47 operatorë dhe të skualifikuar janë 4 operatorë për shkak të ofertimit mbi fondin limit të parashikuar.

Blerje pajisje zyre

Kjo procedurë nis me Procesverbalin mbi Argumentimin e Fondit limit nënshkruar nga L.T, B.Sh, S.P i cili nuk ka datë. Komisioni duke u bazuar në testimin e tregut dhe në bazë të prokurimeve të mëparshme pothuaj me të njëjtat parametra teknik për të marrë tregues për cmimet e këtij shërbimi duke përshkruar të gjitha ofertat përcaktoi fondin me vlerë 16,000 lekë. Prokurimet e mëparshme, ofertat nuk janë bashkëlidhur këtij procesverbali, ndaj përlllogaritja nuk mund të konsiderohet e dokumentuar. Kjo bie në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 për “Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 76, pika 2 “AK përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet”.

Më pas u nënshkrua nga Kancelari R.K Urdhri i Prokurimit nr. 26, datë 12.05.2021 për “Blerjet me Vlera të Vogla” me objekt “Blerje fshese me korent (të re)”. Në këtë Urdhër ndër të tjera specifikohet se afati i lëvrimit të mallrave do të jetë jo më vonë se 1 ditë kalendarike.

Në Ftesën për Ofertë thuhet se data e zhvillimit do të jetë 14.05.2021, ora 10:00. Në datën 14.05.2021, printuar nga SPE gjendet klasifikimi përfundimtar, ku janë kualifikuar 9 operatorë dhe të skualifikuar janë 6 operatorë për shkak të ofertimit mbi fondin limit të parashikuar. Fitues u shpall D&J me ofertë 12,000 lekë.

Blerje materiale, reagent, kimikate

Kjo procedurë nis me Procesverbalin mbi Argumentimin e Fondit limit nënshkruar nga L.T, B.Sh, S.P i cili nuk ka datë. Komisioni duke u bazuar në prokurimet e mëparshme pothuaj me të njëjtat parametra teknik, për të marrë tregues për cmimet e këtij shërbimi duke përshkruar të gjitha ofertat përlllogaritje fondin me vlerë 224,000 lekë. Kjo përlllogaritje nuk është e dokumentuar ndaj bie në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 për “Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 76, pika 2 “AK përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet”. Kjo përlllogaritje nuk është e dokumentuar.



Ndër të tjera në Urdhrin e Prokurimit specifikohet se *afati i lëvrimit të mallrave do të jetë jo më vonë se 4 ditë pas zhvillimit të kësaj procedure.*

Në Ftesën për Ofertë thuhet se data e zhvillimit do të jetë 23.06.2021, ora 11:00. Në po të njëjtën datë, printuar nga SPE gjendet klasifikimi përfundimtar, ku janë kualifikuar 3 operatorë. Fitues shpallet T me ofertë 222,000 lekë por *për këtë nuk ka një procesverbal nga Komisioni i Prokurimit.* Më 30.06.2021 është nënshkruar nga L.XH, V.V dhe A.B akt marrja në dorëzim e mallit. Kjo bie në kundërshtim me kërkesat e Urdhrit të Prokurimit dhe Ftesës për Ofertë ku përcaktohet se *“afati i lëvrimit të mallrave do të jetë jo më vonë se 4 ditë kalendarike”.* Në po të njëjtën datë dhe fletë-hyrja nr.29 dhe Fatura elektronike.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi M.M dhe Komisioni i Blerjeve të Vogla V.Xh, Kryetar (Përgjegjëse e Sektorit të Financës), E.M, Anëtar, A.B, Anëtar.

Blerje materiale anticovid-19

Kjo procedurë nis me Procesverbalin mbi Argumentimin e Fondit limit nënshkruar nga L.T, B.Sh, S.P i cili nuk ka datë. Komisioni duke u bazuar në ankesën e bërë nga një OE për kualifikimin e një numri të konsiderueshëm ofertash që janë nën kufirin e 50% të fondit limit të përcaktuar, pas anulimit të procedurës, bëri ndryshimin e fondit limit dhe duke iu referuar numrit të operatorëve në listën kualifikuese, mori mesataren e ofertave të paraqitura prej tyre dhe përcaktoi fondin me vlerë 114,000 lekë. *Kjo metodë nuk është e parashikuar në ligj dhe nuk përbën studim tregu duke rënë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 5, datë 25.06.2021, pika 7.*

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi Grupi i Përlllogaritjes së Fondit Limit L.T, B.Sh, S.P.

Në Ftesën për Ofertë thuhet se data e zhvillimit do të jetë 16.09.2021, ora 10:30. Në po të njëjtën datë, printuar nga SPE gjendet klasifikimi përfundimtar, ku operatorë ekonomik të kualifikuar janë 36 operatorë dhe të skualifikuar janë 9 operatorë për shkak të ofertimit mbi fondin limit të parashikuar. Grupi i Auditimit vuri re se 6 ofertat e para të kualifikuara kanë vlerën më pak se 50% e fondit limit. Konkretisht:

A.M12,501 lekë
V.Gj 47,000 lekë
V.O 50,000 lekë
I.P.A 53,000 lekë
E.M 54,800 lekë
B.L 55,000 lekë

Kjo bie në kundërshtim me Udhëzimin nr. 5, datë 25.06.2021, pika 15/c ku thuhet se *“Anëtarët e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël do të refuzojnë automatikisht operatorët ekonomikë, oferta e të cilëve është ulur më shumë se 50% e fondit limit të përlllogaritur. Ofertat e refuzuara nuk do të përfshihen në klasifikimin e ofertave.”*

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi Komisioni i Prokurimit A.B, E.F.M, V.Xh.

Më 17.09.2021 Komisioni i Prokurimit (A.B, E.F.M, V.Xh) kryen procesverbalin për kalimin tek operatori ekonomik i rradhës, pasi A.M është tërhequr duke dërguar një mesazh në SPE. Ky procesverbal i printuar nga SPE, nuk ka firmat e anëtarëve të komisionit. Në po të njëjtën datë është krijuar një tjetër procesverbal për kalimin tek operatori ekonomik i rradhës, pasi fituesi V.Gj është tërhequr nga tenderimi. Më 20.09.2021 i njëjti procesverbal është kryer për operatorin V.O i cili është tërhequr nga tenderimi. Operatori fitues rezulton I.P.A, por nuk ka një procesverbal për shpalljen e fituesit.

**Blerje të Vogla 2022****Riparim mirëmbajtje e pajisjeve të zyrave**

Bashkëlidhur Urdhër Shpenzimit nr. 24, datë 26.01.2023 nuk ndodhet procesverbali mbi argumentimin e fondit limit. Kjo bie në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 për “Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 76, pika 2 “AK përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet”. Kjo përlllogaritje nuk është e dokumentuar.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi Grupi i Përlllogaritjes së Fondit Limit L.T, B.Sh, S.P.

Më pas u nënshkrua nga Kancelari Urdhri i Prokurimit pa numër dhe datë për “Blerjet me Vlera të Vogla” me objekt “Riparime karrigesh për sallën e mbledhjeve”. Ndër të tjera specifikohet se afati i lëvrimit të mallrave do të jetë 2 ditë.

Në Ftesën për Ofertë specifikohet se data e zhvillimit do të jetë 28.12.2022, ora 15:30. Printuar nga SPE gjendet klasifikimi përfundimtar, ku është kualifikuar 1 operator dhe të skualifikuar janë 8 operatorë për shkak të ofertimit mbi fondin limit të parashikuar. Fitues është shpallur operatori A.B me ofertë 50,000 lekë (pa TVSH), por mungon një procesverbal nga Komisioni i Prokurimit.

Konstatim: Më 29.12.2022 është kryer nga N.D, A.B dhe F.B akt marrja në dorëzim e mallit, por është nënshkruar vetëm nga 1 prej anëtarëve. Në po të njëjtën datë dhe Fatura Elektronike, ndërsa Fletë Hyrja në magazinë nuk ndodhet bashkëlidhur Urdhër Shpenzimit. Udhëzim nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve Në Njësitë e Sektorit Publik” pika 40 dhe 49. Konkretisht:

- “Magazineri dorëzon te nëpunësi përgjegjës për financat e njësisë nga një kopje origjinale për fletë hyrjet, faturën e furnizuesit (shitësit) si dhe fletë daljen...”

- “Aktivet e marra në ruajtje dokumentohen menjëherë me fletë hyrjen që përmban shënimin “vlera në ruajtje””.

Biletë avioni

Nga auditimi i procedurave të Blerjes Dinamike të Biletave për Transportin Ajror rezulton se nuk ka bashkëlidhur dokumentacion që vërteton zhvillimin e një aktiviteti. ASHSH nuk disponon dosje prokurimi për procedurat me blerje të vogla/dinamike por e gjithë praktika dokumentohet bashkëlidhur urdhërshpenzimit. Kjo bie në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 2, pika 2/a. Konkretisht: *Për cdo procedurë prokurimi autoriteti/enti kontraktor duhet të dokumentojë të paktën a) një përshkrim të shkurtër të mallrave, punëve ose shërbimeve që do prokurohen ose të nevojës për prokurim për të cilën autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur nisjen e procedurës.*

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi Komisioni për Blerjet Dinamike të Biletave për Transportin Ajror.

1. Bashkëlidhur Urdhër Shpenzimit nr. 263, datë 28.06.2022 nuk ndodhet organizimi i aktivitetit, ftesa nga organizuesit etj. Procedura nis menjëherë me Urdhrin e Prokurimit nr. 35, datë 15.06.2022 për “Blerjet Dinamike e Biletave për Transportin Ajror” me objekt “Blerje bileta avioni”. Do të prokurohet 1 biletë me datat 19 Qershor-22 Qershor 2022, Tiranë-Romë-Tiranë dhe anasjelltas, koha e nisjes paradite, pa ndalesë dhe me 10 kg bagazh. Në këtë Urdhër ndër të tjera specifikohet se OE duhet të njoftojë AK për realizimin/mosrealizimin e objektit të prokurimit brenda tre orëve duke filluar nga momenti i klasifikimit të ofertave në APP. Në Ftesën për Ofertë



thuhet se data e zhvillimit do të jetë 15.06.2022, ora 19:00. Printuar nga SPE gjendet klasifikimi përfundimtar, ku ka marrë pjesë dhe është kualifikuar 1 operator i cili shpallet fitues. Konkretisht A.T.T me vlerë të ofertuar 57,950 lekë (pa TVSH). Fatura elektronike mban datën 16.06.2022

2. Bashkëlidhur Urdhër Shpenzimit nr. 264, datë 28.06.2022 nuk ndodhet organizimi i aktivitetit, ftesa nga organizuesit etj. Procedura nis menjëherë me Urdhrin e Prokurimit nr. 37, datë 20.06.2022 për “Blerjet Dinamike e Biletave për Transportin Ajror” me objekt “Blerje bileta avioni”. Do të prokurohen 2 bileta me datat 21 gusht-28 gusht 2022, Tiranë-Venecia (Marco Polo)-Tiranë dhe anasjelltas. Në këtë Urdhër ndër të tjera specifikohet se OE duhet të njoftojë AK për realizimin/mosrealizimin e objektit të prokurimit brenda tre orëve duke filluar nga momenti i klasifikimit të ofertave në APP.

Në Ftesën për Ofertë thuhet se data e zhvillimit do të jetë 21.06.2022, ora 14:30. Printuar nga SPE gjendet klasifikimi përfundimtar, ku janë kualifikuar 3 operatorë. Më 21.06.2022 Komisioni ka kryer në Procesverbal për kalimin tek operatori ekonomik i rradhës për mosparaqitje brenda afatit të operatorit të klasifikuar në vend të parë. Operatori i skualifikuar është A “D” VT dhe fitues shpallet A.T.T me vlerë të ofertuar 102,480 lekë. Fatura elektronike mban datën 22.06.2022.

Blerje të Vogla 2023

Mirëmbajtje Mjedisesh të Jashtme

Bashkëlidhur Urdhër Shpenzimit nr. 473, datë 25.08.2023 ndodhet Procesverbali për Testimin e Tregut, për Argumentimin e Fondit Limit për shërbimin me objekt “Lyerje ambjent i jashtëm kati i dytë”. Sipas këtij procesverbali Grupi i Punës testoi tregun dhe në bazë të prokurimeve të mëparshme pothuaj me të njëjta parametra teknik për të marrë tregues për cmimet e këtij shërbimi duke përshkruar të gjitha ofertat dhe duke përllogaritur fondin limit. Bashkëlidhur procedurës nuk gjenden këto procedura të mëparshme ose oferta. Kjo bie në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 për “Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 76, pika 2 “AK përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet”. Kjo përllogaritje nuk është e dokumentuar. Fondi limit u vendos 85,000 lekë (pa TVSH).

Për sa më sipër mban përgjegjësi L.T, B.Sh, S.P.

Më pas u nënshkrua nga Kancelari Urdhri i Prokurimit nr. 49 datë 14.08.2023 për “Blerjet me Vlera të Vogla” me objekt “Mirëmbajtje mjedisesh të jashtme”. Në këtë procedurë kërkohet:

-Lyerja e sipërfaqes së jashtme të ASH (suvatime, riparime, sipas kërkesave të AK) me bojë hidroplastike importi cilësi e parë, ana perëndimore, kati i dytë (bashkë me vendosjen e skelave): sasia 200 m².

Ndër të tjera specifikohet se afati i realizimit të këtij shërbimi do të jetë brenda 10 ditëve kalendarike duke filluar nga momenti i kalimit të afateve të dorëzimit të ankesave.

Në Ftesën për Ofertë specifikohet se data e zhvillimit do të jetë 15.08.2023, ora 13:30. Printuar nga SPE gjendet klasifikimi përfundimtar, ku janë kualifikuar 8 operatorë dhe të skualifikuar janë 6 operatorë për shkak të ofertimit mbi fondin limit të parashikuar. Më 17.08.2023 nënshkrohet nga KVO Procesverbal për kalimin tek operatori ekonomik i rradhës pasi operatorit fitues H-Xh është tërhequr nga tenderi. Fitues shpallet Sh.M me ofertë 46,000 lekë (pa TVSH).

Më 22.08.2023 është kryer nga N.D, L.K dhe F.B procesverbali për marrje shërbimi në dorëzim nr. 24. Në datën 22.08.2023 Fatura Elektronike 22.08.2023.

**Mirëmbajtje Mjedisesh të Jashtme**

Bashkëlidhur Urdhër Shpenzimit nr. 468, datë 25.08.2023 ndodhet Procesverbali për Argumentimin e Fondit Limit për shërbimin me objekt “Mirëmbajtje mjedisesh të jashtme”. Sipas këtij procesverbali Grupi i Punës (L.T, B.Sh, S.P) testoi tregun dhe në bazë të prokurimeve të mëparshme pothuaj me të njëjta parametra teknik për të marrë tregues për cmimet e këtij shërbimi duke përshkruar të gjitha ofertat dhe duke përlloritur fondin limit. Bashkëlidhur procedurës 3 oferta nga A-K shpk me vlerë 240,000 lekë me TVSH, A me vlerë 277,200 lekë me TVSH, O&A shpk me vlerë 264,000 lekë me TVSH. Fondi limit u vendos 200,000 lekë (pa TVSH) por kjo vlerë nuk përkon me mesataren e ofertave të ardhura. Gjithashtu nuk ndodhen bashkëlidhur kontrata të mëparshme të cilat thuhet se janë marrë në konsideratë. Kjo bie në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 për “Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 76, pika 2 “AK përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlloriturjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet”. Kjo përlloriturje nuk është e dokumentuar.

Më pas u nënshkrua nga Kancelari Urdhri i Prokurimit nr. 42 datë 01.08.2023 për “Blerjet me Vlera të Vogla” me objekt “Mirëmbajtje mjedisesh të jashtme”. Në këtë procedurë kërkohet:

-Lyerja e sipërfaqes së jashtme të ASH (suvatime, riparime, sipas kërkesave të AK) me bojë hidroplastike importi cilësi e parë, ana perëndimore, kati i dytë (bashkë me vendosjen e skelave): sasia 550 m2.

Ndër të tjera specifikohet se afati i realizimit të këtij shërbimi do të jetë brenda 10 ditëve kalendarike duke filluar nga momenti i kalimit të afateve të dorëzimit të ankesave.

Në Ftesën për Ofertë specifikohet se data e zhvillimit do të jetë 02.08.2023, ora 13:30. Printuar nga SPE gjendet klasifikimi përfundimtar, ku janë kualifikuar 13 operatorë dhe të skualifikuar janë 4 operatorë për shkak të ofertimit mbi fondin limit të parashikuar. Më 07.08.2023 nënshkruhet nga KVO (M.M, E.F.M, V.V) Procesverbal për kalimin tek operatori ekonomik i rradhës pasi operatori fitues A.B është tërhequr nga tenderi. Fitues shpallet M.BA me ofertë 114,400 lekë (pa TVSH).

Më 23.08.2023 është kryer nga N.D, L.K dhe F.B procesverbali për marrje shërbimi në dorëzim nr. 23. Ky procesverbal tregon se OE nuk e ka kryer shërbimin brenda afatit të vendosur në Ftesën për Ofertë dhe Urdhrin e Prokurimit. Në datën 23.08.2023 Fatura Elektronike.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi M.M, E.F.M, V.V.

Këto dy procedura, duke marrë parasysh faktin që kanë qenë shumë afër në kohë duhet të ishin kryer si një procedurë e vetme.

Blerje materiale laboratorit projekti Hg Vlorë

Bashkëlidhur Urdhër Shpenzimit nr. 460, datë 18.08.2023 ndodhet Procesverbali për Argumentimin e Fondit Limit për shërbimin me objekt “Blerje material laboratorit”. Sipas këtij procesverbali Grupi i Punës (L.T, B.Sh, S.P) testoi tregun dhe në bazë të prokurimeve të mëparshme pothuaj me të njëjta parametra teknik për të marrë tregues për cmimet e këtij shërbimi duke përshkruar të gjitha ofertat dhe duke përlloritur fondin limit i cili rezulton 208,001 lekë. Në fakt nuk ka bashkëlidhur procedurës asnjë dokumentacion që vërteton këtë përlloriturje. Kjo bie në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 për “Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 76, pika 2 “AK përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlloriturjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet”. Kjo përlloriturje nuk është e dokumentuar.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQPËRISË

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi Grupi i Përlogaritjes së Fondit Limit L.T, B.Sh, S.P.

Më pas u nënshkrua nga Kancelari Urdhri i Prokurimit nr. 44 datë 01.08.2023 për “Blerjet me Vlera të Vogla” me objekt “Blerje material laborator për HG Vlorë”, ku listohen mallrat dhe sasia e tyre. Afati i realizimit përcaktohet 6 ditë kalendarike duke filluar nga momenti i kalimit të afateve të dorëzimit të ankesave.

Në Ftesën për Ofertë specifikohet se data e zhvillimit do të jetë 02.08.2023, ora 14:00. Printuar nga SPE gjendet klasifikimi përfundimtar, ku janë kualifikuar 2 operatorë dhe të skualifikuar janë 5 operatorë për shkak të ofertimit mbi fondin limit të parashikuar. Fitues shpallet “K” me vlerë 205,000 lekë në datën 02.08.2023. *Nuk ka një procesverbal nga KVO që pasqyron këtë proces.* Më 03.08.2023 “K” shpk paraqet dokumentacionin në ASHSH.

Më 11.08.2023 është kryer nga N.D, A.B dhe F.B procesverbali për marrje në dorëzim të mallit.

Në datën 11.08.2023 është prerë Fatura Elektronike dhe në po të nētën datë është nënshkruar nga Magazinieri Fletë Hyrja nr. 26 datë 11.08.2023

Duke qenë se në vitin 2023 është kryer tashmë një procedurë tenderi e tipit E hapur e Thjeshtuar me dy lote për blerjen e materialeve të projektit HG Vlorë, realizimi i kësaj procedure tregon copëzim fondi dhe një **mangësi në parashikimin e regjistrit**. Kjo bie në kundërshtim me VKM 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” neni 3, pika 2. Konkretisht: *Regjistri i parashikimeve duhet të synojë planifikimin e mirë të përdorimit të fondeve publike dhe planifikimin e realizimit në kohë të procedurave të prokurimit publik.*

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit është paraqitur observacion:

Me shkresën nr.896/35 datë 29.03.2024, protokolluar në KLSH me nr. 959/6 prot, datë 02.04.2024, në lidhje me Projekt Raportin e Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë me Nr.Prot.959/5, datë 29.02.2024 nga përfaqësuesit e subjektit R.K, M.M, A.B, V.Xh, O.Ç, E.M, V.V, L.T, B.Sh, S.P

➤ Në pretendimet e ngritura në shkresën përmendur më lartë, arsyetohet se:

-Sa i përket procedurës me objekt “Blerje materiale anticovid-19”, edhe pse nuk janë skualifikuar operatorët ekonomikë me ofertë nën 50% të fondit limit, artikulli ka ardhur sipas të gjitha parametrave të kërkuar (shpjegim i dhënë në Akt konstatimin 4/4).Duke ditur buxhetin modest të institucionit të ASH, dhe nevojave të tij për mallra, punë e shërbime, me qëllim minimizimin e shpenzimeve të tij, është vepruar në atë mënyrë. Në zbatim të rekomandimit tuaj, Ju bëjmë me dije se është bërë reflektimi i tij në procedurat e prokurimit blerje me vlerë të vogël, në vijim.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Grupi i auditimit vlerëson qëndrimin tuaj për përmirësimin e situatës në vijim, por vlen të përmendet se pavarësisht buxhetit të Institucionit, duhen ndjekur të gjitha Udhëzimet e parashikuara në ligj. Për sa më sipër, argumenti juaj nuk paraqet fakt të ri, arsye për të cilën nuk pranohet.

- Në tri raste është kryer prokurim “Blerje me vlerë të vogël” në SPE me O.Ç, pasi vendi i përgjegjës së sektorit të financës ka qenë vakant dhe për shkak të domosdoshmërisë në kryerjen e këtyre procedurave. Shpjegimin e këtij veprimi e kemi paraqitur dhe në përgjigjen e Akt konstatimit nr.4/4. Kjo ka qenë e para herë që është vepruar në këtë mënyrë (nisur nga viti 2010 e vijim).Nga ana jonë do të merren masa për zbatimin e rekomandimeve tuaja.

Qëndrimi i grupit të auditimit



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQPËRISË

Grupi i auditimit vlerëson qëndrimin tuaj për përmirësimin e situatës në vijim, por vlen të theksohet se O.Ç, e cila ka shkëputur marrëdhëniet e punës datë 31.12.2021 me anë të dorëheqjes që është aprovuar nga Titullari i ASHSH, ka kryer veprimtari në emër të institucionit. Argumenti juaj nuk paraqet fakt të ri, arsye për të cilën nuk pranohet.

-Në raportin përfundimtar dhe rekomandimet për auditimin e pasqyrave financiare, dërguar në ASHSH me nr.1199/6 prot., datë 17.12.2018, protokolluar në ASH me nr. 400/4, datë 20.12.2018, nuk ka pasur komente dhe rekomandime sa i përket kësaj pike. Nga ana jonë do të merren masa për zbatimin e rekomandimeve tuaja. Që nga janari 2024 është vënë në zbatim ky rekomandim.

Oëndrimi i grupit të auditimit

Grupi i auditimit vlerëson qëndrimin tuaj për përmirësimin e situatës në vijim, por vlen të përmendet se në tre vitet objekt auditimi në komisionin e prokurimit me vlera të vogla, kryetar i komisionit është caktuar Përgjegjësi i Sektorit të Financës. Argumenti juaj nuk paraqet fakt të ri, arsye për të cilën nuk pranohet.

Titulli i gjetjes nr. 1	Parregullsi në përcaktimin e Kryetarit të Njesisë së Prokurimit për Blerjet e Vogla
Situata:	Nga auditimi konstatohet se në tre vitet në komisionin e prokurimit me vlera të vogla kryetar i komisionit është caktuar Përgjegjësi i Sektorit të Financës (Nëpunës Zbatues) në kundërshtim me nenin 12 të Ligji nr. 10 296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.
Kriteri:	Ligji nr. 10 296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 12.
Ndikimi/Efekti:	Përgjegjësi i Sektorit të Financës në rolin e kryetarit të komisionit të prokurimit me vlerë të vogla konsiderohet konflikt interesi.
Shkaku:	Parregullsi në përcaktimin e Kryetarit të Njesisë së Prokurimit për Blerjet e Vogla.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandim:	Strukturat përgjegjëse të ASHSH të marrin masa për përcaktimin e nëpunësve të duhur në grupet e dhura të punës. Përgjegjësi i Sektorit të Financës nuk duhet të jetë më pjesë e Komisionit të Blerjeve të Vogla.

Titulli i gjetjes nr. 1	Mungesa e dokumentimit të përlogaritjes së fondit limit në procesverbalet për Blerjet me Vlerë të Vogël
Situata:	Në procedurat “Blerje pajisje zyre” (2021), “Blerje materiale, reagent, kimikate” (2021), “Mirëmbajtje Mjedisesh të Jashtme” (2023), “Blerje materiale laboratorit projekti Hg Vlorë” (2023): Komisioni duke u bazuar në testimin e tregut dhe në bazë të prokurimeve të mëparshme pothuajse me të njëjtat parametra teknike për të marrë tregues për çmimet e këtij shërbimi duke përshkruar të gjitha ofertat përcaktoi fondin limit. Ofertat nuk janë bashkëlidhur këtyre procesverbaleve, ndaj përlogaritja nuk mund të konsiderohet e dokumentuar;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

	<p>-Në procedurën “Riparim e mirëmbajtje e pajisjeve të zyrave” (2022) nuk ndodhet bashkëlidhur Urdhër Shpenzimit nr. 24, datë 26.01.2023 procesverbali për përllogaritjen e fondit limit.</p> <p>-Në procedurën “Mirëmbajtje mjedisesh të jashtme” (2023): Sipas procesverbalit të përllogaritjes së fondit limit Grupi i punës testoi tregun dhe në bazë të prokurimeve të mëparshme pothuaj me të njëjta parametra teknik për të marrë tregues për çmimet e këtij shërbimi duke përkthyer të gjitha ofertat dhe duke përllogaritur fondin limit. Bashkëlidhur procedurës 3 oferta. Fondi limit u vendos 200,000 lekë (pa TVSH) por kjo vlerë nuk përkon me mesataren e ofertave të ardhura. Gjithashtu nuk ndodhen bashkëlidhur kontrata të mëparshme të cilat thuhet se janë marrë në konsideratë.</p> <p>Veprime në kundërshtim me neni 76, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 për “Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.</p>
Kriteri:	VKM nr. 285, datë 19.05.2021 për “Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 76, pika 2.
Ndikimi/Efekti:	Mungesa e një përllogaritjeje të mirëfilltë të fondit limit mund të sjellë vendosjen e një fondi limit më të lartë sesa mund të ishte realizuar. Gjithashtu përzgjedhja e ofertës më të ulët gjatë procedurës së përllogaritjes së fondit mund të sjellë ulje të konkurrencës dhe pjesëmarrje të një numri më të vogël OE në procedurë.
Shkaku:	Mungesë transparence nga ana e Grupit të Përllogaritjes së Fondit Limit.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandim:	Strukturat përgjegjëse të ASH të marrin masa për argumentimin dhe dokumentimin procedurës së hartimit të fondit limit duke ju referuar metodës konkrete për përllogaritjen e vlerës.

Titulli i gjetjes nr. 2	Ofertat e ardhura për Blerjet me Vlerë të Vogël kualifikohen edhe kur kanë vlerë më të vogël se 50% e fondit limit.
Situata:	-Në procedurën “Blerje materiale anticovid-19”: Operatorë ekonomik të kualifikuar janë 36 operatorë dhe të skualifikuar janë 9 operatorë për shkak të ofertimit mbi fondin limit të parashikuar. Grupi i Auditimit vuri re se 6 ofertat e para të kualifikuara kanë vlerën më pak se 50% e fondit limit në kundërshtim me pikën 15/c të Udhëzimit nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.
Kriteri:	Udhëzimi nr. 5, datë 25.06.2021, pika 15/c.
Ndikimi/Efekti:	Kualifikimi i ofertave nën 50% sjell për institucionin shtyrje të procedurës për shkak të pjesëmarrjes së operatorëve të cilët tërhiqen nga gara. Gjithashtu mund të krijojë problematika në përmbushjen e objektivit të prokurimit në mënyrë të rregullt.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e Njesisë së Prokurimit.
Rëndësia:	E mesme



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

Rekomandim:	Strukturat përgjegjëse të ASH të marrin masa për përmbushjen e Udhëzimit nr. 5 datë 25.06.2021 dhe të skualifikohen nga procedura gjithmonë operatorët me oferta më të ulëta se 50% e fondit limit me qëllim përmbushjen e objektit të prokurimit me cilësi.
--------------------	--

Titulli i gjetjes nr. 3	Malli dorëzohet nga OE pas afatit të përcaktuar në Urdhrin e Prokurimit dhe Ftesën për Ofertë.
Situata:	<p>Në Urdhrin e Prokurimit për procedurën “Blerje materiale, reagent, kimikate” specifikohet se <i>afati i lëvrimin të mallrave do të jetë jo më vonë se 4 ditë pas zhvillimit të kësaj procedure</i>. Më 30.06.2021 është nënshkruar akt marrja në dorëzim e mallit.</p> <p>-Në Urdhrin e Prokurimit nr. 42 datë 01.08.2023 për “Blerjet me Vlera të Vogla” me objekt “Mirëmbajtje mjedisesesh të jashtme” specifikohet se afati i realizimit të këtij shërbimi do të jetë brenda 10 ditëve kalendarike duke filluar nga momenti i kalimit të afateve të dorëzimit të ankesave. Në Ftesën për Ofertë specifikohet se data e zhvillimit do të jetë 02.08.2023 ndërkohë që më 23.08.2023 është hartuar procesverbali për marrje shërbimi në dorëzim nr. 23. Veprime në kundërshtim me Urdhrin e Prokurimit nr. 35, datë 21.06.2021; Urdhrin e Prokurimit nr. 42 datë 01.08.2023 dhe Udhëzimin nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.</p>
Kriteri:	<p>-Urdhri i Prokurimit nr. 21.06.2021;</p> <p>-Urdhri i Prokurimit nr. 42 datë 01.08.2023;</p> <p>-Udhëzimi nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.</p>
Ndikimi/Efekti:	Vonesa të tilla çojnë në vonesën e kryerjes së shërbimit/dorëzimit të mallit të cilat mund të jenë thelbësore për veprimtarinë e institucionit.
Shkaku:	Neglizhencë institucionale.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandim:	ASH të marrë masa për zbatimin korrekt nga ana e OE fitues të afateve të përcaktuara për dorëzimin/ furnizimin e mallrave/ shërbimeve etj.

Titulli i gjetjes nr. 4	Parregullsi në dosjet e Blerjes Dinamike të Biletave për Transportin Ajror
Situata:	Në procedurat e Blerjes Dinamike të Biletave për Transportin Ajror me fond limit 160,430 lekë mungon ftesa nga vendet e huaja bashkëlidhur praktikës, organizimi i aktivitetit etj, në kundërshtim me nenin 2, pika 2/a të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.
Kriteri:	VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 2, pika 2/a.
Ndikimi/Efekti:	Dokumentacion i paplotë
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e Njësisë së Prokurimit.
Rëndësia:	E mesme



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

Rekomandim:	Në të gjitha Urdhër Shpenzimet për Blerjet Dinamike të Biletave të jenë bashkëlidhur ftesa nga vendet e huaja, organizimi i aktivitetit, personat që do të shkojnë etj.
--------------------	---

Titulli i Gjetjes nr.5:	Hyrja në sistemin e APP e një punonjëse të larguar
Situata:	Nga auditimi i praktikave të blerjeve me vlera të vogla për këtë periudhë konstatohet se në 3 raste zj. O.Ç, me detyrë ish Përgjegjëses së Sektorit të Financës dhe në cilësinë e anëtares së KVO ka hyrë në sistem dhe ka kryer vlerësimin për 3 procedura prokurimi me vlera të vogla me gjithë etapat e tyre në sistemin e APP (janar-shkurt 2022) edhe pasi është larguar nga detyra dhe ka shkëputur marrëdhëniet financiare me Akademinë e Shkencave më datë 31.12.2021 sipas shkresës nr. 780/1, datë 31.12.2021 “Ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për shkak të dorëheqjes” në kundërshtim me Neni 12 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues” të ligjit nr. 10 296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Vendimin nr. 16 datë 24.03.2022 “Për miratimin e rregullores së brendshme administrative të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë neni 44 “Specialist për Financë” pika b.
Kriteri:	Neni 12 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues” të ligjit nr. 10 296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Vendimin nr. 16 datë 24.03.2022 “Për miratimin e rregullores së brendshme administrative të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë neni 44 “Specialist për Financë” pika b.
Ndikimi/Efekti:	Hyrja në sistem e personave të paautorizuar.
Shkaku:	Mos mbyllja e llogarisë në sistemin e APP.
Rekomandimi:	Akademia e Shkencave të marrë masa që të verifikojë të gjithë përdoruesit aktiv në sistemin elektronik në APP, si dhe në rastet e largimit nga puna të punonjësve të sigurojë mbylljen e menjëhershme të llogarive të përdorimit të sistemit duke mos cënuar sigurinë e procesit të prokurimit.
Rëndësia:	E lartë
Afati zbatimit:	Menjëherë dhe në vijimësi.

b. Verifikimi i veprimeve të kryera përmes magazinës

Ditari i magazinës është mbajtur dhe veprimet hidheshin periodikisht.

U audituan me zgjedhje dokumentacioni i magazinës për periudhën e auditimit.

Fletë daljet dhe fletë hyrjet e aktiveve janë të hartuara sipas rendit kronologjik dhe pa korrigjime. Hyrja e aktiveve në magazinë dokumentohet në çdo rast me fletëhyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre. Fletëhyrjet lëshohen nga magazinieri, pasi është bërë më parë verifikimi fizik i sasisë, i cilësisë dhe i çmimit, në përputhje me përcaktimet e paragrafit 37, kreu iii, të



Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë. 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, i ndryshuar.

Kontabilizimet e fletë daljeve dhe fletë hyrjeve janë bërë në mbështetje të planit unik kontabël dhe në mënyrë kronologjike e sistematike në ditarët e magazinës. Dokumentacioni i magazinës përpilohet nga administratori i vlerave materiale, ndërsa kontabilizimi i veprimeve kryhet nga një specialiste e sektorit të financës.

c. Inventarizimi i pronës shtetërore.

Në datën 08.11.2023 është dorëzuar kërkesa për dokumentacion në të cilën janë kërkuar specifikisht nga urdhri i ngritjes së komisionit edhe dokumentacion në lidhje me procesit e inventarizimit dhe vlerësimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimit nga ana e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë u vendos në dispozicion vetëm dosje e nxjerrjes jashtë përdorimit si rezultat i procesit të inventarizimit të vitit 2020.

Me email-in datë 13.12.2023 Përgjegjëse e Sektorit të Financës ka konfirmuar se nuk është kryer procesi i inventarizimit **për vitin 2021 dhe vitin 2022** në kundërshtim me Neni 8 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar dhe 73-74 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar. **Për sa më sipër mban përgjegjësi R.K, Kancelar dhe M.M, Përgjegjëse e Sektorit të Financës.**

Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar “Neni 8

Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit

1. Titullarët e njësive publike, të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.

2. Titullarët e njësive publike, të përmendura në pikën 1 të nenit 3 të këtij ligji, caktojnë nëpunësit autorizues, sipas përcaktimeve të ligjit “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.

3. Titullarët e njësive publike, të përmendura në pikat 2 e 3 të nenit 3 të këtij ligji, mund të caktojnë një nëpunës të nivelit më të lartë drejtues dhe t'i ngarkojnë atij përgjegjësi që janë të barasvlershme me ato të nëpunësit autorizues.

4. Në rast mosçaktimi të nëpunësit autorizues, përgjegjshmëria menaxheriale dhe përgjegjësitë, sipas parashikimeve të nenit 9 të këtij ligji, i takojnë titullarit të njësisë publike.

5. Drejtuesit e të gjitha niveleve të njësive të varësisë i japin llogari eprorit, sipas shkallës hierarkike, deri tek titullari i njësisë publike, dhe janë përgjegjës për realizimin e objektivave dhe zbatimin e përgjegjësive të caktuara nga titullari, duke menaxhuar fondet publike në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.”

Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar:

**“IV. SISTEMI I KONTROLLIT PERIODIK TE AKTIVEVE****Inventarizimi i aktiveve**

73. Inventarizimi i aktiveve eshte nje element i rendesishem kontrolli ne kuadrin e menaxhimit te aktiveve te njesise, i cili kryhet per te vërtetuar saktësinë, cilesine e gjendjes fizike të aktiveve në një kohë të caktuar si dhe perdorimin ne menyren e duhur dhe me eficience te tyre. Inventarizimi kryhet nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave të miratuara me këtë udhezim dhe nga titullari i njesisë publike.

74. Cdo njësi publike duhet të kontrollojë te pakten nje here ne vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës.

Për vitin 2023

Me Urdhrin nr. 72 prot., datë 31.01.2023 “Për inventarizimin e aktiveve për vitin 2023 në ASH”, është ngritur grupi për kryerjen e procesit të inventarizimit:

1. G.V, Kryetar
2. E.M, Anëtar
3. A.B, Anëtar

Afati i kryerjes së inventarit në përdorim 31.10.2023.

Afati i kryerjes së inventarit në magazine 30.11.2023.

Do të hartohet relacioni deri në 15.12.2023.

Nga auditimi rezulton se Grupi i Inventarizimit nuk ka kryer inventarin në laboratorët pranë qendrave kërkimore si dhe inventarin personal të stait që i ka në ngarkim pasqyruar kjo edhe në Aktverifikimin nr.1, protokolluar në Akademinë e Shkencave me nr. 896, datë 12.12.2023 dhe Aktverifikimin nr.2, protokolluar në Akademinë e Shkencave me nr. 896/1, datë 12.12.2023, për sa më sipër mban përgjegjësi grupi i inventarizimit i përbërë nga G.V, E.M, A.B të cilë kanë vepruar në kundërshtim me Urdhrin nr. 72 prot., datë 31.01.2023 “Për inventarizimin e aktiveve për vitin 2023 në ASH” dhe me pikat 85, 86 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

“85. Komisioni i inventarizimit ka përgjegjesine për:

a. Verifikimin fizik dhe cilesor te gjendjes se aktiveve ne ngarkim/perdorim te personelit te njesise publike dhe pasqyrimin e te dhenave te inventarizimit ne proceverbalin perkates, i cili ruhet gjate periudhes se inventarizimit.

b. Të bëjë krahasimin e gjendjes konkrete të aktiveve me të dhënat përkatëse të librave që mbahen nga punonjësit me përgjegjësi materiale e që janë të përputhura me sektorin e financës, të llogaritë kompensimet e lejueshme, duke marrë edhe mendimin e specialistëve përkatës dhe, për diferencat që mund të dalin pas kompensimeve, të hartojë procesverbalet.

c. Te perpiloje nje raport lidhur me inventarizimin fizik te aktiveve, per kushtet e ruajtjes se tyre, gjendjen fizike dhe per vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve te konstatuara, për shkaqet e tyre dhe personat pergjegjes, dhe, së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t'ia dorezoje per veprime te metejshme Nepunesit Autorizues.

86. Personat e ngarkuar për kryerjen e inventarizimeve mbajnë sipas rastit përgjegjësi disiplinore, materiale a penale për moskryerjen me saktësi të inventarit.”



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

Për sa më sipër mban përgjegjësi R.K, Kancelar dhe M.M, Përgjegjëse e Sektorit të Financës, G.V, E.M, A.B, në cilësinë e anëtarëve të komisionit të inventarizimit.

Titulli i gjetjes nr. 6	Mos kryerja e inventarizimit
Situata:	Nga auditimi rezulton se ASH nuk është kryer procesi i inventarizimi për vitet 2021, 2022 si dhe i pjesshëm për vitin 2023. Grupi i inventarizimit nuk ka kryer inventarin në laboratorët pranë qendrave kërkimore si dhe inventarin personal të stafit që i ka në ngarkim, veprime në kundërshtim me Urdhrin nr. 72 prot., datë 31.01.2023 “Për inventarizimin e aktiveve për vitin 2023 në ASH” dhe me pikat 85, 86 të Udhëzimit të MFE nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.
Kriteri:	Urdhrin nr. 72 prot., datë 31.01.2023 “Për inventarizimin e aktiveve për vitin 2023 në ASH” dhe me pikat 85, 86 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti:	Mos pasja e sigurisë për ekzistencën e aktiveve.
Shkaku:	Mos kryerja e inventarëve.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandime:	Akademia e Shkencave të marrë masa që të kryejë inventarizim të plotë të të gjitha aseteve që disponon duke e shtrirë procesin e inventarizimit edhe tek laboratorët duke evidentuar aktivet e dhuruara apo në përdorim si dhe ato të blera.
Afati:	Në vijimësi

5. Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave.

Me Vendimin Nr. 36/2020 datë 09.07.2020 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe nivelit të pagave për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë” të Kuvendit është miratuar struktura e Akademisë për periudhën objekt auditimi, konkretisht:

Drejtimi Institucional Shkencor

Kryesia – 4

- Kryetar
- Zvendëskryetar
- Sekretar Shkencor
- Sekretar Kryesisë

Seksionet Shekncore – 4

- Kryetar i Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjie (anëtar Kryesie)
- Sekretar teknik i SSSHSA-së
- Kryetar i Seksionit të Shkencave Natyrore-Teknike (anëtar Kryesie)
- Sekretar teknik i SSHTN-së

Qendra e projekteve dhe koordinimit të kërkimit shkencor – 4

- Drejtor
- Koordinator kërkimor-shkencor

Administrata

Kancelari – 1



Sektori i marrëdhënieve me jashtë dhe publikun – 2

Specialist për burimet njerëzore

Specialist për marrëdhëniet me jashtë

Sektori i botimeve shkencore – 6

Përgjegjës sektori

Redaktor shkencor

Redaktor shkencor

Bibliografe

Bibliotekare

Editor botimesh

Sektori i buxhetit dhe financës - 4

Përgjegjës sektori

Specialist finance

Specialist për shpërndarjen e librit akademik

Magaziner/ shofer

Sektori ndihmës – 4

Shofer

Punëtor mirëmbajtës

Punonjës pastrimi

Arkivist-protokollist

Totali 29 punonjës

Me Vendimin nr. 85/2022, datë 17.11.2022 “Për një ndryshim në Vendimin e Kuvendit nr. 36/2020 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe nivelit të pagave për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”” të Kuvendit ka ndryshuar struktura dhe niveli i pagave, konkretisht:

- Pozicioni i punës së një kordinatori shkencor ka kaluar duke shtuar pozicionin e përgjegjës të sektori i marrëdhënieve me jashtë dhe publikun.

Me Vendimin nr. 115/2023, datë 02.11.2023 “Për disa ndryshime në Vendimin e Kuvendit nr. 36/2020 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe nivelit të pagave për akademinë e shkencave në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar””, ka ndryshuar struktura dhe niveli i pagave, konkretisht

- Sekretar Kryesisë është shtuar Kryesekretare

- Specialist për burimet njerëzore është shtuar edhe jurist.

Për periudhën objekt auditimi ka qenë në fuqi Rregullore e miratuar me Vendimin e Kryesisë datë 29.12.2014 “Për aprovimin e rregullores së brendshme të Akademisë së Shkencave”, dhe me Vendimin nr. 16, datë 24.03.2022 të Kryesisë është miratuar Rregullore e Brendshme Administrative e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Nga auditimi konstatohet se Rregullore e Brendshme e Funksionimit e cila ka qenë në zbatim deri në 24.03.2022 ka qenë e pa azhornuar me ndryshimin ligjor të funksionimit të akademisë të ndodhur në datë 18.07.2019 dhe në këtë rregullore nuk janë të përcaktuara kriteret minimale që duhet të plotësohen për çdo post pune. Nga auditimi dhe analizimi i rregullores aktuale në fuqi konstatohet se ka disa poste pune për të cilat janë shprehur preference arsimit të cilat nuk justifikohen për pozicionin e punës apo përshkrimin e punës që kanë të përshkruara në rregullore ose nuk ka asnjë lloj specifikimi, konkretisht:

Pozicioni i punës Kancelar (Neni 31, pika 4) – nuk ka të përcaktuar arsim;



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

neni 8 "Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit", pika nr.1 dhe nr.8, të ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 "Per menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, që thekson:

"1. Titullarët e njësive publike, të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ..."

8. Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore:

a) miratimin e politikave dhe monitorimin e objektivave" të njësive publike që ata drejtojnë".

- Të ketë përfunduar arsimin e lartë

pozicioni i punës specialist për marrëdhëniet me jashtë dhe publikun – shumë specifik dhe nuk kërkohet arsimit kryesor i mundshëm për këtë.

- Të jetë diplomuar për gjuhë shqipe ose gjuhë të huaja;

pozicioni i punës bibliotekari – Shkenca Sociale:

– Të ketë arsim të lartë në **shkenca sociale**, preferohet të ketë specializimin "Shkolla Kombëtare për Bibliotekonominë";

pozicioni i punës specialist për shpërndarjen e librit akademik:

– Të ketë diplomë në shkenca ekonomike, preferohet në **degën biznes**.

Punësimet

Për periudhën objekt auditimi konstatohet se ka 9 punonjës të rekrutuar nga të cilat u përzgjidhën në mënyrë rastësore tre:

- Koordinator e Kërkimit – Shkencor
- Përgjegjës i Sektorit të Financës dhe Buxhetit
- Sekretar Teknik pranë Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike

Nga auditimi rezulton se në Ligjin 53/2019 "Për akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar ka lenë një hapsirë të papërcaktuar për statusin e punonjësve të Akademisë së Shkencave dhe hapsirën ligjore për përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të punonjësve, vetëm në nenin 22, pika 3 të Ligjit, parashikohet:

"3. Zgjedhja e kancelarit dhe punonjësve të administratës rregullohet sipas legjislacionit në fuqi për shërbimin civil, duke e njësuar pozicionin e kancelarit me atë të Sekretarit të Përgjithshëm në ministri."

Statuti i Institucionit i miratuar me Vendimin e ASH nr. 22, datë 18.10.2019, i ndryshuar nuk ka të parashikuar asnjë detaj shtesë mbi rregullimin e marrëdhënieve të punës vetëm neni 54 i tij parashikon po të njëjtin paragraph të ligjit. Referuar neneve të ligjit dhe statutit janë parashikuar në rregullore e brendshme të institucionit nenet 53-67 të saj vetëm mbi procedurën e rekrutimit.

Pozicioni i punës për sekretarin teknik pranë seksioneve është zhvilluar drejtëpërdrejtë nga seksioni pasi pika 4, neni 36 i Statutit, parashikon: "Çdo seksion drejtohet nga Kryetari i Seksionit dhe ka në përbërje edhe sekretarin teknik. Kryetari i Seksionit zgjidhet sipas këtij statute. Sekretari teknik emërohet nga kryesia me propozim të Kryetarit të Seksionit"

Nga auditimi rezulton se në Akademinë e Shkencave për punonjësit e përherëm ka kontrata pune.



Vlerësimi në punë

Nga auditimi rezulton se asnjë strukturë brenda institucionit nuk vlerëson punonjësit e njësisë së varësisë dhe nuk është e parashikuar si procedurë në asnjë akt i brendshëm rregullativ.

Largimet nga puna

Gjatë periudhës objekt auditimi u konstatua se ka 5 punonjës së larguar nga Akademia e Shkencave, konkretisht: 2 punonjës në vitin 2021, 1 punonjës në vitin 2022 dhe 2 punonjës në vitin 2023. Arsyet e largimit janë 2 punonjës kanë dalje në pension dhe 3 punonjës largim me dëshirë për arsye personale.

Masa disiplinore

Gjatë periudhës objekt auditimi është dhënë vetëm 1 masë disiplinore në vitin 2022 “Vërejtje me shkrim”, ku është zbatuar procedura sipas Rregullores së Brendshme.

Ngritje ne detyrë

Gjatë periudhës objekt auditimi ka 2 procedura ngritje në detyrë:

1 – Koordinator në qendrën e projekteve dhe koordimit të kërkimit shkencor

2 – Sekretare e Kryesisë

Bashkëlidhur praktiave ka:

- Shprehje interesi
- Përkujtesë e hartuar nga Kancelari
- Urdhë – lirim dhe emërimi në detyrë

Procedura e ngritjes në detyrë nuk është e parashikuar në rregulloren e institucionit si dhe statusi ligjor i paqartë i punonjësve ka sjell mos zhvillimin e një procedure të drejtë duke mos ofruar mundësi të barabarta për punonjësit.

Vendimet Gjyqësore

Për periudhën objekt auditimi nuk ka asnjë proces gjyqësor për ndërprerje marrëdhënie pune, ka vetëm 1 proces të mbartur nga periudha mëparshme dhe Vendimi i Shkallës së Parë nr. 1197, datë 26.02.2020 detyron Akademinë të rikthej punonjësin në detyrë, vijon procesi në apel. Nuk është kryer asnjë pagesë për vendimin e shakllës së pare.

Plotësimi i dosjeve

Nga auditimi rezulton se asnjë dosje personeli nuk është e inventarizuar, nuk ka një listë të dokumentave se çfarë përmbajnë dosjet, por kanë dokumenta të pa renditura brenda tyre.

U audituan me zgjedhje 5 dosje personeli:

- V.V, sekretare e Kryesisë/Kryesekretare
- Dh. H, specialist për marrëdhëniet me jashtë
- N.D, specialist për shperndarjen e librit akademik
- I.B, bibliotekare
- A. V, përgjegjëse sektori

Në dosje ndodhen dokumentat e nevojshme.

**Trajnimet**

Nga auditimi rezulton se në Akademinë e Shkencave nuk ka një regjistër mbi trajtimet e kryera nga punonjësit dhe nuk hartohen plane trajnimi vjetore duke kryer një evidentim paraprak të nevojave dhe adresimin e tyre në insitucione përkatëse për trajnimin sipas nevojave të stafit.

Plotësimi i listë pagesave nga punonjësi i caktuar për pagat, si dhe mbështetja në të dhënat e dokumentacionit bazë (listë prezenca e firmosur nga menaxheri i strukturës përkatëse) për shërbimin e kryer. Kontrolli dhe nënshkrimi nga punonjësi i caktuar me menaxhimin e burimeve njerëzore dhe nëpunësi zbatues ose i deleguari i tij.

Nga auditimi në tërësi të listë pagesave për periudhën e përcaktuar në program, rezultoi se shuma e përgjithshme e listë pagesave është e njëjtë me Urdhër Shpenzimet e përgatitur për këtë qëllim. Përmbledhëset e listë pagesës në çdo rast janë të nënshkruara nga personat përgjegjës. Listë pagesat janë të shoqëruara me listë prezenca përkatëse. Listë pagesat paraqesin nga paga bruto, shtesat, ndalesat deri në pagën neto. Në procedurën e pagesës hartohet listë prezenca dhe nënshkruhet nga personat përkatës më pas hartohet listë pagesa mbi bazën e klasifikimit të pagave, shtesa për pozicione të veçanta pune të cilat janë të miratuara nga Kuvendi, duke kryer llogaritjet për tatimin mbi të ardhurat nga punësimi dhe kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, plotësohet listëpagesa përkatëse dhe dërgohet në Thesar për pagesë. Janë kryer ndalesat për tatimin mbi të ardhurat personale nga punësimi sipas përcaktimeve në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar dhe janë paguar brenda datës 20 të muajit që pason muajin në të cilin është kryer pagesa. Është përlllogarit, ndalur dhe derdhur në organet tatimore kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore mbi bazën e pagës minimale dhe maksimale si dhe përqindjeve përkatëse punëdhënës e punëmarrës sipas VKM nr. 1114, datë 30.7.2008 i ndryshuar “Për disa çështje në zbatim të ligjeve nr. 7703, datë 11. 5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ligji nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe ligji nr. 7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 26, datë 16.4.2009 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore” i ndryshuar, dhe pas hyrjes në fuqi të VKM-së nr. 457, datë 09.07.2014, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 1114, datë 30.7.2008, të këshillit të ministrave, “Për disa çështje në zbatim të ligjeve nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë””, të ndryshuar, nr. 9136, datë 11.9.2003, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nr. 10383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”. Afatet e deklarimit dhe pagesës së kontributeve janë në varësi të statusit të personit që detyrohet të paguajë kontributet dhe përcaktohen në nenet 10 dhe 11 të ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, i përcaktuar jo më vonë se data 20 e muajit pasardhës. Pagesa e tatimit mbi të ardhurat personale nga punësimi, si dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Nga auditimi konstatohet se nuk ka orë jashtë orarit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQPËRISË

Tabela nr. 5/1: Numri i punonjësve për periudhën objekt auditimi

	Punonjës të përhershëm		Punonjës me kontratë		Punonjës të përhershëm		Punonjës me kontratë		Punonjës të përhershëm		Punonjës me kontratë	
	Viti 2021		Viti 2021		Viti 2022		Viti 2022		Viti 2023		Viti 2023	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
	29	26	1	1	29	28	1	1	29	29	1	1

Burimi : Akademia e Shkencave

Tabela nr. 5/2 Të dhëna përmbledhëse për detyrimet nga marrëdhëniet e punës për periudhën objekt auditimi

Nr	Emërtimi	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023 (30.11.2023)
1	Fondi i pagave gjithësej	24 500 000	25 523 555	33 340 457
2	Detyrimi për tatimin mbi të ardhurat personale	1 982 820	2 059 977	3 278 037
3	Gjoha të paguara për pagesë të vonuar	0	5 000	
4	Interesa të paguar për pagesë të vonuar	0		
5	Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shendetesore	3 949 426	4 181 299	5 118 745
6	Gjoha të paguara për pagesë të vonuar	0		
7	Interesa të paguar për pagesë të vonuar	0		

Burimi : Akademia e Shkencave

Nga auditimi rezulton se është gjoha e marrë prej 5000 lekë për mos deklarim në kohë të punonjësit, akademikë i huaj për shkak të vonesës së marrjes së lejes së qëndrimit.

Tabela nr. 5/3 Të dhëna përmbledhëse për përdorimin e fondit të veçantë për periudhën objekt auditimi (dhe të tjera nëse ka)

Nr	Emërtimi	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023
1	Fondi i veçantë	134 340	670 000	300 000
2	Shpërblime për rezultate në punë	0	0	
3	Shpërblime për fund viti	0	370 000	
4	Shpërblime sëmundje	0	50 000	50 000
5	Për largime nga puna	0	0	
6	Për raste fatkeqësie/lindje	0	0	
7	Për dalje në pension	134 340	0	86 200

Burimi : Akademia e Shkencave

Me Vendimin nr. 1, datë 11.01.2021 “Për ngritjen e njësisë së kërkim – studimit Qendra e botimeve albanologjike dhe encikopedike”.

Me Vendimin nr. 7, datë 01.02.2021 “Për ngritjen e njësisë së kërkim – studimit Qendra e botimeve albanologjike dhe encikopedike” është ngritur **Qendra e botimeve albanologjike dhe encikopedike** e cila financohet nga buxheti i shtetit me një fond të veçantë prej 100 milion lekë, si dhe drejtimi.

Për periudhën objekt auditimi Strukturë (struktura dhe organigrama)

Nuk ka rregullores e funksionimit

Nuk ka procedurë rekrutimi për 4 punonjësit në kundërshtim me pika 4 neni 66 të Rregullores së Brendshme:

“Për pranimet për shërbime administrative, në pozicionet plotësuese ndiqet e njëjta procedurë si për funksionet analoge bazë”

Me vendimin nr. 2, datë 09.01.2023 “Për zgjatjen e afatit të funksionimit të qendrës së botimeve” dhe në vitin 2023 është përcaktuar struktura.

Me Vendimin nr. 20, datë 28.02.2020 “Ngritjen e Njësisë së Kërkim – Studimit në fushën e bioshkencës, bioteknologjisë dhe gjenetikës”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

Me Vendimin nr. 2, datë 10.01.2022 “Ngritjen e Njesisë së Kërkim – Studimit në fushën e bioshkencës, bioteknologjisë dhe gjenetikës” zgjat afatin e qendrës.

Me Vendimin nr. 35, datë 27.06.2023 “Për shtesat në vendimin e Kryesisë nr. 2, datë 10.01.2022 “Për ngritjen e qendrës kërkimore – shkencore të bioteknologjisë dhe gjenetikës”, vendimin nr. 5, datë 13.01.2022 “Për zgjatjen e afatit të njesisë së kërkim studimit të nanoshkencës dhe nanoteknologjisë (NanoAlb)” dhe ndryshimin e emërimit të saj” dhe vendimin nr. 30, datë 20.06.2023 “Për vazhdimin e veprimtarisë së Institutit Kombëtar Virtual i Fizikës (IKVF)” janë përcaktuar niveli i pagave dhe strukturat përkatëse.

Me Vendimin nr. 43, datë 18.12.2019 “**Për ngritjen e njesisë së kërkim – studimit në fushën e NANO – shkencës dhe NANO - teknologjisë**”.

Me Vendimin nr. 5, datë 13.01.2022 “Për zgjatjen e afatit të njesisë së kërkim – studimit në fushën e NANO – teknologjisë dhe ndryshimin e emërimit të saj”.

Pranë kësaj qendre është punësuar dy kordinator të cilët janë përcaktuar me Vendim të Kryetarit të ASH dhe është lidhur kontratë shërbimi dhe është mbajtur tatimi në burim 15%.

Me Vendimin nr. 42, datë 05.07.2021 “**Për krijimin e njesisë kërkimore të përkohshme Instituti Kombëtare (IKF)**”.

Me Vendimin nr. 30, datë 20.06.2023 “Për vazhdimin e veprimtarisë së institutit kombëtar Virtual i fizikës (IKVF)” .

Pranë kësaj qendre është punësuar një kordinator i cili është përcaktuar me Vendim të Kryetarit të ASH dhe është lidhur kontratë shërbimi dhe është mbajtur tatimi në burim 15%.

Me vendimin nr. 8, datë 16.01.2020 “Për shpërblimin e punës së anëtarëve të jashtëm të komisioneve dhe të njësive afatshkurtra të Kërkim - Studimit” është vendosur pagesa për anëtarët e jashtëm të komisioneve, të cilët shpërblehen për pjesëmarrje për mbledhje në shumën 5500 lekë, por jo më shumë se 6 mbledhje në vit.

Komisionet epërhershme shkencore të ASH:

1. Komisioni i gjuhësisë, letërsisë;
2. Komisioni i historisë, arkeologjisë;
3. Komisioni i shkencave sociale, juridike, ekonomike;
4. Komisioni i artit, trashëgimisë kulturore;
5. Komisioni i matematikës, informatikës;
6. Komisioni i fizikës, kimisë;
7. Komisioni i inxhinierisë;
8. Komisioni i mjekësisë;
9. Komisioni i biologjisë, bujqësisë, veterinarisë.

Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr. 5, nr. 896/14 prot., datë 15.01.2024 “Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave”

Titulli i gjetjes nr. 1	Mbi marrëdhëniet e punës
Situata:	Nga auditimi dhe analizimi i rregullores aktuale në fuqi konstatohet se: - Janë disa poste pune për të cilat janë shprehur preferenca arsimit të cilat nuk justifikohen për pozicionin e punës apo përshkrimin e punës që kanë të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

	<p>caktuara në rregullore ose nuk ka asnjë lloj specifikimi, kancelari, bibliotekari, shpërndarësi i librit akademik etj.</p> <p>-Asnjë strukturë brenda institucionit nuk vlerëson punonjësit e njësisë së varësisë dhe nuk është e parashikuar si procedure në asnjë akt të brendshëm rregullativ.</p> <p>Akademina e Shkencave nuk ka një regjistër mbi trajtimet e kryera nga punonjësit dhe nuk hartohen plane trajnimi vjetore duke kryer një evidentim paraprak të nevojave dhe adresimin e tyre në institucionet përkatëse për trajnimin sipas nevojave të stafit.</p>
Kriteri:	Ligjin 53/2019 “Për akademina e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti:	Status jo i qartë
Shkaku:	Hapsira ligjore
Rëndësia:	E mesme
Rekomandime:	Akademia e Shkencave të marrë masa për hartimin e plotë të një dokumenti të politikave të punësimit dhe rregullimit të normimit të marrëdhënieve të punës, si dhe hartimin në kohë të akteve të brendshme rregullative duke specifikuar profile studimi të qarta për pozicionet drejtuese në akademi, dhe heqjen e llojit të studimit specifik në pozicione pune që është i panevojshëm. Akademia e Shkencave të marrë masa për hartimin e një regjistri trajnimesh për punonjësit.
Afati:	Menjëherë dhe në vijimësi

6. Prokurimet e fondeve publike.

Për vitin 2021

Parashikuar në regjistër në fillim të vitit 0 procedura me fond limit 0 lekë, regjistri është ndryshuar 4 herë me fond limit 11,223,000 lekë.

Janë realizuar 3 procedura me vlera kontrate 7,450,700 lekë.

Për vitin 2022

Parashikuar në regjistër në fillim të vitit 0 procedura me fond limit 0 lekë, regjistri është ndryshuar 3 herë me fond limit 16,462,309 lekë.

Janë realizuar 3 procedura me vlera kontrate 1,5278,800 lekë.

Për vitin 2023

Parashikuar në regjistër në fillim të vitit 0 procedura me fond limit 0 lekë, regjistri është ndryshuar 3 herë me fond limit 15,580,700 lekë.

Janë realizuar 3 procedura me vlera kontrate 14,457,000 lekë.

Nga auditimi i hartimit, ndryshimit dhe realizimit të regjistrit të prokurimeve konstatohet se:

1. Nuk ka një regjistër parashikimi si rrjedhojë për periudhën janar – prill 2021 në kundërshtim me nenin 4 të Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të



prokurimit publik” dhe pikat 3,4 të nenit 3 “Regjistri i parashikimeve të procedurave të prokurimit publik” të Vendimit Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” për periudhën vijuese:

“3. Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të nevojave, gjatë periudhës shtator – dhjetor të çdo viti, përgatit regjistrin për vitin ushtrimor në vijim, bazuar në ligjin që miraton parashikimet buxhetore afatmesme. Në çdo rast, afati maksimal i hartimit të regjistrit është jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga miratimi i ligjit për buxhetin për vitin ushtrimor pasardhës. Autoritetit/enti kontraktor, brenda 5 (pesë) ditëve nga hartimi i regjistrit të parashikimit të procedurave të prokurimit, duhet të dërgojë në organin qendror blerës të dhënat teknike e sasiore dhe fondin përkatës për objektet që do të prokurohen në mënyrë të përqendruar.

4. Autoriteti/enti kontraktor ka detyrimin të krijojë regjistrin e parashikimeve në sistemin e prokurimit elektronik dhe publikimi i zërave të tij nga APP-ja duhet të bëhet brenda 3 (tre) ditëve nga dita e nesërme e punës, nga dërgimi i tij për publikim në sistem. APP-ja, nëse vëren se regjistri i parashikimeve nuk është hartuar në përputhje me kërkesat e legjislacionit të prokurimit publik, kthen e këshillon autoritetin/entin kontraktor për hartimin e tij në përputhje me këto kërkesa. Një kopje e regjistrit të parashikimeve i vihet në dispozicion degës së thesarit dhe institucionit qendror, që vë në dispozicion fondet buxhetore, në rastin kur ka një të tillë.”

2. Nuk kanë të dokumentuar procesin e mbledhjes së kërkesave nga sektorët përkatës për hartimin e regjistrit të parashikimit në kundërshtim me për periudhën janar – prill 2021 në kundërshtim me nenin 4 të Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe pikat 1 dhe 2 të nenit 3 “Regjistri i parashikimeve të procedurave të prokurimit” të Vendimit Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” për periudhën vijuese:

“1. Në bazë të nevojave për punë, mallra ose shërbime, autoriteti/enti kontraktor është përgjegjës për hartimin e regjistrit vjetor të parashikimeve për procedurat e prokurimit publik, në përputhje me formën dhe mënyrën e parashikuar në udhëzimet e APP-së.

2. Regjistri i parashikimeve duhet të synojë planifikimin e mirë të përdorimit të fondeve publike dhe planifikimin e realizimit në kohë të procedurave të prokurimit publik.”

3. Nga verifikimi në sistemin e APP për hedhjen në sistem të regjistrit të rezultojnë se:

Nga auditimi rezultojnë se në sistemin e APP nuk është hedhur një regjistër fillestar parashikimi por janë hedhur në ditë të ndryshme dhe janë shtuar zërat më vonë në kundërshtim me nenin 4 të Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe pika 4 të nenit 3 “Regjistri i parashikimeve të procedurave të prokurimit publik” të Vendimit Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” për periudhën vijuese:

“4. Autoriteti/enti kontraktor ka detyrimin të krijojë regjistrin e parashikimeve në sistemin e prokurimit elektronik dhe publikimi i zërave të tij nga APP-ja duhet të bëhet brenda 3 (tre) ditëve nga dita e nesërme e punës, nga dërgimi i tij për publikim në sistem. APP-ja, nëse vëren se regjistri i parashikimeve nuk është hartuar në përputhje me kërkesat e legjislacionit të prokurimit publik, kthen e këshillon autoritetin/entin kontraktor për hartimin e tij në përputhje me këto kërkesa. Një kopje e regjistrit të parashikimeve i vihet në dispozicion degës së thesarit dhe institucionit qendror, që vë në dispozicion fondet buxhetore, në rastin kur ka një të tillë.”

4. Për sa i përket modifikimit të regjistrit të parashikimeve konstatohet se ndryshimi bëhet rast pas rasti duke shtuar nga një procedurë prokurimi dhe është ndryshuar 4 herë për vitin 2021, 3 herë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

për vitin 2022 dhe 3 herë në vitin 2023 dhe në asnjë rast nuk ka një argumentim mbi këto ndryshime në rast se vijnë për arsye që nuk kanë qenë të mundura të parashikohen në kohën e hartimit të regjistrit dhe nuk një miratim nga titullari i autoritetit kontraktor për këto ndryshime nuk janë dërguar në Degën e Thesarit në kundërshtim me nenin 4 të Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe pikën 7 të nenit 3 “Regjistri i parashikimeve të procedurave të prokurimit publik” të Vendimit Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” për periudhën vijuese:

“Autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të bëjë ndryshime në regjistrin e parashikimeve të procedurave të prokurimit, vetëm në raste kur këto ndryshime vijnë për arsye që nuk kanë qenë të mundura të parashikohen në kohën e hartimit të regjistrit.

Çdo ndryshim i regjistrit të parashikimeve bëhet nga vetë autoriteti ose enti kontraktor në sistemin e prokurimit elektronik, dhe publikimi i tij nga APP-ja bëhet brenda 3 (tri) ditëve nga dita e nesërme e punës nga dërgimi i tij për publikim në sistem.

APP-ja, nëse konstaton se ky ndryshim nuk është bërë në përputhje me kërkesat e legjislacionit të prokurimit publik, kthen dhe këshillon autoritetin/entën kontraktor për hartimin e tij në përputhje me këto kërkesa.

Një kopje e këtyre ndryshimeve i vihet në dispozicion degës së thesarit dhe institucionit qendror që vë në dispozicion fondet buxhetore, në rastin kur ka një të tillë”.

Procedura e prokurimit “Blerje pajisje elektronike” e tipit e hapur e thjeshtuar.

Të dhëna për tenderin:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Blerje pajisje elektronike”		
1.Urdhër Prokurimi nr. 47 datë 23.07.2021	3.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: NjP: Urdhër nr. 47, datë 23.07.2021 A.B – Juriste V.Xh – Përgjegjëse e Sektorit të Financës E.M – Specialiste	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave: Urdhër nr. 48, datë 23.07.2021 N.F N.F A.B
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: E hapur e thjeshtuar		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 3,023,000 lekë Burimi i financimit Buxheti i Shtetit	6.Oferta fituese S.Co me ofertë 2,941,100 lekë (pa tvsh)	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 81,900 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 06.08.2021	9.Burimi Financimit: Buxheti i Shtetit	10.Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender: 2 OE b)S’kualifikuar – 0 OE c) Kualifikuar – 2 OE
11.Ankimime S’ka	12. Përgjigje ankesës nga AK	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP
b.Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14.Lidhja e kontratës Nr. 407/11 prot., datë 02.09.2021	15.Vlera e kontratës: S.Co – 3,529,320 lekë (me tvsh)	16. Likuiduar: Likujdim pjesor më 22.09.2021, 1,580,520 lekë me TVSH Likujdim pjesor më 20.10.2021, 1,948,800 lekë me TVSH
		Afati i kontratës 30 ditë



Kjo procedurë nisi në 11.06.2021 me kërkesën drejtuar Kryetarit nr. 407 prot., në kuadër të projektit “Historia e Shqipërisë” ku listoheshin:

- 7 laptopë
- 1 aparat fotografik
- 1 fotokopje (skaner, printer)
- Regjistrimi i autorëve të tekstit në bibliotekë elektronike
- Blerje e një numri të kufizuar librash, botimesh të huaja

Në një tjetër kërkesë e cila nuk ka datë ose numër protokolli, drejtuar Kryetarit në kuadër të projektit “Fjalori i Madh i Gjuhës Shqipe” listoheshin:

- 1 server i fuqishëm dhe 4 harddisqe të jashtëm me 4 dhe 8 Tera
- 2 skaner të cilësisë së lartë, me shpejtësi të madhe
- 3 kompjuter të fuqishëm PC me njësi qendrore dhe ekranin (HP, Dell, Apple) një për sekretarin shkencor, 2 për punonjësit ndihmës
- 3 laptopë për hartues a redaktorë që do jenë online
- Flesh 64 GB (5 copë)
- Fjalorë të ndryshëm shpjegues
- Fjalor i gjuhës shqipe
- Fjalor drejtshkrimor i gjuhës shqipe
- Fjalor shqip-anglisht me 170.000 njësi
- Fjalor shqip-gjermanisht

Në Urdhrin nr. 44, datë 23.07.2021 për “Caktimin e Personit Përgjegjës për Prokurimin” u vendos A.B me profesion specialist e burimeve njerëzore dhe juriste. Ky Urdhër iu përcoll edhe Agjencisë së Prokurimit Publik në po të njëjtën datë.

Në Urdhrin nr. 45, datë 23.07.2021, nr. 407/3 prot. për “Ngritjen e Grupit të Punës për Hartimin e Specifikimeve Teknike për Procedurën e Prokurimit me Objekt “Blerje Pajisje Elektronike”” u vendosën A.B, G.V, F.B. Detyra e këtij grupi është kryerja e hartimit të specifikimeve teknike që duhet t’i përcillet grupit të punës së përlllogaritjes së fondit limit dhe Njesisë së Prokurimit. Procesverbali për specifikimet teknike nuk ka datë, numër protokolli dhe firma të grupit të punës. *Në procesverbal gjenden të listuar dy kondicionerë të cilët nuk kanë qenë pjesë e kërkesave të ardhura për nisjen e procedurës. Gjithashtu kondicionerët nuk janë të parashikuar në CPV-të e Regjistrimit të Parashikimeve, zëri “Blerje pajisje elektronike”. Kjo tregon keqmenaxhim të fondeve dhe mospërcaktim të saktë të nevojave, që bie në kundërshtim me VKM 285, datë 19.05.2021 për “Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 1, pika 2 “Autoriteti/enti kontraktor ka detyrimin të planifikojë në cilësi dhe në kohë nevojat e tij e fondet publike respektive dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi”.*

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi R.K (Kancelar), A.B (Personi Përgjegjës për Prokurimin)

Në Urdhrin nr. 46, datë 23.07.2021, nr. 407/4 prot., për “Ngritjen e Grupit të Punës për Përlllogaritjen e Fondit Limit” janë caktuar L.T, I.B, M.A. Në këtë urdhër është përcaktuar se ky grup do të kryejë përlllogaritjen e fondit limit bazuar në specifikimet teknike të objektit të prokurimit të hartuara nga grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe dokumentacioni do t’i përcillet Njesisë së Prokurimit. Grupi i Punës nuk ka kryer asnjë aktivitet dhe si fond limit për këtë procedurë është vendosur vlera 3,023,000 miratuar nga Buxheti i Shtetit në Regjistrin e Parashikimeve. Kjo bie në kundërshtim me nenin 76, pika 2 e VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. “Autoriteti/enti kontraktor, përpara



nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet”.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi L.T, I.B, M.A.

Në Urdhrin e Prokurimit nr. 47, datë 23.07.2021, nr. 407/5 prot., “Për Procedurën e Prokurimit me Objekt “Blerje Pajisje Elektronike” u urdhërua:

- prokurimi i fondit limit 3,023,000 lekë (pa TVSH)
- lloji i procedurës së prokurimit: “Procedurë e hapur e thjeshtuar”
- Njësia e Hartimit të Dokumentave: A.B (Specialiste e Burimeve Njerëzore dhe Jurist, person përgjegjës), V.Xh (Përgjegjëse e Sektorit të Financës), E.M (specialist)

Me Urdhrin nr. 48, datë 23.07.2021, nr. 407/6 prot., për “Emërimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për Procedurën e Prokurimit me Objekt “Blerje Pajisje Elektronike” u caktuan pjesëmarrësit N.F(kryetar), N.F (anëtar), A.B (anëtar).

Në asnjë nga këta urdhra nuk ndodhen të pranishëm formularët e deklarimit të kryetarëve dhe anëtarëve të Grupeve, në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” nenin 73, pika 4; “Titullari i autoritetit/entit kontraktor duhet të marrë masa për shmangien e çdo konflikti interesi në marrëdhëniet e tij, punonjësve të angazhuar në procesin e prokurimit dhe operatorit ekonomik, sikurse përcaktohet në nenin 19 të LPP-së”.

Në proces-verbalin e datës 30.07.2021 për “Argumentimin dhe Miratimin e Specifikimeve Teknike dhe Kriteve për Kualifikim” përgatitur nga NJHD kanë firmosur vetëm dy anëtarë të Grupit të Punës që përbëhet nga tre persona. E njëjta problematikë konstatohet edhe në Dokumentet Standarte të Tenderit.

Mungon një Procesverbal nga ana e KVO mbi hapjen e procedurës dhe vlerësimin e ofertave. Në kundërshtim me VKM 285, datë 19.05.2021 për “Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 2, pika 1 dhe neni 80 pika 4. Konkretisht: Autoriteti/enti kontraktor duhet të administrojë të gjithë dokumentacionin për procedurën e prokurimit duke filluar nga planifikimi i saj deri te zbatimi i kontratës. Për këtë qëllim autoriteti/enti kontraktor duhet të mbajë procesverbale dhe dokumentacion të plotë për procedurat e kryera. Çdo hap i procedurës së prokurimit duhet të regjistrohet dhe të pasqyrohet në procesverbal. Personi përgjegjës për prokurimin, anëtar i njësies së prokurimit është përgjegjës për regjistrimin e çdo faze të procesit dhe teksti përfundimtar i tij duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e KVO.

Në datën 12.08.2021, nr. 407/8 prot., u publikua Formulari i Njoftimit të Fituesit. Sipas këtij Formulari në procedurën e tenderimit kanë marrë pjesë:

1. PC.S shpk me NIPT L.....A (vlera e ofertuar 2,864,500 lekë)
2. S.CO shpk me NIPT K.....F (vlera e ofertuar 2,941,100 lekë)

Operatori PC S. shpk është skualifikuar për arsyet si më poshtë:

1. Specifikimet Server: serveri i ofertuar nga ky operator nuk përmbush specifikimet teknike të kërkuara, zgjerueshmërinë në 3TB të RAM. Serveri i ofertuar suporton deri në 1TB RAM, nuk përmban 24 DIMMS por 16 DIMMS në kapacitet maksimal dhe kontrollerat për këtë model server të ofertuar DL160 Gen10 nuk e kalojnë kashenë 4GB, ndërkohë që duhet të ishin me kasha 8GB.
2. Specifikimet Skaner Dokumentash: shpejtësia e skanimit me ngjyra të operatorit është 25ppm (ndërkohë që duhet të ishte 30 ppm), kapaciteti i ADF është 20 fletë (ndërkohë që kërkohej 50 fletë) dhe shpejtësia e skanimit me ngjyra 25 ppm/50 ipm (ndërkohë që kërkohej 30ppm/60 ipm).
3. Katalogët nuk janë të përkthyer dhe të noterizuar nga subjekti.



Grupi i Auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit ka kryer një kontroll të dokumentacionit të dorëzuar nga subjekti S.C, njëkohësisht dhe fituesi i kësaj procedure dhe janë vënë re këto mangësi në dokumentacionin e dorëzuar:

1. Kriteret e përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit: ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së. f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interes sipas legjislacionit në fuqi. g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës. gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi. h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi. i) Operatori Ekonomik nuk ka cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Kjo bie në kundërshtim me VKM 285, neni 25 “Kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP janë të detyrueshme për t’u plotësuar nga çdo operator ekonomik pjesëmarrës në një procedurë prokurimi”.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi KVO; N.F, I. K., A.B.

Mungon Raporti Përmbledhës, në kundërshtim me VKM 285, neni 84. Konkretisht “Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pas përfundimit të afateve të ankimit përgatit një raport përmbledhës për procesin e shqyrtimit e të vlerësimit të ofertave dhe ia dërgon për miratim titullarit të autoritetit/entit kontraktor”.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi KVO: N.F, I. K., A.B dhe A.B Personi Përgjegjës për Prokurimin.

Më 27.08.2021 është kryer Formulari i Sigurimit të Kontratës dhe nga operatori është paguar 10% e vlerës së kontratës, konkretisht 352,932 lekë. Më 02.09.2021, nr. 407/11 prot., u nënshkrua Kontrata “Blerje Pajisje Elektronike” mes Akademisë së Shkencave si Autoriteti kontraktor dhe shoqërisë S.Co shpk si Kontraktuesi. Vlera e përgjithshme e kontratës është 2,941,100 lekë pa TVSH, kohëzgjatja 30 ditë nga data e nënshkrimit, pagesa do të kryhet nga Autoriteti Kontraktor brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes në dorëzim të çdo partie malli.

Më 10.09.2021, nr. 407/13 prot., është ngritur Urdhri nr. 54 për “Ngritjen e Grupit të Punës për Zbatimin e Mbikqyrjen e Kontratës”. Grupi i punës përbëhet nga G.V (anëtar), N.D (anëtar), E.M (anëtare). Vihet re që në këtë grup asnjë nga anëtarët nuk është i listuar si kryetar. Më 13.09.2021 është nënshkruar nga Komisioni për zbatimin e mbikqyrjen e kontratës Akti i Marrjes në Dorëzim. Pjesa e parë e pagesës është kryer më 22.09.2021, konkretisht 1,580,520 lekë dhe kjo pagesë është brenda afatit të përcaktuar në Kontratën “Blerje Pajisje Elektronike” datë 02.09.2021. Pjesa e dytë e pagesës është kryer më 20.10.2021, 1,948,800 lekë. Ky likujdim pjesor është kryer jashtë afatit të përcaktuar në kontratë, pasi është 7 ditë pas afatit. Kjo bie në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” pika 61; “Pagesat ndërmjet njërive publike dhe entiteteve të sektorit privat bëhen nëpërmjet Sistemit të Thesarit direkt në llogarinë bankare të përfituesit. Njësitë e qeverisjes së përgjithshme janë të detyruara të procedojnë me kryerjen e pagesës për mbylljen e detyrimeve menjëherë pas marrjes së faturës tatimore nga funitori dhe të vërtetuar me kryerjen e shërbimit/marrjes në dorëzim të aktiveve në



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQPËRISË

përputhje me kushtet e kontratës. Për moszbatimin e këtij detyrimi zbatohen sanksionet ligjore të përcaktuara në kontratën e lidhur në mes palëve ose në marrëveshjet përkatëse dypalëshe për të cilat mban përgjegjësi Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues i njësisë respektive”.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi R.K (Kancelari) dhe Përgjegjësi i Sektorit të Financës (Nëpunësi Zbatues).

Procedura e prokurimit “Shtypje libra studimore dhe revista periodike për vitin 2021” e tipit Kërkesë për Propozim.

Të dhëna për tenderin:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Shtypje libra studimore dhe revista periodike për vitin 2021”		
1.Urdhër Prokurimi nr. 24 datë 17.05.2021	3.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: NjP: Urdhër nr. 24, datë 17.05.2021 V.Xh – Përgjegjëse e Sektorit të Financës A.B – Juriste S.P (Vaqarri)- specialiste, bibliografe	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave: Urdhër nr. 25, datë 17.05.2021 Sh.S N.F A.V
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: E hapur e thjeshtuar		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 3,309,950 lekë Burimi i financimit Buxheti i Shtetit	6.Oferta fituese K.KH me ofertë 2,590,500 lekë (pa tvsh)	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 719,450 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 31.05.2021	9.Burimi Financimit: Buxheti i Shtetit	10.Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender: 2 OE b)S’kualifikuar – 0 OE c) Kualifikuar – 2 OE
11.Ankimime Në datën 21.05.2021 nr. 273/9 prot., u dërgua një kërkesë për sqarim nga operatori “A.C” shpk ku evidentohet mospërputhje me sasinë e kërkuara në shtojcën 10 të DST dhe sasinë e vendosura tek “Të dhënat teknike të botimeve për vitin 2021”.	12. Përgjigje ankesës nga AK U kryen në DST ndryshimet e kërkuara.	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP Asistencë nga APP për këto ndryshime.
b.Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14.Lidhja e kontratës Nr. 273/21 prot., datë 21.06.2021	15.Vlera e kontratës: K.KH – 3,108,600 lekë (pa tvsh)	16. Likuiduar: Likujdim pjesor më 24.12.2021, 2,372,400 lekë me TVSH Likujdim pjesor më 24.11.2021, 736,200 lekë me TVSH
		Afati i kontratës nga lidhja e kontratës deri më 31.12.2021

Kjo procedurë nisi me Vendimin nr. 29, datë 12.04.2021 për “Miratimin përfundimtar të titujve të veprave për botim për vitin 2021” dhe publikimin e listës së botimeve të miratuara nga Këshilli Botues për vitin 2021 që përfshinte 36 vepra.

Më 21.04.2021 u ngrit Urdhri nr. 14, nr. 273/1 prot., ku u vendos zyrtari i autorizuar i Autoritetit Kontraktor Kancelari. Me Urdhrin nr. 15, datë 21.04.2021, nr. 273/2 prot., u vendos personi i



kontaktit për prokurimin me objekt “Shtypje libra studimorë dhe revista periodike për vitin 2021” A.B (specialist e burimeve njerëzore dhe juriste) dhe ky urdhër iu përçua APP.

Më pas me Urdhrin nr. 16, datë 21.04.2021, nr. 273/4 prot., për “Ngritjen e Grupit të Punës për Hartimin e Specifikimeve Teknike, për Procedurën e Prokurimit me Objekt “Shtypje libra studimorë dhe revista periodike për vitin 2021” u vendosën pjesë e komisionit E.M, V.V, I.B. Urdhri nr. 17, datë 21.04.2021, nr. 273/5 prot., për “Ngritjen e Grupit të Punës për Përlllogaritjen e Fondit Limit” vendosi në komision L.T, B.Sh, A.B. Në këto urdhëra nuk është specifikuar roli i pjesëmarrësve, konkretisht kryetari edhe anëtarët.

Procesverbali i grupit të punës për “Hartimin e Specifikimeve Teknike” dhe ai “Mbi Argumentimin e Fondit Limit të Botimeve” nuk kanë datë, numër protokollit dhe mungojnë firmat e të gjithë anëtarëve.

Në procesverbalin e argumentimit të fondit limit, grupi i punës nuk ka vendosur asnjë argument dhe bazë mbi çmimet e vëna për botimet, gjë që bie në kundërshtim me nenin 76, pika 2 e VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar “Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet”.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi L.T, B.Sh, A.B.

Urdhër nr. 23, datë 17.05.2021, nr. 273/6 prot., për “Ngritjen e Njesisë së Prokurimit” vendosi pjesëmarrës A.B (Specialiste e Burimeve Njerëzore dhe Jurist, person përgjegjës), V.Xh (Përgjegjëse e Sektorit të Financës), S.P (Vaqarri) (specialiste, bibliografe). Në këtë Urdhër nuk specifikohen rolet e pjesëtarëve dhe nuk janë bashkëlidhur Formularët e Deklarimit të të gjithë anëtarëve.

Nuk ndodhen të pranishme formularët e deklaramit të kryetarëve dhe anëtarëve të Njesisë së Prokurimit, në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” nenin 73, pika 4: “Titullari i autoritetit/entit kontraktor duhet të marrë masa për shmangien e çdo konflikti interesi në marrëdhëniet e tij, punonjësve të angazhuar në procesin e prokurimit dhe operatorit ekonomik, sikurse përcaktohet në nenin 19 të LPP-së”.

Urdhri i Prokurimit nr. 24, datë 17.05.2021, nr. 273/7 prot., për “Procedurën me Objekt “Shtypje Libra Studimorë dhe Revista Periodike për Vitin 2021”” urdhëron:

1. Të kryhet prokurimi i fondit limit 3,971,940 lekë me TVSH
2. Lloji i procedurës të jetë Kërkesë për Propozim
3. Anëtarët e Njesisë së Hartimit të Dokumentave: V.Xh, A.B, S.P

Me Urdhrin nr. 25, datë 17.05.2021, nr. 273/8 prot., për “Emërimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për Procedurën e Prokurimit me Objekt “Shtypje Libra Studimorë dhe Revista Periodike për Vitin 2021” pjesë e komisionit u vendos Sh.S (kryetar), N.F(anëtar), A.V (anëtar). Pas ngritjes së grupeve të punës procedura u hodh në sistem më 18.05.2021 me një afat kohor deri në datën 31.05.2021 ora 11:00.

Në datën 21.05.2021 nr. 273/9 prot., u dërgua një kërkesë për sqarim nga operatori “A.C.” shpk ku evidentohet mospërputhje me sasi të kërkuara në shtojcën 10 të DST dhe sasi të vendosura tek “Të dhënat teknike të botimeve për vitin 2021”. Kështu me Urdhrin nr. 27 datë 21.05.2021 “Për pezullimin e vazhdimin të procedurave të prokurimit” procedura pezullohet. Arsyeja e shënuar në sistem ishte *për një lapsus teknik në të dhënat teknike të disa botimeve (lidhur me tirazhin)*. Në po të njëjtën datë u krye një procesverbal mbi sqarimin për të dhënat teknike të botimeve të procedurës së prokurimit. Më pas më 21.05.2021 doli Urdhri nr. 28 për “Heqjen nga pezullimi të



procedurës së prokurimit me objekt Shtypje libra studimorë dhe revista periodike për vitin 2021”. APP me anë të një E-maili asistoi Autoritetin Kontraktor për krijimin e një shtojce, kështu u njoftuan të gjithë operatorët ekonomikë dhe me Urdhër nr. 29 datë 25.05.2021 kjo procedurë u pezullua përsëri. Me njoftimin e operatorëve ekonomikë doli Urdhri nr. 30 datë 25.05.2021 për “Heqjen nga pezullimi i procedurës”.

Më 31.05.2021, si pasqyrohet në procesverbalin “Mbi dorëzimin e mostrave për procedurën e prokurimit” nënshkruar nga anëtarët e KVO, u dorëzuan monstat nga dy operatorë D.X oferta e të cilit ishte 3.276.650 lekë dhe K-KH shpk me ofertë 2.590.500 lekë. Pas shqyrtimit të dokumentacionit rezultoi se të dy operatorët i plotësonin të gjitha kërkesat, ndaj fitues i procedurës u shpall K.KH me ofertën më të ulët. Ky vendim pasqyrohet në procesverbalin “Mbi shqyrtimin e dokumentacionit tekniko-ligjor të operatorëve ekonomikë për procedurën e prokurimit” nënshkruar nga KVO.

Më 09.06.2021 u krye Formulari i Njoftimit të Fituesit dhe operatori dorëzoi dokumentacionin më 18.06.2021 me nr.273/20 prot. Më 18.06.2021 u krye Formulari i Sigurimit të Kontratës, me vlerë 310,860 lekë. Më pas Kontrata u nënshkrua në datën 21.06.2021 nr. 273/21 prot ku përcaktohej vlera e kontratës 3,108,600 lekë (me TVSH), afati i lëvrimit të mallrave që do të jetë nga lidhja e kontratës deri më 31.12.2021 dhe pagesa që do të kryhet brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes në dorëzim të çdo partie malli.

Më 11.10.2021 Këshilli i Botimeve me nënshkrim të Kryetarit S.Gj miratojnë Vendimin nr. 61, nr. 630/2 prot., “Për një zëvendësim në listën e botimeve të vitit 2021”. Konkretisht, nuk është arritur të merret pëlqimi i akad. T.J, autor i veprës Fjalor i përkundërt greqisht-arvanisht-shqip si dhe ende nuk është dorëzuar në sektorin e botimeve libri: J.K, Faik Konica-Jeta dhe vepra (ribotim i plotësuar). Ndaj Këshilli i Botimeve merr vendimin të miratojë për botim veprën Historia e Luftës antifashiste vëllimi II me autor Paskal Milo, të vazhdohen negociimet me Titos Jochalas dhe veprat e Panajot Kupitorit dhe Jul Kastratit të përfshihen në listën e botimeve të vitit të ardhshëm. Sektori i financës të përlllogarisë pjesën e buxhetit të prokuruar për 2 veprat dhe të caktohet tirazhi dhe të dhënat e tjera teknike të veprës zëvendësuese. Më 21.12.2021, nr. 790 prot., Sektori i Botimeve dhe Bibliotekës (përgjegjësja A.V) i drejtoi Kryetarit S.Gj një propozim për zëvendësim të një titulli në botimet e vitit 2021. Libri Byllis me autore O.C nuk është dorëzuar në Sektorin e Botimeve pasi autorja është në fazën e paraqitjes së këtij libri si temë të mbrojtjes së doktoraturës dhe kërkojnë zëvendësimin e këtij titulli me titullin e gatshëm për botim Shqiptarët në dokumentet austro-hungareze, vëllimi VIII me autor Marenglen Verli.

Më 30.12.2021 u krye një modifikim-amendament i kontratës me vlerë 333.333 lekë (pa TVSH), me afat 30 ditë pas lidhjes së saj dhe me objekt Realizimin e 12.9% shtesë kontrate. Kjo kontratë u bazua në Vendimin nr. 73, datë 21.12.2021 ku ndër të tjera thuhet se *Sektori i Financës duhet të përlllogarisë pjesën e buxhetit të prokuruar për veprën zëvendësuese*. Këto llogaritje nuk gjenden në dosjen e tenderit dhe nuk janë vënë në dispozicion nga Akademia e Shkencave. Gjithashtu kjo Kontratë nuk është ekzekutuar.

Më 20.12.2021 është kryer Urdhër Shpenzimi nr. 685 për vlerën 2,372,400 lekë me TVSH. Bashkëlidhur Urdhër Shpenzimit ndodhet Urdhri i Prokurimit nr. 24 datë 17.05.2021, Njoftim Fituesi nr. 273/18 datë 09.06.2021, Kontrata nr. 273/21 datë 21.06.2021, Sigurimi i Kontratës datë 18.06.2021, Fatura nr. 35/2021 datë 24.12.2021 dhe Fletë Hyrje nr. 2 datë 24.12.2021.

Më 31.12.2021 është kryer Urdhër Shpenzimi nr. 701 për diferencën e pagesës 736,200 lekë. Bashkëlidhur Urdhër Shpenzimit ndodhet Urdhri i Prokurimit nr. 24 datë 17.05.2021, Njoftim Fituesi nr. 273/18 datë 09.06.2021, Kontrata nr. 273/21 datë 21.06.2021, Sigurimi i Kontratës datë



18.06.2021, Fatura nr. 35/2021 datë 24.12.2021 dhe Fletë Hyrje nr. 3 datë 24.12.2021. Fletë-Hyrja është nënshkruar nga magazinieri F.B dhe përmban 7 vepra, konkretisht:

- 1.Shqiptarët në dokumentat austro-hungareze vëllimi VIII
- 2.Shqiptarët në Luftën e II Botërore
- 3.Kadare në kritikën botërore vëllimi III
- 4.Arkitektura në Iliri Anglisht
- 5.Udhërrëfyes i dokumenteve osmanisht në Arkivin e Stambollit për Korçën
- 6.Studime shqiptare (botim dygjuhësh në origjinal dhe shqip)
- 7.Jeta dhe vepra ribotim i plotësuar

Ndërkohë që në Procesverbalin e marrjes në dorëzim të botimeve të Akademisë për vitin 2021, nënshkruar nga OE K-KH dhe Grupi i Marrjes në Dorëzim që përbëhej nga F.B, A.B, E.M, listohen si të marra në dorëzim veprat:

- 1.Kadare në kritikën botërore vëllimi III
- 2.Arkitektura në Iliri Anglisht
- 3.Udhërrëfyes i dokumenteve osmanisht në Arkivin e Stambollit për Korçën
- 4.Studime shqiptare (botim dygjuhësh në origjinal dhe shqip)
- 5.Faik Konica, Jeta dhe Vepra
- 6.Byllis (Shqiptarët në dokumentet austro-hungareze, vëllimi VIII)
- 7.Panajot Kupitori-Fjalori i përkundërt arvanisht/shqip-greqisht (Shqiptarët në Luftën e Dytë Botërore, vëllimi 2)

Ka një mospërputhje mes veprave të listuara në procesverbalin e Marrjes në Dorëzim dhe Fletë Hyrjes në Magazinë. Emrat e veprave të shënuara në kllapa nga Grupi i Punës i Marrjes në Dorëzim janë veprat e aprovuara më 11.10.2021 nga Këshilli i Botimeve me nënshkrim të Kryetarit S.Gj me Vendimin nr. 61, nr. 630/2 prot., “Për një zëvendësim në listën e botimeve të vitit 2021” ndërsa veprat e shkruara përpara kllapës, konkretisht “Studime Shqiptare”, “Byllis” dhe “Fjalor i përkundërt arvanisht/shqip-greqisht” janë ato të zëvendësuarat. Një pasqyrim i tillë i marrjes në dorëzim të veprave nuk është transparent dhe i kuptueshëm.

Vepra “Faik Konica, Jeta dhe Vepra” nuk figuron në listën e veprave të botuara në vitin 2021, nuk gjendet as në magazinën e ASHSH por njëkohësisht në Fletë-Hyrje listohet si një artikull që ndodhet në ASHSH. Në E-mailin e datës 12.01.2024 nga M.M konfirmohet se kjo vepër nuk është botuar në vitin 2021 dhe nuk ka hyrje për këtë vit. Kjo bie në kundërshtim me Udhëzim Nr. 30, datë 27.12.2022 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” Dokumentimi i lëvizjeve të aktiveve pika 36, konkretisht: *Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet duhet të jenë pa korrigjime, të lexueshme dhe të eliminojnë mundësinë për gabime, harresa, numërim të dyfishtë si dhe atë të mashtrimeve.*

Vepra Shqiptarët në Luftën e Dytë Botërore, Vëllimi 2-Paskal Milo

Titulli i Veprës	Urdhër-Shpenzimi	Sasia fillestare	Gjendja në magazinë	Kosto/copë
<i>Shqiptarët në Luftën e Dytë Botërore, vëllimi 2</i>	Nr. 685, datë 29.12.2021	150 copë	0 copë	480 lekë
<i>Shqiptarët në Luftën e Dytë Botërore, vëllimi 2</i>	Nr. 701, datë 31.12.2021	150 copë	85 copë	780 lekë

Të dhënat të përpunuara nga Grupi i Auditimit i KLSH



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQPËRISË

Sikurse vihet re në tabelën e mësipërme për të njëjtën vepër janë dy vlera të ndryshme. Kjo vepër jo vetëm që nuk ishte e përfshirë në DST por ka dhe një mospërputhje të vlerave të saj dhe sasisë së hyrë në institucion për vlerën 189,000 lekë. Kjo bie në kundërshtim me Ligjin 162/2020 “Për Prokurimin Publik” neni 91, pika 1 dhe 2. Koncretisht:

1. *Pas afatit përfundimtar për hapjen e ofertës nuk duhet të kryhet asnjë bisedim ndërmjet Autoritetit/entit kontraktor dhe ofertuesit për vlerën e ofertës në përputhje me parashikimet e këtij ligji.*
2. *Një ofertuesi si kusht për shpalljen fitues nuk duhet t’i kërkohet që të ndërmarrë përgjegjësi të papërcaktuara në dokumentet e tenderit të ndryshojë vlerën e ofertës së tij ose të modifikojë në çfarëdolloj mënyre ofertën.*

Zëvendësimi i tre veprave me dy vepra të tjera nuk është pasqyruar në kontratë me anë të një modifikimi të saj. Kjo bie në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020, neni 122 dhe 124. Koncretisht:

- *Kushtet e kontratës të lidhura sipas këtij ligji nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fituese, me përjashtim të rasteve kur kontraktori për arsye objektive dhe të pavarura prej tij në kohën e ofertimit ofron me të njëjtin cmim kushte më të mira se ato të tenderuara.*

- *Autoriteti ka detyrimin të ndjekë zbatimin e kontratës sipas kushteve në bazë të të cilave është nënshkruar për të garantuar se ajo zbatohet në kohën, cilësinë dhe vlerën e përcaktuar në përputhje me kushtet e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe me legjislacionin në fuqi.*

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi R.K (Kancelar), Përgjegjësi i Financës, Grupi i Marrjes në Dorëzim (F.B, A.B, E.M), N.D (Magazineri), A.B (Personi Përgjegjës për Prokurimin).

Procedura e Prokurimit “Reagentë dhe mjete konsumi për fazën 3/1 të studimit të Seroprevalencës Covid 19” e tipit e hapur e thjeshtuar

Të dhëna për tenderin:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Reagentë dhe mjete konsumi për fazën 3/1 të studimit të Seroprevalencës Covid 19”		
1.Urdhër Prokurimi nr. 36 datë 11.06.2021	3.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: NjP: Urdhër nr. 36, datë 11.06.2021 A.B – Juriste V.Xh – Përgjegjëse e Sektorit të Financës E.Sh -	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave: Urdhër nr. 37, datë 11.06.2021 N.F A.B M.P
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: E hapur e thjeshtuar		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 2,200,000 lekë Burimi i financimit Buxheti i Shtetit	6.Oferta fituese Al.M me ofertë 1,919,100 lekë (pa tvsh)	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 280,900 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 28.06.2021	9.Burimi Financimit: Buxheti i Shtetit	10.Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender: 5 OE b)S’kualifikuar – 4 OE c) Kualifikuar – 1 OE
11.Ankimime Më 07.07.2021, nr. 348/13 prot., në Akademinë e Shkencave u dërgua Formulari i Ankesës nga subjekti Al.M shpk. Në këtë ankesë subjekti pretendonte se “Sipas ligjit të procedurës së prokurimit	12. Përgjigje ankesës nga AK Me Vendimin nr. 44, datë 12.07.2021 u paraqit mospranimi i ankimit dhe iu dërgua Al.M në po të njëjtën datë me nr 348/18 prot.	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP KPP sjell Vendimin nr. 39/2021, datë 23.07.2021 ku ankesa e Al.M shpk pranohet dhe anulon vendimin e KVO. Sipas këtij Vendimi, Autoriteti Kontraktor nuk e ka specifikuar në DST



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQPËRISË

<i>publik vlerësimi i ofertave bëhet vetëm në bazë të kriterëve të përcaktuara në DST. Sipas shtojcës së DST mbi kriteret e përgjithshme dhe të vecanta të kualifikimit nuk është kërkuar paraqitja e certifikatave CE/FDA”.</i>		tipin e licencave profesionale ndaj nuk mund t’ia kërkojë operatorit.
b.Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14.Lidhja e kontratës Nr. 348/27 prot., datë 18.08.2021	15.Vlera e kontratës: Al.M – 2,302,920 lekë (me tvsh) Amendamenti i kontratës-460,584 lekë	16. Likuiduar: Likujdim datë 16.09.2021-2,302,920 lekë me TVSH Likujdimi i amendamentit datë 07.12.2021-460,584 lekë me TVSH
		Afati i kontratës zgjat 5 javë

Kjo procedurë nisi me kërkesën nga komisioni i Shëndetësisë (G.S) datë 18.05.2021 drejtuar N.F. Më pas me shkresën nr. 348 prot., datë 18.05.2021 “Kërkesë propozimi reagent dhe mjete konsumi për Fazën e Parë të projektit të Seroprevalencës Covid 19, 2021” nga Seksioni i Shkencave Natyrore dhe Teknike kjo kërkesë i përcillet Kryesisë.

Më pas me Urdhrin nr. 33, datë 11.06.2021, nr. 398/4 prot., caktohet personi përgjegjës për prokurimin A.B, kjo i dërgohet edhe APP në të njëjtën datë me shkresën nr. 348/5 prot. Më 11.06.2021 u nënshkrua Urdhri nr. 34 për “Ngritjen e Grupit të Punës për Hartimin e Specifikimeve Teknike” me anëtarë G.S, E.M dhe J.D.

Me Urdhrin nr. 35, datë 11.06.2021, nr. 348 prot., për “Ngritjen e Grupit të Punës për përllogaritjen e Fondit Limit për procedurën e prokurimit” u vendosën anëtarët të cilët janë L.T, B.Sh dhe N.D. Procesverbali i Fondit Limit nuk ka datë dhe numër protokolli. Arsyeimi pas vendosjes së vlerave është se janë mbështetur në prokurime të mëparshme por këto praktika nuk ndodhen bashkëlidhur procesverbalit. Kjo bie në kundërshtim me nenin 76, pika 2 e VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar “Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet”.Fondi limit u vendos 2,200,916.7 lekë.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi L.T, B.Sh, N.D.

Ndërkohë me Urdhrin e Prokurimit nr. 36, datë 11.06.2021 nr. 348/8 prot, u vendosën anëtarët e NJHD. Konkretisht A.B, V.Xh, E.Sh. *Formularët e Deklarimit nuk janë plotësuar për të gjithë anëtarët.* Me Urdhrin nr. 37, datë 11.06.2021, nr. 348/9 prot., për “Emërimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave” u caktuan anëtarët të cilët janë N.F(Kryetar), A.B (Anëtar) dhe M.P (Anëtar).

Me Urdhrin nr. 38 datë 18.06.2021 “Për pezullimin e vazhdimin të procedurave të prokurimit” procedura u pezulla për shkak të asistencës që u jep APP Autoritetit Kontraktor duke sugjeruar hartimin e një shtojce. Shtojca u krye datë 18.06.2021 dhe me Urdhrin nr. 39, datë 23.06.2021 pezullimi u hoq.

Më 28.06.2021 u krye hapja e ofertave të operatorëve ekonomikë nga KVO. Ofertat janë paraqitur nga 4 operatorë. Në procesverbalin mbi shqyrtimin e dokumentacionit tekniko-ligjor datë 30.06.2021, KVO shprehet se:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

1. “AL.M” SHPK nuk ka paraqitur licencë profesionale.
2. “I” SHPK nuk ka paraqitur dokumentacionin tekniko ligjor dhe ofertën ekonomike.
3. “K” SHPK ka paraqitur vetëm ekstraktin tregtar, vërtetim të sigurimeve shëndetësore dhe vërtetim tatimesh. Mungojnë të gjitha dokumentet e tjera dhe oferta.
4. “S” SHPK plotësonte të gjitha kushtet e DST.

Me shpjalljen fitues të “S” u publikua dhe Formulari i Njoftimit të Fituesit datë 01.07.2021.

Në DST certifikatat CE/FDA nuk janë përmendur në kriteret e përgjithshme dhe të vecanta të kualifikimit, ndaj mungesa e tyre nuk është kriter për skualifikim të operatorit ekonomik. Përmbushja e kërkesave të përcaktuara në specifikimet teknike të DST është pjesë e një faze të mëvonshme të procedurës. Nga ana e Akademisë së Shkencave duhet të ketë koherencë në përzgjedhjen e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta dhe arsyeve të kualifikimit ose jo të operatorëve. Kjo bie në kundërshtim me nenin 78 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku parashikohet se:

1. *Dokumentet e tenderit hartohen nga njësia e prokurimit në përputhje me këto rregulla dhe me legjislacionin në fuqi. Në hartimin e dokumenteve të tenderit, njësia e prokurimit duhet të përdorë dokumentet standarte të tenderit, sipas llojit të procedurës e tipit të kontratës.*

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi A.B, V.Xh, E.Sh.

Më 07.07.2021, nr. 348/13 prot., në Akademinë e Shkencave u dërgua Formulari i Ankesës nga subjekti Al.M shpk. Në këtë ankesë subjekti pretendonte se “*Sipas ligjit të procedurës së prokurimit publik vlerësimi i ofertave bëhet vetëm në bazë të kriterëve të përcaktuara në DST. Sipas shtojcës së DST mbi kriteret e përgjithshme dhe të vecanta të kualifikimit nuk është kërkuar paraqitja e certifikatave CE/FDA*”. Kështu Autoriteti Kontraktor pezulloi procedurën e prokurimit me Urdhrin nr. 42, datë 08.07.2021 dhe ngriti Urdhrin nr. 43 në po të njëjtën datë për “Ngritjen e Komisionit për Shqyrtimin e Ankesës së Operatorit ekonomik Al.M”. Ky komision përbëhej nga G.S, E.M dhe N.D. Me Vendimin nr. 44, datë 12.07.2021 u paraqit mospranimi i ankimit dhe iu dërgua Al.M në po të njëjtën datë me nr 348/18 prot. Më pas KPP sjell Vendimin nr. 39/2021, datë 23.07.2021 ku ankesa e Al.M shpk pranohet dhe anulon vendimin e KVO. Sipas këtij Vendimi, Autoriteti Kontraktor nuk e ka specifikuar në DST tipin e licencave profesionale ndaj nuk mund t’ia kërkojë operatorit.

Me Urdhër nr. 49, datë 26.07.2021, nr 348/20 prot., për “Heqjen nga pezullimi të procedurës së prokurimit” u krye dhe një Proces Verbal datë 26.07.2021 “Mbi rivlerësimin e Ofertës së Operatorit Al.M shpk” mbi të cilin ky operator u kualifikua përsëri. Duke qenë se vlera e ofertuar nga Al.M ishte më e ulët se vlera e ofertuar nga “S”, Al.M u shpall fitues me Formularin e Njoftimit të Fituesit datë 26.07.2021.

Më 18.08.2021, u nënshkrua Kontrata nr. 348/27. Vlera e përgjithshme e kontratës është 1,919,100 lekë (pa TVSH) dhe afati i lëvrimit nuk është i përcaktuar. Sipas nenit 3 të kontratës “*Afati i lëvrimit të mallit objekt i kontratës do të jetë nga data e lidhjes së kontratës*”. Pagesa do të kryhet jo më vonë se 30 ditë pas datës së pranimit të mallrave. Më 06.08.2021 u nënshkrua Urdhër nr. 52 “Për Mbikqyrjen e Kontratës” me anëtarë G.S, M.P dhe J.D. Procesverbali i marrjes në dorëzim nuk ka datë.

Në Urdhër Shpenzimin nr. 352 datë 16.09.2021 me vlerë 2,302,920 gjenden bashkëlidhur Urdhri i Prokurimit nr. 36 datë 11.06.2021, Formulari i Njoftimit të Fituesit datë 11.08.2021, Kontrata nr. 358/24 prot., datë 18.08.2021, Grafiku i Lëvrimit të Mallit, Formulari i Sigurimit të Kontratës,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

Urdhri nr. 52 datë 06.08.2021 “Për Ngritjen e Grupit të Punës për Zbatimin e Mbikqyrjen e Kontratës”. Fletë Hyrje nr. 37, datë 07.09.2021, Fatura nr. 33/2021, datë 07.09.2021, Procesverbal për marrjen në dorëzim pa datë dhe numër protokoll.

Më 23.09.2021 vjen një kërkesë për vazhdimin e studimit “Faza 3/2 e studimit të seroprevalencës së antitropave anti SARS-COV-2 si dhe e përgjigjes imunitare ndaj këtij virusi” drejtuar Kryetarit S.Gj nga G.S. Sipas kësaj kërkesë variant Delta shtron si nevojë imediate shtrirjen e studimit dhe në moshat nën 20 vjeç, gjë e cila nuk ishte parashikuar në projektin e kësaj faze. Gjithashtu sipas kësaj kërkesë del e nevojshme dhe studimi kompleks i efektivitetit të vaksinave që përdoren në vendin tonë. Vlera me TVSH sipas kësaj kërkesë do të ishte 460,584 lekë. Kjo vlerë është *ekzaktësisht* 20% e vlerës së kontratës fillestare.

Në njoftimin për modifikimin e marrëveshjes kuadër/kontratës gjatë zbatimit, AK shprehet se është në zbatim të nenit 127, pika 1, gërma c “kur modifikimi është bërë i nevojshëm për shkak të rrethanave të paparashikueshme nga AK dhe që nuk ndryshojnë në thelb natyrën e kontratës publike apo të marrëveshjes kuadër” dhe neni 2 “Në rastet e referuara në pikën 1, shkronjat a, b, c të këtij neni vlera totale e modifikimeve të kontratës apo marrëveshjes kuadër nuk duhet të tejkalojë 20% të vlerës së kontratës fillestare apo të marrëveshjes kuadër”.

Në datën 18.11.2021, nr. 603/1 prot. u krye Modifikim-Amendament i Kontratës. Procesverbali i marrjes në dorëzim pa datë dhe pa numër protokoll.

Procedura e prokurimit “Blerje kite/reagent për studime sero-epidemiologjike: Reagentë për studime të Nanoalb” e tipit e hapur e thjeshtuar

Të dhëna për tenderin:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Blerje kite/reagent për studime sero-epidemiologjike: Reagentë për studime të Nanoalb”		
1.Urdhër Prokurimi nr. 27 datë 08.07.2022	3.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: NjP: Urdhër nr. 27, datë 08.07.2022 M.M-Përgjegjëse e Sektorit të Financës dhe Buxhetit A.B – Juriste E.M - Specialiste	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave: Urdhër nr. 30, datë 08.07.2022 N.F M.P (K) E.P
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: E hapur e thjeshtuar		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 6,132,309 lekë Loti 1: 3,500,000 lekë Loti 2: 2,632,309 lekë Burimi i financimit Buxheti i Shtetit	6.Oferta fituese Loti 1: “S” me ofertë 3,450,000 lekë (pa tvsh) Loti 2: “K” shpk me ofertë 2,631,600 lekë (pa tvsh)	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) Loti 1: 50,000 lekë Loti 2: 709 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: Loti 1: 25.07.2022 Loti 2: 30.09.2022	9.Burimi Financimit: Buxheti i Shtetit	10.Operatoret Ekonomike Loti 1: a)Pjesëmarrës në tender: 1 OE b)S’kualifikuar – 0 OE c) Kualifikuar – 1 OE Loti 2: a)Pjesëmarrës në tender: 1 OE b)Skualifikuar-0 OE c)Kualifikuar – 1 OE
11.Ankimime S’ka	12. Përgjigje ankesës nga AK	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP
b.Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		



KONTROLLI I LARTË I SHITETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

14.Lidhja e kontratës Loti 1: nr. 493/10 prot., 05.08.2022 Loti 2: nr. 493/17 prot., datë 20.10.2022	15.Vlera e kontratës: Loti 1: “S” – 4,140,000 lekë (me TVSH) Loti 2: “K” shpk – 2,631,600 lekë (pa TVSH)	16. Likuiduar: Loti 1: Likujdim më 27.09.2022, 4,140,000 lekë me TVSH Loti 2: Likujdim pjesor më 16.12.2022, 38,400 lekë me TVSH Likujdim pjesor më 16.12.2022, 1,892,340 lekë me TVSH Likujdim pjesor më 29.12.2022, 1,227,180 lekë me TVSH
		Loti 1: Afati i kontratës deri më 30.10.2022 Loti 2: 31.12.2022

Kjo procedurë nisi në 13.06.2022 me kërkesën nr. 436 prot., nga I.M Seksioni i Shkencave Natyrore dhe Teknike (kryetar N.F) drejtuar Kryesisë ku bashkëlidhej kërkesa drejtuar Kryetarit të Seksionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike nga Qendra Kërkimore Shkencore e Bioteknologjisë dhe Gjenetikës në kuadër të ngritjes së Bankës Gjenetike. në kuadër të projektit “Historia e Shqipërisë. Më 13.06.2022, nr. 438 prot., Njësia e Nanoshkencës dhe Nanoteknologjisë Shqiptare NanoAlb dërgon specifikimet e materialeve të projekteve NanoAlb. Më 20.06.2022 i dërgohet një shkresë Kryetarit të Akademisë së Shkencave (S.Gj), për dijeni Kancelari (R.K), përgatitur nga G.S me lëndë “Mbi realizimin e Fazës IV të studimit të seroprevalencës SARS-CoV-2 në popullatën shqiptare”. Sipas kësaj shkrese, në këtë fazë të projektit është parashikuar monitorimi i përgjigjes imunitare të popullatës shqiptare të përgjithshme në periudhën aktuale qershor-korrik 2022. Bashkëlidhur kërkesës specifikimet teknike.

Më 24.06.2022 Komisioni i Mjekësisë, përfaqësuar nga G.S i ka përcjellë kryetarit të Akademisë së Shkencave shkresën me lëndë “Një ndryshim në nevojat tona në kite reagent të nevojshëm për realizimin e Fazës IV të studimit të seroprevalencës SARS-CoV-2 në popullatën shqiptare”. Sasia e përgjithshme e kërkuar mbetet e njëjtë por ndryshohet llojshmëria e tyre.

Në datën 30.06.2022 është dërguar Informacion nga Administrata drejt Kryetarit të Akademisë së Shkencave mbi procedurën e prokurimit “botime” dhe revista periodike të ASH” dhe përgatitja e dokumentacionit paraprak për procedurën e tenderimit për projektet e njësive NanoAlb, Bioteknologji. Kancelari shprehet se tenderi do të ndahet në dy lote pasi nuk është gjetur një operator ekonomik që mund të kryejë dhe të sjellë të gjitha materialet që do të përfshihen në tenderim. Konkretisht lotet do të jenë:

1. Loti 1-materiale laboratorike të 5 projekteve të NanoAlb.
2. Loti 2-materiale (kite, reagent, antigene etj.) përkatësisht të projektit të gjenetikës dhe të projektit të seriovalencës.

Në Urdhrin nr. 26, datë 08.07.2022 për “Caktimin e Personit Përgjegjës për Prokurimin” u vendos A.B me profesion specialist e burimeve njerëzore dhe juriste. Ky Urdhër iu përcoll edhe Agjencisë së Prokurimit Publik në po të njëjtën datë.

Në Urdhrin e Prokurimit nr. 27, datë 08.07.2022 nr. 493/3 prot., për “Zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt “Blerje kite/reagent për studime sero-epidemiologjike, reagent për studime të NanoAlb” u vendos:

- prokurimi i fondit limit 6,132,309 lekë (pa TVSH)
- lloji i procedurës së prokurimit: “Procedurë e hapur e thjeshtuar”



- loti 1: “Blerje kite/reagent për studime sero-epidemiologjike” me fond 3,500,000 lekë pa tvsh.
- Njësia e Hartimit të Dokumentave: M.M (Përgjegjëse e Sektorit të Buxhetit dhe Financës), A.B (Specialiste e Burimeve Njerëzore dhe Jurist, person përgjegjës), E.M (specialist).

Në Urdhrin nr. 28, datë 08.07.2022, nr. 493/4 prot. për “Ngritjen e Grupit të Punës për Hartimin e Specifikimeve Teknike për Procedurën e Prokurimit me Objekt “Blerje kite/reagent për studime sero-epidemiologjike; I.M, K.Xh, E.Sh. Detyra e këtij grupi është kryerja e hartimit të specifikimeve teknike që duhet t’i përcillet grupit të punës së përllogaritjes së fondit limit dhe Njesisë së Prokurimit. Ky grup e ka kryer procesverbalin e specifikimeve teknike për procedurën e hapur e thjeshtuar, *por nuk ka datë ose numër protokoll.*

Në Urdhrin nr. 29, datë 08.07.2022, nr. 493/5 prot., për “Ngritjen e Grupit të Punës për Përllogaritjen e Fondit Limit” janë përcaktuar pjesëmarrësit e grupit, konkretisht: M.V, L.T dhe G.S. Gjithashtu është përcaktuar se *ky grup do të kryejë përllogaritjen e fondit limit bazuar në specifikimet teknike të objektit të prokurimit të kartuara nga grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe dokumentacioni do t’i përcillet Njesisë së Prokurimit. Procesverbali i Komisionit nuk ka datë.* Sipas këtij procesverbali është testuar tregu, janë marrë oferta nga operatorë të ndryshëm dhe në bazë të prokurimeve të mëparshme është përllogaritur fondi limit. Konkretisht:

“P”, më 12.07.2022: 3,629,000 lekë pa TVSH

“E”, më 11.07.2022: 3,500,000 lekë pa TVSH

“K”, më 11.07.2022: 4,681,800 lekë pa TVSH

Grupi i Punës përllogariti fondin limit me vlerën 3,500,000 lekë. Kjo vlerë nuk përkon me mesataren e e përllogaritur të tre operatorëve që kanë sjellë ofertat e tyre. Kjo vlerë do të ishte 3,936,933 lekë. Gjithashtu nuk ka të bashkëlidhur këtij procesverbali asnjë dokumentacion që qartëson si është përllogaritur kjo vlerë duke përdorur testimin e tregut ose prokurimin e mëparshëm. Kjo bie në kundërshtim me nenin 76, pika 2 e VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar “*Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet*”.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi M.V, L.T, G.S.

Për lotin e dytë Reagentë për studime të NanoAlb nuk ka asnjë procesverbal të përllogaritjes së fondit limit. Kjo bie në kundërshtim me nenin 76, pika 2 e VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar “*Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet*”.

Urdhri i Prokurimit nr. 27, datë 08.07.2022 është në fuqi përpara ngritjes së Urdhrin nr. 29, datë 08.07.2022, nr. 493/5 prot., për “Ngritjen e Grupit të Punës për Përllogaritjen e Fondit Limit” e rrjedhimisht përpara procesverbalit të përllogaritjes së fondit limit. Kjo bie në kundërshtim me nenin 76, pika 2 e VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar “*Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet*”.

Për sa më lartë mbajnë përgjegjësi R.K (Kancelari).



Me Urdhrin nr. 30, datë 08.07.2022, nr. 493/6 prot., për “Emërimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për Procedurën e Prokurimit me Objekt “Blerje kite/reagent për studime sero-epidemiologjike; Reagentë për studime të NanoAlb”” u caktuan pjesëmarrësit N.F (kryetar), M.P (anëtar), E.P (anëtar).

Loti 1: Blerje kite/reagent për studime sero-epidemiologjike

Më 01.08.2022, nr. 493/8 prot., “S” në përgjigje të shkresës nr. 493/7 prot., datë 28.07.2022 ka vënë në dispozicion dokumentacionin tekniko-ligjor. Në datën 04.08.2022, nr. 493/9 prot., u publikua Formulari i Njoftimit të Fituesit. Sipas këtij Formulari në procedurën e tenderimit ka marrë pjesë vetëm operatori “S” shpk që ka ofertuar vlerën 3,450,000 lekë pa TVSH.

Mungon një Procesverbal nga ana e KVO mbi hapjen e procedurës dhe vlerësimin e ofertave. Në kundërshtim me VKM 285, datë 19.05.2021 për “Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 2, pika 1 dhe neni 80 pika 4.

Mungon Raporti Përmbledhës, në kundërshtim me VKM 285, neni 84. Për sa më sipër mban përgjegjësi KVO; N.F(kryetar), M.P (Kurti) (anëtar), E.P (anëtar) dhe R.K (Kancelar).

Pjesa tjetër e kësaj procedure është audituar nga grupi i auditimit dhe rezulton e rregullt.

Loti 2: Reagentë për studime të NanoAlb

Më 24.08.2022 është nënshkruar një Relacion për “Anullimin e Lotit 2: Reagentë për studime të NanoAlb”. Në këtë procesverbal shprehen se kjo procedurë është hedhur dy herë në SPE dhe ka dështuar pasi nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme sipas kërkesave të autoritetit kontraktor, të specifikuar në DST. Ky relacion është nënshkruar nga Njësia e Prokurimit dhe jo nga KVO, ndërkohë që është pikërisht KVO që merret me procedurën e hapjes, vlerësimit të ofertave dhe shpalljes së fituesit. Kjo bie në kundërshtim me VKM nr. 285 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 75, pika 4: Komisioni është përgjegjës për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave. Nga ana e KVO mungojnë procesverbale mbi hapjen e procedurës dhe vlerësimin e ofertave të ardhura.

Në DST, në pikën “Kriteret e vecanta të kualifikimit” pika 2.1/a AK përcakton “Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatën ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalent, ose/dhe ISO 13485:2016 mbi “Sistemin e menaxhimit të cilësisë për pajisjet mjekësore ose ekuivalent” lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit”. Kjo bie në kundërshtim me Ligjin 162/2020 “Për Prokurimin Publik” neni 3. Konkretisht: Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

Më pas, më 16.09.2022 është kryer një procesverbal nga NJHD për Argumentimin dhe Miratimin e Specifikimeve Teknike dhe Kriteve për Kualifikim.

Më 03.10.2022, nr. 493/13 prot., është kryer Raporti Përmbledhës, miratuar nga Zyrtari i Autorituzar i Autoritetit Kontraktor R.K. Sipas këtij raporti, më 30.09.2022, ora 12:00 KVO hynë në sistem dhe bënë hapjen e ofertave, ku është paraqitur vetëm një operator ekonomik, përkatësisht “K” shpk me ofertë 2,631,600 lekë pa TVSH. Më 03.10.2022 AK ka njoftuar operatorin ekonomik mes SPE mbi rezultatet e vlerësimit të KVO dhe njoftimi i fituesit është bërë më 04.10.2022. Më 10.10.2022 është publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 139, datë 10.10.2022 “Formulari i Njoftimit të Fituesit”.

Në dosjen e procedurës së prokurimit ndodhet shkresa nr. 493/16 prot., ardhur në 20.10.2022 ku “K” ka dorëzuar dokumentacionin për tenderin, por ky dokumentacion nuk gjendet në institucion. Kjo konfirmohet dhe me e-mailin zyrtar dërguar Grupit të Auditimit të KLSH nga Personi Përgjegjës i Prokurimit A.B ku pranohet se ky dokumentacion nuk gjendet në institucion



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

për shkak të lëvizjeve të zyrave dhe faktit që nuk ishte arkivuar. Kjo bie në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimet Publike”, neni 21 pika 2:

Autoriteti ose enti kontraktor administron të gjithë dokumentacionin për procedurën e prokurimit, duke filluar nga planifikimi deri te zbatimi i kontratës, me qëllim kontrollin e zbatimit të ligjit.

Gjithashtu bie në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 2, pika 2/j:

Për çdo procedurë prokurimi autoriteti ose enti kontraktor duhet të dokumentojë të paktën j) administrimin dhe verifikimin e dokumentacionit të operatorit ekonomik fitues në formë shkresore përpara nënshkrimit të kontratës ose përpara nënshkrimit të marrëveshjes kuadër nga organi qendror blerës.

Pjesa tjetër e kësaj procedure është audituar nga grupi i auditimit dhe rezultoi e rregullt.

Procedura e prokurimit “Pajisje për laboratorin e biologjisë molekulare të qendrës bioteknologjisë dhe gjenetikës” e tipit e hapur e thjeshtuar.

Të dhëna për tenderin:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Pajisje për laboratorin e biologjisë molekulare të qendrës së bioteknologjisë dhe gjenetikës”		
1.Urdhër Prokurimi nr. 44 datë 22.09.2022	3.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: NjP: Urdhër nr. 44, datë 22.09.2022 M.M-Përgjegjëse e Sektorit të Financës dhe Buxhetit A.B – Juriste E.M – Specialiste	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave: Urdhër nr. 46, datë 22.09.2022 I.M N.F M.P
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: E hapur e thjeshtuar		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 6,830,000 lekë Burimi i financimit Buxheti i Shtetit	6.Oferta fituese “K” me ofertë 6.566.500 lekë (pa TVSH)	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 263,500 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 05.10.2022	9.Burimi Financimit: Buxheti i Shtetit	10.Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender: 2 OE b)S’kualifikuar – 1 OE c) Kualifikuar – 1 OE
11.Ankimime S’ka	12. Përgjigje ankesës nga AK	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP
b.Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14.Lidhja e kontratës 100/12 prot., datë 18.11.2022	15.Vlera e kontratës: “K” shpk-7,879,800 lekë	16. Likuiduar: Likujdim pjesor më 27.09.2022, 4,108,920 lekë me TVSH Likujdim pjesor më 27.09.2022, 3,770,800 lekë me TVSH
		Loti 1: Afati i kontratës deri më 31.12.2022

Kjo procedurë nisi në 03.02.2021 me shkresën drejtuar Kryesisë nr. 100 prot., ku përcillet kërkesa e ardhur me postë elektronike për pajisjet e Qendrës së Bioteknologjisë. Në këtë e-mail konceptuar nga I.M dhe G.S listohen parashikimet e shpenzimeve për laboratorin të ndara në Pajisje dhe Mjetet e Konsumit. Vlera totale pa tvsh parashikohet 6,827,600 lekë. Më 04.02.2022, nr. 100.1 prot., u realizua shkresa nga E.K, I.M dhe G.S mbi “Disa objektiva parësore në lidhje me veprimtarinë kërkimore në Qendrën Kërkimore të Bioteknologjisë dhe Gjenetikës” ku lisohej ndër të tjera dhe



pajisja me aparaturat dhe reagentët e domosdoshëm të Laboratorit të Antropogjenetikës për fillimin e hapave të punëve kërkimore.

Në Urdhrin nr. 42, datë 22.09.2022 për “Caktimin e Personit Përgjegjës për Prokurimin” u vendos A.B me profesion specialist e burimeve njerëzore dhe juriste. Ky Urdhër iu përcoll edhe Agjencisë së Prokurimit Publik në po të njëjtën datë.

Në Urdhrin nr. 43, datë 22.09.2022, nr. 100/4 prot. për “Ngritjen e Grupit të Punës për Hartimin e Specifikimeve Teknike për Procedurën e Prokurimit me Objekt “Pajisje për laboratorin e biologjisë molekulare të qendrës bioteknologjisë dhe gjenetikës” u vendosën G.S, E.Sh, A.Dh. Detyra e këtij grupi është kryerja e hartimit të specifikimeve teknike që duhet t’i përcillet grupit të punës së përllogaritjes së fondit limit dhe Njesisë së Prokurimit.

Në Urdhrin e Prokurimit nr. 44, datë 22.09.2022, nr. 100/5 prot., “Për Procedurën e Prokurimit me Objekt “Blerje pajisje për laboratorin e qendrës së bioteknologjisë dhe gjenetikës”” u urdhërua:

- prokurimi i fondit limit 6.830.000 lekë (pa TVSH)
- lloji i procedurës së prokurimit: “Procedurë e hapur e thjeshtuar”
- Njësia e Hartimit të Dokumentave: M.M (përgjegjëse e sektorit të buxhetit dhe financës), A.B (Specialiste e Burimeve Njerëzore dhe Jurist, person përgjegjës), E.M (specialist)

Vihet re se Urdhri i Prokurimit është nënshkruar përpara Urdhrit për “Ngritjen e Punës për Përllogaritjen e Fondit Limit”. Kjo bie në kundërshtim me nenin 76, pika 2 e VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar “Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet”.

Në Urdhrin nr. 45, datë 22.09.2021, nr. 100/6 prot., për “Ngritjen e Grupit të Punës për Përllogaritjen e Fondit Limit” janë vendosur J.D, L.T, G.V. Nuk ndodhen Formularët e Deklarimit të anëtarëve të grupit. Procesverbali i përgatitur nga ky grup pune nuk ka datë, numër protokollit dhe firma të kryetarit dhe anëtarëve të komisionit. Në procesverbal ata shprehen se kanë testuar tregun dhe kanë marrë oferta nga operatorë të ndryshëm e në bazë të prokurimeve të mëparshme kanë përllogaritur fondin limit. Ofertat e administruara nga Grupi i Punës janë:

1. “P” shpk 6,920,200 lekë (pa TVSH)
2. “K” shpk 6,666,500 lekë (pa TVSH)
3. “K” shpk 6,820,600 lekë (pa TVSH)
4. “E” shpk 6,903,500 (pa TVSH)

Këto oferta nuk kanë datë dhe numër protokollit nga ana e Akademisë së Shkencave. Gjithashtu i njëjti ofertues, konkretisht operatori “K” shpk, ka dorëzuar për të njëjtat zëra dy oferta të ndryshme, me vlerë me TVSH të njëjtë (8,193,120 lekë) dhe vlerë pa tvsh të ndryshme (përkatesisht 6,666,500 lekë dhe 6,820,600 lekë). Në të dyja ofertat e “K” shpk, vlera totale me TVSH nuk përkon me ato pa TVSH, pasi për ofertën e parë 6,666,500 lekë vlera duhet të ishte 7,999,800 lekë dhe për ofertën e dytë 6,820,600 lekë 8,184,720 lekë.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi J.D, L.T, G.V.

Me Urdhrin nr. 46, datë 22.09.2022, nr. 100/7 prot., për “Emërimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për Procedurën e Prokurimit me Objekt “Blerje Pajisje për laboratorin e qendrës së bioteknologjisë dhe gjenetikës” u caktuan pjesëmarrësit I.M (kryetar), N.F(anëtar), M.P (anëtar). Nuk ndodhen të gjithë Formularët e Deklarimit të anëtarëve.

Në datën 22.09.2022 është kryer procesverbali për “Argumentimin dhe Miratimin e Specifikimeve Teknike dhe Kriteve për Kualifikim. Më pas procedura është hedhur në sistem dhe është hapur më 05.10.2022. Më 26.10.2022 është publikuar Formulari i Njoftimit të Fituesit. Nga ana e KVO



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQPËRISË

nuk ka asnjë Procesverbal mbi hapjen e ofertave, zgjedhjen e fituesit në datat ekzakte të kryerjes së këtyre procedurave. Në kundërshtim me VKM 285, datë 19.05.2021 për “Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 2, pika 1 dhe neni 80 pika 4.

Pjesa tjetër e kësaj procedure është audituar nga grupi i auditimit dhe rezulton e rregullt.

Procedura e prokurimit “Blerje pajisje dhe materiale NanoAlb; Blerje materiale laboratorike për NanoAlb” e tipit e hapur e thjeshtuar.

Të dhëna për tenderin:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Blerje pajisje dhe materiale NanoAlb; Blerje materiale laboratorike për NanoAlb”		
1.Urdhër Prokurimi nr. 31 datë 04.05.2023	3.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: NjP: Urdhër nr. 31, datë 04.05.2023 A.B – Juriste E.M – Specialiste A.B – Koordinatorë	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave: Urdhër nr. 32, datë 05.05.2023 N.F M.V K.Xh
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: E hapur e thjeshtuar		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 4,564,700 lekë Loti 1: 3,112,224 lekë Loti 2: 1,452,476 lekë Burimi i financimit Buxheti i Shtetit	6.Oferta fituese Loti 1: “K” me ofertë 3,081,000 lekë (pa tvsh) Loti 2: “K” me ofertë 1,415,000 lekë (pa TVSH)	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) Loti 1: 31,224 lekë Loti 2: 37,476 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: Loti 1:16.06.2023 Loti 2: 16.06.2023	9.Burimi Financimit: Buxheti i Shtetit	10.Operatorët Ekonomike Loti 1: a)Pjesëmarrës në tender: 1 OE b)S’kualifikuar – 0 OE c) Kualifikuar – 1 OE Loti 2: a)Pjesëmarrës në tender: 1 OE b)S’kualifikuar – 0 OE c) Kualifikuar – 1 OE
11.Ankimime S’ka	12. Përgjigje ankesës nga AK	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP
b.Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14.Lidhja e kontratës Loti 1: Nr. 380/13 prot., datë 27.07.2023 Loti 2: 380/14 prot., datë 27.07.2023	15.Vlera e kontratës: Loti 1: “K” – 3,697,200 lekë Loti 2: “K”– 1,698,000 lekë	16. Likuiduar: Loti 1: likuidim datë 18.10.2023-3,697,200 lekë me TVSH Loti 2: Likuidim pjesor më 19.12.2023, 1,698,000 lekë me TVSH
		Afati i kontratës nga data e lidhjes së kontratës deri më 15.12.2023

Mungon një kërkesë për nisjen e procedurës që bie në kundërshtim me VKM 285 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 2, pika 2/a. Konkretisht: *Për çdo procedurë prokurimi autoriteti/enti kontraktor duhet të dokumentojë të paktën një përshkrim të shkurtër të mallrave, punëve ose shërbimeve që do të prokurohen ose të nevojës për prokurim për të cilën autoriteti/enti kontraktor ka vendosur nisjen e procedurës.*

Në Urdhrin nr. 28, datë 04.05.2023 për “Caktimin e Personit Përgjegjës për Prokurimin” u vendos A.B me profesion specialist e burimeve njerëzore dhe juriste. Ky Urdhër iu përcoll edhe Agjencisë së Prokurimit Publik në po të njëjtën datë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQPËRISË

Në Urdhrin nr. 29, datë 04.05.2023, nr. 380/2 prot. për “Ngritjen e Grupit të Punës për Hartimin e Specifikimeve Teknike për Procedurën e Prokurimit me Objekt “Blerje pajisje dhe materiale NanoAlb; Blerje materiale laboratorike për NanoAlb” u vendosën L.V, AB, G.V. Detyra e këtij grupi është kryerja e hartimit të specifikimeve teknike që duhet t’i përcillet grupit të punës së përllogaritjes së fondit limit dhe Njesisë së Prokurimit. Formulari i deklarimit nuk është nënshkruar nga të tre anëtarët e grupit të punës.

Në Urdhrin nr. 30, datë 04.05.2023, nr. 380/3 prot., për “Ngritjen e Grupit të Punës për Përllogaritjen e Fondit Limit” janë vendosur P.M (NanoAlb), A.Dh (koordinatore Qendra e projekteve dhe koordinimi i kërkimit shkencor), L.T (sektori i buxhetit dhe financës). *Nuk ndodhen Formularët e Deklarimit e të gjithë anëtarëve të grupit.* Bashkëlidhur Urdhrit ndodhen vetëm 3 oferta të cilat nuk kanë datë dhe numër protokoll nga ana e Akademisë së Shkencave, konkretisht:

- EV F. shpk 3,054,890 lekë pa TVSH
- “K” shpk 3,107,000 lekë pa TVSH
- “E” 3,174,782 lekë pa TVSH

Mungesa e një procesverbali të mirëfilltë ku llogaritet fondi limit bie në kundërshtim me nenin 76, pika 2 e VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar “*Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet*”.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi P.M, A.Dh, L.T.

Në Urdhrin e Prokurimit nr. 31, datë 04.05.2023, nr. 380/4 prot., “Për Procedurën e Prokurimit me Objekt “Blerje pajisje dhe materiale NanoAlb; Blerje materiale laboratorike për NanoAlb” u urdhërua:

- prokurimi i fondit limit 4,564,700 lekë (pa TVSH)
- loti 1 “Blerje pajisje për NANOAlb” me fond 3,112,224 lekë pa TVSH
- loti 2 “Blerje materiale laboratorike për NANOAlb” me fond 1,452,476 lekë pa TVSH
- lloji i procedurës së prokurimit: “Procedurë e hapur e thjeshtuar” i ndarë në dy lote
- Njësia e Hartimit të Dokumentave: A.B (Specialiste e Burimeve Njerëzore dhe Jurist, person përgjegjës), E.M (specialist), A.B (koordinatore, Qendra e projekteve dhe koordinimit të kërkimit shkencor).

Me Urdhrin nr. 32, datë 05.05.2023, nr. 380/5 prot., për “Emërimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për Procedurën e Prokurimit me Objekt “Blerje pajisje dhe materiale NanoAlb; Blerje materiale laboratorike për NanoAlb” u caktuan pjesëmarrësit N.FSSHNT (kryetar), M.V NANOAlb (anëtar), K.Xh NANOAlb (anëtar).

Pjesa tjetër e kësaj procedure është audituar nga grupi i auditimit dhe rezulton e rregullt.

Procedura e prokurimit “Blerje materiale laboratorike për projektin Cellstam; Blerje pajisje për projektet Cellstam, HG Gjiri i Vlorës, Cryofruit” e tipit e hapur e thjeshtuar.

Të dhëna për tenderin:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “ <i>Blerje materiale laboratorike për projektin Cellstam; Blerje pajisje për projektet Cellstam, HG Gjiri i Vlorës, Cryofruit</i> ”		
1.Urdhër Prokurimi nr. 40 datë 18.07.2023	3.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: NjP: Urdhër nr. 40, datë 18.07.2023 A.B – Juriste	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave: Urdhër nr. 41, datë 18.07.2023 N.F



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: E hapur e thjeshtuar 2 Lote	E.M – Specialiste A.B (koordinatore Qendra e Projekteve dhe e Koordinimit të Kërkimit Shkencor)	I.M V.S
5.Fondi Limit (pa tvsh) Loti 1: 3,300,000 lekë Loti 2: 4,216,000 lekë Burimi i financimit Buxheti i Shtetit	6.Oferta fituese Loti 1: “K” me ofertë 3,278,000 lekë (pa TVSH) Loti 2: “K” me ofertë 4,198,000 lekë (pa TVSH)	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) Loti 1: 22,000 lekë Loti 2: 18,000 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: Loti 1: 07.08.2023 Loti 2: 07.08.2023	9.Burimi Financimit: Buxheti i Shtetit	10.Operatoret Ekonomike Loti 1: a)Pjesëmarrës në tender: 1 OE b)S’kualifikuar – 0 OE c) Kualifikuar – 1 OE Loti 2: a)Pjesëmarrës në tender: 1 OE b)S’kualifikuar – 0 OE c) Kualifikuar – 1 OE
11.Ankimime S’ka	12. Përgjigje ankesës nga AK	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP
b.Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14.Lidhja e kontratës Loti 1: nr. 574/12 prot., datë 31.08.2023 Loti 2: 574/14 prot., datë 19.09.2023	15.Vlera e kontratës: Loti 1: “K”-3,278,000 lekë (pa TVSH) Loti 2: “K”-4,198,000 lekë (pa TVSH)	16. Likuiduar: Loti 1: Likujdim pjesor më 16.11.2023, 1,786,000 lekë me TVSH Likujdim pjesor më 18.12.2023, 2,061,600 lekë me TVSH Likujdim pjesor më 21.12.2023, 85,800 lekë me TVSH Loti 2: Likujdim pjesor më 17.11.2023, 4,188,000 lekë me TVSH Likujdim pjesor më 18.12.2023, 849,600 lekë me TVSH
		Afati i kontratës deri më 20.12.2023

Kjo procedurë nisi me Vendimin nr, 14 të datës 11.04.2023, nr. 309 prot., nga Kryesia nënshkruar nga Kryetari S.Gj. “Për miratimin e projekteve shkencore të qendrës kërkimore të Bioteknologjisë dhe Gjenetikës, Komisionit të Inxhinierisë dhe Komisionit të Fizikës dhe Kimisë pranë ASH për periudhën 2023-2024”. Në vijim, më 12.04.2023, nr. 312 prot., me kërkesën drejtuar Administratorit R.K nga Seksioni i Shkencave Natyrore dhe Teknike Qendra Kërkimore e Bioteknologjisë dhe Gjenetikës kërkohet prokurimi i reagentëve të nevojshëm për projektin Cellstam në kuadrin e aktivitetit kërkimor. Bashkëlidhur kësaj kërkesë ndodhet lista e materialeve që kërkohen, specifikimet e tyre, sasia dhe vlera për secilin zë.

Në kërkesën e dërguar mungon një prej firmave të përpiluesve të shkresës.

Në Urdhrin nr. 37, datë 18.07.2023, nr.574 prot., për “Caktimin e Personit Përgjegjës për Prokurimin” u vendos A.B me profesion specialiste e burimeve njerëzore dhe juriste. Ky Urdhër iu përcoll edhe Agjencisë së Prokurimit Publik në po të njëjtën datë.



Në Urdhrin nr. 38, datë 18.07.2023, nr. 574/2 prot. për “Ngritjen e Grupit të Punës për Përlllogaritjen e Fondit Limit” janë caktuar I.M (Bioteknologji dhe Gjenetikë), E.P (Projekti Cryofruit), N.D (Sektori i Buxhetit dhe Financës).

Në këtë urdhër është përcaktuar se *ky grup do të kryejë përlllogaritjen e fondit limit bazuar në specifikimet teknike të objektit të prokurimit të hartuara nga grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe dokumentacioni do t’i përcillet Njësisë së Prokurimit*. Grupi i Punës nuk ka kryer asnjë aktivitet dhe nuk është dokumentuar arsyetimi pas vendosjes së këtij fondi limit. Kjo bie në kundërshtim me nenin 76, pika 2 e VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar “Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet”.

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi I.M, E.P, N.D.

Në Urdhrin nr. 39, datë 18.07.2023, nr. 574/3 prot. për “Ngritjen e Grupit të Punës për Hartimin e Specifikimeve Teknike për Procedurën e Prokurimit me Objekt “Blerje materiale laboratorike për projektin Cellstam; Blerje pajisje për projektet Cellstam, HG Gjiri i Vlorës, Cryofruit”” u vendosën G.S, M.K, E.Sh. Detyra e këtij grupi është kryerja e hartimit të specifikimeve teknike që duhet t’i përcillet grupit të punës së përlllogaritjes së fondit limit dhe Njësisë së Prokurimit. Në dosjen e procedurës nuk ka asnjë procesverbal të aktivitetit të këtij grupi. Kjo bie në kundërshtim me VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” neni 2, pika 2/c. Konkretisht: *Për cdo procedurë prokurimi Autoriteti/enti kontraktor duhet të dokumentojë të paktën c)argumentimin e kritereve për kualifikim dhe specifikimet teknike të përcaktuara në procedurën e prokurimit*.

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi G.S, M.K, E.Sh.

Në Urdhrin e Prokurimit nr. 40, datë 18.07.2023, nr. 574/4 prot., “Për Procedurën e Prokurimit me Objekt “Blerje materiale laboratorike për projektin Cellstam; Blerje pajisje për projektet Cellstam, HG Gjiri i Vlorës, Cryofruit”” u urdhërua:

- prokurimi i fondit limit 7,516,000 lekë (pa TVSH)
- loti 1: Blerje materiale laboratorike për projektin Cellstam: 3,300,000 lekë (pa TVSH)
- loti 2: Blerje pajisje për projektet Cellstam, HG Gjiri i Vlorës, Cryofruit: 4,216,000 lekë (pa TVSH)
- lloji i procedurës së prokurimit: “Procedurë e hapur e thjeshtuar”
- Njësia e Hartimit të Dokumentave: A.B (Specialiste e Burimeve Njerëzore dhe Jurist, person përgjegjës), E.M (specialist), A.B (koordinatore Qendra e Projekteve dhe e Koordinimit të Kërkimit Shkencor)

Me Urdhrin nr. 41, datë 18.07.2023, nr. 574/5 prot., për “Emërimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për Procedurën e Prokurimit me Objekt “Blerje materiale laboratorike për projektin Cellstam; Blerje pajisje për projektet Cellstam, HG Gjiri i Vlorës, Cryofruit”” u caktuan pjesëmarrësit N.FSSHNT (kryetar), I.M (anëtar), V.S Bioteknologji dhe Gjenetikë (anëtar).

Pjesa tjetër e kësaj procedure është audituar nga grupi i auditimit dhe rezulton e rregullt.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

Titulli i gjetjes nr. 1	Prokurimi i mallrave të cilat nuk janë përfshirë në kërkesën fillestare për nisjen e procedurës.
Situata:	Në procedurën “Blerje pajisje Elektronike” kryer në vitin 2021 ndër të tjera janë prokuruar dhe dy kondicionerë. Në procesverbalin për Hartimin e Specifikimeve Teknike (i cili nuk ka datë dhe numër protokolli) hartuar nga grupi i punës gjenden të listuar dy kondicionerë të cilët nuk kanë qenë pjesë e Kërkesës nr. 407 prot., datë 11.06.2021 drejtuar Kryetarit të ASHSH mbi nisjen e kësaj procedure. Gjithashtu kondicionerët nuk janë të parashikuar në CPV-të e Regjistrit të Parashikimeve, zëri “Blerje pajisje elektronike” dhe nuk gjendet e shpjeguar nevoja për to dhe korrelacioni mes objektit të prokurimit i cili kryhet në kuadër të projekteve “Historia e Shqipërisë”, “Fjalori i madh i gjuhës shqipe” dhe këtij artikulli të prokuruar.
Kriteri:	<i>VKM 285, datë 19.05.2021 për “Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 1, pika 2 .</i>
Ndikimi/Efekti:	Pjesëmarrja e një numri më të ulët operatorësh ekonomik duke qenë se në një prokurim që përmban skaner, usb, PC, server etj. përfshihen dhe kondicionerë, të cilët janë pajisje elektro-shtëpiake.
Shkaku:	Mos vëmendje e duhur institucionale.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandime:	Çdo mall/shërbim që do të jetë pjesë e një procedure prokurimi duhet të shoqërohet me arsyetimin pas përfshirjes së tij në procedurë dhe nevojës së institucionit për të. Nëse një mall/shërbim nuk është i përfshirë në kërkesën fillestare duhet të ketë një shkresë tjetër që vërteton nevojën për të.

Titulli i gjetjes nr. 2	Problematika në hartimin e Procesverbalit të Përlllogaritjes së Fondit Limit.
Situata:	<p>Në procedurën “Blerje pajisje Elektronike” kryer në vitin 2021 Grupi i Punës për Përlllogaritjen e Fondit Limit nuk ka dokumentuar veprimet në lidhje me fondin limit të vendosur prej 3,023,000, lekë, sa miratuar nga Buxheti i Shtetit dhe përfshire në regjistrin e parashikimit të prokurimeve publike.</p> <p>-Në procedurën Shtypje libra studimorë dhe revista periodike për vitin 2021” Grupi i Punës për Përlllogaritjen e fondit Limit nuk ka vendosur asnjë argument dhe bazë mbi çmimet e vëna për botimet.</p> <p>-Në procedurën “Reagentë dhe mjete konsumi për fazën 3/1 të studimit të Seroprevalencës Covid 19”: Procesverbali i Fondit Limit nuk ka datë dhe numër protokolli. Arsyetimi pas vendosjes së vlerave është se janë mbështetur në prokurime të mëparshme por këto praktika nuk ndodhen bashkëlidhur procesverbalit.</p> <p>-Në procedurën “Blerje kite/reagent për studime sero-epidemiologjike: Reagentë për studime të Nanoalb” loti 1: Sipas procesverbalit të përlllogaritjes së fondit limit është testuar tregu, janë marrë oferta nga operatorë të ndryshëm dhe në bazë të prokurimeve të mëparshme është përlllogaritur fondi limit. Grupi i Punës përlllogariti fondin limit me vlerën 3,500,000 lekë. Kjo vlerë</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

	<p>nuk përkon me mesataren e përlloritur të tre operatorëve që kanë sjellë ofertat e tyre. Kjo vlerë do të ishte 3,936,933 lekë. Gjithashtu nuk ka të bashkëlidhur këtij procesverbal asnjë dokumentacion që qartëson si është përlloritur kjo vlerë duke përdorur testimin e tregut ose prokurimin e mëparshëm.</p> <p>-Për lotin e dytë të procedurës “Blerje kite/reagent për studime sero-epidemiologjike: Reagent për studime të Nanoalb nuk ka asnjë procesverbal të përlloraritjes së fondit limit.</p> <p>-Në procedurën “Pajisje për laboratorin e biologjisë molekulare të qendrës bioteknologjike dhe gjenetikës”: Në procesverbalin për përlloraritjen e fondit limit shprehen se kanë testuar tregun dhe kanë marrë oferta nga operatorë të ndryshëm e në bazë të prokurimeve të mëparshme kanë përlloritur fondin limit. Ofertat e administruara nga Grupi i Punës janë katër. Këto Oferta nuk kanë datë dhe numër protokoll nga ana e Akademisë së Shkencave. Gjithashtu i njëjti ofertues, ka dorëzuar për të njëjtat zëra dy oferta të ndryshme.</p> <p>-Në procedurën “Blerje materiale laboratorike për projektin Cellstam; Blerje pajisje për projektet Cellstam, HG Gjiri i Vlorës, Cryofruit” Grupi i Punës për përlloraritjen e fondit limit nuk ka kryer asnjë aktivitet dhe nuk është dokumentuar arsyetimi pas vendosjes së këtij fondi limit.</p> <p>-Në procedurën Blerje pajisje dhe materiale NanoAlb; Blerje materiale laboratorike për NanoAlb”: Bashkëlidhur Urdhrit nr. 30, datë 04.05.2023, nr. 380/3 prot., për “Ngritjen e Grupit të Punës për Përlloraritjen e Fondit Limit” ndodhen vetëm 3 oferta të cilat nuk kanë datë dhe numër protokoll nga ana e Akademisë së Shkencave dhe mungon një procesverbal i mirëfilltë ku llogaritet fondi limit.</p>
Kriteri:	<i>VKM 285, datë 19.05.2021 për “Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 76, pika 1 dhe 2.</i>
Ndikimi/Efekti:	Mungesa e dokumentimit të përlloraritjes së fondit limit lë hapësira për interpretim dhe “K” paqartësi mbi vlerën e vendosur. Risk për keq menaxhim të fondeve publike.
Shkaku:	Mos kryerja e saktë e detyrave të përcaktuara në Urdhrat e brendshëm të institucionit.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Për çdo procedurë prokurimi Grupi i Punës për Përlloraritjen e Fondit Limit duhet të realizojë një argumentim të saktë dhe të dokumentuar të vlerës së vendosur, me anë të një procesverbal dhe duke bashkëlidhur kontrata të kaluara nëse vlerat merren në këtë mënyrë, oferta të ardhura nga operatorë ekonomikë me numër protokoll, datë dhe përlloraritjet aritmetike të kryera për vlerën përfundimtare.
Titulli i gjetjes nr. 3	Parregullsi në dosjet e procedurave të prokurimit të ASHSH.
Situata 1:	Në shumë prej procedurave mungojnë formularët e deklarimit të anëtarëve të grupeve të punës ose komisioneve.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

Situata 2:	-Në Procedurat e Prokurimit “Blerje Pajisje Elektronike”, “Blerje kite/reagent për studime sero-epidemiologjike: Reagentë për studime të Nanoalb”, Pajisje për laboratorin e biologjisë molekulare të qendrës së bioteknologjisë dhe gjenetikës mungon një Procesverbal nga ana e KVO mbi hapjen e procedurës dhe vlerësimin e ofertave.
Situata 3:	-Në Procedurën e Prokurimit “Blerje Pajisje Elektronike”, “Blerje kite/reagent për studime sero-epidemiologjike: Reagentë për studime të Nanoalb” mungon Raporti Përmbledhës.
Situata 4:	-Parregullsi të firmave në procesverbalet nga grupet e punës dhe komisionet e njësitë e procedurave të prokurimit.
Situata 5:	-Në Procedurën “Blerje kite/reagent për studime sero-epidemiologjike: Reagentë për studime të Nanoalb” Urdhri i Prokurimit nr. 27, datë 08.07.2022 është në fuqi përpara ngritjes së Urdhrit nr. 29, datë 08.07.2022, nr. 493/5 prot., për “Ngritjen e Grupit të Punës për Përlllogaritjen e Fondit Limit” e rrjedhimisht përpara procesverbalit të përlllogaritjes së fondit limit.
Situata 6:	-Në Procedurën “Pajisje për laboratorin e biologjisë molekulare të qendrës së bioteknologjisë dhe gjenetikës” vihet re se Urdhri i Prokurimit nr. 44, datë 22.09.2022 daton përpara Urdhrit për “Ngritjen e Punës për Përlllogaritjen e Fondit Limit” nr. 45, datë 22.09.2021, nr. 100/6 prot.-Në Procedurën “Blerje materiale laboratorike për projektin Cellstam; Blerje pajisje për projektet Cellstam, HG Gjiri i Vlorës, Cryofruit” me Urdhrin nr. 39, datë 18.07.2023, nr. 574/3 prot. për “Ngritjen e Grupit të Punës për Hartimin e Specifikimeve Teknike për Procedurën e Prokurimit u vendosën G.S, M.K (P.), E.Sh. Në dosjen e procedurës nuk ka asnjë procesverbal të aktivitetit të ktij grupi mbi hartimin e specifikimeve teknike.
Situata 7:	-Në Procedurën “Blerje pajisje dhe materiale NanoAlb; Blerje materiale laboratorike për NanoAlb” mungon një kërkesë për nisjen e procedurës, rradhitja e materialeve dhe pajisjeve që do të prokurohen, arsyeja për kërkesën e tyre etj.
Kriteri:	<i>-VKM 285, datë 19.05.2021 për “Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 73, pika 4</i> <i>- VKM 285, datë 19.05.2021 për “Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” neni 2, pika 1 dhe neni 80 pika 4</i> <i>-VKM 285, datë 19.05.2021 për “Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 84</i> <i>- VKM 285, datë 19.05.2021 për “Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 76, pika 2</i> <i>- VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” neni 2, pika 2/c</i> <i>- Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimet Publike”, neni 21 pika 2:</i> <i>-VKM 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 2, pika 2/a</i>
Ndikimi/Efekti:	Mungesë transparence në dosjet e prokurimit. Procedurat nuk janë të plota dhe me të gjithë hapat e nevojshëm.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

Shkaku:	Neglizhenca e personit përgjegjës të prokurimit dhe nëpunësve të tjerë për përmbushjen e të gjitha detyrave të tyre.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Nga ana e ASH të merren masat që procesverbalet, apo raportet e nevojshme mbajtur gjatë procedurës së vlerësimit të ofertave, të hartohen në përputhje me kërkesat e akteve nënligjore të fushës së prokurimeve me fondet publike.

Titulli i gjetjes nr. 4	Parregullsi në shpalljen e fituesit të procedurës së prokurimit “Blerje Pajisje Elektronike”.
Situata:	<p>Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga subjekti S.Co, njëkohësisht dhe fituesi i kësaj procedure u konstatua se mungonin disa nga dokumentet të cilat janë paraqitur në SPE por jo fizikisht në ASH, konkretisht:</p> <p>-Kriteret e përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit: ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së. f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interes sipas legjislacionit në fuqi. g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës. gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi. h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi. i) Operatori Ekonomik nuk ka cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik gjatë kohës që ky vendim është në fuqi në kundërshtim me “Ligji për Prokurimin Publik” 162/2020 neni 82, pika 5 dhe VKM 285 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, neni 26, pika 6.</p>
Kriteri:	<i>-VKM 285, datë 19.05.2021 për “Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 25.</i>
Ndikimi/Efekti:	Mos përmbushja e kriterëve të përcaktuara në DST mund të sjellë mos realizim në kohë dhe cilësi të kontratës.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e grupit të KVO mbi kontrollin e dokumentave të OE fitues.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Akademia e Shkencave të marrë masa dhe verifikojë para publikimit të njoftimit të fituesit dokumentacionin e operatorit fitues për plotësimin e kërkesave të DST dhe ta dokumentojë këtë me anë të shkresave përkatëse të cilat duhet të jenë pjesë e dosjes së prokurimit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

Titulli i gjetjes nr. 5	Mosrespektim i afatit të pagesës nga ana e ASHSH për procedurën e prokurimit “Blerje Pajisje Elektronike”.
Situata:	Nga auditimi i zbatimit të kontratës për procedurën “Blerje pajisje elektronike” u konstatua se likuidimi i saj është kryer me dy pjesë. Pjesa e dytë e pagesës është kryer më 20.10.2021 për 1,948,800 lekë. Ky likuidim pjesor është kryer jashtë afatit të përcaktuar në kontratë, konkretisht 7 ditë pas afatit.
Kriteri:	- Udhëzimi nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” pika 61 -Kontrata “Blerje Pajisje Elektronike” nr. 407/11 prot., datë 02.09.2021
Ndikimi/Efekti:	Mosrespektimi i afateve të tilla mund të sjellë dëm të buxhetit të shtetit.
Shkaku:	Mungesë vëmendje institucionale.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Spektori i Financës duhet të sigurojë pagesat në kohë, duke respektuar afatet e vendosura në kontratë.

Titulli i gjetjes nr. 6	Parregullsi në procedurën “Shtypje libra studimorë dhe revista periodike për vitin 2021”
Situata 1:	Ekziston një mospërputhje mes veprave të listuara në procesverbalin e Marrjes në Dorëzim i cili nuk ka datë (nënshkruar nga F.B, A.B, E.M) dhe Fletë Hyrjes në Magazinë nr. 3 datë 24.12.2021 (nënshkruar nga magazinieri F.B).
Situata 2:	Zëvendësimi i veprave i kryer në bazë të Vendimit nr. 61, nr. 630/2 prot., “Për një zëvendësim në listën e botimeve të vitit 2021” nuk është pasqyruar në formë shkresore, as në vlerën e kontratës. Në këtë vendim gjithashtu thuhet se <i>Spektori i financës duhet të përlllogarisë pjesën e buxhetit të prokuruar për 2 veprat dhe të caktohet tirazhi dhe të dhënat e tjera teknike të veprës zëvendësuese, gjë që nuk është e dokumentuar.</i>
Situata 3:	Vepra “Faik Konica, Jeta dhe Vepra” nuk figuron në listën e veprave të botuara në vitin 2021, nuk gjendet as në magazinën e ASHSH si botim i vitit 2021 por njëkohësisht në Fletë-Hyrjen nr. 3 datë 24.12.2021 listohet si një artikull që ndodhet në ASHSH.
Situata 4:	Në databazën e ASHSH mbi veprat e botuara të institucionit është konstatuar se vepra <i>Shqiptarët në Luftën e Dytë Botërore, vëllimi 2</i> me autor Paskal Milo ka pasur dy hyrje të ndryshme. Herën e parë me Urdhër-Shpenzimin nr. 685, datë 29.12.2021, 150 copë me kosto/copë 480 lekë, gjendja në magazinë 0 dhe herën e dytë me Urdhër Shpenzimin nr. 701, datë 31.12.2021, 150 copë, kosto/copë 780 lekë, gjendja në magazinë 85 copë. Për të njëjtën vepër janë vendosur dy vlera të ndryshme. Kjo vepër jo vetëm që nuk ishte e përfshirë në DST por ka dhe një mospërputhje të vlerave të saj dhe sasisë së hyrë në institucion, për vlerën 189,000 lekë , vlerë e cila është shpenzim jo efektiv i buxhetit të shtetit.
Kriteri:	- Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 122 dhe 124 - Ligjin 162/2020 “Për Prokurimin Publik” neni 91, pika 1 dhe 2



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

	<p>- Udhëzim Nr. 30, datë 27.12.2022 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” Dokumentimi i lëvizjeve të aktiveve pika 36</p> <p>- Vendimi nr. 61, nr. 630/2 prot., “Për një zëvendësim në listën e botimeve të vitit 2021” i ASHSH.</p>
Ndikimi/Efekti:	<p>-Mungesa e dokumentimit të ndryshimeve të tilla në kontratë krijojnë risk për keqmenaxhim të fondeve publike;</p> <p>-Mospërputhja e procesverbalit të marrjes në dorëzim dhe fletë-hyrjes në magazinë sjell mungesë transparence në veprimtarinë e institucionit dhe “K” hapësira për shkelje të mëtejshme të ligjit;</p> <p>-Shënimi i një vepre në Fletë-Hyrjen në magazinë si e dorëzuar nga OE kur në fakt është dorëzuar një tjetër vepër “K” paqartësi në procesin e inventarizimit.</p> <p>-Ndryshimet e kontratës të pa vërtetuara me anë të shkresave që përfshijnë mallin e ardhur në institucion dhe çmimin e këtij malli i cili nuk ka një bazë financiare për përlogaritjen e tij dhe futet në institucion dy herë me dy çmime të ndryshme “K” konfuzion, mungesë vërtetësie në dokumentacionin e ASHSH.</p>
Shkaku:	Mungesë vëmendje institucionale, neglizhencë nga ana e Sektorit të Financës, magazinierit, Grupit të Punës për Marrjen në Dorëzim të Mallit, mungesë koherence nga ana e ASHSH.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	ASH dhe strukturat përkatëse të marrin masa për analizimin e mospërputhjeve që rezultojnë në zbatimin e kontratës së botimeve 2021, si dhe nxjerrjen e përgjegjësive lidhur me veprimet fiktive.

Titulli i gjetjes nr. 7	Problematika në hartimin e DST
Situata:	Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Reagentë dhe mjete konsumi për fazën 3/1 të studimit të Seroprevalencës Covid 19” rezulton se: Në DST certifikatat CE/FDA nuk janë përmendur në kriteret e përgjithshme dhe të vecanta të kualifikimit, ndaj mungesa e tyre nuk është kriter për skualifikim të operatorit ekonomik. Kjo bie në kundërshtim me VKM nr.285 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, neni 25 dhe neni 40.
Kriteri:	<i>-VKM 285, datë 19.05.2021 për “Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 78</i>
Ndikimi/Efekti:	DST nuk janë hartuar në mënyrë të qartë dhe vlerësimi i OE nuk është kryer në bazë të tyre.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e Njësisë së Hartimit të Dokumentave.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Nga ana e ASH të merren masat e nevojshme që DST e hartuara të jenë të qarta, të kuptueshme dhe kriter skualifikimi për OE të përdoren vetëm ato të përmendurat në kriteret e përgjithshme dhe të veçanta.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQPËRISË

Titulli i gjetjes nr.8	Hartimi, ndryshimi dhe realizimi i regjistrit të prokurimeve
Situata:	<p>Nga auditimi i regjistrimit të parashikimeve, ndryshimit dhe realizimit të prokurimeve, u konstatua:</p> <ul style="list-style-type: none">- Nuk ka një regjistër parashikimi ku të jenë përfshirë procedurat me vlera të mëdha, afatet e hartimit dhe miratimit nga ana titullarit të autoritetit kontraktor të regjistrit të prokurimeve.- Nuk është i dokumentuar procesi i mbledhjes së kërkesave nga sektorët përkatës për hartimin e regjistrit të parashikimit.- Nga auditimi rezulton se në sistemin e APP nuk është hedhur një regjistër fillestar parashikimi por janë hedhur në ditë të ndryshme dhe janë shtuar zërat më vonë. <p>Regjistri i parashikimeve është ndryshuar 4 herë për vitin 2021, 3 herë për vitin 2022 dhe 3 herë në vitin 2023 dhe në asnjë rast nuk ka argumentim dhe miratim nga titullari i autoritetit kontraktor mbi këto ndryshime. Gjithashtu këto ndryshime nuk janë dërguar në Degën e Thesarit.</p> <p>Për sa konstatuar me sipër, është në kundërshtim me nenin 4 të Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe nenin 3 “Regjistri i parashikimeve të procedurave të prokurimit publik”, Vendimit Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.</p>
Kriteri:	<p>për periudhën janar – prill 2021 në kundërshtim me nenin 4 të Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe pikat 3 ,4 të nenit 3 “Regjistri i parashikimeve të procedurave të prokurimit publik” të Vendimit Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” për periudhën vijuese:</p> <ol style="list-style-type: none">1. Në bazë të nevojave për punë, mallra ose shërbime, autoriteti/enti kontraktor është përgjegjës për hartimin e regjistrit vjetor të parashikimeve për procedurat e prokurimit publik, në përputhje me formën dhe mënyrën e parashikuar në udhëzimet e APP-së.2. Regjistri i parashikimeve duhet të synojë planifikimin e mirë të përdorimit të fondeve publike dhe planifikimin e realizimit në kohë të procedurave të prokurimit publik.3. Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të nevojave, gjatë periudhës shtator – dhjetor të çdo viti, përgatit regjistrin për vitin ushtrimor në vijim, bazuar në ligjin që miraton parashikimet buxhetore afatmesme. Në çdo rast, afati maksimal i hartimit të regjistrit është jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga miratimi i ligjit për buxhetin për vitin ushtrimor pasardhës. Autoritetit/enti kontraktor, brenda 5 (pesë) ditëve nga hartimi i regjistrit të parashikimit të procedurave të prokurimit, duhet të dërgojë në organin qendror blerës të dhënat teknike e sasiore dhe fondin përkatës për objektet që do të prokurohen në mënyrë të përqendruar.4. Autoriteti/enti kontraktor ka detyrimin të krijojë regjistrin e parashikimeve në sistemin e prokurimit elektronik dhe publikimi i zërave të tij nga APP-ja duhet të bëhet brenda 3 (tre) ditëve nga dita e nesërme e punës, nga dërgimi



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQPËRISË

	<p><i>i tij për publikim në sistem. APP-ja, nëse vëren se regjistri i parashikimeve nuk është hartuar në përputhje me kërkesat e legjislacionit të prokurimit publik, kthen e këshillon autoritetin/entin kontraktor për hartimin e tij në përputhje me këto kërkesa. Një kopje e regjistrit të parashikimeve i vihet në dispozicion degës së thesarit dhe institucionit qendror, që vë në dispozicion fondet buxhetore, në rastin kur ka një të tillë.”</i></p> <p><i>Autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të bëjë ndryshime në regjistrin e parashikimeve të procedurave të prokurimit, vetëm në raste kur këto ndryshime vijnë për arsye që nuk kanë qenë të mundura të parashikohen në kohën e hartimit të regjistrit.</i></p> <p><i>Çdo ndryshim i regjistrit të parashikimeve bëhet nga vetë autoriteti ose enti kontraktor në sistemin e prokurimit elektronik, dhe publikimi i tij nga APP-ja bëhet brenda 3 (tri) ditëve nga dita e nesërme e punës nga dërgimi i tij për publikim në sistem.</i></p> <p><i>APP-ja, nëse konstaton se ky ndryshim nuk është bërë në përputhje me kërkesat e legjislacionit të prokurimit publik, kthen dhe këshillon autoritetin/entin kontraktor për hartimin e tij në përputhje me këto kërkesa. Një kopje e këtyre ndryshimeve i vihet në dispozicion degës së thesarit dhe institucionit qendror që vë në dispozicion fondet buxhetore, në rastin kur ka një të tillë.</i></p>
Ndikimi/Efekti:	Mos detajimi i regjistrimit dhe jo si pas nevojave konkrete.
Shkaku:	Rregjistër parashikimesh vetëm me blerjet e vogla.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	ASH në cilësinë e autoritetit kontraktor të marrë masa për hartimin e regjistrit të parashikimeve të plotë bazuar mbi nevojat konkrete të sektorëve të saj dhe njësisive kërkimore duke zbatuar afatet e përcaktuara në kuadrin rregullator dhe përcjelljen e tij në institucionet përgjegjëse pas miratimit nga titullari i autoritetit kontraktor.
Afati:	Menjëherë dhe në vijimësi

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit është paraqitur observacion:

Me shkresën nr. 896/35 prot., datë 29.03.2024, protokolluar në KLSH me nr. 959/6 prot, datë 02.04.2024, në lidhje Projekt Raportin e Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë nr.959/5 prot., datë 29.02.2024 nga përfaqësuesit e subjektit R.K, M.M, A.B.

➤ ***Në pretendimet e ngritura në shkresën përmendur më lartë, arsyetohet se:***

-Blerja e dy kondicionerëve ishte e nevojshme pasi ato do të instaloheshin, një pranë dhomës ku do të vendosej serveri qendror për QBAE-në dhe ASHSH ku do të ruhen dhe të dhënat në “cloud” për projektet “Historia e Shqiptarëve” dhe “Fjalori i Madh i Gjuhës Shqipe”, ashtu si dhe në një nga zyrat ku do të sistemoheshin punonjësit e QBAE-së. Kjo gjë është e verifikueshme dhe në terren. Njëkohësisht ju bëjmë me dije se në zbatim të rekomandimit tuaj, do të bëhet kujdes në vijim.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit lexoi me vëmendje argumentimin tuaj, por i qëndron konstatimit fillestar se kjo nevojë për blerjen e kondicionerëve nuk është e paraqitur në asnjë moment në formë shkresore. Argumenti juaj nuk paraqet fakt të ri, ndaj nuk do të merret parasysh.



-Raporti përmbledhës me nr. 493/136 prot., i datës 3.10.2022 në lidhje me procedurën “Reagentë për studime të Nanoalb”, ka qenë i firmosur dhe pjesë e dosjes. Lidhur me rekomandimet, për gjetjet në pikën 32, ato janë marrë parasysh dhe janë aplikuar e zbatuar në procedurat që kemi nisur në vijim. Lidhur me arkivimin e dosjeve ju bëjmë me dije se ka nisur procedura e inventarizimit dhe është në proces arkivimi. Me shtimin e personelit, me shtimin e një specialisti vetëm për prokurimet dhe me parashikimin për të patur një auditues të brendshëm, do të vijojmë me zbatimin me përpikmëri të rekomandimeve tuaja.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit lexoi me vëmendje parashtrimin tuaj dhe vlerëson qëndrimin për përmirësimin e situatës në vijim, por vlen të theksohet se Raporti Përmbledhës i procedurës “Reagentë për studime të Nanoalb” nuk ka qenë pjesë e dosjes së prokurimit dorëzuar grupit të auditimit. Argumenti juaj nuk paraqet fakt të ri, ndaj nuk do të merret parasysh.

-Edhe në bashkëbisedimet verbale me grupin e auditit gjatë periudhës së auditimit, kemi sqaruar se kjo vepër ka zëvendësuar dy botime të tjera që nuk arritën të bëhen gati në fund të vitit. Për të mos ndryshuar objektin e prokurimit kemi vijuar me zërat objekt prokurimi, por në hyrjet e magazinës kemi vënë në kllapa veprën që ka zëvendësuar këto botime. Jemi koshient që ky veprim në pamje të parë sjell përfundimet që ju keni cituar, por kjo në asnjë moment nuk ka qenë shpenzim jo efektiv i buxhetit. Sa i përket tirazhit vepra “Shqiptarët në Luftën e Dytë Botërore” është bërë hyrje në magazinë 300 kopje aq sa dhe janë dy veprat e zëvendësuara.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit lexoi me vëmendje parashtrimin tuaj dhe i qendron arsyetimit fillestar se ky është shpenzim jo efektiv i buxhetit të shtetit. Për sa kohë e njëjta vepër është botuar dy herë me dy vlera të ndryshme, nuk ka qenë e përfshirë në DST dhe ka një mospërputhje të vlerave të saj dhe sasisë së hyrë në institucion. Argumenti juaj nuk paraqet fakt të ri ndaj nuk do të merret parasysh.

7. Vlerësimi i sistemeve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

Në zbatim të pikës nr.7 të programit të auditimit: “Mbi vlerësimin e Menaxhimit Financiar dhe të Kontrollit”, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Rregullore e brendshme dhe Rregullore e Etikës;
2. Shkresat e përcaktimit të NA dhe NZ në përputhje me kërkesat e ligjit 10296/2010;
3. Shkresat për krijimin e grupeve të menaxhimit strategjik (GMS);
4. Regjistri i riskut;
5. Raportet e monitorimit ku përfshihen edhe deklarata e cilësisë dhe Pyetëtori i vetëvlerësimit.
6. Planet strategjike për periudhën (2020 – 2022), Planet vjetore të institucionit (2020-2022);
7. Raportet vjetore të veprimtarisë (2020, 2021).

Ky auditim u krye në zbatim të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar; urdhri nr. 108, datë 17.11.2016 i Ministrisë të Financave “Për miratimin e manualit të menaxhimit financiar dhe kontrollit”, si dhe aktet ligjore e nënligjore dalë në zbatim të tyre.



Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet se:

a) Mbi vlerësimin e Menaxhimit Financiar dhe të Kontrollit

Menaxhimi financiar dhe kontrolli është një sistem politikash, procedurash, veprimtarish dhe kontrollesh, nëpërmjet të cilave burimet financiare janë planifikuar, drejtuar dhe kontrolluar për të mundësuar dhe influencuar ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike. Ky sistem vendoset, ruhet dhe përditësohet rregullisht nga titullari i njësisë publike dhe vihet në zbatim nga i gjithë personeli, me qëllim për të adresuar risqet e për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- a) veprimtarive efektive, të efektshme dhe me ekonomi;
- b) pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
- c) informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- ç) mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Titullarët e njësive të sektorit publik zbatojnë menaxhimin financiar dhe kontrollin nëpërmjet këtyre komponentëve të ndërlidhur me njëri-tjetrin:

1. Mjedisi i kontrollit.
2. Menaxhimi i riskut.
3. Veprimtaritë e kontrollit.
4. Informacioni dhe komunikimi.
5. Monitorimi.

Mjedisi i kontrollit

Mjedisi i kontrollit është baza e menaxhimit të fondeve buxhetore dhe përbën themelin, ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm. Titullarët e njësive të sektorit publik janë përgjegjës për ngritjen, gjendjen dhe përmirësimin e mjedisit të kontrollit.

- Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësive publike

Sipas përcaktimeve të Manualit të MFK-së të miratuar me Urdhër nr. 108, datë 17.11.2016 të Ministrisë të Financave “Për miratimin e manualit të menaxhimit financiar dhe kontrollit” (këtu e në vijim **Manuali MFK**), në Kapitullin III, pika 3.1 përcaktohet se “*Kuadri i sjelljes së menaxherëve dhe stafit duhet të përcaktohen nga titullari i njësive publike në një Kod të Brendshëm Etike, ose në një Kod Sjelljeje*”, si dhe në zbatim të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar dhe të ligjit nr. 9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, institucionet duhet të hartojnë kod etike. Për sa më sipër, rezulton se Akademia e Shkencave nuk disponon Kod Etike të veçantë, por në nenin 12 të Rregullores së Brendshme në fuqi, është specifikuar “Etika profesionale e punonjësve” si dhe me Urdhër nr.13 datë 6.06.2017 me nr.288 prot., “Për njohjen, pranimin dhe zbatimin e “Kodit Evropian të Sjelljes për Integritet në Kërkimin Shkencor” njihet dhe pranohet Kodi Evropian i ALLEAS.

Akademia e Shkencave disponon “Rregulloren e etikës për shërbimin civil” por ky dokument nuk është i miratuar nga ana e titullarit të institucionit, si dhe i përket një periudhe kohore të largët (nr. 400/5 prot., datë 26.12.2018).

**Observacion i paraqitur nga ana e subjektit me shkresën nr. 896/35 prot., datë 29.03.2024
protokolluar në KLSH me nr. 959/6 prot., datë 02.04.2024**

- Rezultoni se Akademia e Shkencave nuk disponon Kod Etike. Mungojnë parashikime të elementëve si: rastet e konfliktit të interesit dhe shmangia e tyre; rregullat për ruajtjen e sekretit shtetëror etj.

Pretendimi i subjektit: Akademia e Shkencave ka njohur dhe zbaton ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, i ndryshuar, mbi të cilën është bazuar dhe për hartimin e rregullores së brendshme administrative. Në nenin 12 të rregullores së brendshme administrative miratuar me vendim nr.16 datë 24.03.2022 me numër prot.231/1 është specifikuar “Etika profesionale e punonjësve” ku janë përfshirë orari i punës, rregulla të veshjes, të takimeve dhe të pritjeve zyrtare, prona shtetërore, parimet e etikës që duhet të respektojnë punonjësit në punën e tyre, etj.

- Me urdhër nr.13 datë 6.06.2017 me numër prot. 288 “Për njohjen, pranimin dhe zbatimin e “Kodin Evropian të Sjelljes për Integritet në Kërkimin Shkencor” njihet dhe pranohet Kodi Evropian i ALLEAS. Të dy aktet e mësipërme që zbatohen nga Akademia e Shkencave kanë parashikime të elementëve si: rastet e konfliktit të interesit dhe shmangia e tyre gjatë veprimtarisë, lejimin apo ndalimin e veprimtarive të jashtme, rregullat për ruajtjen e sekretit apo të mirëbesimit kur është e nevojshme, sjellje të veçanta që duhet të manifestojnë punonjësit etj.

- Në lidhje me rregullat për ruajtjen e sekretit kemi gjithashtu dhe rregulloren “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në Akademinë e Shkencave” miratuar me vendim nr.42 datë 25.07.2023, prot 593.

- Në rregulloren e brendshme administrative të ASH-së dhe konkretisht: Kreu i VI, “Aktet administrative e dokumentacioni, hartimi, miratimi dhe ruajtja e tyre” përcaktohen gjithashtu masat për ruajtjen dhe përpunimin e informacionit shtetëror shkresor dhe elektronik.

Oëndrimi Grupit të Auditimit:

Sa i takon observimit Tuaj, shprehemi se,

Ndërkohë Urdhri me nr.13 datë 6.06.2017 nr. prot., 288 “Për njohjen, pranimin dhe zbatimin e “Kodin Evropian të Sjelljes për Integritet në Kërkimin Shkencor” me të cilin njihet dhe pranohet Kodi Evropian i ALLEAS, gjatë periudhës audituese NUK na është vendosur në dispozicion.

Referuar observacionit të paraqitur, në kushtet e sjelljes së dokumentacionit të ri justifikues observacioni pranohet.

Sa më sipër observacioni pranohet.

- Politikat menaxheriale dhe stili i punës

Stili i të vepruarit dhe filozofia e menaxhimit reflektojnë pikëpamjet kryesore të drejtuesit rreth mënyrës se si duhen organizuar punonjësit dhe aktivitetet e një njësie. Çdo drejtues ka një filozofi dhe një stil pune të veçantë, nëpërmjet të cilit ai/ajo menaxhon punonjësit, demonstroi dhe nxit kompetencën dhe sjelljen etike.

Qasja ndaj punës dhe ngritja e sistemeve, zakonisht paraqiten në një strategji institucionale. Në nenin 8, pika 8/a të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar përcaktohet se ‘Titullarët e njësisve publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore: a) miratimin e politikave dhe monitorimin e objektivave të njësisve publike që ata drejtojnë, të planeve strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e



menaxhimit të riskut dhe të plan-veprimeve për arritjen e objektivave'. Për sa më sipër rezultojn se Akademia e Shkencave ka hartuar një strategji institucionale në të cilën të paraqiten prioritetet dhe objektivat, si dhe planet e veprimit për arritjen e tyre me nr.79/1 datë 19.02.2019 e cila është e miratuar nga titullari i njësisë, në përputhje me nenin 8 gërma a, e ligjit për MFK-në konkretisht specifikohet... *Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore: a) hartimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e objektivave të njësive publike që ata drejtojnë, të planeve strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan veprimeve për arritjen e objektivave.*

Gjithashtu, po në nenin 8, pika 8/b të ligjit për MFK, përcaktohet se “*Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore: b) ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik të njësisë publik*”. Në nenin 27 të këtij ligji përcaktohet se “*Grupi për menaxhimin strategjik përbëhet nga titullari i njësisë publike, zëvendës titullarët, nëpunësi autorizues, nëpunësi zbatues dhe të gjithë menaxherët e tjerë të nivelit të lartë. Kreu i auditimit të brendshëm merr pjesë në mbledhjet e grupit për menaxhimin strategjik pa të drejtë vendimmarrjeje. Çështjet, që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, duhet të diskutohen gjatë takimeve periodike ndërmjet menaxherëve të niveleve të ndryshme në njësinë publike. Çështjet kryesore dhe mangësitë serioze që dalin brenda njësisë i parashtrohen grupit për menaxhimin strategjik, me qëllim diskutimin e mëtejshëm dhe marrjen e masave*”.

Për vitin 2023 është ngritur GMS/EMP me Urdhër të Titullarit nr.6 datë 28.02.2022 “Për ngritjen dhe funksionimin e GMS” dhe për vitin 2022 me Urdhër të Titullarit nr.11 datë 17.02.2023 “Për ngritjen dhe funksionimin e GMS”. Për vitin 2021, titullari i ASH ka nxjerrë urdhër nr.10 datë 23.03. 2021 “Për ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik”.

Në Udhëzimin nr.16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e kordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe kordinatorit të riskut në njësitë publike”, lidhur me rolin e GMS në sistemin e MFK, përcaktohet se “*GMS duhet të mbledhet të paktën 4 herë në vit. Vendimet duhet të regjistrohen nga sekretari dhe vihen në dispozicion të drejtimit të njësisë publike*”.

Për sa më sipër,

- për periudhën 2021 nuk rezultojn asnjë dokumentim i mbledhjeve të kryera nga GMS.
- për periudhën 2022 janë kryer 3 mbledhje nga minimumi 4 parashikuar në Udhëzimin e sipërcituar operuar në këto kushte jo në përputhje me këtë udhëzim;
- për periudhën 2023 janë kryer 5 mbledhje.

Nga auditimi u konstatua se, në përfundim të takimeve është mbajtur një protokoll i mbledhjeve i nënshkruar nga Kryetari i GMS dhe Sekretari i GMS, **por jo vendimet respektive të çdo mbledhje**, të cilat duhet të regjistrohen nga sekretari dhe vihen në dispozicion të drejtimit të njësisë publike, operuar në këto kushte në kundërshtim me Udhëzimin nr.16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e kordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe kordinatorit të riskut në njësitë publike”.

Për vitin 2021, 2022, 2023 titullari i ASH nuk ka nxjerrë urdhër për ngritjen e ekipit të menaxhimit të programeve në kundërshtim me nenin 8, pika 8/b të ligjit për MFK.

Në nenin 10 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, përcaktohet se “*Koordinator i menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe kordinator i riskut është nëpunësi autorizues i njësisë publike. Në përmbushje të përgjegjësisë të tij, nëpunësi autorizues mund t'i delegojë disa prej detyrave të veta për koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollin e koordinimin e riskut punonjësve, pjesë të strukturës së financës*”. Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nuk figuron që nëpunësi autorizues të ketë deleguar disa



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

prej detyrave të veta për koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollin e koordinimin e riskut punonjësve, pjesë të strukturës së financës.

Observacion i paraqitur nga ana e subjektit me shkresën nr. 896/35 prot., datë 29.03.2024 protokolluar në KLSH me nr. 959/6 prot., datë 02.04.2024

- Për vitin 2021, 2022, 2023, titullari i ASHSH nuk ka nxjerrë urdhër për ngritjen e ekipit të menaxhimit të programeve në kundërshtim me nenin 8/b të ligjit për MFK.

- Për vitin 2021, nuk rezulton asnjë dokument i mbledhjeve të kryera nga GMS, (është mbajtur një protokoll i mbledhjeve i nënshkruar nga kryetari i GMS dhe Sekretari i GMS, por jo vendimet respektive të cdo mbledhje, të cilat duhet të regjistrohen nga sekretari dhe vihen në dispozicion të drejtimit të njësisë publike, në kundërshtim me udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrta e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësinë publike”.

Pretendimi i subjektit: Mbledhjet e GMS (kryesia e zgjeruar) janë zhvilluar rregullisht çdo vit dhe nga EMP janë vënë në dispozicion dokumentet që kanë shërbyer si dokumentacion bazë për përgatitjen e PBA-së për vitet 2021, 2022 dhe 2023. Për vitin 2021 takimet e GMS-së nuk janë zbardhur me procesverbal nga sekretaria, por për vitet 2022 dhe 2023 janë të evidentuara të gjitha takimet. Ka një mospërputhje çfarë është përshkruar më lart me Observacionin e paraqitur me shkresën nr.959/3 prot., datë 22.01.2024 nga kryetari i ASHSH në lidhje me gjetjen “Mangësi në dokumentimin e proceseve të buxhetimit nga ana e NZ dhe GMS” (f. 13 e projekt-raportit). Komenti dhe argumenti i dërguar për këtë gjetje është pranuar nga grupi i auditimit (f. 13-14 qëndrimi i grupit të auditimit).

Sjellim në vëmendje gjithashtu se:

Në gjetjen nr. 1 f. 31 të projekt-raportit “Parregullsi në hartimin, zbatimin, dhe monitorimin e Buxhetit të ASHSH”, pranë KLSH është paraqitur observacioni i ASH për sa është trajtuar më sipër. Kemi paraqitur dokumentacionin justifikues për këtë dhe qëndrimi i grupit të auditimit është pozitiv. Komenti dhe argumenti që ne kemi bërë është marrë parasysh. (Qëndrimi i grupit të auditimit, f. 33, paragrafi i fundit).

Po në faqen 204 të projekt-raportit, nga grupi i auditimit, bazuar në dokumentacionin që i është vënë në dispozicion, thuhet: Për vitin 2023 është ngritur GMS/EMP me urdhër të titullarit nr. 6 datë 28.02.2023 “Për ngritjen dhe funksionimin e GMS dhe për vitin 2022 me urdhër të titullarit nr. 11 datë 17.02.2022”. Për vitin 2021 ka dalë urdhri nr. 10, datë 23.03.2021 i titullarit “Për ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik”. Për periudhën 2022 janë kryer tri mbledhje nga 4 të parashikuara në Udhëzimin e MFE. Për periudhën 2023 janë kryer 5 mbledhje. Në përfundim të takimeve është mbajtur protokollin i mbledhjeve, nënshkruar nga Kryetari dhe sekretari i GMS, por jo vendimet respektive të çdo mbledhje... etj.

Observacioni i paraqitur nga ana e ASH me shkresën nr. 886/22 prot., datë 22.01.2024 protokolluar në KLSH me nr.959/4 prot., datë 22.01.2024, është pranuar nga grupi i auditimit bazuar kjo në komentet, argumentet e dokumentet e reja justifikuese të dërguara bashkëlidhur këtij observacioni. Në protokollin e mbajtura janë të miratuara kërkesat buxhetore për vitin, kërkesa të cilat janë bazat e PBA-ve që janë dërguar në MFE elektronikisht dhe në kopje të printuara.

Në mbledhjet vjetore të Asamblesë dhe në programet vjetore të ASHSH (edhe me raport të veçantë të kancelarit), Asambleja miraton buxhetin faktik të vitit përmbyllës dhe atë të detajuar në zërat kryesorë për vitin vijues.

**Oëndrimi Grupit të Auditimit:**

Sjellim në vëmendjen Tuaj se, sikundër edhe në projekt raport sqaruar:

Konstatimet e grupit të auditimit janë kryer mbi dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga Akademia e Shkencave, e si të tilla mbajnë përgjegjësi personat që u lanë si kontakt nga ana Juaj, për mos sjellje të plotë të dokumentacionit justifikues për këto materiaile duke i sjell me mangësi. Sërish rezulton se, në përfundim të takimeve është mbajtur *një protokoll i mbledhjeve* i nënshkruar nga Kryetari i GMS dhe Sekretari i GMS, *por jo zbardhja e vendimeve respektive të çdo mbledhje.* EMP dhe GMS nuk janë e njëjta gjë (e njëjta strukturë), referuar Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin ku ilustron se *raportet e përgatitura nga ekipi i menaxhimit të programit dorëzohen tek Grupi për Menaxhimin Strategjik për vijësi të procedurave.*

Në kushtet e mos sjelljes së dokumentacionit të ri justifikues nuk merret në konsideratë.

Sa më sipër observacioni nuk pranohet.

- Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, hierarkia dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit

Akademia e Shkencave funksionon në bazë të një rregulloreje të brendshme të vitit 2022, përkatësisht "Rregullore e brendshme Administrative për Akademinë e Shkencave", miratuar me Vendim nr. 16, datë 24.03.2022, e ndryshuar me Vendim nr.3 datë 12.01.2023 "Për një shtesë në Rregulloren e Brendshme Administrative të Akademisë së Shkencave". Kjo rregullore nuk i përgjigjet plotësisht kërkesave që rrjedhin nga Manuali MFK, për sa i përket: listimit të prioritetëve kryesore të Institucionit, funksionet e larta të menaxhimit, marrëdhëniet ndërmjet strukturave të Njesisë, mënyrën e kryerjes së përfaqësimit ligjor, rregullat e etikës së stafit në mënyrë të detajuar, lëvizjet e stafit brenda dhe jashtë vendit, rregullat mbi administrimin, komunikimin dhe ruajtjen e dokumentacionit, mënyra e mbajtjes së dosjes së personelit, përshkrimet e punës të secilit prej pozicioneve, procedura e sinjalizimit, procedura e nxjerrjes së akteve administrative të njesisë, mënyra e mbajtjes së korrespondencës me strukturat brenda njesisë dhe me njësitë tjera etj.

**Observacion i paraqitur nga ana e subjektit me shkresën nr. 896/35 prot., datë 29.03.2024
protokolluar në KLSH me nr. 959/6 prot., datë 02.04.2024**

Pretendimi i subjektit: Së pari, sqarojmë se:

Akademia e Shkencave funksionet dhe veprimtarinë e saj e kryen në përputhje me ligjin "Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë", nr. 53/2019, datë. 18.07.2019, dhe Statutit të saj si dhe të gjitha nënakteve të tjera ligjore që rrjedhin nga Ligji për Akademinë e Shkencave (rregulloret specifike).

- Rregullorja e brendshme administrative e Akademisë së Shkencave është një rregullore e re e cila në thelbin e saj ka si objekt organizimin, menaxhimin, funksionimin e brendshëm, kompetencat e funksioneve e të strukturave të administratës së institucionit të Akademisë së Shkencave, si dhe bashkëpunimin e tyre me strukturat e tjera që kryejnë veprimtari administrative. Kjo rregullore është hartuar në zbatim të ligjit 53/2019 për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë dhe statutit të saj.

- Që në kreun e parë të saj përcakton qartë objektivin dhe detyrat kryesore të administratës së institucionit të Akademisë së Shkencave; parimet e organizimit dhe funksionimit të saj, rregullat e etikës profesionale të punonjësve, rregullat mbi dosjen e punonjësit, përbërjen, strukturat e



funksionet kryesore në veprimtarinë administrative të ASH-së, raportimet e analizat administrative në organet e larta drejtuese të Akademisë, lëvizjet e stafit brenda dhe jashtë vendit (neni 80, urdhërat ekzekutiv të Kancelarit) etj.

- Në kreun e dytë gjejmë të pasqyruar administrativisht funksionet e larta të menaxhimit, përcaktimin e përgjegjësive, detyrave dhe marrëdhënieve të punonjësve të administratës si dhe të nëpunësve të strukturave të drejtimit shkencor të ASH-së, në kryerjen e veprimtarive administrative.

- Përgjegjësitë dhe detyrat e sektorëve, përshkrimet e punës të secilit prej pozicioneve të strukturës të Akademisë janë pasqyruar në detaje në kapitullin e tretë të kësaj regulloreje.

- Po kështu kjo rregullore trajton në mënyrë specifike krijimin, trajtimin, qarkullimin, shfrytëzimin, ruajtjen dhe arkivimin e akteve e dokumentacionit të ASH-së, administrimin e dokumenteve të krijuara apo të ardhura në adresë të ASH-së, përcaktimi i rregullave për: rekrutimin, punësimin, disiplinën në punë, masat disiplinore dhe procedurat përkatëse të punonjësve të administratës e nëpunësve të çdo niveli, përveç atyre të rregulluar me statutin e ASH-së,

- Akademia e Shkencave ka Rregullore për komunikimin me mediat, informimin e publikut me nr. 130 prot., datë 18.02.2021 “Rregullore për mënyrën e funksionimit të marrëdhënieve me publikun dhe personat e ngarkuar me to”.

- Në tërësinë e saj, rregullorja e brendshme administrative e ASH *i përgjigjet kërkesave bazë që rrjedhin nga manuali i MFK*, përsa i përket elementeve të sipërcituara. Janë gjashtë akte nënligjore (rregullore specifike sipas rëndësisë së fushave). Në këto rregullore përcaktohen dhe gërshetohen më së miri marrëdhëniet ndërmjet strukturave bazë të institucionit.

- Asnjë rregullore nuk mund të jetë përfekte dhe të rrokë në mënyrë të detajuar të gjitha aspektet dhe elementët e veprimtarisë së një institucioni dhe për më tepër të një institucioni që është në fazat e një reformi të thellë ku struktura dhe gama e detyrave ndryshon dhe shtohen vazhdimisht. Në këtë kuadër edhe konstatimet e auditimit të grupit të KLSH do të gjejnë reflektimin e tyre.

Oëndrimi Grupit të Auditimit:

Në kushtet e argumentimit të situatës nga ana Juaj dhe mos paraqitjes së evidencave të reja justifikuese, njëkohësisht dakortësismit që do të gjejnë zbatim këto konstatime dhe rekomandime me qëllim përmirësimin e situatës, observacioni mësipërm nuk merret në konsideratë.

Sa më sipër observacioni nuk pranohet.

Profesionalizimi i stafit

Stafi i ASH nuk disponon një databazë të trajnimeve të stafit, pavarësisht aktivitetit trajnues që stafi ka patur.

Deri në përfundim të periudhës së auditimit, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, nuk rezulton që ASH, në bashkëpunim me institucionet e tjera, të ketë hartuar dhe miratuar një akt për formimin profesional të punonjësve të institucionit.

Vlerësimi periodik i punonjësve

Nga auditimi u konstatua se, për periudhën objekt auditimi nuk është kryer procesi i vlerësimit periodik të punonjësve.

**Observacion i paraqitur nga ana e subjektit me shkresën nr. 896/35 prot., datë 29.03.2024
protokolluar në KLSH me nr. 959/6 prot., datë 02.04.2024**

Pretendimi i subjektit: Nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA) njoftohemi me e-mail për sesionet informuese, trajnime (qebinare) etj., të fushave të ndryshme. Në komunikimin me ASPA-n, pas kërkesave për të marrë pjesë në këto trajnime, na bëhet e ditur që: “Ky webinar ofrohet vetëm për nëpunësit civil.”

Pasja e një hapësire ligjore lidhur me statusin e punonjësve të ASH, ka ndikuar në mos marrjen pjesë në trajnimet që zhvillonte Shkolla Shqiptare e Administratës Publike për punonjësit jashtë shërbimit civil, për të cilën i është drejtuar dhe me shkresën nr. 247 prot., datë 8.4.2021 “Kërkesë për pjesëmarrjen e stafit administrativ të Akademisë së Shkencave në trajnimet që zhvillon ASPA” pa përgjigje. Por, me qëllim që të mos ketë ndërprerje të trajnimeve të punonjësve, me riorganizimin e punës së punonjësve të administratës, ka filluar puna për mbajtjen e një regjistri/plani trajnimesh. Njëkohësisht këtu përmendim pjesëmarrjen në trajnimin e fundit të organizuar nga KPP më datë 27.3.2023 pranë ambienteve të Kishës Ortodokse; trajnim informues lidhur me arkivat, apo me aplikimin e projekteve, të drejtën e autorit, pronësisë industriale (dt. 5.3.2024 në sallën “Aleks Buda”) etj.

- Me qëllim mos ndërprerjen e vijueshmërisë së trajnimeve për të patur një përditësim lidhur me aktet ligjore e nënligjore të dala për fushat përkatëse. Të financës, botimeve, bibliotekës etj. Punonjësit e ASH kanë ndjekur trajnime specifike rast pas rasti. Këtu përmendim trajnimet e punonjësve A. B, E. M, I. B, S. P, M. M, A. B, L. T.

Qëndrimi Grupit të Auditimit:

Në kushtet e argumentimit të situatës nga ana Juaj dhe mos paraqitjes së evidencave të reja justifikuese, (njëkohësisht dakortësismit që do të gjejnë zbatim këto konstatime dhe rekomandime me qëllim përmirësimin e situatës) observacioni mësipërm nuk merret në konsideratë.

Sa më sipër observacioni nuk pranohet.

Menaxhimi i Riskut

Menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këta objektiva do të realizohen.

Në nenin 21, pika 2 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, përcaktohet se ‘Për t’i zbatuar veprimtaritë e menaxhimit të riskut, titullari i njësisë publike miraton një strategji, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut. Nëpunësi autorizues analizon dhe përditëson kontrollat që synojnë minimizimin e riskut, të paktën një herë në vit.’ Për sa më sipër, rezulton se ASH nuk ka hartuar një strategji risku, në kundërshtim me nenin 21 të Ligjit nr. 10296. Pavarësisht rëndësisë që ka identifikimi i risqeve dhe menaxhimi i tyre, ASH nuk ka ndërmarrë asnjë veprim lidhur me këtë çështje. Mungesa e një strategjie risku dhe identifikimi i risqeve me qëllim marrjen e masave për eliminimin apo zbutjen e efektit të tyre, çënon arritjen e objektivave dhe performancën institucionale.

6. Për vitin 2021 nga ana e Akademisë së Shkencave është hartuar regjistër risku, me nr.45/4 datë 08.02.2021 dhe për vitin 2022 regjistri përmban nr.178/1 datë 28.02.2022 në zbatim të nenit 12, pika 3 e Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar’ ku përcaktohet se ‘Nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve të njësisë publike përgjigjen



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQPËRISË

përpara nëpunësit autorizues përkatës për: d) identifikimin dhe krijimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë'. Për vitin 2023 ky regjistër është hartuar dhe përmban nr.130/1 prot., datë 27.02.2023. Por për të gjithë vitet objekt auditimi ky regjistër rrisht është i pamiratur nga titullari i institucionit në kundërshtim me nenin 8, pika 8/a të ligjit i cili përcakton se: "Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore:

a) miratimin e politikave dhe monitorimin e objektivave të njësive publike që ata drejtojnë, të planeve strategjike e vjetore, përfshirë planet e e menaxhimit për trajtimin e risqeve dhe të plan-veprimeve për arritjen e objektivave;

Observacion i paraqitur nga ana e subjektit me shkresën nr. 896/35 prot., datë 29.03.2024 protokolluar në KLSH me nr. 959/6 prot., datë 02.04.2024

Pretendimi i subjektit: Lidhur me .. ASH nuk ka hartuar një strategji rrisht, në kundërshtim me nenin 21 të Ligjit nr. 10296.

Çdo vit kemi hartuar regjistër rrisht (viti 2021 regjistër rrisht me numër 45/4 datë 08.02.2021: Viti 2022 regjistër me numër 178/1 datë 28.02.2022: viti 2023 regjistër me nr. 130/1,prot. datë 27.02.2023) ku janë të indentifikuar qartë rrishtet që mund të ndodhin gjatë veprimtarisë për realizimin e objektivave. Është e vërtetë që nuk ka një strategji rrisht, mangësi e cila do të realizohet menjëherë dhe në vijimësi.

Qëndrimi Grupit të Auditimit:

Sjellim në vëmendjen tuaj se regjistri rrisht dhe strategjia e rrisht, referuar Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar' janë dy dokumenta të ndryshëm.

Në kushtet e argumentimit të situatës nga ana Juaj dhe mos paraqitjes së evidencave të reja justifikuese, observacioni mësipërm nuk merret në konsideratë.

Sa më sipër observacioni nuk pranohet.

Aktivitetet e Kontrollit

Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që synojnë reduktimin e risqeve në mënyrë që të arrihen qëllimet dhe objektivat e njësisë dhe të nxisin zbatimin e vendimeve të drejtuesve. Mungesa e identifikimit të risqeve, mungesa e qartë e ndarjes së detyrave në ASH, vështirësojnë kryerjen efektive të kontrolleve, identifikimin e parregullsive dhe nxjerrjen e përgjegjësieve.

Në kuadër të zbatimit të veprimtarisë së kontrollit, në nenin 16 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar përcaktohet se 'Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit, për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit. Gjurma e auditimit arkivohet sipas dispozitave ligjore në fuqi'. Gjurma e auditit për v.2022 përmban nr.776/1 prot., dt 29.12.2021; për v.2023 përmban nr.3/3 prot., dt.20.01.2023 dhe për v.2021 nuk rezulton evidencë justifikuese për praninë e kësaj gjurme. Në të dy rastet (v.2022 dhe v.2023) gjurma e auditit mban nënshkrimin e nëpunësit autorizues. Për sa më sipër, rezulton se



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

gjurma e auditimit nuk është e miratuar nga Titullari i ASH për vitet objekt auditimi (2021, 2022, 2023) në kundërshtim me nenin 16 të ligjit për MFK.

Nuk rezulton e miratuar një procedurë mbi ruajtjen, përdorimin dhe arkivimin e dokumentacionit në ASH. Për menaxhimin e aktiveve nuk rezulton i hartuar regjistri i aktiveve, i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësuar si për shtesat dhe pakësimet. Në kuadër të zbatimit të veprimtarisë së kontrollit, në nenin 16 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010.

Ndarja e detyrave

Për të minimizuar rrezikun e gabimeve, parregullsive dhe shkeljeve si dhe moszbulimin e tyre, titullarët duhet të vendosin rregulla që e shpërndajnë tek punonjës të ndryshëm përgjegjës në zbatim të dy, ose më shumë fazave kyçe të një operacioni, procesi, apo aktiviteti.

Ndarja e detyrave në ASH rregullohet me anë të Rregullores së Brendshme, miratuar me Vendim nr.16, datë 24.03.2022 “Për miratimin e Rregullores së Brendshme Administrative të Akademisë së Shkencave” e ndryshuar, me Vendim nr.3 datë 12.01.2023 “Për një shtesë në Rregulloren e Brendshme Administrative të Akademisë së Shkencave”.

Sa i përket përshkrimit të punëve për punonjësit e Akademisë së Shkencave, pozicionet aktuale në strukturë e kanë të reflektuar përshkrimin e punës në rregulloren e sipërcituar.

Informimi dhe komunikimi

Komunikimi është shkëmbimi i informacioneve të dobishme ndërmjet punonjësve të të gjitha niveleve të njësisë publike, si horizontalisht dhe vertikalisht, dhe ndërmjet njësive publike për të mbështetur vendimet dhe për të koordinuar aktivitetet. Informacioni duhet t'i komunikohet menaxhimit dhe punonjësve të tjerë, në formën dhe brenda një harku kohor, që i ndihmon ata për të kryer përgjegjësitë e tyre. Komunikimi me taksapaguesit, furnitorët e shërbimeve, rregullatorët dhe palët e tjera të jashtme është gjithashtu thelbësor për kontrollin e brendshëm efektiv.

Në lidhje me komunikimin e brendshëm, në mungesë të aktit rregullator mbi organizimin dhe funksionimin e ASH, është e paqartë dhe e paverifikueshme bazuar në shkresat zyrtare se si titullari informohet nga përgjegjësit e sektorëve, nëse realizohet me anë të takimeve e mbledhjeve, relacioneve apo raporteve të ndryshme. Gjithashtu është e pa verifikueshme mënyra e përcaktuar për komunikimin e punonjësve brenda institucionit dhe jashtë institucionit.

Në lidhje me komunikimin e jashtëm, ASH ka një faqe zyrtare web në të cilën paraqiten informacione për publikun. Punonjësit e ASH kanë mundësinë e përdorimit të e-mail zyrtar nëpërmjet kompjuterëve të punës dhe faqes web të Akademisë.

Observacion i paraqitur nga ana e subjektit me shkresën nr. 896/35 prot., datë 29.03.2024 protokolluar në KLSH me nr. 959/6 prot., datë 02.04.2024

Pretendimi i subjektit:

- Dëshmi të drejtpërdrejta dokumentimi për veprimtarinë drejtuese të seksioneve dhe strukturave të tjera të ASH, janë vendimet e Kryesisë, miratimet e programeve për veprimtari shkencore që kryhen nën drejtimin e seksioneve përmes komisioneve të përhershme e njësive të përkohshme, qendrave të kërkim-studimit dhe anëtarëve e bashkëpunëtorëve të tyre, në radhë të parë, për organizimin e kongreseve dhe kuvendeve, të konferencave e simpoziumeve; të veprimtarisë botuese që është prioritet themelor për ASHSH; të projekteve shkencore të mbështetura nga ASHSH, në bashkëpunim me institucione të tjera brenda vendit si institucionet e arsimit të lartë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

dhe me bashkëpunim me jashtë. Çdo aktivitet kalon nëpër disa faza: propozohen nga seksionet, marrin pëlqim në Kryesi: hartohet programi, ndiqet zbatimi nga sekretari shkencor, seksioni, komisionet a njësitë; këto përfshihen në planifikimin buxhetor të instituconit, shprehen në mjete njoftimi e imazhi si programe, ftesa, libër abstraktesh, postera, banera, shenja promovuese dhe vlerësuese etj., të cilat miratohen nga Kryesia, që njëherësh përcakton edhe detyrat dhe përgjegjësitë për strukturat.

Kontaktet me strukturat mbahen dhe me takime e mbledhje direkte të Kryesisë (në mbledhjet e zgjeruara të Kryesisë marrin pjesë edhe kryetarët e komisioneve të përhershme e drejtuesit e projekteve të mëdha shkencore në albanologji); përmes postës elektronike e komunikimeve online; si dhe në dokumentet shkencore e administrative të mbajtura në bordet, këshillat dhe redaksitë ku ata përfaqësohen. Kontaktet me Kryesinë janë të përditshme, për një pjesë të punës së tyre edhe të detyrueshme: për realizimin e programit vjetor, të detajuar dhe në kalendarët tremujorë të veprimtarive të propozuara prej seksioneve dhe strukturave në varësi të tyre.

Ndërveprimi midis strukturave dëshmohet katërcipërisht përmes vendimeve të Kryesisë për çështjet që u kalojnë në kompetencë e përgjegjësi atyre dhe strukturave të tyre për zbatim.

Në raportet vjetore të veprimtarisë së ASHSH, i cili hartohet duke bashkuar raportet e dy seksioneve përbërëse të saj dhe sektorëve të administratës që janë dokumente publike, gjenden të dhëna të detajuara për analizat e punës, raportimet, relacionet, këshillimet, marrjen e propozimeve, dhënien e pëlqimeve, për çdo çështje që u takon atyre. Përmendim se gjatë vitit 2021 janë organizuar e realizuar mbi 140 aktivitete shkencore (kuvende, kongrese, konferenca shkencore kombëtare e ndërkombëtare, simpoziume, pa llogaritur veprimtaritë promovuese); gjatë vitit 2022 janë organizuar e realizuar mbi 180 aktivitete dhe në vitin 2023 mbi 170 të tilla. Për të gjitha këto veprimtari, Kryesisë i paraqiten me shkrim nga seksionet: propozimi paraprak, miratimi në seksion, objektivat dhe qëllimet, kalendarit dhe fazat, pjesëmarrësit dhe targeti i të interesuarve, programi përfundimtar me drejtuesit e referuesit. Të gjitha marrëveshjet e protokollit me karakter ndërkademi dhe me institucione të tjera të kërkimit shkencor (universitete, qendra), brenda dhe jashtë vendit, ose propozohen nga seksionet, ose u merret pëlqimi paraprak atyre.

Përveç sa më sipër, komunikimi midis strukturave dhe Kryesisë bëhet për të gjitha akte të rëndësishme ligjore lidhur me veprimtarinë e ASHSH.

Materialet e vëna në dispozicion gjatë periudhës së auditimit dhe në përgjigjet e bëra për Akt konstatimet, vërtetojnë në mënyrë të qartë ekzistencën dhe funksionimin e mirë dhe shkresor mes strukturave të brendshme të ASHSH.

Qëndrimi Grupit të Auditimit:

Sikundër edhe në projekt raport sqaruar, në kushtet e mos paraqitjes së dokumentacionit të ri justifikues por vetëm argumentimit nga ana juaj, observacioni mësipërm nuk merret në konsideratë.

Sa më sipër observacioni nuk pranohet.

Monitorimi

Titullarët e njërive publike janë përgjegjës për ngritjen e një sistemi për monitorimin e menaxhimit financiar dhe të kontrollit, me qëllim vlerësimin lidhur me funksionimin e duhur dhe garantimin e përditësimit të tij, sa herë që ndryshojnë.

Me qëllim monitorimin e institucioneve të varësisë, në nenin 9 pika 3 e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, përcaktohet se ‘Nëpunësit autorizues të të gjitha niveleve të njërive të varësisë janë përgjegjës dhe raportojnë sipas shkallës



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

hierarkike, deri te nëpunësi autorizues i njësisë publike, për statusin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, për riskun e mashtrimit e të parregullsive dhe të çdo mangësie serioze që pengon realizimin e objektivave, ose risqe, të cilat nuk janë adresuar nga njësi, masat korrektuese të marra dhe të përmbushura nga nivelet e menaxhimit të njësisë që drejtojnë’. Për sa më sipër, për shkak të strukturës komplekse të Akademisë së Shkencave (e cila përmban Administratën, Asamblenë, Kryesinë dhe Njësi Kërkimore që ngrihen provizorisht) nuk ka asnjë dokumentim të raportimit të tyre në ASH mbi statusin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, në kundërshtim me nenin 9 të ligjit të MFK.

**Observacion i paraqitur nga ana e subjektit me shkresën nr. 896/35 prot., datë 29.03.2024
protokolluar në KLSH me nr. 959/6 prot., datë 02.04.2024**

Pretendimi i subjektit:

Veprimtaria e njësisë të kërkim-studimit është pjesë e rëndësishme e programit vjetor të ASHSH. Kjo veprimtari planifikohet, përfshihet në programet vjetore të saj; miratohet e mbështetet me buxhet; ndiqet në çdo fazë nga Kryesia dhe seksionet përkatëse në procesin e realizimit. Njësitë janë organizatore të kongreseve, kuvendeve, konferencave shkencore kombëtare e ndërkombëtare, simpoziumeve e ëorkshop-eve; dhe në mënyrë të veçantë janë hartuese e zbatuese të projekteve shkencore, që marrin rregullisht pëlqimin e seksioneve dhe të Kryesisë dhe përmes programeve vjetore edhe nga Asambleja e ASHSH.

Në lidhje me konstatimin e mësipërm sqarojmë se: Njësitë e kërkim-studimit nuk janë njësi me struktura të rregullta administrative dhe përbërja e struktura janë të përcaktuara në aktin e themelimit të tyre dhe nuk kanë statusin e njësisë të varësisë. Veprimtarinë e tyre e bazojnë mbi bazë projektesh kërkimore-shkencore dhe funksionojnë me procedura të njëjta si ato të AKKSHI-së. Një pjesë e mirë e projekteve fituese të tyre financohen dhe ndiqen dhe nga AKKSHI.

Njësitë e kërkim-studimit nuk kanë nëpunës autorizues të nivelit të dytë dhe nuk kanë strukturë të mirëfilltë financiare. Financohen nga buxheti i Akademisë për projektet fituese që miratohen me vendim të Kryesisë, buxhet i cili administrohet e monitorohet plotësisht nga Akademia. Një nga njësitë më aktive është ajo e Seroprevalencës në raport me shpenzimet. Për disa nga këto njësi të kërkim-studimit janë bërë kërkesat për kthimin e tyre në njësi të përhershme (drejtuar Këshillit të Ministrave).

Raportimet e tyre bëhen në rastet e workshopeve që ato organizojnë here pas here si dhe me përfundimin e projekteve, po kështu dhe në çdo muaj për punën e kryer nga koordinatorët e tyre.

Qëndrimi Grupit të Auditimit:

Në kushtet e mos paraqitjes së dokumentacionit të ri justifikues observacioni mësipërm nuk merret në konsideratë.

Sa më sipër observacioni nuk pranohet.

Monitorimi i sistemit të MFK nga titullari mund të realizohet nëpërmjet pyetësorit të vetëvlerësimit të kontrollit të brendshëm, sikurse paraqitet në Shtojcën 2 të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Duke ju përgjigjur pyetjeve të pyetësorit të vetëvlerësimit, institucioni bën vlerësimin e zhvillimit të komponentëve të veçantë të kontrollit të brendshëm, ku çdo përgjigje me jo - tregon se ka mangësi dhe duhen marrë masa për përmirësime. Për sa më sipër, për periudhën nën auditim, rezulton se asnjë nga njësitë e varësisë (njësitë kërkimore) nuk ka plotësuar asnjë pyetësor vetëvlerësimi në mënyrë që të identifikojë problematikat e kontrollit të brendshëm me



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

qëllim përmirësimin e tyre, në kundërshtim kjo me kërkesat e Kapitullit III të Manualit të MFK, të miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016.

Në nenin 18 pika 1 e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, përcaktohet se ‘Nëpunësi autorizues i njësisë publike, në bazë të vetëvlerësimeve, depoziton te titullari i njësisë publike dhe nëpunësi i parë autorizues një deklaratë dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrolleve të brendshme të njësisë publike që mbulon, për vitin e mëparshëm, jo më vonë se fundi i muajit shkurt të vitit aktual’. Për sa më sipër, për vitin 2021 rezultoi se nëpunësi autorizues i ASH ka hartuar deklaratën dhe raportin mbi cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe dërguar në MEF me shkresën nr.178 prot., datë 28.02.2022 dhe për vitin 2022 rezultoi se nëpunësi autorizues i ASH ka hartuar deklaratën dhe raportin mbi cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe dërguar në MEF me shkresën nr.130 prot., datë 27.02.2023.

Konkluzion: Nga analizimi i komponentëve të MFK-së, rezultoi se strukturat drejtuese të ASH përgjithësisht operojnë në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, referuar ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, manualit të MFK, të miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, si dhe urdhërat e udhëzimet e dala në zbatim të tij.

Titulli i gjetjes nr. 1	Mos zbatimi i plotë i kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit
Situata:	<p>Nga auditimi dhe analizimi i komponentëve të MFK-së është konstatuar se:</p> <ul style="list-style-type: none">- Për periudhën objekt auditimi nga titullari i ASHSH nuk janë nxjerrë urdhrat për ngritjen e ekipit të menaxhimit të programeve, në kundërshtim me nenin 8, pika 8/b të ligjit për MFK.- Për periudhën 2021 nuk rezultoi dokumentim i mbledhjeve të kryera nga GMS në kundërshtim me Udhëzimin nr.16, datë 20.07.2016 i MFE “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”.- ASH e ka kryer aktivitetin e saj në bazë të një rregullore të brendshme të vitit 2022 përkatësisht “Rregullore e Brendshme Administrative për Akademinë e Shkencave”, miratuar me Vendim nr.16 dt. 24.03.2022, e ndryshuar e cila nuk i përgjigjet plotësisht kërkesave që rrjedhin nga Manuali MFK.- Nga auditimi u konstatua se, për periudhën objekt auditimi nga ASH nuk është hartuar një program trajnimi për punonjësit në fushën e MFK, e më gjerë dhe nuk ka një databazë të trajnimeve të stafit.- ASH nuk ka hartuar një strategji risku, në kundërshtim me nenin 21 të Ligjit nr. 10296 për MFK.- Titullari i ASH nuk ka miratuar gjurmën e auditimit, në kundërshtim me nenin 16 të ligjit për MFK.- Në mungesë të aktit rregullator mbi organizimin dhe funksionimin e ASH, është i paqartë komunikimi i brendshëm dhe se si titullari informohet nga përgjegjësit e sektorëve.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

	1. - Nuk ka asnjë dokumentim të raportimit të njërive kërkimore mbi statusin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, në kundërshtim me nenin 9 të ligjit të MFK.
Kriteri:	<ul style="list-style-type: none">- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 8, pika 8/a, 8/b; neni 9/3; neni 10; neni 12/3; neni 16; neni 18/1; neni 21/2; neni 27.- Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016.- Udhëzimi nr.16, datë 20.07.2016 ‘Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike’.- Ligji nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.- Ligji nr. 9131, datë 8.9.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”.- Vendimit nr. 142, datë 12.3.2014 ‘Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura’, neni 24; neni 35.
Ndikimi/Efekti:	Mos zbatimi i kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, ka sjellë mungesë të kontrollit të brendshëm, duke riskuar përdorimin me efektivitet, efikasitet dhe ekonomikitet të fondeve financiare publike. Gjithashtu ka ndikuar negativisht në performancën institucionale për kryerjen e veprimtarisë në përputhje me parimet e transparencës dhe ligjshmërisë.
Shkaku:	Mos zbatimi i kuadrit ligjor dhe nënligjor nga titullari i institucionit, nëpunësi autorizues dhe personat e tjerë përgjegjës për MFK.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandim:	Titullari i institucionit të ndjekë me rigorozitet aplikimin dhe zbatimin e të gjithë komponentëve të MFK-së dhe të marrë masa të menjëhershme për hartimin e gjurmës së auditimit.

8. Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme.

Për kryerjen e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve mbi auditimin e ushtruar në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, sipas programit të auditimit nr.959/1 prot, datë 07.11.2023 , si një detyrim që buron nga kërkesat e Ligjit nr.154/2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe nga Standartet Ndërkombëtare të INTOSAI-it.

Nga auditimi rezulton se:

I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve e lëna.



-Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ASHSH, ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve nga marrja e shkresës, sipas të cilës KLSH duhet të vihet në dijeni mbi marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, dërgon planin e veprimeve, duke përcaktuar pranimin e rekomandimeve të KLSH-së, ose refuzimin e zbatimit të rekomandimit në rastin e masës për shpërblim dëmi.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.

-Në zbatim të pikës 2, të nenit 30, të Ligjit nr.154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nga titullari i institucionit urdhi i brendshëm nr.372, datë 27.06.2018 “Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH të lëna në raportin përfundimtar të auditimit të ushtruar në Akademinë e Shkencave, e cila ka kthyer përgjigje në KLSH, me shkresën nr.250 pro., datë 28.06.2019, duke tejkeluar afatin 6 mujor të parashikuar sa më sipër”.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

Për përmirësim të gjendjes janë lënë 6 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht 6, janë zbatuar 3, në proces 4.

Për përmirësim të legjislacionit dhe akteve nënligjore në fuqi janë lënë 1 masë për përmirësim ligjor, e cila është pranuar plotësisht 1, janë zbatuar 0, në proces 0.

Më hollësisht, auditimi i ndjekjes së rekomandimeve paraqitet si vijon:

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN DHE AKTET NËNLIGJORE NË FUQI:

Rekomandim: 1.1 Institucioni të marrë masa në hartimin e Kodit të Etikës, me qëllim vendosjen e rregullave të sjelljes së nëpunësve të administratës publike, sipas standardeve të kërkuara, t'i ndihmojë ata për arritjen e këtyre standardeve dhe të vendosë në dijeni publikun për sjelljen që duhet të ketë nëpunësi i administratës publike gjithashtu të marrë masa në hartimin dhe miratimin lidhur me delegimin e kompetencave në rregulloren e brendshme duke trajtuar delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre. Akademia e Shkencave të marrë masa në miratimin e Strategjisë së Institucionit si dhe Regjistrin të riskut nga titullari i institucionit.

Afati: Në vijimësi.

Përgjigja e institucionit:

Në këtë institucion është miratuar Rregullorja e Brendshme, e cila në përgjithësi parashikon raportet punëdhënës-punëmarrës dhe midis vetë punëmarrësve, por institucioni nuk ka hartuar Kodin e Etikës, si dhe; Lidhur me delegimin e kompetencave, nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues dhe menaxherë të tjerë të njësisë, nuk kanë rregulla të brendshme të miratuara nga titullari, të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre. Me shkresë të KLSH nr.450/12 prot datë 26.06.2019 është paraqitur “Autorizim mbi verifikimin e zbatimit të rekomandimeve”. Në shkresën dërguar KLSH (Departamentit të Auditimit të Institucioneve Qendrore) me nr. 243/1 prot, datë 01.07.2019 “Kthim përgjigje” është përcjellë dokumentacioni i kërkuar sipas rekomandimeve si: rregullore etikës për shërbimin civil nr.400/5 prot. datë 28.12.2018, Regjistri i Riskut për ASH për vitin 2019, Hartimi i strategjisë për ASH, Plani i



masave organizative për zbatimin e rekomandimeve të KLSH.(bashkëlidhur dokumentacioni sipërcituar).

Ndërkohë, në observacionin e ardhur me Nr.959/4 prot., datë 22.01.2024 mbi akt - konstatimin Nr.8 „me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 53/2019 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë” dhe të vendimit të Kuvendit nr. 36/2020 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe nivelit të pagave për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”, nga ASH, vijoi puna për miratimin e rregullore së brendshme administrative e cila u miratua me vendimin e Kryesisë nr. 16, datë 24.3.2022. Pjesë e kësaj rregullore është dhe Etika profesionale e punonjësve (neni 12).

Ndërkohë, në observacionin e ardhur me Nr.959/4 prot., datë 22.01.2024 mbi akt – konstatimin, për çdo vit kemi hartuar regjistër risku siç konfirmohet tek ky akt-konstatim tek pika “Menaxhimi i Riskut” (viti 2021 regjistër risku me numër 45/4 datë 08.02.2021: Viti 2022 regjistër me numër 178/1 datë 28.02.2022: viti 2023 regjistër me nr. 130/1, prot.datë 27.02.2023) ku janë të indentifikuar qartë risqet që mund të ndodhin gjatë veprimtarisë për realizimin e objektivave.

Komenti i grupit të auditimit: Referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion, konkretisht Rregullore së etikës për shërbimin civil me nr.400/5 prot., datë 26.12.2018 i miratuar nga përgjegjëse e sektorit znj. L.Xh, por jo nga titullari i institucionit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i pazbatuar***.

Përsa i takon Regjistrin të Rriskut për ASHSH ka vetëm për vitin 2023 dhe vitin 2021, për vitin 2022 nuk ka një regjistër rrisht të miratuar. Por për të gjithë vitet objekt auditimi ky regjistër risku është i pamiratuar nga titullari i institucionit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i pazbatuar***.

B. MASA ORGANIZATIVE:

Rekomandim 2.1: Për të vlerësuar përshtatshmërinë e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, Akademia e Shkencave të marrë masat për të hartuar dhe miratuar gjurmët e auditimit, ku të përfshihen proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë që përfshijnë zbatimin e aktiviteteve, programeve dhe projekteve me të rëndësishme.

Në vazhdimësi

Përgjigjia e institucionit:

Për të vlerësuar përshtatshmërinë e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, Akademia e Shkencave ka filluar puna për hartimin dhemiratimin e gjurmës së auditimit, ku të përfshihen proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave për zbatimin e aktiviteteve, programeve dhe projektve me të rëndësishme. Proces në vijim.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër, rezulton se gjurma e auditimit nuk është miratuar nga Titullari i ASH-së Për vitet objekt auditimi (2021,2022,2023), në kundërshtim me nenin 16 të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i pazbatuar***.

Rekomandimi 3.1: Të marrë masat e duhura për zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve dhe të hartojë dhe miratojë planin e trajnimeve bazuar në kërkesa specifike për trajnimin e punonjësve të administratës, për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe manualin të dalë në zbatim të tij. Në mënyrë të veçantë për menaxhimin e riskut pasi menaxherët e njësisë nuk zotërojnë informacion për qëllimet dhe rëndësinë e menaxhimit financiar dhe kontrollin.



Në vazhdimësi

Përgjigjia e institucionit:

Hartuar plani i trajnimeve bazuar në kërkesa specifike për trajnimin e punonjësve dhe janë marrë të gjitha masat për vënien e tij në zbatim, me qëllim zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve, kjo e bashkërendura me ASPA.

Komenti i grupit të auditimit:

Nuk ka një plan trajnimesh për periudhën object auditimi, me qëllim zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i pazbatuar***.

Rekomandim 4.1: Për këtë, të merren masa për të ndryshuar kontratën e lidhur midis palëve, duke shtuar një nen të veçantë ku të përcaktohen të “drejtat dhe detyrimet e marrësit në dorëzim” për këtë pajisje.

Në vazhdimësi

Përgjigjia e institucionit:

Bër kërkesë z. H. R për lidhjen e një kontrate të re ligjore me detyrime dhe të drejta mes palëve. Ndërkohë, në observacionin e ardhur me Nr.959/4 prot., datë 22.01.2024 mbi akt – konstatimin, nga ana e Akademisë së Shkencave (referuar dhe shkresës nga Kontrolli i Lartë i Shtetit nr. 1199/6 prot., datë 17.12.2018 “Dërgohet raporti përfundimtar dhe rekomandimet për auditimin e pasqyrave financiare”), kërkesa për lidhjen e një kontrate të re iu është dërguar H. R, por nuk ka patur përgjigje nga ana e tij. Nga seksioni i shkencave natyrore dhe teknike gjatë kësaj jave është tentuar të kontaktojmë z. H. R, por nuk ka qenë e mundur.

Komenti i grupit të auditimit:

Ka vetëm një kërkesë për lidhjen e një kontrate të re, por nuk është vendosur në dispozicion asnjë dokumentacion nëse është lidhur kontrata ose jo.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i pa zbatuar***.

Rekomandim 5.1: Nga kryesia e Akademisë së Shkencave të merren masa për shpërndarjen e tyre në institucione të ndryshme shtetërore ku edhe përshtatet përdorimi, apo edhe në shkolla publike që kanë interes në edukimin e nxënësve apo studentëve.

Në vazhdimësi

Përgjigjia e institucionit:

Në reflektim të drejtpërdrejtë të këtij rekomandim, ka filluar një fushatë bashkëpunimi me pothuajse të gjitha Universitetet Publike të vendit si dhe në institucione të ndryshme shtetërore ku dhe përshtatet përdorimi. Me urdhër nr. 13, datë 16.05.2019 janë dhuruar Fakultetit Filiologjik 150 tituj libra.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i zbatuar***

Rekomandim 6.1: Për këtë, në mbylljen e bilancit kontabël të vitit 2018 të merrën masa për të sistemuar llogarinë 421 “Personeli dhe llogari të lidhura me to” për shumën prej 11,327 lekë, duke kryer veprimin kontabël në debi të llogarisë 421 për shumën prej 11,327 lekë dhe në kredi të llogarisë të ardhura të ndryshme. (në pamundësi për t’u xhiruar në degën e tatim taksave).

Në vazhdimësi



Përgjigjia e institucionit:

Në mbylljen e bilancit kontabël të 2018 u sistemua llogaria 421 për shumën 11 327 lekë duke kryer veprimin kontabël dhe për shumën 11 327 lekë në kredi të llogarisë të ardhura të ndryshme.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i zbatuar***.

Rekomandim 7.1: Akademia e Shkencave të marrë të gjitha masat që në të ardhmen të sigurojë një proces automatik dhe efektiv të regjistrimit dhe raportimit të shpalosjeve në pasqyrat financiare vjetore, duke përdorur programe financiare të mbajtjes së kontabilitetit, të cilat do të sigurojnë kontrole të sigurta, efçente e efektive dhe i mundësojnë drejtuesit të institucionit marrjen e një garancie të besueshme që vendimet në lidhje me buxhetin, planifikimin etj., janë zbatuar siç duhet.

Në vazhdimësi

Përgjigjia e institucionit:

ASH ka marrë të gjithë masat për të siguruar një program informatik dhe efektiv të regjistrimit dhe raportimi të shpalosjeve në pasqyrat financiare vjetore duke përdorur programe financiare 5ë mbajtjes së kontabilitetit. Me urdhër prokurimi nr. 14 datë 03.04.2019 U KRYE BLERJE programi financiar në WRB. Mbahen ne nje softmer alfa por, referuar gjetjeve te brea nga grupi i auditimit per pas financiare, vendosa e ketij programi nuk e ka arritur qëllimin e rekomandimit, si i tille eshte pjeserisht.

Komenti i grupit të auditimit:

ASH ka marrë të gjithë masat për të siguruar një program informatik dhe efektiv të regjistrimit dhe raportimi të shpalosjeve në pasqyrat financiare vjetore duke përdorur programe financiare të mbajtjes së kontabilitetit. Me urdhër prokurimi nr. 14 datë 03.04.2019 u krye blerje programi financiar në Web. Mbahen ne programin financiar alfa por, referuar gjetjeve te bëra nga grupi i auditimit për pasqyrat financiare, vendosja e këtij programi nuk e ka arritur qëllimin e rekomandimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i zbatuar pjesërisht***.

Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, sipas programit të auditimit nr.959/1 prot, datë 07.11.2023 rezulton se, subjekti i audituar ka respektuar afatin 20 ditor për hartimin e planit të masave për zbatimin e rekomandimeve në përputhje me kërkesat e nenit 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në zbatim të pikës 2, të nenit 30, të Ligjit nr.154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nga titullari i institucionit urdhri i brendshëm nr.372, datë 27.06.2018 “Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH të lëna në raportin përfundimtar të auditimit të ushtruar në Akademinë e Shkencave, e cila ka kthyer përgjigje në KLSH, me shkresën nr.250 prot., datë 28.06.2019, duke tejkaluar afatin 6 mujor të parashikuar sa më sipër”.

Rezultoni se janë dhënë gjithsej 7 rekomandime të cilët janë pranuar plotësisht (100 %), dhe rezultojnë të zbatuar plotësisht 4 masa (57 %). Masat e pa zbatuara janë:

- Për të vlerësuar përshtatshmërinë e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, Akademia e Shkencave të marrë masat për të hartuar dhe miratuar gjurmët e auditimit, ku të përfshihen proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë që përfshijnë zbatimin e aktiviteteve, programeve dhe projekteve me të rëndësishme.



- Të marrë masat e duhura për zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve dhe të hartojë dhe miratojë planin e trajnimeve bazuar në kërkesa specifike për trajnimin e punonjësve të administratës, për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe manualin të dalë në zbatim të tij. Në mënyrë të veçantë për menaxhimin e riskut pasi menaxherët e njësisë nuk zotërojnë informacion për qëllimet dhe rëndësinë e menaxhimit financiar dhe kontrollin.

- Për këtë, të merren masa për të ndryshuar kontratën e lidhur midis palëve, duke shtuar një nen të veçantë ku të përcaktohen të “drejtat dhe detyrimet e marrësit në dorëzim” për këtë pajisje.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8 faqe 194-202 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi: Akademia e Shkencave të Shqipërisë të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e të gjitha rekomandimeve që rezultojnë të pazbatuara dhe të zbatuara pjesërisht. Për të gjitha rekomandimet e tjera, që konsiderohen në proces zbatimi, inkurajohet përsheptimi i realizimit të plotë të tyre brenda vitit 2024.

9. Probleme të ndryshme që mund të dalin gjatë auditimit.

Në zbatim të pikës 9 të programit të auditimit: “të ndryshme të dala gjatë auditimit”, u shqyrtua ankesa e ardhur në KLSH me praktikën nr. 1084, datë 12.12.2023 të paraqitur nga “Mjeshtër i madh” dhe “Artist i Merituar” z. Y.LL ku pretendon se:

“Ju drejtohem Juve, si organi më i larti Kontrollit të Lartë të Shtetit”, pasi po mbushen tre dekada, që kur shoqata kulturore artistike Polifonia Shqiptare, në bashkëpunim me të gjithë studiuesit, etnomuzikologët, muzikologët, historian arkeolog, si dhe intelektual të niveleve në vend, që u bashkohen bartësve të këngës shumë zërëshe Shqiptare, për tjetërsimin e identitetit të kësaj vlere të rallë po dhe të vetme shpirtërore në botë nga, pseudo muzikologët e tranzicionit, Vaso Tole, aktualisht në krye të Akademisë së Shkencave!

Me protestat dhe ankesat tona në të gjitha dikasteret dhe pse ky i ashtu quajtur Prof. Dr. si dhe Akademik ne e kemi marrë përgjigjen e merituar nga Ministria e Kulturës me porosi të Kryeministrit z. E. R., se nuk do të përdoret më termi antikombëtar i shpikur nga ky i paudhë (Isopolifoni)!!!

Po të njëjtën përgjigje kemi marr dhe nga Kryetari i Akademisë së Shkencave z. Prof. Dr.S.GJ. ku disponon dhe të gjitha dokumentat e Shoqatës Polifonia me 18 shoqata mbarë kombëtare, me gjithë grupet polifonike, si dhe promemorie dhe rezoluta e Forumit të XI Akademik organizuar nga Akademia e Arteve me Kryetar Artistin z. L.D. Kjo e drejtë nuk po zgjidhet, pasi aryeja dihet!

Sepse ky, që do të bëhet i famshëm, duke ja dhuruar Grekut këtë pasuri, ndodhet në krye të Akademisë së Shkencave, si Nën Kryetar!

Për rëndësinë që i jep vetesme servilizmat e tij, ka marr përsipër dhe disa komisione për kulturën, si në Ministri, Presidencë, Kryeministri, ku në këto komisione, nuk na jepet çdo e drejtë që na takonë, deri dhe tek pensioni i posaçëm, për trajtimin e Artistit, ku propozimi nga Ministria e Kulturës i është bërë për Y. Ll qysh në vitin 2020 për tu trajtuar!

Le të shpresojmë në dikasterin tuaj të nderuar, se drejtësia për të çuar identitetin e këtij kombi në shekuj, do të çohet në vend, se po mbahet peng nga një i shitur, i cili shkel rëndë mbi punën madhoree studiuesve tanë për këtë kultur të Nderit të Kombit Prof. Dr. R.S, Prof. Dr. B.K, Nderit të Kombit L.Ç, S.Sh, A.U e shumë e shumë të tjerë!”

Grupi i auditimit në Akademinë e Shkencave pas disa kërkesave verbale dhe konfirmimeve të mara nga punonjësit e Akademisë se nuk kryhet asnjë pagesë nga Akademia për grupe interesi me përjashtim të:

1. Honorare për autorë botimesh dhe recezentë për botimet e ASH.



2. Honorare për kumtues të jashtëm në konferenca shkencore kombëtare e ndërkombëtare (nuk paguhen për kumtesa staf i brendshëm i ASH)
3. Honorare për anëtar të jashtëm të komisioneve të ngritura në ASH (nuk paguhen akademikët dhe staf i akademisë që janë anëtar komisionesh, përveç sekretarëve të Seksioneve Shkencore sipas Vendimit për këtë qëllim).
4. Honorare për këshillin e botimeve sipas VKM nr.621, datë 24.09.2014 "Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve etj.....".
5. Honorare për tre projekte madhore në Albanologji: Historia e Shqiptarëve, Fjalori i madh i Gjuhës Shqipe dhe Enciklopedia e Shqiptarëve.

Konfirmuar kjo edhe me email nga Përgjegjësia e Sektorit të Financës datë 12.01.2023.

Referuar Neni 5 të Ligj Nr.7703 datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar kushtet e përfitimit, shuma dhe procedura për dhënien e pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

"Neni 5

Pensionet shtetërore të posaçme

Kanë të drejtë për pensione të posaçme që jepen nga shteti personat që:

- a) *Kanë marrë pjesë në lëvizjen e Rilindjes Kombëtare, në lëvizjet popullore, në luftën kundër pushtuesve nazifashistë brenda dhe jashtë Shqipërisë dhe në lëvizjen demokratike dhe që kanë merita të veçanta;*
- b) *kanë arritur rezultate të dallueshme në fushën e shkencës, kulturës, arteve, ekonomisë dhe politikës;*
- c) *kanë vuajtur nga persekutimi politik në rregjimin komunist.*

Personat e përmendur në shkronjat a,b,c të këtij neni përfitojnë:

- a) *pension të posaçëm shtetëror, në rast se nuk përfitojnë pension nga sigurimet shoqërore, ose*
- b) *shtesë pensioni të posaçëm shtetëror mbi pensionin që u takon nga sigurimet shoqërore.*

Kushtet e përfitimit, shuma dhe procedura për dhënien e pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Këshilli i Ministrave ka të drejtë të vendosë që administrimi i pensioneve të posaçme shtetërore të bëhet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe shpenzimet të mbuloohen nga Buxheti i Shtetit."

Si dhe Vendim nr. 429, datë 12.9.2002 "Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore", i ndryshuar:

"4. Kërkesa për përfitimin e pensionit të posaçëm shtetëror ose shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror bëhet nga i interesuari ose nga organizatat a shoqatat, nëpërmjet këshillit të qarkut të vendbanimit të personit të propozuar, ministrave përkatës, Kryeministrit, Kryetarit të Kuvendit ose Presidentit.

Këshilli i qarkut, Ministri, Kryeministri, Kryetari i Kuvendit ose Presidenti, pasi shqyrtojnë kërkesën dhe dokumentacionin shoqëruar, i propozojnë Këshillit të Ministrave, me vendim të argumentuar, dhënien e pensionit të posaçëm shtetëror ose shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror. Vendimi i paraqitet Këshillit të Ministrave, së bashku me dokumentacionin që kërkohet sipas këtij vendimi. Kur kërkesa nuk vlerësohet si e drejtë, i kthehet kërkuarit, e shoqëruar me argumentet përkatëse.



Ministri, Kryeministri, Kryetari i Kuvendit ose Presidenti mund të propozojnë drejtpërdrejt, me nismën e tyre, pavarësisht nga mosparaqitja e kërkesës së të interesuarit, dhënien e pensionit të posaçëm shtetëror ose shtetës së pensionit të posaçëm shtetëror, personave që vlerësohen se plotësojnë kriteret ligjore.

5. Propozimi, që paraqitet në Këshillin e Ministrave, për përfitimin e pensionit të posaçëm shtetëror ose shtesë pensioni të posaçëm shtetëror, shoqërohet me:

- kërkesën e të interesuarit, të shoqatës a të organizatës, e cila duhet të përmbajë: gjeneralitetet, emrin, atësinë, mbiemrin, datëlindjen, vendlindjen etj;

Në rastin e propozimit të drejtpërdrejtë, gjeneralitetet jepen në vendim.

- vendimin e institucionit propozues, të shoqëruar me relacionin, i cili argumenton arsyet e propozimit dhe paraqet procedurën e ndjekur, etj;

- certifikatën e gjendjes civile;

- vërtetimin nga organet e sigurimeve shoqërore nëse merr pension dhe, nëse merr pensionin, vërtetimin për masën e pensionit;

- vërtetimin nga KMCAP-i për personat e paaftë për punë;

- kopjet e noterizuara të dokumenteve, që vërtetojnë meritat e veçanta të personit për të cilin bëhet propozimi, si titujt, medaljet, urdhrat etj;

- kopjen e noterizuar të dokumentit të statusit për përfituesit, sipas shkronjës “c” të nenit 5 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993.

7. Për shqyrtimin e dokumentacionit për pension të posaçëm shtetëror ose shtesë pensioni të posaçëm shtetëror ngrihet një komision i veçantë. Përbërja dhe rregullorja e funksionimit të këtij komisioni miratohen nga Kryeministri. Komisioni përgatit relacion për plotësimin ose jo të kushteve të përcaktuara me ligj dhe me këtë vendim dhe ia paraqet Kryeministrit.

8. Pensioni, data e fillimit të pensionit të posaçëm shtetëror ose shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror caktohen me vendim individual të Këshillit të Ministrave.”

Pra nuk është tagër e as kompetencë ligjore e institucionit nën auditim Akademia e Shkencave. Nëse z. T. është anëtar në ndonjë komision të ngritur nga institucionet kompetente nuk mund ta verifikojmë dot në ASH si dhe ndikimin e tij në vendimarrje.

Për sa i përket termit “ISOPOLIFONI”

Grupi i auditimit shqyrtoj dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga ana e përfaqësuesve të Akademisë së Shkencave si më poshtë vijon:

- Fjalori i madh i gjuhës shqipe, ASHSH

- Fjalori enciklopedik Shqiptar, ASHSH

- Honoraret e ndryshme të dhëna gjatë periudhës për efekt të çështjes sipërcituar

Bashkangjitur fotografi nga fjalorët:



Polifoni – fjlori i madh i gjuhës shqipe

POLIFONI (1980)

POLIFONÍ,~A f. muz. Këngë popullore me shumë zëra. *Polifonia jonë. Polifonia popullore. Polifonia e Jugut.*

POLIFONI (2020)

polifoní,-a f. muz. këngë popullore me shumë zëra: *polifonia e Jugut.* // mb. **-k, -ke** që këndohet me shumë zëra: *këngë polifonike; / i përbërë nga disa këngëtarë popullorë, që këndojnë së bashku me zëra të ndryshëm: grup polifonik.*

POLIFONI (2006)

polifoní,-a f. muz. këngë popullore me shumë zëra: *polifonia e Jugut.*

• **-k, -ke** mb. që këndohet me shumë zëra: *këngë polifonike; / i përbërë nga disa këngëtarë popullorë, që këndojnë së bashku me zëra të ndryshëm: grup polifonik.*

Iso – fjalori i madh i gjuhës shqipe

ISO (1980)

ISO,~JA f. 1. Zë i njëtrajtshëm, që zgjatet pa u ndryshuar dhe që shoqëron e mbështet zërat kryesorë në një këngë me shumë zëra a një melodi. *Iso e fortë (e gjatë, e ngadalshme). Isoja labe (myzeqare). Isoja e burrave (e grave, e të rinjve). Këngë me iso. Iso, more djema, iso! Këndojmë (ia marrim) me iso. Mbjaj (bëj) iso me zë (me fyell).* 2. Tingëllimë e njëjtë dhe e zgjatur që lëshon diçka. *Isoja e zileve (e këmborëve).* * **I mban ison (i bën iso)** dikujt keq. e mbështet dhe e përkrah dikë për çdo gjë, ia pranon a ia miraton mendimet, fjalët etj. për t'i bërë qejfin, i shkon pas qejfit, i mban avazin.

ISO (2020)

iso,-ja f. zë që zgjatet pa u ndryshuar dhe shoqëron e mbështet zërat kryesorë në një këngë me shumë zëra a në një melodi: *isoja e burrave; mbanin iso. i mban iso* (dikujt) keq. e përkrah në çdo gjë, i shkon pas avazit.

ISO (2006)

© Akademia e Shkencave e Shqipërisë | 2023

Fjalori i madh i gjuhës shqipe | ASHSH

iso,-ja f. 1. zë që zgjatet pa u ndryshuar dhe shoqëron e mbështet zërat kryesorë në një këngë me shumë zëra a në një melodi: *isoja e burrave; këngë me iso; mbanin iso.* 2. tingëllimë e njëtrajtshme dhe e zgjatur: *isoja e zileve. i mban(i bën) iso* (dikujt) keq. e përkrah në çdo gjë, i shkon pas avazit.

ISO (K. Topalli)

ISO f. “zë që zgjatet pa ndryshim dhe sho-qëron zërin kryesor në këngë popullore”. Fjalë e toskërishtes, e lidhur me mënyrën e të kën-duarit polifonik në anët e Jugut. Huazim nga gr. e re ἴσο “i njëjtë, i barabartë”. (Bibl.: Uhlisch NL 143).

Isofilifonia- është edhe zë më vete në Fjalorin Enciklopedik Shqiptar Vëll. 2,Viti 2008, f. 1052, Fjalori enciklopedik shqiptar



tare" (Tiranë, 2005) etj.
Në fushën e letërsisë ka botuar përmbledhjet "Rrënjë e fortë" (Antologji e poezisë bashkëkohore të Arbëreshëve të Italisë) (Prishtinë, 1978), "Antologji e poezisë rumune të shek. XX" (Prishtinë, 1979), "Pjetër Budi Poezi 1618–22 (Studim hyrës, transliterim, komente)", (Prishtinë, 1986), "Poezi e sotme arbëreshe" (Prishtinë, 1990); "Moral yjesh" (poezi europiane e shek. XX) (Prishtinë, 1990). Ka përkthyer: F. de Saussure "Kursi i gjuhësisë së përgjithshme" (Prishtinë, 1977; Tiranë, 2002), A. Martinet, "Elemente të gjuhësisë së përgjithshme" (Prishtinë, 1974; 1983, Tiranë, 2002), O. Ducrot - T. Todorov "Fjalor enciklopedik i shkencave të ligjërimit" (Prishtinë, 1984), R. Barthes "Aventura semiologjike" (Prishtinë, 1987) etj. ✎ Seit Mansaku, Enver Hysa ISNIQI. Fshat në komunën e Deçanit, në të dy anët e rrugës automobilistike Pejë-Deçan-Gjakovë, përgjatë rrugës e cila lidh Deçanin me *Strelcën e Poshtëm* (shih). Është një ndër fshatrat më të mëdha të kësaj komune, jo vetëm nga sipërfaqja prej 6963 ha, por edhe nga numri i popullsisë: 4203 banorë. Pjesa më e madhe e territorit shtrihet në malet e Strelcës, të ndërtuara prej formacioneve të Mesozoikut. Në strukturën e tokave vetëm 10% janë tokë arë, 29% janë sipërfaqe me livadhe dhe kullota dhe 61% pyje. Në pjesën më të madhe popullsia merret me bujqësi e sidomos me blegtori dhe pylltari. I si lokalitet i madh, ka disa institucione administrative, shoqërore (bashkësi lokale), shkollë (shkollë fillore dhe paralele të shkollës së mesme), shëndetësore (qendër shëndetësore), komunikacioni (stacion i autobusëve), postë vendore, dyqane zejtarie për nevojat e përditshme të popullsisë etj. ✎ Riza Çavolli ISOPOLIFONIA POPULLORE. *Shih: POLIFONIA POPULLORE.* ISPENXHA. Detyrim kryesor në të holla që u vilej në Perandorinë Osmane

fshatareve *raja* (shih) dhe qytetareve të krishterë, të martuar ose jo, të cilët kishin arritur moshën e pjekurisë, pavarësisht nëse ishin apo nuk ishin pajisur me tokë. Ky detyrim shprehte varësinë e fshatarit *raja* ndaj *spahiut* (shih) të vet dhe ishte një nga detyrimet kryesore në të holla që vilnin spahinj të në dobi të vet. I. në shek. XV–XVI në trevat shqiptare, si dhe në viset e tjera të Ballkanit viley zakonisht në masën 25 akçe për njeri. Më vonë në shek XVII–XVIII, me shthurjen e sistemit të timareve dhe me thellimin e shtypjes feudale, arriti deri në 35 akçe për njeri. Nga fshatarët me besim mysliman në vend të I. viley *taksa e pendës (resmi çift)* në masën 22 akçe për njeri. I. u vol deri në heqjen e sistemit të timarit në v. '30 të shek. XIX. ✎ Selami Pulaha ISTOGU. *Shih: BURIMI.* ISUFI Adem (1831–1911). Luftëtar i *Lidhjes Shqiptare të Prizrenit* (shih). Lindi në Shkrel të Rugovës, rreth v. 1831 në familjen Rexhaj. Mori pjesë në mjaft beteja kundër Malit të Zi për mbrojtjen e tokave shqiptare në Veri, para dhe pas v. 1878. U shqua në betejën e Moraçës më 1877, ku u plagos keq, dhe në betejën e Nokshiqit, më 4 dhjetor 1879 kundër ushtrisë të Malit të Zi. Ka qenë edhe pleqnar. Vdiq në fshatin Boroshiticë të Peshterit dhe u varros në fshatin Grac. Emri i tij përmendet në këngë epike dhe në ninulla në Rugovë e në Rrafshin e Dukagjinit. ✎ Zymer Neziri ISUFI Bejto (1926–1994). Pjesëmarrës i Luftës ANÇ, kolonel. Lindi në Mavrovë (Vlorë). Kreu shkollën fillore në vendlindje dhe ndoqi Shkollën e Mesme Tregtare në Vlorë. U përjashtua në v. 1942 për veprimtari antifashiste dhe u hodh në luftë kundër pushtuesit. Sekretar i Rinisë Komuniste të zonës së Drashovicës (1942). Mori pjesë në aksionin e prerjes së telave (korrik 1942), në djegien e depove të municionit në Mavrovë, në *Luftën e Drashovicës* (shih) etj. Në krye të 30–40 të rinjve u rreshtua në *Brigadën V S* (shih), si

Vepra të publikuara, të cilat kanë në përmbajtje dhe trajtojnë çështjen e polifonisë shqiptare rezultojnë si më poshtë vijon:

- T, V, S. *On the albanian folk iso-polyphoni* / V.S.T, 2004.
- T,V.S. *Folklori muzikor: enciklopedika e muzikës popullore shqiptare* / V.S.T. Pjesa III.- 328 f.; 23 cm., 2001, Tiranë.
- T,V.S. / P.I *Fjalor i muzikës klasike dhe popullore* / V.S.T, I.P, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2015, ISBN 978-99956-10-82-1.
- T,V.S. *Odyssey and sirens : a temptation towards the mystery of the iso-polyphonic regions of Epirus: a Homeric theme with variations* / V.S.T; përktheu: P.P, Mediaprint, Tiranë, 2015, ISBN 978-9928-08-182-7.
- T,V.S. *Iso gjëma : për 16 zëra vajzash* [V.S.T], Tiranë, 1995.
- T,V.S. *Iso polyphony multiverse: për orkestër* / V.S.T [V.S.T], Tiranë, 2015.

Për sa më sipër rezulton se:

✓ Polifonia shqiptare ka hyrë si pasuri kombëtare, jomateriale në UNESCO në datë 25.11.2005 (<https://www.unesco.org/en>) me termin "Isopolifoni" (polifoni me iso) dosje e cila është përgatitur dhe përcjellë nga Ministria e Kulturës, ku edhe personi për të cilin ankohen z. T ka qenë pjesë e grupit të punës.



- ✓ Për sa i përket pjesëmarrjes në komisione dhe pengesa për pensionin e posaçëm, ato nuk janë në kuadrin e veprimtarisë operacionale të Akademisë së Shkencave, por janë kompetencë e Kryeministrit.
- ✓ Nga auditimi i dokumentacionit vendosur në dispozicion lidhur me përkufizimin e fjalës “Isopolifoni” në të gjithë fjalorët që disponon Akademia e Shkencave rezulton fjala “isopolifoni” por në fjalorin Enciklopedik vendos referencën “*shih Polifoni Popullore*” nuk ekziston si togfjalësh në asnjë nga fjalorët, por janë fjalë të veçanta “Iso” dhe “Polifoni”.
- ✓ Nga ana e ASHSH për periudhën 2019-2023 nuk janë kryer shpenzime për pagesa honorare për "Isopolifoni"-në. Ndërkohë llojet e honorareve që paguhën nga ASH për grupet e interesit janë:
 - Honorare për autorë botimesh dhe recezente për botimet e ASH.
 - Honorare për kumtues të jashtëm në konfereca shkencore kombëtare e ndërkombëtare (nuk paguhën për kumtesa staf i brendshëm i ASH).
 - Honorare për anëtarë të jashtëm të komisioneve të ngritura në ASH (nuk paguhën akademikët dhe staf i akademisë që janë anëtarë komisionesh, përveç sekretareve të Seksioneve Shkencore sipas Vendimit për këtë qëllim).
 - Honorare për këshillin e botimeve sipas VKM nr.621, datë 24.09.2014 "Për percaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve etj.....".
 - Honorare për tre projekte madhore në Albanologji: Historia e Shqiptarëve, Fjalori i madh i gjuhës Shqipe dhe Enciklopedia e Shqiptarëve.
- ✓ Pas disa kërkesave verbale për vendosjen në dispozicion të çdo praktike / kërkesë-ankesë të z. Ll. në ASHSH dhe mos vendosjes në dispozicion të tyre, u rikërkuar zyrtarisht e njëjta kërkesë, me emailin e datës 11.01.2024. Përgjigjja zyrtare e ardhur me emailin e datës 12.01.2024 ishte: ... *Nqs do të na ishte identifikuar ndonjë periudhë nga kërkuesi do të ishte ndihmë për një verifikim më të hollësishëm për ndonjë kërkesë të bërë nga personi në fjalë.*

Për sa më sipër u rekomandua:

Gjetje nga auditimi: Polifonia shqiptare ka hyrë si pasuri kombëtare, jo materiale në UNESCO në datë 25.11.2005 me termin “Isopolifoni” (polifoni me iso), dosje e cila është përgatitur dhe përcjellë nga Ministria e Kulturës. Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion lidhur me përkufizimin e fjalës “Isopolifoni”, në gjithë fjalorët që disponon Akademia e Shkencave rezulton se: fjala “Isopolifoni” është vetëm në fjalorin Enciklopedik dhe në referencë ka “*shih Polifoni Popullore*”, gjithashtu nuk ekziston si togfjalësh në asnjë nga fjalorët por janë fjalë të veçanta “Iso” dhe “Polifoni”. Akademia e Shkencave ka botuar ndër vite 6 botime ku trajtohet “Isopolifonia”. Referuar shkresës nr. 3027/1, datë 06.08.2014 “Përgjigje shkresë” të Ministrisë së Kulturës drejtuar Kryeministrit ku konkludohet se Ministria e Kulturës do të përdorë termin “Polifoni Shqiptare”.

Rekomandimi: Akademia e Shkencave me autoritetin shkencor që zotëron, në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës dhe Ekonomisë të marrë masa të menjëhershme për unifikimin e konceptit dhe përdorimit të termit “Polifoni Shqiptare” në të gjithë fjalorët dhe botimet e financuara nga Akademia, si dhe kundërshtimin e ndarjen e termit “Iso” nga muzika kishtarë bizantine.

Menjëherë dhe në vijimësi

**Observacion i paraqitur nga ana e subjektit me shkresën nr.896/35 prot., date 29.03.2024
protokolluar në KLSH me nr. 959/6 prot., datë 02.04.2024****Pretendimi i subjektit:**

Të hiqet nga raporti se s'ka lidhje me veprimtarinë ASHSH-së dhe se problemi i pretenduar nuk mund të jetë objekt kontrolli nga çdo institucion për çështje ligjshmërie e menaxhimi fondesh publike. Sqarojmë se në Unesco nuk i është vënë vetëm emri këngëve polifonike të Shqipërisë së jugut si një prej thesareve të kulturës sonë popullore.

Qëndrimi Grupit të Auditimit:

Pretendimi juaj është i pa bazuar të ligj, KLSH ka trajtuar ankesën e ardhur nga qytetar bazuar në mandatin e saj Kushtetues dhe ligjor duke ruajtur transparencën dhe të drejtën e informimit të qytetarëve.

Sa më sipër observacioni nuk pranohet.

SHËNIM: Disa rekomandime të lëna në projektraport janë zbatuar gjatë fazës së dorëzimit të observacioneve dhe u paraqitën dokumentacion justifikues dhe nuk do të kërkohet zbatimi i rekomandimeve të mëposhtme në raport përfundimtar:

1. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit është konstatuar se ka mospërputhje mes ligjit dhe statutit përsa i përket mandatit të kryetarit. Ndryshimet e reja ligjore, në nenin 11 pika 4 në Ligjin Nr. 53/2019, të ndryshuar, datë 21.7.2023 ku përcaktohet se mund të rizgjidhen në të njëjtin funksion për dy mandate radhazi. Në Statutin e Akademisë sipas nenit 21 pika 2 e tij ku përcaktohet se “Ata mund të rizgjidhen në të njëjtin funksion për dy mandate, por jo 2 herë radhazi”, ky kriter nuk është në koherencë dhe përputhje të bazës ligjore, për shkak të mos përditësimit të statutit.

Grupi i auditimit konstaton se, përsa i takon ndryshimit të pikave 3 dhe 4 të nenit 11 të Ligjit nr.53/2019, të ndryshuar, nuk ka një njoftim nga Kryesia për mbledhje të Asamblesë për miratimin e ndryshimit të statutit, kjo në kundërshtim me pikën 1 d) të nenit 12 të Statutit, po ashtu nuk ka procesverbal mbledhjeje kjo në kundërshtim me pikën 1 të nenit 16 të Ligjit Nr.8480 datë 27.05.1999, nuk ka një argumentim/relacion shpjegues mbi nevojën e ndryshimit të ligjit nga ana e kryesisë, nuk ka një procesverbal mbi votimin e anëtarëve të asamblesë përveçse një dokumenti pa datë dhe vetëm me disa firma të cilat nuk janë të përcaktuara se cilët prej anëtarëve të asamblesë janë dhe nuk është i përcaktuar sa është numri i akademikëve që kanë votuar.

1.1 Rekomandime: Nga ana e Asamblesë së Akademisë së Shkencave të ndërmerren veprimet e nevojshme për miratimin e përmirësimeve të nevojshme të Statutit të ASH, në përputhje me parashikimet e kuadrit ligjor në fuqi, duke reflektuar dhe ndryshimet e ndodhura në institutet dhe qendrat kërkimore, pas mbylljes së veprimtarisë së Akademisë së Studimeve Albanologjike dhe riorganizimit të njësive të saj të përherëshme të kërkim-studimit pranë Akademisë së Shkencave.

2. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit konstatohet, se nuk ka një statut mbi bazë të të cilës funksion, kjo në kundërshtim me nenin 20, pika 4 të Ligji Nr.53/2019 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Akademia e të Rinjve është krijuar me vendim nr.14, datë 07.06.2019 “Për krijimin e Akademisë së të Rinjve pranë Akademisë së Shkencave dhe mbështetjen e studiuesve të rinj”, ku pjesë e saj kanë qenë fitues të cmimeve shkencore për kërkuesit e ri më të sukseshëm, që jepet nga Akademia e Shkencave, kërkues shkencor nën moshën 40 vjec që kanë gradën doktor të shkencave me



veprimtari të certifikuar botuar në revista shkencore të WEB of SCIENCE. Konstatohet se 6 prej anëtarëve deri në 2023 kanë vazhuar të jenë pjesë e akademisë, pavarësisht se kanë qenë mbi moshën 40 vjecare, deri në vendimin nr.65, datë 16.11.2023 “Për përbërjen e komisionit për konkursin e pranimit të anëtarëve të rinj në Akademinë e të Rinjëve”.

2.1 Rekomandimi: Të merren masa nga e Akademisë së Shkencave, për hartimin e një statuti për Akademinë e të Rinjëve në bazë të të cilës duhet të organizohet dhe funksionojë.

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se:

✓ Për v.2021 sa i takon aktrakordimit të të ardhurave me thesarin rezultonte se total i mjeteve monetare që ngeleshin për t’u trashëguar ishte 0.00 lekë, si dhe mungonte gjurma e rakordimit të llogarisë 520 në këtë akt rakordimi duke mos paraqitur tepricat të strukturuar sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të paçelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grantit që trashëgohet).

Për v.2022 llogaria 520 “Disponibilitete në thesar” nuk gjen pasqyrim në aktrakordimin me thesarin, si dhe kjo vlerë nuk rezulton e pasqyruar me kundërparti edhe në pasivin e bilancit kontabël ku duhet të figurojë e paraqitur për efekt diferenca nga përdorimi i sponsorizimeve.

3.1 Rekomandimi: Nga ana e Akademisë së Shkencave, sektori financës, të merren masat,

- Si një njësi e cila trashëgon të ardhura nga një vit ushtrimor në tjetrin, në trajtën e sponsorizimeve të trashëgueshme, sipas kuadrit ligjor në fuqi, nuk duhet të kryhet mbyllja e llogarisë së disponibiliteteve në thesar por kjo llogari do të pasqyrohet për tepricën debitore të saj në aktivet e pasqyrës së pozicionit financiar.

- Tepricat e llogarisë 520 të vërtetohen me aktrakordim me thesarin, një kopje e të cilit i bashkëngjitet llogarisë vjetore, sikundër parashikohet në UMF nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes dhe paraqitjes të PF vjetore të NJQP, pika nr.50 kreu 3.2 Procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të njësisive të qeverisjes së përgjithshme,

4. Gjetje nga auditimi: Nga ana e ASH, për të dy vitet objekt auditimi (v.2021 dhe v.2022) është vijuar me llogaritjen e amortizimit në grup për aktivet, duke bërë që librat dhe ndërtesa të amortizohen me të njëjtën normë amortizimi.

Në këto kushte hasim dy problematika, së pari llogaritje të amortizimit për libra ndërkohë që janë asete që nuk amortizohen dhe së dyti, edhe nëse do të ndodheshim në kushtet përjashtimore për këtë kategori (referuar SKK 5 pika 30, paragrafi II) sërish kemi përdorimin e të njëjtës normë për dy kategori të ndryshme. Sa më sipër operuar në kundërshtim me SKK 5 pika 30 e tij.

4.1 Rekomandim: Nga ana e Akademisë së Shkencave, Sektori i Financës të merren masat e nevojshme duke kryer veprimet përkatëse rregulluese kontabël në vijimësi dhe pasqyrimin e tyre në pasqyrat financiare/formatet përkatëse të ASH duke patur parasysh që, llogaria 212 “Ndërtime e konstruksione” është një llogari aktivi afatgjatë material e cila amortizohet dhe librat janë aktive të cilat referuar SKK nr.5 pika 30, paragrafi II janë të paamortizueshme.

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua fenomen i përsëritur për të dy vitet (v.2021,v.2022) sa i takon veprimeve kontabël me llogarinë 105 “Grant i Brendshëm Kapital”. Kjo vlerë nuk rezultonte e argumentuar me të ardhurat në likuiditete në llogarinë financiare të disponibiliteteve, si dhe me të drejta të konstatuara por të pa arkëtuara në periudhat përkatëse ushtrimore.

Për të dy vitet llogaria 105 “Grant i Brendshëm Kapital” ka mbetur e hapur në vlera (v.2022 në vlerën 9,215,029 lekë dhe për v.2021 në vlerën 6,056,054 lekë) pra me tepricë, pavarësisht faktit se këto grante nuk janë burim për investimet në proces të institucioneve (të papërfunduara ose të



pamarra në dorëzim), Nga ana e ASH këto vlera nuk janë kapitalizuar me fondet bazë në kohën kur investimi është përfunduar dhe marrë në dorëzim. Operuar kështu në kundërshtim me Udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022“ Disa ndryshime në Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 pika 47 gërma e.

5.1 Rekomandim: Nga ana e Akademisë së Shkencave, Sektori i Financës të merren masa për të kryer veprimet rregulluese, duke mbajtur parasysh se këto grante duhet të ishin mbyllur (kapitalizuar) me fondet bazë në kohën kur investimi është përfunduar dhe marrë në dorëzim sikundër parashikohet në Udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022 “Disa ndryshime në Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit në terren, për gjithë periudhën objekt auditimi, nuk është vendosur në dispozicion asnjë dokumentacion për sa i përket përgatitjes së projekt - buxhetit vjetor, si një nga detyrat funksionale të Kryesisë. Për vitin 2021, nuk rezulton asnjë dokument i mbledhjeve të kryera nga GMS, ku pjesë e saj janë edhe anëtarët e Kryesisë, për përgatitjen e projekt-buxhetit vjetor. *Për periudhën 2022-2023, u konstatua se në përfundim të takimeve të kryera nuk janë mbajtur protokollat e mbledhjeve për vendimet respektive të çdo mbledhjeje, të cilat duhet të ishin regjistruar nga sekretari dhe të vendoseshin në dispozicion të drejtimit të njësisë publike, veprime në kundërshtim me nenin 27 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.1 faqe 16-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandime: Të merren masa nga titullari i institucionit, që Kryesia në përmbushje të detyrave funksionale të saj, të bëjë hartimin e projekt – buxhetit, si dhe mbajtjen e protokolleve respektive me qëllim sigurimin e gjurmës së auditimit e më pas të bëjë kalimin për miratim nga Asambleja.

Në vazhdimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nuk ka gjurmë dokumentacioni për raportimin e veprimtarisë së 3 (tre) njësisive dhe komisioneve të ngritura pranë Akademisë së Shkencave. Gjatë auditimit është konstatuar se Seksioni i Shkencave Natyrore e Teknike ka dërguar informacion mbi komisionet e biologjisë, bujqësisë, veterinarisë, fizikë - kimisë, matematikë - informatikës, të mjekësisë dhe të inxhinierisë, për sa i takon veprimtarisë dhe funksionimit të tyre. Ky informacion është dërguar për periudhën janar - qershor 2021 me nr. 489 prot., datë 13.07.2021, po ashtu edhe për periudhën korrik - dhjetor 2021 me nr. 802 prot., datë 23.12.2021.

Nga auditimi u konstatua, se nuk rezulton më asnjë korrespondencë mbi ndjekjen dhe organizimin e punës për këto seksione për periudhën janar-dhjetor 2022 dhe janar-dhjetor 2023. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.1 faqe 16-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*



2.1 Rekomandime: Të merren masa nga titullari i institucionit, që Kryesia të ketë një bashkëveprim mes strukturave të ngritura pranë saj, mbi organizimin dhe ndjekjen e punës së tyre.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: *Mangësi dhe parregullsi ne organizimin dhe funksionimin e Asamblese se ASH dhe Kryesisë, si dhe në dokumentimin e veprimtarisë së tyre, si vijon:*

✓ Në rendin e ditës të miratuar nga Kryetari i ASH me nr. 421 prot., datë 17.06.2021, nuk janë planifikuar diskutimet për miratimin e disa amendamenteve në Statut dhe në rregulloren “Për çmimet shkencore që akordohen nga Akademia e Shkencave dhe për mënyrën e organizimit të konkurseve të tyre”, veprim ky në kundërshtim me nenin 8, pika 1 e Ligjit Nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”.

✓ Me Vendimin e Asamblesë nr. 47, datë 21.07.2021, vendim qarkullues, janë miratuar amendimet e Statutit, në kundërshtim me nenin 27, pika 1, të Statutit.

✓ Është evidentuar se për mbledhjen e kryer në 09.07.2021 nuk ka një procesverbal të mbledhjes, kjo në kundërshtim me nenin 16 të Ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999, duke pasur në vëmendje rëndësinë e mbledhjes për ndryshimet e Statutit të institucionit.

✓ Me Vendimin e Asamblesë nr. 49, datë 23.07.2021 është miratuar ngritja dhe riorganizimi i rrjetit të instituteve të shkencave albanologjike ndërmjet kalimit pranë Akademisë së Shkencave të instituteve ekzistuese të Akademisë së Studimeve Albanologjike (ASA): të Institutit të Historisë, të Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë, të Institutit të Antropologjisë Kulturore dhe Studimeve për Artin, të Institutit të Arkeologjisë. Gjatë auditimit është konstatuar se *nuk ka një relacion arsyetues nga Kryesia, mbi riorganizimin e këtyre instituteve, duke pasur në vëmendje se marrja e një vendimi qarkullues, formulohet dhe propozohet nga kryesia dhe më pas u përcillet anëtarëve për konfirmim.* Po ashtu nuk ka dokumentacion shoqërues që konfirmon shprehjen e dakordësisë të anëtarëve në rrugë elektronike në kundërshtim me nenin 27, pika 2 e Statutit. Vendime të tilla nuk përfshihen në fushën e vendimeve qarkulluese, pasi ato përfshijnë çështje të cilat kanë më shumë rol këshillues e ratifikues dhe jo riorganizim të instituteve, veprim ky në kundërshtim me nenin 27, pika 1 e Statutit.

✓ Me vendimin nr.5, datë 29.01.2021, Kryesia shpall njoftimin për 5 vendet e lira për konkurrim për anëtarët e rinj në Asamblenë e ASHSH. Me Vendimin nr.12, datë 02.02.2021 të Kryesisë është shpallur i njëjti objekt si Vendimi nr.5, datë 29.01.2021. *Konstatohet se ka dy vendime të Kryesisë së ASH me të njëjtën përmbajtje.* Në vijim të vendimit të parë, atij me nr.05, datë 29.01.2021, Kryesia me shkresën nr.85/1 prot., datë 02.02.2021, paraqet kriteret e plotësimit për kandidaturat, vendos afatet për paraqitjen e interesit për konkurim, afatin për shqyrtimin e plotësimit të kriterëve ligjore nga Komisioni Teknik, afatin e vlerësimit nga njësia bazë universitare a kërkimore, si dhe afatin e shqyrtimit të kandidaturave në komisionet dhe seksionet shkencore të ASH. Ndërkohë kryesia nuk ka përcaktuar anëtarët e komisionit teknik, kjo në kundërshtim me nenin 7, pika 6 e Statutit. Në vijimësi Kryesia del me vendimin nr.20, datë 16.03.2021 për shtyrje afati të regjistrimit të kandidatëve që konkurrojnë për pranim si anëtarë, por duke ju referuar vendimit të dytë me nr.12, datë 02.02.2021, ku kërkohet të shtyhet afati deri më 31 mars 2021. *Konstatohet një mungesë koherence dhe mos përputhje mes vendimeve të Kryesisë për të njëjtin fakt.* Me vendimin nr.25, datë 07.04.2021 është miratua për vijimin e procedurës për kandidatët të cilët kanë aplikuar. Për këtë procedurë nuk ka më asnjë gjurmë dokumentare mbi vijimin e procedurës. Nuk



ka procesverbal mbledhjeje kjo në kundërshtim me nenin 16 të Ligjit nr.8480/1999. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.1 faqe 16-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Të merren masa nga titullari i institucionit, që për të gjitha vendimet e Asamblesë dhe të Kryesisë së ASH të dokumentohet qartë dhe të protokollohen të gjitha materialet e veprimtarisë së saj si dhe të zbatohen përcaktimet statutorë në fuqi për organizimin dhe funksionimin e Akademisë dhe Kryesisë së ASH.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i hartimit dhe zbatimit të buxhetit të ASHSH u konstatuan mangësitë si më poshtë:

-Për vitin 2021: Programi buxhetor i shpenzimeve në zërin 01520 “Veprimtari Akademike” është realizuar në masën **57%**, pra në vlerën 125,178 mijë lekë, kundrejt 218,361 mijë lekë të planit të periudhës/progresive, ose me një mosrealizim në vlerën 93,183 mijë lekë kundrejt planit përfundimtar.

Shpenzimet korrente janë realizuar në masën **56 %**, me një mos realizim në vlerën 92,841 mijë lekë kundrejt planit të rishikuar. Në shpenzimet totale të realizuara, shpenzimet korrente zënë peshën kryesore prej 95%. Konkretisht në llogarinë 602 “Mallra e shërbime” ka një mosrealizim prej 91,753 mije lekë.

Në llogarinë 604 “Transferta Korrente të Brendshme” ka një mosrealizim prej 877 mijë lekë, ose 12% të fondit të përllogaritur. Llogaria 604 ka qenë në vitin 2020 në shumën 820 mijë lekë, plani i PBA për vitin 2022 në shumën 1,000 mijë lekë dhe realizimi 12%. Kjo tregon që 86% e llogarisë 604 nuk është realizuar, gjë që tregon problematika në planifikimin e buxhetit.

-Raportet e monitorimit të buxhetit për vitin 2021 janë dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në zbatim të Udhëzimit nr. 22, datë 27.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”, por nuk janë zbatuar afatet e përcaktuara në Udhëzim, konkretisht:

- Raporti i monitorimit 4–muor për zbatimin e buxhetit është dërguar me shkresën nr. 47, prot datë 16.06.2021, **17 ditë me vonesë**, në kundërshtim me afatin përcaktuar në Udhëzimin nr. 22, datë 27.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”.

-Raportet e monitorimit të buxhetit për vitin 2022 janë dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në zbatim të Udhëzimit nr. 22, datë 27.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”, konkretisht:

- Raporti i monitorimit 12-mujor për zbatimin e buxhetit të vitit 2022 është dërguar me shkresën nr. 165 prot., datë 02.03.2023, **2 ditë më vonë** se afati i përcaktuar në Udhëzimin nr. 22, datë 27.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.2 faqe 27-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandim: Të gjitha hallkat e ASHSH të bashkëpunojnë në fazën e hartimit të projektbuxhetit për të shmangur realizimin e tij në përqindje të ulët dhe rialokime të shpeshta gjatë vitit. Kjo mund të bëhet me anë të mbledhjeve të ndryshme mes Sektorëve, me anë të kërkesave të Njësive për projektet që do të zhvillohen të cilat duhet të dokumentohen.

4.2 Rekomandim: Strukturat përgjegjëse të ASHSH të marrin masa për përgatitjen brenda afateve të përcaktuara në ligj të raporteve të monitorimit 4 mujore dhe vjetore të zbatimit të buxhetit, të cilat i japin mundësinë institucionit të përmirësojë procesin e planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit.

*Menjëherë dhe në vijimësi***5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se:

Nga ana e ASH, për të dy vitet objekt auditimi, të ardhurat e trashëguara nuk rakordohen me degën e thesarit dhe mungon argumentimi i tyre në formatin e akt rakordimit.

Sa më sipër rezulton se nuk janë kryer veprimet rregulluese dhe përmbyllëse të fundit të periudhës nga ana e ASH duke operuar në kundërshtim me UMF nr.8 datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore të Njësitë të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar.

Për vitin 2021 llogaria 12 “Rezultatet e mbartur” me vlerë totale prej 9,126,323 lekë, nuk rezultonte e argumentuar me të ardhurat në likuiditete në llogarinë financiare të disponibiliteteve, si dhe me të drejta të konstatuara por të pa arkëtuara në periudhat përkatëse ushtrimore në kundërshtim me UMF nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Paragrafi Funkcionimi i llogarisë 12 “Rezultati i mbartur”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.3 faqe 35-111 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1 Rekomandimi: Nga ana e Akademisë së Shkencave, sektori financës, të merren masa për kontabilizimin në trajtën e regjistrimit dyfish me kundërparti diferencat nga përdorimi i sponsorizimeve në llogarinë 85 “Rezultati i ushtrimit”, kurse diferenca si rezultat i ushtrimit të mëparshëm të pasqyrohen në llogarinë 12 “Rezultat i mbartur”, për një pasqyrim më të drejtë të kundërpartisë së disponibiliteteve në thesar, me qëllim që të parandalohen gabimet apo parregullsitë e mundshme në interpretimin e llogarive të pasqyrave financiare.

5.2 Rekomandimi: Nga ana e Akademisë së Shkencave, sektori financës në kushtet kur llogaria 12 “Rezultat i mbartur” pasqyron rezultatin e viteve të kaluara mbetur të papërdorur me të drejta të paparashikueshme për ta përdorur në vitin korrent, të merren masa për të kryer argumentimin e saj si dhe me të drejta të konstatuara por të pa arkëtuara në periudhat përkatëse ushtrimore.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua fenomen i përsëritur për të dy vitet, (2021 – 2022) mbi rakordimin e vlerave mes situacionit të shpenzimeve paraqitura në akt-rakordimin me degën e thesarit Tiranë, “Shpenzimet korrente” dhe ato të pasqyruara në pasqyrat financiare për llogaritë e shpenzimeve. Për vitin 2021 u konstatua diferencë prej 88,529 lekë dhe për vitin 2022 u konstatua një diferencë prej 9,468,967 lekë.

- Në relacionin e pasqyrave financiare apo në shënimet shpjeguese, mungon argumentimi lidhur me shifrat e rakorduara me thesarin dhe vlerat që përfshihen në deklaratat financiare, si dhe mungon shpjegimi mbi këto diferenca. Sa më lart është në kundërshtim me UMF nr. 24128, datë 27.12.2011 “Procesimi i transaksioneve në fund të vitit” dhe UMF nr. 9, datë 20.03.2018 “Procedura standarde e zbatimit të buxhetit”, Kreu III, “Procedurat për kryerjen e shpenzimeve publike”, nënkapitulli “Marrja e angazhimeve dhe kryerja e shpenzimeve publike” dhe UMF nr. 8, dt. 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 37 – 39.

Nga auditimi mbi rakordimin zë për zë të vlerave mes situacionit të shpenzimeve dhe ato të pasqyruara në pasqyrat financiare rezulton se:



✓ për të dy vitet nga ana e ASH në totalin e llogarisë së shpenzimeve operohej duke shtuar edhe llogarinë 63 “Ndryshim i gjendjes së inventarit” në total të shpenzimeve me qëllim nxjerrjen e rezultatit final të tyre,

✓ për vitin 2021 në pasqyrën e performancës financiare (PASH) nuk rezultonte me vlerë llogaria 604 “Transferime korrente të brendshme” ndërkohë që në situacionin e thesarit kjo llogari përmban vlerë (konkretisht 122,740 lekë).

Nga krahasimi mes pasqyrave dhe situacionit të shpenzimeve, u konstatua ndryshim tjetër ishte sa i takon veprimeve me llogarinë 231, llogari e cila në pasqyra financiare rezulton pa vlerë (në shënime shpjeguese nuk jepet informacion se për çfarë është çelur kjo llogari apo për çfarë është përdorur) ndërkohë në situacionin me thesarin përmban vlerë (konkretisht, 4,745,046 lekë). (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.3 faqe 35-111 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1 Rekomandim: Nga ana e Sektorit të Financës të kryet rakordimi dhe unifikimi i vlerave të paraqitura në pasqyrat financiare me vlerat e paraqitura në aktet e rakordimit me degën e thesarit duke argumentuar në shënimet shpjeguese se çfarë përfshihet në shifrat e rakorduar me thesarin dhe çfarë vlerash përfshihen në deklaratat financiare.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare u konstatua i njëjti fenomen i përsëritur për të dy vitet objekt auditimi (viti 2021 dhe viti 2022) i pranisë së vlerave në llogarinë 531 “Mjete monetare në Arkë” të mbartura prej vitesh në pasqyrat e institucionit (viti i nisjes së regjistrimit të kësaj vlere daton përpara vitit 2000). Kjo llogari përfaqëson arkën në valutë ku ndodhen 8,500 forinta hungareze si shlyerje e një paradhënie në valutë të cilën Banka e Kursimeve nuk e ka konvertuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.3 faqe 35-111 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1 Rekomandim: Nga ana e Akademisë së Shkencave, të merren masat për të vlerësuar mundësinë e konvertimit të valutës së huaj me monedhën vendase duke shmangur në këto kushte mbajtjen e saj pa vlerë dhe efekt financiar.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit justifikues mbi të ardhurat (konkretisht pasqyra e performancës financiare (PASH) dhe akt rakordimi me thesarin, u konstatua se:

✓ Për vitin 2021 në akt rakordim nuk paraqiten të ndara (në klasifikimin buxhetor me nr.710 9600) të ardhura nga qerata megjithëse janë gjeneruar të ardhura prej dhënies me qera të sallës së Akademisë së Shkencave.

✓ Për vitin 2022 në akt rakordimin me thesarin për pjesën takuese, referuar përqindjeve të parashikuara, figuron 100% e të ardhurave të sponsorizimeve dhe 100% e të ardhurave nga grantet korrente të brendshme mbahen nga institucioni. Në vlerë absolute 7,458,442 lekë. Këto janë fonde që janë mbartur/trashëguar në llogari të ASH, por mungon gjurma dokumentare e vërtetimit të këtij transaksioni. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.3 faqe 35-111 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

✓ **8.1 Rekomandim:** Nga ana e Akademisë së Shkencave, sektori i financës, të merren masat:
- Për paraqitje në akt rakordimin të të ardhurave dhe shpenzimeve financiare me thesarin të paraqiten në mënyrë të detajuara të ardhurat e krijuara nga institucioni sipas burimit të tyre dhe natyrës, në përputhje me UMF nr.8 datë 09/03/2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe



raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar dhe të rakordohen të ardhurat e trashëguara me degën e thesarit.

- në formatin e akt rakordimit, të përshtaten dhe pasqyrohen përqindjet respektive reale të të ardhurave që derdhen në buxhet dhe atyre që mban vet institucioni.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” për të dy vitet objekt auditimi (viti 2021, viti 2022) mbartet në vlerën 11,344 lekë dhe përbëhet nga debitorë të viteve të kaluara.

Nga auditimi i dokumentacionit justifikues u konstatua se, vlera e mbartur daton prej vitit 2001 dhe është kryer për blerje librash me shumë totale prej 19,650 lekë. Përgjatë kësaj periudhe prej Akademisë së Shkencave nuk janë ndërmarrë nisma për të kërkuar në rrugë ligjore dhe administrative arkëtimin e të drejtave mbi debitorët operuar në kundërshtim me gërmat “g” dhe “gj”, neni 12, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.3 faqe 35-111 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1 Rekomandim: Akademia e Shkencave të ndërmarrë nisma për të kërkuar në rrugë ligjore dhe administrative arkëtimin e të drejtave mbi debitorët duke analizuar llogaritë e arkëtueshme në kuptimin e vjetërsisë dhe mundësive reale për arkëtimin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatau fenomen i mbartur për të dy vitet, llogaria 202 “Studime dhe projekte” e cila përmban vlerën e “Studimit të rregullimit të tërësisë ujore të Shkodrës” që daton prej vitit 2004 ku vlera fillestare e tij ka qenë 308,053 lekë. Ky studim nuk është jetëzuar në asnjë moment, prej Akademisë së Shkencave ka filluar të llogaritet amortizim i vlerës së studimit prej vitit 2019, praktik e cila vijon të kryhet ende. Aktualisht nuk është ndërmarrë asnjë nismë për vlerësimin e efektivitetit të këtij studimi (duke patur parasysh se periudha kohore që ka kaluar është relativisht e gjatë 19 vite) apo mundësinë për ta vendosur në zbatim apo jo referuar ndryshimeve që kanë ndodhur me vitet. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.3 faqe 35-111 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1 Rekomandimi: Nga ana e Akademisë së Shkencave të merren masat për të parë mundësinë e jetëzimit të studimeve dhe projekteve referuar ndryshimeve që kanë ndodhur me vitet. Gjithashtu të merren masa për të vendosur autorësinë mbi studimet e kryera rast pas rasti duke aplikuar parashikimet ligjore për të drejtat e autorit.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua fenomen i përsëritur lidhur me veprimet kontabile në formatin nr.1, Zëri “Ndërtime e konstruksione” (llog. 212).

Nga ana e Akademisë së Shkencave specifikohet se pjesë e inventarit të asetëve të ASH dhe pjesë e bilancit kontabël konkretisht në llogarinë 212 “Ndërtime e konstruksione” pasqyrohet edhe fondi i librave shkencorë (për vitin 2021 kjo llogari e cila paraqitet për vlerën 31,643,349 lekë, është shtuar dhe kontabilizuar edhe për vlerën e një investimi prej 132,344 lekë për efekt të fondit të librave, konkretisht blerje e librave shkencore).

Në këto kushte, nga ASH është kryer një keq klasifikim i aktiveve, duke përfshirë libra (pa grupim/klasifikim në bazë të përdorimit) në llogarinë ekonomike 212 “Ndërtime e konstruksione”; - Ky keq klasifikim bën që kjo llogari të mos pasqyrojë situatën reale të njësisë si dhe denatyrton pasqyrat financiare për sa i takon natyrës së klasifikimit të llogarive.



-Po ashtu nga ana e ASH specifikohet se, përgjatë vitit 2022 është kryer kalim në llogarinë 212 edhe vlera e librave nga magazina në bibliotekë me vlerë totale prej 93,448.8 lekë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.3 faqe 35-111 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1 Rekomandim: Nga ana e Akademisë së Shkencave, Sektori i Financës, të merren masa të kryhen sistemimet përkatëse kontabile dhe rishikimet e nevojshme mbi klasifikimin e aktiveve dhe përshtatjes së tyre me klasifikimet korrekte referuar SKK 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Jomateriale, si dhe UMF në 8, datë 09/03/2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Menjëherë dhe në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, ndërtesat e kaluara në përgjegjësi administrimi ASH-së sipas Listës së Inventarit të Pronave të Paluajtshme Shtetërore miratuar me VKM nr.440 datë 16.06.2005, ndryshuar me VKM nr.248 datë 09.05.2018, nuk rezultojnë të regjistruara në pasqyra financiare, përveç ndërtesës “Akademia e Shkencave” me sipërfaqe prej 1,128.25 m² dhe vlerë 18,105,620 lekë e pasqyruar në kontabilitetin e ASH.

Nga ana e ASH për godinën “Akademia e Shkencave” me sipërfaqe prej 1,128.25 m², prej vitit 1996 me kontrata vjetore, detyrimi qirave mujore për pronarët e truallit dhe ndërtesës deri në muajin nëntor 2023 është në vlerën 161,990,296 lekë dhe në fakt është paguar në vlerën 134,629,243.04 lekë. Kjo ndërtesë me VKM e mësipërme është në përgjegjësi administrimi të Akademisë së Shkencave. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.3 faqe 35-111 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

12.1 Rekomandimi: Nga ana e Akademisë së Shkencave, të merren masa për të sqaruar pronësitë e aktiveve që ajo disponon, duke vendosur një korrespondencë me ASHK dhe të rifreskohen kartelat/hartat treguese të saj, të specifikohen qartazi kufijtë e pasurive të paluajtshme që janë dokumentuar aktet e fitimit të pronësisë apo posedimit rast pas rasti.

- Sa i takon pagesave periodike për qera ambientesh, në varësi të përgjigjes që do të merret nga ASHK pas kryerjes së një analize tregu, kosto përfitim të vlerësohet dhe gjykohet mundësia, për gjetje/investim të një ambienti të ri ku mund të ushtrohet plotësisht aktiviteti i këtij Institucioni.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua, prania dhe nënshkrimi i 6 kontratave me parregullsi sa i takon ekstremiteteve dhe përfaqësimit të palës së Akademisë së Shkencave, konkretisht në rolin e përfaqësuesit të ASH specifikuar në kontratë figuron z. Sh.S me cilësinë e Kryetar i Akademisë së Shkencave, ndërkohë faktikisht personi në fjalë ka qenë i ngarkuar me rolin e Nënpunësit Autorizues sipas shkresës më nr.9/1 prot., datë 10.01.2020 *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.3 faqe 35-111 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

13.1 Rekomandimi: Nga ana e Akademisë së Shkencave të merren masa për të rifreskuar kontratat me probleme duke patur parasysh nënshkrimet dhe protokollimin si ekstremitete të domosdoshme të një dokumenti për të plotësuar kriteret e zyrtarizimit, si dhe formalizimin e veprimet referuar fakteve aktuale.

Menjëherë dhe në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, për vitin 2022 formati 7 “Ndryshime në gjendjen e aktiveve” nuk pasqyron vlerat reale të aktiveve, po ashtu hartimi i tij përmban pasaktësi të shumta sa i takon vlerave. Në të gjitha rastet e aktiveve u konstatua amortizim mbi shtesa kur



vlerë shtese nuk kishte dhe po ashtu teprica në mbyllje e vitit pararendës nuk rakordon me tepricën në mbyllje të vitit aktual. Si rrjedhojë përmes pasqyrave financiare nuk arrihet sigurimi i informacionit të plotë mbi situatën e aktiveve dhe ndryshimet që kishin pësuar përgjatë vitit. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.3 faqe 35-111 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1 Rekomandimi: Nga ana e Akademisë së Shkencave të merren masa për të kryer kontabilizimet në përputhje me faktet reale, në mënyrë që të pasqyrohet situata faktike e njësisë. Duke evidentuar shtesa/pakësime dhe vetëm në rastet kur ka shtesa të kryhen veprime amortizimi mbi vlera reale, në përputhje me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018, i ndryshuar me UMF nr.5 datë 21.02.2022.

Menjëherë dhe në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, nuk është hartuar regjistri i aktiveve, në varësi të llojit të tyre si dhe grupit përkatës brenda llojit përfshirë datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëposhme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

Sa më lart në zbatim të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kapitulli III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pikat 26, 28, 30 sa i takon hartimit të regjistrit të aktiveve. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.3 faqe 35-111 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15.1 Rekomandimi: Nga ana e Akademisë së Shkencave të merren masa për hartimin e regjistrit të aktiveve, në varësi të llojit të tyre si dhe grupit përkatës brenda llojit në përputhje dhe zbatim me Udhëzimin nr. 30 të MFE datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Menjëherë dhe në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi u konstatua se, sa i takon vitit 2023 nuk është rinovuar marrëveshja mes QSUNT dhe ASHSH, megjithëse nga ana e ASHSH janë dërguar 2 shkresa drejtuar QSUNT për rinovim marrëveshje.

Në të dy marrëveshjet e lidhura (UT dhe QSUNT) nuk specifikohet si do të operohet për pronësinë intelektuale në përfundim të projektit/studimit, dhe më tej në projekte nuk specifikohet personi koordinator, gjithashtu nuk rregullohet mënyra e raportimit mbi kostot e projekt/studimeve për secilën fazë.

Në projektet “NanoAlb”, “Imunologji” dhe marrëveshjet e bashkëpunimit nuk specifikohet vendi se ku do të kryhen studimet/projektet dhe ku do të jenë vendosur pajisjet që do të përdoren për efekt studimi, në kundërshtim me Statutin e ASHSH, neni 45, pika 2.

Në secilin prej projekteve respektive, mungon gjurma e raportimit për kostot e secilës fazë projekti në ASH.

Për projektet fituese mungon analiza paraprake kosto përfitim, shoqëruar me një analizë kostoje të detajuar përpara përzgjedhjes. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.3 faqe 35-111 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**16.1 Rekomandimi:**

- Nga ana e Akademisë së Shkencave të merren masat për të rivendosur edhe njëherë korrespondencën me QSUNT për rinovim të marrëveshjes.
- Në bashkëpunim me njësitë kërkimore studimore apo qendrat të cilat kryejnë studime/projekte, të administrohet praktika dokumentare që përbën gjurmë auditimi.
- Të rregullohet baza ligjore dhe rregullatore sa i takon pronësisë intelektuale në përfundim të projekteve/studimeve që financohen nga ASH.
- Në çdo projekt/studim të specifikohet qartazi se cili do të jetë koordinator i projektit/studimit dhe cili do të jetë personi që do të marr në dorëzim artikujt/mallrat.
- Në çdo rast të parashikohet specifikisht mënyra e raportimit të kostos, në mënyrë të tillë që të mund të parashikohen në mënyrë reale nevojat e ardhshme dhe të justifikohen dhe argumentohen në mënyrë korrekte dhe të plotë shpenzimet për efekt të veprimtarive të këtyre projekte/studimeve,
- Në çdo studim/projekt Drejtorja e Projekteve të marrë masa për të krijuar një data bazë të plotë duke theksuar vlerat e projektit për çdo vit, si dhe duke specifikuar vendin se ku po kryhet studimi dhe se ku janë shpërndarë pajisjet e financuara nga ASH për efekt të studimit.
- Në mënyrë periodike (sikundër të vendoset pas një analize të kryer nga ana e Sektorit të Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e Projekteve) të kryhen raportime mbi kostot respektive për secilin projekt/studim.
- Në momentin e shprehjes së interesit për financimin e një studimi/projekti të parashikohet edhe kosto totale dhe e detajuar e këtij studimi/projekti në trajtën e një preventivi të nevojave financiare (respektive nga secili projekt për secilën fazë).
- Në rastet kur kërkohet vijueshmëria e studimit/projektit përtej afatit fillestar të miratuar, të detajohen kostot shtesë dhe të analizohet përfitimi, me qëllim justifikimin e vijueshmërisë ose jo të tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: ASH nuk ka informacion, në trajtën e një databaze (listë emërore) se ku po kryhej puna studimore prej grupeve kërkimore apo vendndodhjen e materialeve/pajisjeve.

✓ rasti i njësisë kërkimore studimore në fushën e bioshkencës, bioteknologjisë dhe gjenetikës nga ana e së cilës janë propozuar 2 projekte për vitin 2020, u konstatua mungesë e gjurmës se cilat janë institucionet apo universitetet (përmes një listimi të emrave të tyre) në të cilat po shtrihet veprimtaria e NanoAlb dhe janë të shpërndara pajisjet e financuara nga ana e ASH). Operuar në kundërshtim me vetë relacionin e veprimtarisë pikën 3 të tij.

Nga auditimi u konstatua se në përfundim të projektit nuk del një material përmbledhës apo studim i cili të jetë pronë e Akademisë së Shkencave apo një dokument përmbyllës justifikues të veprimtarisë në favor autorësie të ASH. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3.3 faqe 35-111 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

17.1 Rekomandimi: Nga ana e Akademisë së Shkencave të merren masat:

- për çdo bashkëpunim që kryhet me institucione publike apo private, brenda dhe jashtë vendit të jetë e dokumentuar prania e marrëveshjeve respektive të lidhura;
- nga ana e drejtorisë përgjegjëse për projektet/studimet ashtu sikundër specifikohen në raportet e veprimtarisë së njësisë, të kryhen vizita monitorime në laboratorët apo ambientet e punës, për njohjen me funksionimin e tyre;
- për të dokumentuar dhe formalizuar pronësinë intelektuale sa i takon projekte/studimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi



18. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi në terren i kryer në laboratorin e *Imunologjisë në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”*, referuar listës së inventarit bashkangjitur marrëveshjes u konstatua se:

- Nga verifikimi në laborator i pajisjeve të marra në përdorim nga QSUT nuk u arritën të evidentoheshin 8 pajisje dhe 22 inventar i imët si pasojë e mungesës së etiketave me kodet përkatëse.

- një pjesë e artikujve që ndodheshin në magazinën e laboratorit, ishin jashtë funksionit dhe kishin kohë që nuk përdoreshin. Por mungonte një relacion lidhur me to, ku të specifikohet kjo gjë.

a. Nga verifikimi në terren i kryer në laboratorët e *Imunologjisë në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”*, laboratorin e fizikës në Universitetin Politeknik të Tiranës, laboratorin e fizikës Fakultetin e Shkencave të Natyrës u konstatuan si më poshtë vijojnë:

- Për blerjet e realizuara rishtazi (viti 2023) mungojnë të dhënat identifikuese specifike të tyre (bar kode apo të dhëna të tjera specifike).

- Në aktin e marrjes në dorëzim, grupi punës nuk shprehet mbi cilësinë e mallit të lëvruar, nëse është e njëjtë me atë për të cilën është shpallur kontraktori, po ashtu mungonte vlerësimi nëse artikujt përputhen me standardet dhe të gjitha parametrat në cilësi dhe sasi, të kërkuara sipas DST dhe nënshkruara në kontratë.

- Grupi i punës për marrje në dorëzim nuk shprehet për mënyrën sesi është verifikuar apo testuar cilësia e mallrave të lëvruara, po ashtu nuk shprehen në kraht të artikujve të marrë mbi specifikimet e tyre për të krahasuar me ato të cilat janë kërkuar në DST.

- Akti i marrjes në dorëzim nuk është nënshkruar nga ana e Operatorit Ekonomik dhe nuk rezulton prania e një përfaqësuesi nga ana e OE.

Sa më sipër operuar në kundërshtim me UMF nr.30 datë 27.12.2011 Menaxhimi i aktiveve të NJSP, pika 37 dhe pika 42, si dhe si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” neni 77 pika 6.

b. Laboratori *Imunologjisë QSUNT*:

- Grupi i marrjes në dorëzim nuk është shprehur mbi specifikimet teknike të pajisjes, “Sistem real time PCR me 384 puse” po ashtu grupi i auditimit nuk arrin të identifikojë pajisjen për shkak të mungesës së të dhënave specifike me vlerë totale 4,188,000 lekë.

- 200 copë /artikuj “Komplet për mbledhje dhe ruajtje të pështymës” në momentin e verifikimit nuk ndodheshin në ambientet e laboratorit por i dispononte studiuesi, i cili ishte në proces mbledhje mostrash në terren, me vlerë totale 84,000 lekë.

c. Laboratori i fizikës *UPT*:

Nga auditimi i praktikave dokumentare për projektin/studimin “Përgatitja dhe karakterizimi i nanofibrave elektrofibra të pastër PVA dhe matricës PVA/MMT për të kapsuluar një vaj esencial të bimës mjekësore shqiptare për aplikime biomjekësore” .

- Pajisja “homogjenizer” copë 1, me vlerë 300,000 lekë, rezultonte e pa vënë në përdorim, blerë me faturë numër 1444, datë 18.09.2023, është bërë hyrje në magazinën e ASH. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.3 faqe 35-111 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

18.1 Rekomandimi: Nga ana e Akademisë së Shkencave të merren masat:

- Për të vlerësuar pajisjet e ndodhura në laboratorin e QSUNT sa i takon funksionalitetit të tyre, e më tej përpilimin e një relacioni lidhur me to.

- Të identifikojë në mënyrë specifike çdo artikull/pajisje në mënyrë që të jetë lehtësisht e evidentueshme.



- Plotësim dhe dokumentim i praktikave dokumentare të bashkëpunimit me njësitë kërkimore studimore dhe qendrat e kërkimit në zbatim të UMF nr.30 dt. 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” dhe UMF nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të NjQP”, i ndryshuar.

-Në bashkëpunim me njësitë e kërkim studimit dhe qendrat kërkimore dhe studimore të zyrtarizohet korrespondenca dhe mënyra e raportimit mbi aktivitetet e tyre kur preket ana financiare.

Menjëherë dhe në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i praktikave të blerjeve me vlera të vogla për këtë periudhë konstatohet se në 3 raste zj. O.Ç, me detyrë ish përgjegjëse e Sektorit të Financës dhe në cilësinë e anëtares së KVO ka hyrë në sistem dhe ka kryer vlerësimin për 3 procedura prokurimi me vlera të vogla me gjithë etapat e tyre në sistemin e APP (janar-shkurt 2022) edhe pasi është larguar nga detyra dhe ka shkëputur marrëdhëniet financiare me Akademinë e Shkencave më datë 31.12.2021 sipas shkresës nr. 780/1, datë 31.12.2021 “Ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për shkak të dorëheqjes” në kundërshtim me Neni 12 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues” të ligjit nr. 10 296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Vendimin nr. 16 datë 24.03.2022 “Për miratimin e rregullores së brendshme administrative të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë neni 44 “Specialist për Financë” pika b. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.4 faqe 112-136 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

19.1 Rekomandimi: Akademia e Shkencave të marrë masa që të verifikojë të gjithë përdoruesit aktiv në sistemin elektronik në APP, si dhe në rastet e largimit nga puna të punonjësve të sigurojë mbylljen e menjëhershme të llogarive të përdorimit të sistemit duke mos cënuar sigurinë e procesit të prokurimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se në tre vitet në komisionin e prokurimit me vlera të vogla kryetar i komisionit është caktuar Përgjegjësi i Sektorit të Financës (Nëpunës Zbatues) në kundërshtim me nenin 12 të Ligji nr. 10 296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.4 faqe 112-136 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

20.1 Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse të ASHSH të marrin masa për përcaktimin e nëpunësve të duhur në grupet e duhura të punës. Përgjegjësi i Sektorit të Financës nuk duhet të jetë më pjesë e Komisionit të Blerjeve të Vogla.

Menjëherë dhe në vijimësi

21. Gjetje nga auditimi: Në procedurat “Blerje pajisje zyre” (2021), “Blerje materiale, reagent, kimikate” (2021), “Mirëmbajtje Mjedisesh të Jashtme” (2023), “Blerje materiale laboratorit projekti Hg Vlorë” (2023): Komisioni duke u bazuar në testimin e tregut dhe në bazë të prokurimeve të mëparshme pothuajse me të njëjtat parametra teknike për të marrë tregues për çmimet e këtij shërbimi duke përshkruar të gjitha ofertat përcaktoi fondin limit. Ofertat nuk janë bashkëlidhur këtyre procesverbaleve, ndaj përlllogaritja nuk mund të konsiderohet e dokumentuar; -Në procedurën “Riparim e mirëmbajtje e pajisjeve të zyrave” (2022) nuk ndodhet bashkëlidhur Urdhër Shpenzimit nr. 24, datë 26.01.2023 procesverbali për përlllogaritjen e fondit limit.



-Në procedurën “Mirëmbajtje mjedisesh të jashtme” (2023): Sipas procesverbalit të përlogaritjes së fondit limit Grupi i punës testoi tregun dhe në bazë të prokurimeve të mëparshme pothuaj me të njëjta parametra teknik për të marrë tregues për çmimet e këtij shërbimi duke përshkruar të gjitha ofertat dhe duke përlogaritur fondin limit. Bashkëlidhur procedurës 3 oferta. Fondi limit u vendos 200,000 lekë (pa TVSH) por kjo vlerë nuk përkon me mesataren e ofertave të ardhura. Gjithashtu nuk ndodhen bashkëlidhur kontrata të mëparshme të cilat thuhet se janë marrë në konsideratë.

Veprime në kundërshtim me neni 76, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 për “Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.5 faqe 144-176 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

21.1 Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse të ASH të marrin masa për argumentimin dhe dokumentimin procedurës së hartimit të fondit limit duke ju referuar metodës konkrete për përlogaritjen e vlerës.

Menjëherë dhe në vijimësi

22. Gjetje nga auditimi: Në procedurën “Blerje materiale anticovid-19”: Operatorë ekonomik të kualifikuar janë 36 operatorë dhe të skualifikuar janë 9 operatorë për shkak të ofertimit mbi fondin limit të parashikuar. Grupi i Auditimit vuri re se 6 ofertat e para të kualifikuara kanë vlerën më pak se 50% e fondit limit në kundërshtim me pikën 15/c të Udhëzimit nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.5 faqe 144-176 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

22.1 Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse të ASH të marrin masa për përmbushjen e Udhëzimit nr. 5 datë 25.06.2021 dhe të skualifikohen nga procedura gjithmonë operatorët me oferta më të ulëta se 50% e fondit limit me qëllim përmbushjen e objektit të prokurimit me cilësi.

Menjëherë dhe në vijimësi

23. Gjetje nga auditimi: Në Urdhrin e Prokurimit për procedurën “Blerje materiale, reagent, kimikate” specifikohet se *afati i lëvrimin të mallrave do të jetë jo më vonë se 4 ditë pas zhvillimit të kësaj procedure*. Më 30.06.2021 është nënshkruar akt marrja në dorëzim e mallit.

-Në Urdhrin e Prokurimit nr. 42 datë 01.08.2023 për “Blerjet me Vlera të Vogla” me objekt “Mirëmbajtje mjedisesh të jashtme” specifikohet se afati i realizimit të këtij shërbimi do të jetë brenda 10 ditëve kalendarike duke filluar nga momenti i kalimit të afateve të dorëzimit të ankesave. Në Ftesën për Ofertë specifikohet se data e zhvillimit do të jetë 02.08.2023 ndërkohë që më 23.08.2023 është hartuar procesverbali për marrje shërbimi në dorëzim nr. 23. Veprime në kundërshtim me Urdhrin e Prokurimit nr. 35, datë 21.06.2021; Urdhrin e Prokurimit nr. 42 datë 01.08.2023 dhe Udhëzimin nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.5 faqe 144-176 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

23.1 Rekomandimi: ASH të marrë masa për zbatimin korrekt nga ana e OE fitues të afateve të përcaktuara për dorëzimin/ furnizimin e mallrave/ shërbimeve etj.

Menjëherë dhe në vijimësi

24. Gjetje nga auditimi: Në procedurat e Blerjes Dinamike të Biletave për Transportin Ajror me fond limit 160,430 lekë mungon ftesa nga vendet e huaja bashkëlidhur praktikës, organizimi i aktivitetit etj., në kundërshtim me nenin 2, pika 2/a të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.5 faqe 144-176 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*



24.1 Rekomandimi: Në të gjitha Urdhër Shpenzimet për Blerjet Dinamike të Biletave të jenë bashkëlidhur ftesa nga vendet e huaja, organizimi i aktivitetit, personat që do të shkojnë etj.

Menjëherë dhe në vijimësi

25. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se ASH nuk është kryer procesi i inventarizimi për vitet 2021, 2022 si dhe i pjesshëm për vitin 2023. Grupi i inventarizimit nuk ka kryer inventarin në laboratorët pranë qendrave kërkimore si dhe inventarin personal të stafit që i ka në ngarkim, veprime në kundërshtim me Urdhrin nr. 72 prot., datë 31.01.2023 “Për inventarizimin e aktiveve për vitin 2023 në ASH” dhe me pikat 85, 86 të Udhëzimit të MFE nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.4 faqe 112-136 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

25.1 Rekomandimi: Akademia e Shkencave të marrë masa që të kryejë inventarizim të plotë të të gjitha aseteve që disponon duke e shtrirë procesin e inventarizimit edhe tek laboratorët, duke evidentuar aktivet e dhuruara apo në përdorim si dhe ato të blera.

Në vijimësi

26. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dhe analizimi i rregullores aktuale në fuqi konstatohet se:
- Janë disa poste pune për të cilat janë shprehur preferenca arsimit të cilat nuk justifikohen për pozicionin e punës apo përshkrimin e punës që kanë të caktuara në rregullore ose nuk ka asnjë lloj specifikimi, kancelari, bibliotekari, shpërndarësi i librit akademik etj.

-Asnjë strukturë brenda institucionit nuk vlerëson punonjësit e njësisë së varësisë dhe nuk është e parashikuar si procedure në asnjë akt të brendshëm rregullativ.

Akademia e Shkencave nuk ka një regjistër mbi trajtimet e kryera nga punonjësit dhe nuk hartohen plane trajnimi vjetore duke kryer një evidentim paraprak të nevojave dhe adresimin e tyre në institucionet përkatëse për trajnimin sipas nevojave të stafit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.7 faqe 176-190 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

26.1 Rekomandimi: Akademia e Shkencave të marrë masa për hartimin e plotë të një dokumenti të politikave të punësimit dhe rregullimit e normimit të marrëdhënieve të punës, si dhe hartimin në kohë të akteve të brendshme rregullative duke specifikuar profile studimi të qarta për pozicionet drejtuese në akademi, dhe heqjen e llojit të studimit specifik në pozicione pune që është i panevojshëm.

Akademia e Shkencave të marrë masa për hartimin e një regjistri trajnimesh për punonjësit.

Menjëherë dhe në vijimësi

27. Gjetje nga auditimi: Në procedurën “Blerje pajisje Elektronike” kryer në vitin 2021 ndër të tjera janë prokuruar dhe dy kondicionerë. Në procesverbalin për Hartimin e Specifikimeve Teknike (i cili nuk ka datë dhe numër protokoll) hartuar nga grupi i punës gjenden të listuar dy kondicionerë të cilët nuk kanë qenë pjesë e Kërkesës nr. 407 prot., datë 11.06.2021 drejtuar Kryetarit të ASHSH mbi nisjen e kësaj procedure. Gjithashtu kondicionerët nuk janë të parashikuar në CPV-të e Regjistrimit të Parashikimeve, zëri “Blerje pajisje elektronike” dhe nuk gjendet e shpjeguar nevoja për to dhe korrelacioni mes objektit të prokurimit i cili kryhet në kuadër të projekteve “Historia e Shqipërisë”, “Fjalori i madh i gjuhës shqipe” dhe këtij artikulli të prokuruar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.6 faqe 144-176 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*



27.1 Rekomandimi: Çdo mall/shërbim që do të jetë pjesë e një procedure prokurimi duhet të shoqërohet me arsyetimin pas përfshirjes së tij në procedurë dhe nevojës së institucionit për të. Nëse një mall/shërbim nuk është i përfshirë në kërkesën fillestare duhet të ketë një shkresë tjetër që vërteton nevojën për të.

Menjëherë dhe në vijim

28. Gjetje nga auditimi: Në procedurën “Blerje pajisje Elektronike” kryer në vitin 2021 Grupi i Punës për Përlllogaritjen e Fondit Limit nuk ka dokumentuar veprimet në lidhje me fondin limit të vendosur prej 3,023,000, lekë, sa miratuar nga Buxheti i Shtetit dhe përfshirë në regjistrin e parashikimit të prokurimeve publike.

-Në procedurën Shtypje libra studimorë dhe revista periodike për vitin 2021” Grupi i Punës për Përlllogaritjen e fondit Limit nuk ka vendosur asnjë argument dhe bazë mbi çmimet e vëna për botimet.

-Në procedurën “Reagentë dhe mjete konsumi për fazën 3/1 të studimit të Seroprevalencës Covid 19”: Procesverbal i Fondit Limit nuk ka datë dhe numër protokolli. Arsyetimi pas vendosjes së vlerave është se janë mbështetur në prokurime të mëparshme por këto praktika nuk ndodhen bashkëlidhur procesverbalit.

-Në procedurën “Blerje kite/reagent për studime sero-epidemiologjike: Reagentë për studime të Nanoalb” loti 1: Sipas procesverbalit të përlllogaritjes së fondit limit është testuar tregu, janë marrë oferta nga operatorë të ndryshëm dhe në bazë të prokurimeve të mëparshme është përlllogaritur fondi limit. Grupi i Punës përlllogaritit fondin limit me vlerën 3,500,000 lekë. Kjo vlerë nuk përkon me mesataren e përlllogaritur të tre operatorëve që kanë sjellë ofertat e tyre. Kjo vlerë do të ishte 3,936,933 lekë. Gjithashtu nuk ka të bashkëlidhur këtij procesverbalit asnjë dokumentacion që qartëson si është përlllogaritur kjo vlerë duke përdorur testimin e tregut ose prokurimin e mëparshëm.

-Për lotin e dytë të procedurës “Blerje kite/reagent për studime sero-epidemiologjike: Reagent për studime të Nanoalb nuk ka asnjë procesverbal të përlllogaritjes së fondit limit.

-Në procedurën “Pajisje për laboratorin e biologjisë molekulare të qendrës bioteknologjike dhe gjenetikës”: Në procesverbalin për përlllogaritjen e fondit limit shprehen se kanë testuar tregun dhe kanë marrë oferta nga operatorë të ndryshëm e në bazë të prokurimeve të mëparshme kanë përlllogaritur fondin limit. Ofertat e administruara nga Grupi i Punës janë katër. Këto Oferta nuk kanë datë dhe numër protokolli nga ana e Akademisë së Shkencave. Gjithashtu i njëjti ofertues, ka dorëzuar për të njëjtat zëra dy oferta të ndryshme.

-Në procedurën “Blerje materiale laboratorike për projektin Cellstam; Blerje pajisje për projektet Cellstam, HG Gjiri i Vlorës, Cryofruit” Grupi i Punës për përlllogaritjen e fondit limit nuk ka kryer asnjë aktivitet dhe nuk është dokumentuar arsyetimi pas vendosjes së këtij fondi limit.

-Në procedurën Blerje pajisje dhe materiale NanoAlb; Blerje materiale laboratorike për NanoAlb”: Bashkëlidhur Urdhrit nr. 30, datë 04.05.2023, nr. 380/3 prot., për “Ngritjen e Grupit të Punës për Përlllogaritjen e Fondit Limit” ndodhen vetëm 3 oferta të cilat nuk kanë datë dhe numër protokolli nga ana e Akademisë së Shkencave dhe mungon një procesverbal i mirëfilltë ku llogaritet fondi limit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.6 faqe 144-176 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

28.1 Rekomandimi: Për çdo procedurë prokurimi Grupi i Punës për Përlllogaritjen e Fondit Limit duhet të realizojë një argumentim të saktë dhe të dokumentuar të vlerës së vendosur, me anë të një procesverbalit dhe duke bashkëlidhur kontrata të kaluara nëse vlerat merren në këtë mënyrë, oferta



të ardhura nga operatorë ekonomikë me numër protokolli, datë dhe përllogaritjet aritmetike të kryera për vlerën përfundimtare.

Menjëherë dhe në vijimësi

29. Gjetje nga auditimi: Në shumë prej procedurave mungojnë procesverbalet apo raportet e nevojshme, të parashikuara nga kuadri ligjor e nënligjor në fuqi, përkatësisht si më poshtë vijon:

-Në Procedurat e Prokurimit “Blerje Pajisje Elektronike”, “Blerje kite/reagent për studime sero-epidemiologjike: Reagentë për studime të Nanoalb”, Pajisje për laboratorin e biologjisë molekulare të qendrës së bioteknologjisë dhe gjenetikës mungon një Procesverbal nga ana e KVO mbi hapjen e procedurës dhe vlerësimin e ofertave.

-Në Procedurën e Prokurimit “Blerje Pajisje Elektronike”, “Blerje kite/reagent për studime sero-epidemiologjike: Reagentë për studime të Nanoalb” mungon Raporti Përmbledhës.

-Parregullsi të firmave në procesverbalet nga grupet e punës dhe komisionet e njësitë e procedurave të prokurimit.

- Në tre raste, për procedurat e prokurimit me objekt “Blerje kite/reagent për studime sero-epidemiologjike: Reagentë për studime të Nanoalb”, “Pajisje për laboratorin e biologjisë molekulare të qendrës së bioteknologjisë dhe gjenetikës”, dhe “Blerje materiale laboratorike për projektin Cellstam; Blerje pajisje për projektet Cellstam, HG Gjiri i Vlorës, Cryofruit”, ka rezultuar se data është e njëjtë vetëm se urdhri i prokurimit ka numër rendor me përpara se sa të lëshohet urdhri për përllogaritjen e fondit limit, në kundërshtim me përcaktimet e pikës nr. 7, të Udhëzimit të APP me nr. 5, datë 25.06.2021.

-Në Procedurën “Blerje pajisje dhe materiale NanoAlb; Blerje materiale laboratorike për NanoAlb” mungon një kërkesë për nisjen e procedurës, radhitja e materialeve dhe pajisjeve që do të prokurohen, arsyeja për kërkesën e tyre etj. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.6 faqe 144-176 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

29.1 Rekomandimi: Nga ana e ASH të merren masat që procesverbalet, apo raportet e nevojshme mbajtur gjatë procedurës së vlerësimit të ofertave, të hartohen në përputhje me kërkesat e akteve nënligjore të fushës së prokurimeve me fondet publike.

Menjëherë dhe në vijimësi

30. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i regjistrimit të parashikimeve, ndryshimit dhe realizimit të prokurimeve, u konstatua:

- Nuk ka një regjistër parashikimi ku të jenë përfshirë procedurat me vlera të mëdha, afatet e hartimit dhe miratimit nga ana titullarit të autoritetit kontraktor të regjistrimit të prokurimeve.

- Nuk është i dokumentuar procesi i mbledhjes së kërkesave nga sektorët përkatës për hartimin e regjistrimit të parashikimit.

- Nga auditimi rezulton se në sistemin e APP nuk është hedhur një regjistër fillestar parashikimi por janë hedhur në ditë të ndryshme dhe janë shtuar zërat më vonë.

Regjistri i parashikimeve është ndryshuar 4 herë për vitin 2021, 3 herë për vitin 2022 dhe 3 herë në vitin 2023 dhe në asnjë rast nuk ka argumentim dhe miratim nga titullari i autoritetit kontraktor mbi këto ndryshime. Gjithashtu këto ndryshime nuk janë dërguar në Degën e Thesarit.

Për sa konstatuar me sipër, është në kundërshtim me nenin 4 të Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe nenin 3 “Regjistri i parashikimeve të procedurave të prokurimit publik”, Vendimit Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave



të prokurimit publik”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.6 faqe 144-176 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

30.1 Rekomandimi: ASH në cilësinë e autoritetit kontraktor të marrë masa për hartimin e regjistrit të parashikimeve të plotë bazuar mbi nevojat konkrete të sektorëve të saj dhe njërive kërkimore duke zbatuar afatet e përcaktuara në kuadrin rregullator dhe përcjelljen e tij në institucionet përgjegjëse pas miratimit nga titullari i autoritetit kontraktor.

Menjëherë dhe në vijimësi

31. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga subjekti S.Co, njëkohësisht dhe fituesi i kësaj procedure u konstatua se mungonin disa nga dokumentet të cilat janë paraqitur në SPE por jo fizikisht në ASH, konkretisht:

-Kriteret e përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit: ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së. f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interes sipas legjislacionit në fuqi. g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës. gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi. h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi. i) Operatori Ekonomik nuk ka cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfutur fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik gjatë kohës që ky vendim është në fuqi në kundërshtim me “Ligji për Prokurimin Publik” 162/2020 neni 82, pika 5 dhe VKM 285 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, neni 26, pika 6. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.6 faqe 144-176 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

31.1 Rekomandimi: Akademia e Shkencave të marrë masa dhe verifikojë para publikimit të njoftimit të fituesit dokumentacionin e operatorit fitues për plotësimin e kërkesave të DST dhe ta dokumentojë këtë me anë të shkresave përkatëse të cilat duhet të jenë pjesë e dosjes së prokurimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

32. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës për procedurën “Blerje pajisje elektronike” u konstatua se likuidimi i saj është kryer me dy pjesë. Pjesa e dytë e pagesës është kryer më 20.10.2021 për 1,948,800 lekë. Ky likuidim pjesor është kryer jashtë afatit të përcaktuar në kontratë, konkretisht 7 ditë pas afatit. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 39-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

32.1 Rekomandimi: Sektori i Financës duhet të sigurojë pagesat në kohë, duke respektuar afatet e vendosura në kontratë.

Menjëherë dhe në vijimësi

33. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Reagentë dhe mjete konsumi për fazën 3/1 të studimit të Seroprevalencës Covid 19” rezulton se: Në DST certifikatat CE/FDA nuk janë përmendur në kriteret e përgjithshme dhe të vecanta të kualifikimit, ndaj



mungesa e tyre nuk është kriter për skualifikim të operatorit ekonomik. Kjo bie në kundërshtim me VKM nr.285 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, neni 25 dhe neni 40. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.6 faqe 144-176 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

33.1 Rekomandim: Nga ana e ASH të merren masat e nevojshme që DST e hartuara të jenë të qarta, të kuptueshme dhe kriter skualifikimi për OE të përdoren vetëm ato të përmendurat në kriteret e përgjithshme dhe të veçanta.

Menjëherë dhe në vijimësi

34. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dhe analizimi i komponentëve të MFK-së është konstatuar se:

- Për periudhën objekt auditimi nga titullari i ASHSH nuk janë nxjerrë urdhrat për ngritjen e ekipit të menaxhimit të programeve, në kundërshtim me nenin 8, pika 8/b të ligjit për MFK.

- Për periudhën 2021 nuk rezulton dokumentim i mbledhjeve të kryera nga GMS në kundërshtim me Udhëzimin nr.16, datë 20.07.2016 i MFE “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”.

- ASH e ka kryer aktivitetin e saj në bazë të një rregullore të brendshme të vitit 2022 përkatësisht “Rregullore e Brendshme Administrative për Akademinë e Shkencave”, miratuar me Vendim nr.16 dt. 24.03.2022, e ndryshuar e cila nuk i përgjigjet plotësisht kërkesave që rrjedhin nga Manuali MFK.

- Nga auditimi u konstatua se, për periudhën objekt auditimi nga ASH nuk është hartuar një program trajnimi për punonjësit në fushën e MFK, e më gjerë dhe nuk ka një databazë të trajnimeve të stafit.

- ASH nuk ka hartuar një strategji risku, në kundërshtim me nenin 21 të Ligjit nr. 10296 për MFK.

- Titullari i ASH nuk ka miratuar gjurmën e auditimit, në kundërshtim me nenin 16 të ligjit për MFK.

- Në mungesë të aktit rregullator mbi organizimin dhe funksionimin e ASH, është i paqartë komunikimi i brendshëm dhe se si titullari informohet nga përgjegjësit e sektorëve.

- Nuk ka asnjë dokumentim të raportimit të njërive kërkimore mbi statusin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, në kundërshtim me nenin 9 të ligjit të MFK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.7 faqe 176-190 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

34.1 Rekomandim: Titullari i institucionit të ndjekë me rigorozitet aplikimin dhe zbatimin e të gjithë komponentëve të MFK-së dhe të marrë masa të menjëhershme për hartimin e gjurmës së auditimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

35. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, sipas programit të auditimit nr.959/1 prot, datë 07.11.2023 rezulton se, subjekti i audituar ka respektuar afatin 20 ditor për hartimin e planit të masave për zbatimin e rekomandimeve në përputhje me kërkesat e nenit 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në zbatim të pikës 2, të nenit 30, të Ligjit nr.154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nga titullari i institucionit urdhri i brendshëm nr.372, datë 27.06.2018 “Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH të lëna në raportin përfundimtar të auditimit të ushtruar në Akademinë e Shkencave, e cila ka kthyer përgjigje në KLSH, me shkresën nr.250 prot., datë 28.06.2019, duke tejkalluar afatin 6 mujor të parashikuar sa më sipër”.



Rezultoni se janë dhënë gjithsej 7 rekomandime të cilët janë pranuar plotësisht (100 %), dhe rezultojnë të zbatuar plotësisht 4 masa (57 %). Masat e pa zbatuara janë:

- Për të vlerësuar përshtatshmërinë e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, Akademia e Shkencave të marrë masat për të hartuar dhe miratuar gjurmët e auditimit, ku të përfshihen proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë që përfshijnë zbatimin e aktiviteteve, programeve dhe projekteve me të rëndësishme.

- Të marrë masat e duhura për zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve dhe të hartojë dhe miratojë planin e trajnimeve bazuar në kërkesa specifike për trajnimin e punonjësve të administratës, për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe manualin të dalë në zbatim të tij. Në mënyrë të veçantë për menaxhimin e riskut pasi menaxherët e njësisë nuk zotërojnë informacion për qëllimet dhe rëndësinë e menaxhimit financiar dhe kontrollin.

- Për këtë, të merren masa për të ndryshuar kontratën e lidhur midis palëve, duke shtuar një nen të veçantë ku të përcaktohen të “drejtat dhe detyrimet e marrësit në dorëzim” për këtë pajisje.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8 faqe 194-202 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

35.1 Rekomandimi: Akademia e Shkencave të Shqipërisë të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e të gjitha rekomandimeve që rezultojnë të pazbatuara dhe të zbatuara pjesërisht. Për të gjitha rekomandimet e tjera, që konsiderohen në proces zbatimi, inkurajohet përshtetimi i realizimit të plotë të tyre brenda vitit 2024.

Menjëherë

36. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi është evidentuar se Polifonia Shqiptare ka hyrë si pasuri kombëtare, jo materiale në UNESCO në datë 25.11.2005 me termin “Isopolifoni” (polifoni me iso), dosje e cila është përgatitur dhe përcjellë nga Ministria e Kulturës. Nga vlerësimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion lidhur me përkufizimin e fjalës “Isopolifoni”, në gjithë fjalorët që disponon Akademia e Shkencave rezultoni se: fjala “Isopolifoni” është përfshirë vetëm në fjalorin Enciklopedik dhe në referencë ka “shih Polifoni Popullore”, gjithashtu nuk ekziston si togefjalësh në asnjë nga fjalorët por janë fjalë të veçanta “Iso” dhe “Polifoni”. Akademia e Shkencave ka botuar ndër vite 6 botime ku trajtohet “Isopolifonia”. Referuar shkresës nr. 3027/1, datë 06.08.2014 “Përgjigje shkrese” të Ministrisë së Kulturës drejtuar Kryeministrisë, konkludohet se Ministria e Kulturës do të përdorë termin “Polifoni Shqiptare”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.9 faqe 194-202 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

36.1 Rekomandimi: Akademia e Shkencave me autoritetin shkencor që zotëron, në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës dhe Ekonomisë të marrë masa të menjëhershme për unifikimin e konceptit dhe përdorimit të termit “Polifoni Shqiptare” në të gjithë fjalorët dhe Enciklopeditë, botimet e financuara nga Akademia, si dhe kundërshtimin e ndarjen e termit “Iso” nga muzika kishtare bizantine.

Menjëherë dhe në vijimësi

B. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE, TË ARDHURAT E MUNGUARA



1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në terren për projektet e financuara nga Akademia u konstatua se:

- Në Akademinë e Shkencave në 3 raste, rezulton që nuk kanë gjetur zbatim përcaktimet e nenit 45 “Njësitë afatshkurtra”, pika 2 i Statutit të ASH miratuar me Vendim të Asamblesë nr. 22, datë 18.10.2019, i ndryshuar, pasi nuk ka raportime mbi statusin e secilës fazë të studimit, si dhe mungon një preventiv për të argumentuar nevojat financiare (respektive nga secili projekt për secilën fazë) me qëllim miratimin e vijueshmërisë apo jo të tyre.

Për projektet e Qendrës Kërkimore Nanoteknologjike NanoAlb, që shtrijnë veprimtarinë përkatësisht në laboratorët e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, laboratorin e Fizikës në Universitetin Politeknik të Tiranës dhe në disa universitete në Kosovë, referuar të dhënave vendosur në dispozicion të audituesve rezulton se janë kryer 5 projekte, për periudhën 2022-2023 të cilët mbajnë statusin në proces, me vlerë totale të shpenzimeve deri në fund të vitit 2023 prej 9,048,239 lekë.

1.1 Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi mbi raportet e dërguar në ASH nga ana e ekipit të punës mbi projektin “*Studimi sero-epidemiologjik i Gjendjes imunitare ndaj virusit SARS-CoV-2 në popullatën shqiptare*”, drejtuar nga z. G.S, përfunduar të 4 fazat e studimit me kosto totale prej **24,163,492 lekë**:

- Mungon gjurma e administruar e komunikimit me institucionet përgjegjëse (Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Instituti Shëndetit Publik apo institucione të tjera të cilat u morën me menaxhimin e pandemisë) për të koordinuar punën apo dhënë orientime/sugjerime referuar studimit, përcaktuar në projekt propozimin për studimin “Faza e III e studimit të seroprevalencës së antitropave, anti-SARS-CoV-2 si dhe e përgjigjes imunitare ndaj këtij virusi në popullatën shqiptare”, datë 05.11.2020; pika 1 “Rëndësia e studimit”, paragrafi 2.

1.2 Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi mbi dokumentacionin justifikues lidhur me projektin pilot “*Përzgjedhja e materialit bimor të kumbullës, të kontrolluar nga viruset sipas protokollit, për krijimin e impiantit pilot nëpërmjet shëndetësisë dhe mikroshumimit, në funksion të fillimit të certifikimit të materialit mbjellës, VITROCERT*” drejtuar prej zj.E.K, udhëheqëse e projektit, kosto paraprake e tij deri në fund të vitit 2023 është 2,323,798 lekë.

Ka përfunduar faza e parë në v.2022 me vlerë 867,600 lekë ka vijuar me statusin në proces faza e dytë deri fund vitit 2023 me vlerën 1,456,198 lekë u konstatua se:

- Në përfundim të fazës së parë, “Vitrocert 2 - 2022” nuk rezulton gjurmë dokumentare e rezultatit final (raport) nga ky projekt.

Në kushtet e mungesës së dokumentacionit justifikues bazë, argumentues dhe të domosdoshëm në aspektin e dokumentimit financiar vlera prej 23,387,530 lekë (21,063,732 lekë për projektin e Seroimunologjisë, 2,323,798 lekë për projektin Vitrocert) përbëjnë shpenzim jo efektiv të buxhetit të shtetit. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.3 faqe 35-111 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Nga ana e Akademisë së Shkencave të merren masat:

- Të analizohen pagesat në vlerën 21,063,732 lekë, të kryera për “*Studimi sero epidemiologjik të gjendjes imunitare ndaj virusit SARS-COV-2 në popullatën shqiptare*” SEROIMUNE, duke argumentuar nevojat dhe nxjerrjen e përgjegjësive konkrete.

- Të analizohen pagesat e kryera deri në fund të vitit 2023 në vlerën prej 2,323,798 lekë për projektin pilot “*Përzgjedhja e materialit bimor të kumbullës, të kontrolluar nga viruset sipas protokollit, për krijimin e impiantit pilot nëpërmjet shëndetësisë dhe mikroshumimit, në funksion*



të fillimit të certifikimit të materialit mbjellës, “VITROCERT”, duke dokumentuar gjurmë dokumentare e rezultatit final (raport) nga ky projekt.

- Në bashkëpunim me njësitë e kërkim-studimit dhe qendrat kërkimore e studimore të unifikohet dhe normohet mënyra e raportimit të aktiviteteve, ku në mënyrë të veçantë të raportohet sipas dokumentacionit për pjesën financiare të ecurisë së projekteve kërkimore-shkencore që zbatohen nga ana e ASH.

- Të rishqyrtohet kuadri ligjor e nënligjor, aktet rregulluese për të riparë dhe formalizuar pronësinë intelektuale sa i takon projekteve/studimeve të zbatuara me fondet e ASH dhe jo vetëm, dhe që hartohen nga ana e stafit shkencor.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit justifikues mbi projektin “ArkeoBylis – gërmime metoda gjeofizike i agorasë së Bylisit” drejtuar nga z.N.C, udhëheqës i projektit, me kosto totale prej **2,821,434 lekë** u konstatua se:

- Mungesë e informacionit lidhur me personat/punëtorët që ishin pjesë e këtij studimi, si në numër personash po ashtu edhe në trajtë nominale për të verifikuar se për cilët është kryer pagesa;

- Në raportin e dërguar në ASH për veprimtarinë e projektit Arkeobylylis 2023 nuk rezulton që ky raport të përmbajë ekstremite të regjistrimit (vetëm nënshkrimi i drejtorit ekzekutiv pa numër protokolli, datë);

- Nuk ka asnjë rezultat final të dokumentuar nga ky projekt, apo gjurmë e publikimit të rezultateve të studimit;

*Në kushtet e mungesës së dokumentacionit justifikues bazë dhe të domosdoshëm vlera prej **2,821,434 lekë** përbën përdorim jo efektiv të fondeve të buxhetit të shtetit. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.3 faqe 35-111 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1 Rekomandimi: Nga ana e Akademisë së Shkencave të merren masat për analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjësisve, plotësimin dhe dokumentimin e praktikave dokumentare duke shmangur mangësitë dhe boshllëqet ligjore si dhe argumentim, dokumentim dhe justifikim të veprimtarisë kërkimore / studimore e cila financohet prej buxhetit Akademisë së Shkencave, rrjedhimisht buxheti i shtetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimeve me arkën u konstatuan parregullsitë si më poshtë:

-Në të gjitha rastet është dhënë paradhënia për shërbime-dieta pa autorizimin e nëpunësit autorizues.

-Bashkëlidhur praktikave programe aktiviteteve pa data, pa nr. protokolli dhe të pa plotësuar mbi kostot e tyre apo edhe datat e aktiviteteve.

-Në asnjë rast nuk ka relacion mbi aktivitetin që është kryer.

-Janë kryer rimbursime biletash avioni për akademikë të ftuar kur vetë Akademia zhvillon procedura prokurimi për blerje biletash (**1565 euro dhe 525 usd**), vlerë e cila përbën shpenzim jo efektiv të buxhetit të shtetit, pasi nuk janë përdorur fondet me ekonomikitet.

-Nuk ka dokumente justifikimi bashkëlidhur për çdo mandat pagesë dhe mandat arkëtim por janë lidhur bashkë për një aktivitet.

-Arkëtim 10,000 leke nga arka.

-Urdhër shërbimet të pa rakorduara.



Nga rakordimi i të dhënave me pasqyrat financiare u konstatua mungesë e gjurmës së paraqitjes së paradhënies. Nuk kryhet veprimi i kthimit të paradhënies pas kthimit nga aktiviteti.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikat 52-72 të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe përbëjnë shpenzim jo efektiv.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 112-136 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Akademia e Shkencave të marrë masa për analizimin e veprimeve financiare të kryera me arkën si dhe plotësimin e saktë dhe të plotë të dokumentacionit justifikues për çdo veprim të kryer me arkën, minimizimin e arkëtimeve që kryen dhe respektimin e limitit, mos kryerjen e rimbursimeve për biletat e avionit për akademikët e ftuar por blerjen e tyre nga vetë Akademia nëpërmjet procedurave të prokurimit.

3.2 Rekomandimi: Akademia e Shkencave të marrë masa për plotësimin e një dokumentacioni të plotë, justifikues për çdo shërbim jashtë vendit, si dhe kthimin e paradhënies konform ligjit.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës së botimeve për vitin 2021, rezulton se ekziston një mospërputhje mes listës së titujve të veprave në procesverbalin e komisionit të marrjes në dorëzim, pa datë, dhe Fletë Hyrjes nr. 3 datë 24.12.2021. Në procesverbalin e marrjes në dorëzim nuk është e qartë se cilat vepra janë marrë realisht në dorëzim. Në këtë procesverbal janë listuar edhe ato botime të cilat me Vendimin e Kryesisë nr. 61 datë 11.10.2021 dhe Vendimin e Kryesisë nr. 73 datë 21.12.2021 do të zëvendësoheshin, ndërkohë në kllapa pas tyre është shënuar lista e veprave të reja zëvendësuese. Kjo e bën këtë procesverbal të pasaktë. Ndërkohë që në Fletë Hyrje veprat që do të zëvendësoheshin sipas vendimeve nuk janë shënuar, përveç botimit të Jupi Kastratit “Faik Konica Jeta dhe Vepra”.

- Zëvendësimi i veprave, i kryer në bazë të Vendimit të Kryesisë nr. 61, datë 11.10.2021 “Për një zëvendësim në listën e botimeve të vitit 2021” dhe Vendimit të Kryesisë nr. 73 datë 21.12.2021, nuk është pasqyruar në formë shkresore, as në vlerën e kontratës. Në vendim gjithashtu thuhet se *Spektori i financës duhet të përlogarisë pjesën e buxhetit të prokuruar për 2 veprat dhe të caktohet tirazhi dhe të dhënat e tjera teknike të veprës zëvendësuese*, gjë që nuk është e dokumentuar, më konkretisht:

- Vepra “Faik Konica, Jeta dhe Vepra” nuk figuron në listën e veprave të botuara në vitin 2021, nuk gjendet as në magazinën e ASHSH, vërtetuar edhe me Aktverifikimin nr. 6, datë 15.01.2024, mbajtur nga grupi i auditimit, si botim i vitit 2021, por njëkohësisht në Fletë-Hyrjen nr. 3 datë 24.12.2021 listohet si një artikull që ndodhet në ASH me çmim 780 lekë/copë, sasi 150 copë dhe vlerë 117,000 lekë.

-Në databazën e ASHSH mbi veprat e botuara të institucionit është konstatuar se vepra *Shqiptarët në Luftën e Dytë Botërore, vëllimi 2* me autor Paskal Milo ka pasur dy hyrje të ndryshme. Referuar Urdhër-Shpenzimit nr. 685, datë 29.12.2021, janë bërë hyrje 150 copë me kosto/copë 480 lekë, dhe sipas Urdhër Shpenzimit nr. 701, datë 31.12.2021, 150 copë, kosto/copë 780 lekë. Konstatohet se në Fletë-Hyrjen nr. 3 datë 24.12.2021 kjo vepër është shënuar vetëm një herë, me vlerën 480 lekë/copë, ndërkohë që me vlerën e dytë që figuron në Urdhër Shpenzim gjendet vepra “Faik Konica, Jeta dhe Veprat”. Për të njëjtën vepër janë vendosur dy vlera të ndryshme. Kjo vepër jo vetëm që nuk ishte e përfshirë në DST, por ka dhe një mospërputhje të vlerave të saj dhe sasisë së hyrë në institucion, për vlerën **189,000 lekë**, vlerë e cila është shpenzim jo efektiv i buxhetit të shtetit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.6 faqe 144-176 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*



4.1 Rekomandimi: ASH dhe strukturat përkatëse të marrin masa për analizimin e mospërputhjeve që rezultojnë në zbatimin e kontratës së botimeve 2021, si dhe nxjerrjen e përgjegjësisve lidhur me veprimet fiktive.

Menjëherë dhe në vijimësi

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1.1 Gjetje nga auditimi: Për projekte të *Qendrës Kërkimore Nanoteknologjike NanoAlb*, që shtrinë veprimtarinë e vet në *laboratorët e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, laboratorin e Fizikës në Universitetin Politeknik të Tiranës dhe universitete në Kosovë*, referuar të dhënave vendosur në dispozicion rezultojnë se janë 5 projekte, për periudhën 2022-2023 të cilët kanë mbajtur statusin në proces, me vlerë totale të shpenzimeve deri në fund të vitit 2023 prej 9,048,239 lekë.

- Në njërin prej laboratorëve të FSHN (zj. L.V) u konstatua prania e 10 nga 17 materialet e specifikuar në kartelën personale të personit (inventar i imët) që i kishte në ngarkim dhe pjesa tjetër rezultoi se mbahej në ambiente private jashtë ambienteve laboratorike të FSHN (7 me vlerë totale prej **373,200 lekë** referuar kartelës personale vendosur në dispozicion) prej një tjetër personi (informacion ky i padisponuar për sektorin e financës dhe magazinën e ASHSH). *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.3 faqe 35-111 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandimi: Akademia e Shkencave të vlerësojë dhe analizojë vlerën prej **373,200 lekë** e cila rezultojnë e paargumentuar, ku të përcaktohen shkaqet, arsyet, përgjegjësitë ligjore dhe financiare. Të ndiqen të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës nga personat përfitues.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi raportet e dërguara në ASHSH nga ana e ekipit të punës mbi projektin “*Studimi sero-epidemiologjik i Gjendjes imunitare ndaj virusit SARS-CoV-2 në popullatën shqiptare*”, përfunduar të 4 fazat e studimit me kosto totale prej 24,163,492 lekë, u konstatua se:

- për studimin pilot mostrat e analizuar janë ato të marra nga Banka Kombëtare e Transfuzionit të Gjaku, rrjedhimisht kjo sjell mospërputhje mes objektit të kryerjes së studimit për të cilin janë blerë materiale për testimin e gjakut;

- mungon gjurma e kryerjes së përzgjedhjes së personave të kontraktuar me kohë të pjesshme për efekt studimi, ku vlera financiare e akorduar për këtë qëllim rezultojnë në **490,000 lekë**;

- mungon gjurma e dokumentimit të trajnimeve të kryera për çdo infermiere për marrje gjaku në çdo qendër.

Në kushtet e mungesës së dokumentacionit justifikues bazë dhe të domosdoshëm të kryerjes së pagesës nga Akademia e Shkencave drejt stafit mjekësor të përfshirë në projekt, vlera prej 490,000 lekë, përbën dëm ekonomik. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.3 faqe 35-111 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Akademia e Shkencave të vlerësojë dhe analizojë vlerën **490,000 lekë** e cila rezultojnë e paargumentuar, ku të përcaktohen shkaqet, arsyet, përgjegjësitë ligjore dhe financiare. Të ndiqen të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës nga personat përfitues.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i praktikave të pagesave me bankë u konstatuan mangësi në lidhje me dokumentacionin justifikues bashkëlidhur pagesave, konkretisht:



-Pagesa e koordinatorëve të projekteve pa relacionin e punës së kryer (3 koordinator dhe pagesa mujore për të tre dhe periudhën objekt auditimi **1,901,892 lekë**), në kundërshtim me pikën 3 të nenit 5 të kontratave respektive të punës “*Ofertuesi i shërbimit duhet të raportojë për shërbimin e kryer në përfundim të afatit të kontratës*”.

-Pagesa për konsulencë topografike me dokumentacion jo të plotë dhe pa procedurë prokurimi në vlerën **400,000 lekë**.

-Kryerja e pagesave për akomodim në hotel pa specifikuar dhe identifikuar personat e akomoduar. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikat 52-72 të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.4 faqe 112-136 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Akademia e Shkencave të vlerësojë dhe analizojë vlerën **2,301,892 lekë** e cila rezulton e paargumentuar, ku të përcaktohen shkaqet, arsyet, përgjegjësitë ligjore dhe financiare. Të ndiqen të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës nga personat përfitues.

Menjëherë dhe në vijimësi

V. Aneks

Aneks 1: Auditimi i aktiveve të qëndrueshme:

a. Objektivat e auditimit të aktiveve të qëndrueshme, janë që të sigurohemi se:

- *Aktivet ekzistojnë fizikisht;*
- *ato i përkasin subjektit;*
- *janë të vlerësuara në mënyrë korrekte;*
- *janë regjistruar në mënyrë korrekte;*
- *është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve korrente dhe aktiveve të qëndrueshme;*
- *informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe korrekte.*

b. Kontrole të përgjithshme të llogarive dhe dokumenteve:

Për auditimin e aktiveve të qëndrueshme, paraprakisht u kryen një numër kontrollesh të përgjithshme si:

- *U verifikua tabela e lëvizjeve të aktiveve të qëndrueshme në raport me gjendjet dhe ndryshimin e tyre gjatë periudhës ushtrimore;*
- *U ekzaminua tabela e lëvizjeve, nëse ka ndodhura ndonjë variacion anormal mbi aktivet e qëndrueshme;*
- *U ekzaminuan të gjitha shpjegimet që janë paraqitur lidhur me shmangiet dhe përjashtimet e veçanta;*
- *U verifikua nëse parimet kontabël të ndjekura prej subjektit për vlerësimin dhe kontabilizimin janë konform parimeve të përgjithshme të pranuar dhe udhëzimeve përkatëse.*
- *U verifikua nëse shifrat e çeljes rakordojnë me ato të mbylljes së ushtrimit të mëparshëm;*
- *U krahasuan investimet e realizuara gjatë ushtrimit me ato të planifikuara në buxhet, evidentimi kontabël.*

c. Disa nga parimet e zbatuara për auditimin e aktiveve të qëndrueshme:



1. Gjatë hyrjes së aktiveve në pronësinë e subjektit, duhet të sigurohemi se:

- Aktivët e blera kontabilizohen sipas vlerës së tyre të marrjes. (çmimit të blerjes shtuar shpenzimet e tjera të nevojshme për vënien në gjendje përdorimi të pasurisë);
- Aktivët e prodhuara nga subjekti (Nëse ka) kontabilizohen sipas kostos së tyre të prodhimit.
- Aktivët e marra falas kontabilizohen duke i vlerësuar ato me vlerën e shitjes;
- Aktivët e sjella në subjekt nga të tretët nëse kontabilizohen me vlerën e tyre të sjelljes. (UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”).

2. Për inventarin, duhet të sigurohemi që subjekti:

- Procedon për regjistrimin dhe vlerësimin e aktiveve të saj të qëndrueshme sipas rregullave kontabël përgjithësisht të pranuar;
- Përdor referencat ose teknikat më të përshtatshme për natyrën e pasurisë (çmimi i tregut, tabelat e publikuara, treguesit specifikë, etj.);
- Ka ruajtur të njëjtat rregulla vlerësimi nga një inventar në tjetrin.

Vlerësimi nëse aktivi dhe pasivi janë llogaritur drejtë dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse si dhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare.

Përsa i përket rakordimit të pasqyrave financiare për vitin 2021:

- Auditimi për barazimin e vlerës totale të Formatit të Pozicionit Financiar “Pasqyra e Aktiv Pasiv të bilancit kontabël” rezulton se totali i aktiveve është i barabartë me totalin e pasiveve të bilancit kontabël, në shumën 106,694,124 lekë në vitin 2021;

Sa më sipër, nuk u konstatua mospërputhje përsa i përket kësaj llogarie.

- Auditimi i barazisë në vlera të Formatit të Performancës Financiare “Pasqyra e të ardhura shpenzimeve”. Të ardhurat e paraqitura në zërin A të formatit të performancës financiare janë të barabarta me shpenzimet e paraqitura në po këtë format plus Teprica/Deficiti i periudhës nga pikëpamja e shumave, përkatësisht 122,266,059 lekë (120,588,901 - (4,677,158)). Pra, totali në pasqyrën e shpenzimeve nuk është i barabartë me totalin në pasqyrën e të ardhurave të funksionimit për efekt të diferencës së deficitit të periudhës;

- Llogaria 63 “Ndryshim i gjendjeve të inventarit”, evidentuar në Formatin e performancës financiare, për 4,764,450 lekë, rakordon me ndryshimin e gjendjes të magazinës dhe është sa diferenca e klasës 2 “Gjendja e inventarit” në aktivin e bilancit. Pra, (63,443,616-58,679,166) dhe janë të barabarta që të dyja me vlerën prej (4,764,450) lekë.

Sa më sipër, nuk u konstatua mospërputhje përsa i përket kësaj llogarie.

- Auditimi për barazimin e vlerës totale të Formatit të Flukseve Monetare “Burimet dhe shpenzimet lidhur me investimet” kjo pasqyrë jep informacion në lidhje me gjendjen dhe ndryshimet në mjetet monetare apo ekuivalentet e tyre (llogaritë financiare të klasës 5). Në fund, kjo pasqyrë tregon shtimin apo pakësimin e mjeteve monetare të njësisë së qeverisjes së përgjithshme, të shkaktuar nga kryerja e veprimtarive të njësisë gjatë vitit ushtrimor të mbyllur.

Sa më sipër, nuk u konstatua mospërputhje përsa i përket kësaj llogarie.

- Auditimi për barazimin e vlerës totale të Formatit nr.4 “Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto” kjo pasqyrë na jep informacion në lidhje me gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve dhe fondeve neto të njësisë gjatë vitit ushtrimor të mbyllur. Totali i fondeve të vet të kësaj pasqyre duhet të jetë i barabartë me totalin e aktiveve/fondeve neto të evidentuar në rubrikën C të pasqyrës financiare individuale të pozicionit financiar, konkretisht për 102,900,323 lekë.

Sa më sipër, nuk u konstatua mospërputhje përsa i përket kësaj llogarie.



-*Auditimi për barazimin e vlerës totale të **Formatit nr.5** “Shënimet shpjeguese”, japin informacion të përgjithshëm në lidhje me njësinë (emërtimin e njësisë, emërtimin e njësisë eprore, NIPT-in e njësisë, kodin e njësisë, adresën apo dhe një përshkrim të shkurtër të veprimtarisë së tij);*

- informacion shpjegues të përgjithshëm në lidhje me paraqitjen e pasqyrave financiare vjetore (datën e paraqitjes në degën e thesarit, plotësia e këtyre pasqyrave të paraqitura, përfshirja e të gjitha njësive të vartësisë, etj);
- informacion në lidhje me rakordimet financiare ndërmjet zërave të ndryshëm të pasqyrave financiare vjetore të njësisë;
- informacion në lidhje me elementë specifike të pasqyrave financiare të dorëzuara; si dhe
- Informacion në lidhje me problemet e ndryshme që mund të kenë rezultuar gjatë përgatitjes dhe paraqitjes së pasqyrave financiare.

Shënimet shpjeguese japin një përshkrim ose zbërthim të mëtejshëm të zërave të paraqitur në këto pasqyra, si dhe informacion mbi zërat që nuk plotësojnë kriteret për një paraqitje të veçantë në pasqyrat financiare. Në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare, një njësi ekonomike raportuese do të japë informacionin, duke u bazuar në konceptin e materialitetit, dhe zërat jomaterialë mund të paraqiten të grupuar.

Nga auditimi u konstatua se, përgjithësisht plotësimi i këtij formati nga ana e institucionit ishte i plotë.

Sa më sipër, nuk u konstatuan mospërputhje përsa i përket kësaj llogarie.

-*Auditimi për barazimin e vlerës totale të **Formatit nr.6** “Investimet dhe Burimet e financimit”. Balanca mes burimeve për investime dhe shpenzimeve për investime duhet të jetë si rregull më e madhe ose e barabartë me zero, dhe për ASH është 0.*

*Nga auditimi konstatohet se, “Teprica ne mbyllje” **nuk rakordon** me shumën që figuron në postin përkatës të llogarive financiare (520) për ushtrimin e mbyllur në aktiv të bilancit.*

Sa më sipër, u konstatua mospërputhje përsa i përket kësaj llogarie.

-*Auditimi për barazimin e vlerës totale të **Formatit nr. 7/a** dhe **Formatit nr. 7/b** “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme (kosto historike)”, jep informacion të analizuar për gjendjen në fillim të periudhës, ndryshimet (shtesat e pakësimet) gjatë periudhës ushtrimore të mbyllur në aktivet afatgjata (material e jomateriale) me vlerën historike të tyre si dhe gjendjen në fund të periudhës.*

Vlera neto për gjendjen në fillim të periudhës ushtrimore, për shtesat gjatë periudhës ushtrimore, për pakësimet gjatë periudhës ushtrimore dhe për gjendjen në fund të periudhës ushtrimore, është e barabartë me vlerën historike të aktiveve duke i zbritur amortizimin për 44,119,550 lekë (Kosto Historike 72,608,329 lekë – AA 30,991,308 lekë)

Sa më sipër, nuk u konstatuan mospërputhje përsa i përket kësaj llogarie.

-*Auditimi për barazimin e vlerës totale të **Formatit nr.8** “Numri i punonjësve dhe fondi i pagave”, siguron një informacion të saktë mbi numrin e punonjësve, ndryshimet e ndodhura gjatë vitit, fondin e pagave, shpërblimet suplementare dhe shpërblime të tjera, kontributet për Sigurimet Shoqërore dhe Tatimet e të ardhurave personale. Është plotësuar nga burimet njerëzore pjesa për gjendjen në fillim, lëvizjet dhe gjendjen në fund të punonjësve, ndërsa pjesa për fondin e pagave është e plotësuar sipas të dhënave nga pasqyra e shpenzimeve.*

Kjo pasqyrë është e rakorduar me të dhënat e paraqitura në llogarinë 600 të formatit nr.2 Shpenzime të Shfrytëzimit.

Sa më sipër, nuk u konstatua mospërputhje përsa i përket këtyre llogarive.



Mbyllja e bilancit për vitin 2021 në përgjithësi është në përputhje me kërkesat e ligjit nr.9228, datë 29.04.2004 neni 6, me VKM nr. 248, datë 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël” si dhe Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në NjQP”

Veprimet për vitin 2021 janë axhornuar periodikisht, janë kontabilizuar në ditarët, ku llogaritë në përgjithësi janë në pozicionin e duhur dhe në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 neni 6, si dhe UMF nr.14, datë 28.12.2006, UMF nr.26, datë 27.12.2007.

2022

Përsa i përket rakordimit të pasqyrave financiare për vitin 2022:

- *Auditimi për barazimin e vlerës totale të Formatit të Pozicionit Financiar “Pasqyra e Aktiv Pasiv të bilancit kontabël”* rezulton se totali i aktiveve është i barabartë me totalin e pasiveve të bilancit kontabël, në shumën 125,058,856 lekë në vitin 2022;

Sa më sipër, nuk u konstatua mospërputhje përsa i përket kësaj llogarie.

- Auditimi i barazisë në vlera të Formatit të Performancës Financiare “Pasqyra e të ardhura shpenzimeve”. Të ardhurat e paraqitura në zërin A të formatit të performancës financiare janë të barabarta me shpenzimet e paraqitura në po këtë format plus Teprica/Deficiti i periudhës nga pikëpamja e shumave, përkatësisht 145,568,093 lekë (135,560,810 + 10,007,283). Pra, totali në pasqyrën e shpenzimeve nuk është i barabartë me totalin në pasqyrën e të ardhurave të funksionimit për efekt të diferencës së deficitit të periudhës;

- Llogaria 63 “Ndryshim i gjendjeve të inventarit”, evidentuar në Formatin e performancës financiare, për (4,261,021) lekë, rakordon me ndryshimin e gjendjes të magazinës dhe është sa diferenca e klasës 2 “Gjendja e inventarit” në aktivin e bilancit. Pra, (63,443,616-58,679,166) dhe janë të barabarta që të dyja me vlerën prej (4,764,450) lekë.

Sa më sipër, nuk u konstatua mospërputhje përsa i përket kësaj llogarie.

-*Auditimi për barazimin e vlerës totale të Formatit të Flukseve Monetare “Burimet dhe shpenzimet lidhur me investimet”* kjo pasqyrë jep informacion në lidhje me gjendjen dhe ndryshimet në mjetet monetare apo ekuivalentet e tyre (llogaritë financiare të klasës 5). Në fund, kjo pasqyrë tregon shtimin apo pakësimin e mjeteve monetare të njësisë së qeverisjes së përgjithshme, të shkaktuar nga kryerja e veprimtarive të njësisë gjatë vitit ushtrimor të mbyllur.

Sa më sipër, nuk u konstatua mospërputhje përsa i përket kësaj llogarie.

-*Auditimi për barazimin e vlerës totale të Formatit nr.4 “Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto”* kjo pasqyrë na jep informacion në lidhje me gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve dhe fondeve neto të njësisë gjatë vitit ushtrimor të mbyllur. Totali i fondeve të vet të kësaj pasqyre duhet të jetë i barabartë me totalin e aktiveve/fondeve neto të evidentuar në rubrikën C të pasqyrës financiare individuale të pozicionit financiar, konkretisht për 117,381,478 lekë.

Sa më sipër, nuk u konstatua mospërputhje përsa i përket kësaj llogarie.

-*Auditimi për barazimin e vlerës totale të Formatit nr.5 “Shënimet shpjeguese”*, japin informacion të përgjithshëm në lidhje me njësinë (emërtimin e njësisë, emërtimin e njësisë eprore, NIPT-in e njësisë, kodin e njësisë, adresën apo dhe një përshkrim të shkurtër të veprimtarisë së tij);

- informacion shpjegues të përgjithshëm në lidhje me paraqitjen e pasqyrave financiare



vjetore (datën e paraqitjes në degën e thesarit, plotësia e këtyre pasqyrave të paraqitura, përfshirja e të gjitha njësive të vartësisë, etj);

- informacion në lidhje me rakordimet financiare ndërmjet zërave të ndryshëm të pasqyrave financiare vjetore të njësive;
- informacion në lidhje me elementë specifikë të pasqyrave financiare të dorëzuara; si dhe
- informacion në lidhje me problemet e ndryshme që mund të kenë rezultuar gjatë përgatitjes dhe paraqitjes së pasqyrave financiare.

Shënimet shpjeguese japin një përshkrim ose zbërthim të mëtijshëm të zërave të paraqitur në këto pasqyra, si dhe informacion mbi zërat që nuk plotësojnë kriteret për një paraqitje të veçantë në pasqyrat financiare. Në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare, një njësi ekonomike raportuese do të japë informacionin, duke u bazuar në konceptin e materialitetit, dhe zërat jomaterialë mund të paraqiten të grupuar.

Nga auditimi u konstatua se, përgjithësisht plotësimi i këtij formati nga ana e institucionit ishte i plotë.

Sa më sipër, nuk u konstatuan mospërputhje përsa i përket kësaj llogarie.

-*Auditimi për barazimin e vlerës totale të **Formatit nr.6** “Investimet dhe Burimet e financimit”. Balanca mes burimeve për investime dhe shpenzimeve për investime duhet të jetë si rregull më e madhe ose e barabartë me zero, dhe për ASH është 0.*

*Nga auditimi konstatohet se, “Teprica në mbyllje” **nuk rakordon** me shumën që figuron në postin përkatës të llogarive financiare (520) për ushtrimin e mbyllur në aktiv të bilancit.*

Sa më sipër, u konstatua mospërputhje përsa i përket kësaj llogarie.

-*Auditimi për barazimin e vlerës totale të **Formatit nr. 7/a** dhe **Formatit nr. 7/b** “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme (kosto historike)”, jep informacion të analizuar për gjendjen në fillim të periudhës, ndryshimet (shitesat e pakësimet) gjatë periudhës ushtrimore të mbyllur në aktivet afatgjata (material e jomateriale) me vlerën historike të tyre si dhe gjendjen në fund të periudhës.*

*Vlera neto për gjendjen në fillim të periudhës ushtrimore, për shitesat gjatë periudhës ushtrimore, për pakësimet gjatë periudhës ushtrimore dhe për gjendjen në fund të periudhës ushtrimore, **është e barabartë me vlerën historike të aktiveve duke i zbritur amortizimin për 44,119,550 lekë (Kosto Historike 72,608,329 lekë – AA 30,991,308 lekë).***

Nga auditimi u konstatua se, për v.2022 formati 7 “ndryshime në gjendjen e aktiveve” nuk pasqyronte vlerat reale të aktiveve, po ashtu hartimi i tij përmbante pasaktësi të shumta sa i takon vlerave. Në të gjitha rastet e aktiveve u konstatua amortizim mbi shtesa kur vlerë shtese nuk kishte dhe po ashtu u konstatua se, teprica në mbyllje e vitit pararendës nuk rakordonte me tepricën në mbyllje të vitit aktual.

Si rrjedhojë përmes pasqyrave financiare nuk arrihej sigurimi i informacionit të plotë mbi situatën e aktiveve dhe ndryshimet që kishin pësuar përgjatë vitit.

Letrat e punës për llogaritë e shpenzimeve

V.2021

Llogaria 601 “kontribute të sigurimeve shoqërore” për 694,792 lekë, janë shtuar si rrjedhojë e shteses së punonjesve si rrjedhojë e plotësimit të vendeve bosh në organikën e institucionit.



Llogaria 602 “blerje mallra dhe shërbime” shtuar për vlerën 19,736,531 lekë e përbërë nga:

- 6020 Materiale dhe shërbime zyre të përgjithshme për 7,563,210 lekë e cila nga vetë emërtimi paraqet shpenzimet që institucionet kanë kryer për blerje materiale, leter, boje, kancelari etj për kryerjen e aktivitetit të administratës.
- 6021 Materiale dhe shërbime speciale për shumën lekë paraqet shpenzimet e institucioni për botim të librave sipas kontratave specifike dhe blerje dokumentacioni për programe konferencash dhe flete palosje.
- 6022 Shërbime nga të tretë për shumën lekë 4,458,191 lekë paraqet shpenzimet e institucionit për energji, ujë, telefon, posta, shërbim bankar etj.
- 6024 Shpenzime udhëtimi për vlerën 2,166,233 lekë përfaqësojnë, shpenzimet e institucionit për shërbime udhëtimi, akomodimi, brenda dhe jashtë vendit të cilat këtë vit kanë qenë 1,242,294 lekë më shumë se viti i kaluar, për shkak të aktiviteteve madhore që janë zhvilluar si Kongresi “Nano tech” dhe Kongresi i Albanologjisë, në raport me vitin 2020 që ishte pandemi dhe aktivitetet në të shumtën e rasteve zhvilloheshin online.
- 6025 Mirëmbajtje të zakonshme për shumën 1,364,960 lekë janë shpenzimet që janë bërë për mirëmbajtje të ambjenteve si lyerje e riparime në vlerën 1,006,720 lekë dhe pjesa e mbetur 358,240 lekë për riparime paisje zytrash si printere, fotokopje etj
- 6026 Qeramarrje për shumën 8,053,680 lekë janë shpenzimet që janë bërë për qeranë e zyrave ku vlera totale e kontratës së godinës së Topanëve është 6,914,580 lekë, janë shpenzuar 1,021,200 lekë për qera sale për zhvillim kongresesh dhe për qera automjeti me vlerë 117,900 lekë.
- 6029 Shpenzime të tjera Operative për shumën 35,097,585 lekë përfaqëson shpenzime të institucionit për pagesa :
 - Shpenzime pritje e percjellje 7,821,819 lekë;
 - Shpenzime për honorare 27,275,766 lekë.

Viti 2022

Llogaria 602 “blerje mallra dhe shërbime” shtuar për vlerën 79,078,302 lekë e përbërë nga:

- 6020 Materiale dhe shërbime zyre të përgjithshme për 10,994,115 lekë e cila nga vetë emërtimi paraqet shpenzimet që institucionet kanë kryer për blerje materiale, pastrim dezinfektim, për funksionimin e pajisjeve speciale, kitet dhe baza materiale e kërkimit shkencor etj për kryerjen e aktivitetit të administratës.
- 6021 Materiale dhe shërbime speciale për shumën 2,960,760 lekë paraqet shpenzimet e institucioni për botimet monografi dhe ato periodike.
- 6022 Shërbime nga të tretë për shumën lekë 2,984,307 lekë paraqet shpenzimet e institucionit për energji, ujë, telefon, posta, shërbim bankar etj.
- 6024 Shpenzime udhëtimi për vlerën 3,658,918 lekë përfaqësojnë shpenzimet e institucionit për shërbime udhëtimi, akomodimi, brenda dhe jashtë vendit.
- 6025 Mirëmbajtje të zakonshme për shumën 639,407 lekë paraqet shpenzime per mirëmbajtje e sigurim objekti ndërtimor.
- 6026 Qeramarrje për shumën 7,609,286 lekë janë shpenzimet që janë bërë për qeranë e zyrave (qira familjes Toptani)
- 6029 Shpenzime të tjera Operative për shumën 48,727,990 lekë përfaqëson shpenzime të kryera për aktivitet vjetore (konferenca, forume, honorare botimesh, recensa kumtesa, pagesa koordinatorë, pagesa honorare të projekteve etj.)



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËR AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT